



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI**

**PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË DHE AUDITIMIN
FINANCIAR TË SHTËPISË SË FËMIJËVE SHKOLLORË
“ZYBER HALLULLI”**

TIRANË

Shtator 2022

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
	1. Përshkrim i shkurtër i Auditimit	3
	2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
	3. Konkluzioni i Përgjithshëm i Auditimit	14-18
II.	HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit)	18-24
	Titulli & Marrësi	
	Objektivat dhe qëllimi	
	Identifikimi i çështjes	
	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	Përgjegjësitë e audituesve	
	Kriteret e vlerësimit	
	Standardet e auditimit	
	Metodat e auditimit	
	Dokumentimi i rezultateve të auditimit	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	24-202
2	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	24-27
2.1	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit: a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit; b) Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar; c) Realizimi i planit të buxhetit	27-37
2.2	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave	37-45
2.3	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	45-66
2.4	Vlerësimi i raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën 2019-2020-2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në Udhëzimin e MFE nr.08, datë 09.03.2018	66-74
2.5	Mbi zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.9643, dt. 20.11.2016, i ndryshuar, òPër prokurimin publikò, VKM nr.914, dt. 29.12.2014òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar	74-180
2.6	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin	180-185
2.7	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	185-205
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	205-224
V	ANEKSE	225-240



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i auditimit

Në Shqipëri funksionon një rrjet institucionesh të përkujdesit shoqëror (IPSH), të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli”, (SHFSH), për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar me strukturën e miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror dhe Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të SHFSH, Tiranë, miratuar nga SHSSH me nr. 2712/prot, datë 31.12.2015.

SHFSH gjithashtu e ka ushtruar veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin nr. 10347, datë 04.11.2010 për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, VKM nr.231, datë 20.3.2013 për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë, në qendrat publike dhe jo-publike, VKM nr. 425, datë 27.06.2012 për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqërorë i ndryshuar dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në përputhje me konventën e Mbi të drejtën e fëmijës dhe kartën e të drejtave të fëmijëve.

Strategjia e institucionit në arritjen e objektivave bazohet në:

- Respektimin dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore
- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve nëpërmjet kualifikimit të stafit, menaxhimit efektiv, fuqizimit të burimeve materiale dhe financiare
- Dhënien e shërbimeve të personalizuar, duke vlerësuar nevojat e veçanta sociale, shëndetësore, emocionale, kulturore dhe materiale të përfituesve

Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat e miratuara etj. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 381/1, datë 30.04.2022, i ndryshuar me nr. 381/2, datë 07.06.2022.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të objektit kryesor që ky institucion ka pasi puna e tij duhet të bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj fëmijëve.

KLSH në periudhën nga data 20.04.2022 deri në 10.07.2022 për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2019 deri në 31.12.2021, kreu auditimin financiar dhe të Përputhshmërisë në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli”, (SHFSH), me qëllim të një vlerësimi të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit, gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund anekset.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ëZyber Hallulli, në hartimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt ëBlerje mallra ushqimorë të realizuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021, me vlerë totale të fondit limit 3,504,935 lekë pa TVSH nuk ka paraqitur procesverbalin e përlllogaritjes së fondit limit, në të cilën duhet të përfshiheshin elementët (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasitë e kalorive ditore që i duhet çdo fëmije sipas grup moshave), kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ëPër prokurimin Publikë i ndryshuar, dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar neni 59.</p> <p>Gjithashtu, në bazë të auditimit u konstatua se, VKM nr.518 datë 04.09.2018 ëPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë Kreu V si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ëPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të perkujdesit shoqërorë, kanë përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të perkujdesit shoqëror sipas grup moshës, por nuk kanë përcaktuar sasitë e kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës.</p>	92-117	E lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë e varësisë në Shërbimin Social Shtetëror, Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ëZyber Hallulli, të marrin masa, për përmirësimin e VKM nr.518 datë 04.09.2018 ëPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë, duke përcaktuar sasitë e kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës si dhe në bashkëpunim me INSTAT të bëjë përditësimin e ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit nëpërmjet Udhëzimit të Ministrisë të MSHMS, me qëllimsaktësimin e mënyrës së përcaktimit të vlerës ditore të shpenzimeve për secilin fëmijë në</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

				përputhje me nevojat për ushqim.
2	<p>Nga auditimi konstatohet se, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve të masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, <i>oPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore</i>.</p>	28-39	E lartë	<p>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, të marrë masa, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8-mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritsëme deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.</p>
3	<p>Nga analiza e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) konstatohet se subjekti ka përdorur normën 5% për përlllogaritjen e amortizimit vjetor të òMjeteve të Transportit, dhe jo normën 20%, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 <i>oPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>o paragrafi 36.</p>	68-77	E lartë	<p>Të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor të òMjeteve të transportit me normën 20% në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.</p>
4	<p>Nga stafi i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, nuk është zbatuar niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit nr. 689, datë 02.10.2018 <i>oPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime</i>, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore.</p> <p>Ligji 121/2016 në nenin 24 pika 6 përcakton se Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve. Por lidhur me standardet e shërbimeve sociale shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelin e përcaktimit të tarifave, MSHMS nuk ka nxjerrë akte të reja nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.</p> <p>Lidhur me nevojat ditore të fëmijëve për lëndë ushqyese dhe kalori, menjuja ushqimore përgatitet për të gjithë fëmijët e institucionit pa dallim grup- moshe, gjinie ose gjendjeve të veçanta. Në hartimin e menisë nuk merr pjesë ekipi multidisiplinar, në mospërputhje me kërkesat Rregullore të Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shtëpisë së Fëmijës òZyber Hallulli, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, neni òdetyrat funksionale të mjekut, pika 4. Vlera në lekë e përcaktuara për</p>	92-117	E lartë	<p>4.1. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë të marrë masa të menjëhershme që hartimi i menisë ditore të fëmijëve të kryhet nga ekipi multidisiplinar dhe të udhëhiqet nga standardet në fuqi të ushqyerjes, referuar grup moshës së fëmijëve, llojit të produktit ushqimor për konsum, normës ditore, vlerës në k/kalori, dhe në fund vlerësimi në vlerë duke respektuar kuotën ditore të miratuar nga MSHMS.</p> <p>4.2 Lidhur me zbatimin e standardeve të kërkuara për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

<p>kuotën ditore për fëmijët nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore që duhet të konsumojnë fëmijët, për shkak të mos respektimit të saj nga institucioni, si dhe mos indeksimit të kuotës ushqimore sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT.</p> <p>Për pasojë vlerat e kuotës së ushqyerjes në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021, për muajt e përzgjedhur për auditim, kanë qenë më të ulëta se kuota e miratuar, kjo e fundit përgjegjësi drejtpërdrejt e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar, duke qëndruar në vlera të njëjta të kostos ditore për çdo grup moshë të fëmijëve, prej vitit 2018, në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë Kreu V, pika 71 dhe Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorë, ndonëse përgjatë këtyre viteve ka inflacion të madh dhe rritje çmimesh në produktet ushqimore bazë, si pasojë e situatës së Covid-19 dhe situatave globale.</p> <p>Kështu, nisur nga të dhënat e INSTAT në faqen zyrtare, në lidhje me ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, për grupin e Ushqime dhe pije alkoolike, nga grupi i auditimit u përlllogaritën se sa duhet të ishin ndryshuar këto kuota çdo vit, për koston ditore për secilin grup moshë, duke konstatuar se:</p> <p>Për grup moshën 6-12 vjeç, nga 440 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 487,35 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 47 lekë/ditë.</p> <p>Për grup moshën 13-15 vjeç, nga 480 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 531,66 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 52 lekë/ditë.</p> <p>Për grup moshën 16-18 vjeç, nga 500 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 553,81 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 54 lekë në ditë.</p> <p>Sa më sipër, mos përditësimi i ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit nga institucioni i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, ka ndikuar drejtpërdrejtë në llogaritjen e fondit limit, vlerë e cila nuk jep garanci të jetë përlllogaritur saktë dhe në përputhje me nevojat ditore fëmijëve për ushqim duke shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore për secilin grup moshë për fëmijë.</p>			<p>fëmijëve, deri në përmirësimin e kuadrit rregullator nga MSHMS, ekipi multidisiplinar i Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, duhet të udhëhiqet nga Manuali <i>ëBazat e ushqyerjes, ushqyerja e gruas shtatzënë, ushqyerja e fëmijës</i> modul i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë ne vitin 2011, në bashkëpunim me rekomandimet e UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët), OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe FAO, (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë).</p> <p>4.3. Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për trajnimin e stafit të Shtëpisë së Fëmijëve Zyber Hallulli Tiranë (ekipit multidisiplinar), mbi njohjen dhe zbatimin e Manualit mbi bazat e Ushqyerjes deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p>	
5	Nga auditimi i realizimit të procedurave tenderuese u konstatua se, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ëZyber Hallulli ë në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka mungesë të njohurive ligjore/ nënligjore nga ana e personelit të angazhuar në prokurime publike si dhe mos	79-185	E lartë	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

<p>ndjekjes së trajnimeve që organizon APP mbi prokurimet publike, për pasojë janë evidentuar mangësi dhe problematika, si vijon:</p> <p>Nga Titullari i AK janë vendosur persona të njëjtë në komisionet e hartimit të fondit limit, në njësinë e prokurimit, në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe në vendosjen e emrit të njëjtë të personit, për ndjekjen e ecurisë së kontratës, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 për prokurimin Publikë i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, neni 58 dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollinë i ndryshuar.</p> <p>Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë Zyber Hallulli, për tre vitet në auditim 2019, 2020 dhe 2021, ka realizuar tre procedura të Blerje Ushqimesh për fëmijët në Shtëpinë e fëmijëve shkollorë, Tiranë në negociim pa shpallje me vlerë të fondit limit 3,504,935 lekë pa TVSH ose në vlerë kontrate 3,936,834 lekë me TVSH, për shkak të mos realizimit në kohë nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) si dhe 3 procedura për vitin 2020 të Shërbimit roje civile në Shtëpinë e fëmijëve shkollorë, Tiranë me vlerë të fondit limit 2,488,402,13 lekë pa TVSH, për shkak të mos realizimit në kohë nga O.Gësh.a. Kështu realizimi i tyre, rezultoi me mangësi të cilësisë së hartimit të Dokumenteve Standarde (DST), të cilësisë për llogaritjen e fondit limit, të cilësisë për hartimin e kontratave, deri në përzgjedhjen e operatorit fitues.</p> <p>Nga auditimi i procedurave të Negocimit pa shpallje referuar DST shtojcës 1 (Formulari i ftesës për pjesëmarrje), nga njësia e prokurimit i është dërguar ftesë për ofertë 3 operatorëve ekonomik, por nuk rezultoi arsyetimi mbi përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar neni 35, pika 4, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 për përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike në pika 6 paragrafi 2.</p> <p>Në lidhje me procedurën me objekt të Shërbimit roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. 61.prot, datë 09.04.2020, u konstatua se të gjithë urdhrat e miratuara nga titullari i AK, kanë një numër të ndryshëm protokolli, specifikisht, urdhri për ngritjen e KVO, Grupit për llogaritjen e fondit limit, si dhe urdhri i prokurimit, nuk mban të njëjtin numër protokolli në seri, në kundërshtim me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.</p> <p>Në lidhje me procedurën me objekt të Shërbimit roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. 61.prot, datë 09.04.2020 dhe procedurën me objekt të Shërbimit roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, sipas Urdhër Prokurimi nr.17,</p>		<p>Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë Zyber Hallulli, në cilësinë e institucioneve të varësisë, të marrë masa për personat të cilët do të angazhohen në realizimin, monitorimin e procedurave të prokurimeve publike, për trajnimin e tyre të vazhdueshëm pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për të marrë përgjegjësinë dhe detyrat, për realizimin e hartimit të kërkesave dhe kritereve në përzgjedhjen e operatorit fitues konform kuadrit ligjor dhe rregullator të procedurave tenderuese, për ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke synuar forcimin e kontrollit të brendshëm, për të mirë menaxhuar fondet buxhetore.</p>
---	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>datë 30.09.2020 me fond limit prej 306.666,4 lekë pa TVSH u konstatua se, nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.</p> <p>Nga auditimi i procedurave tenderuese për periudhën 2019-2021, Titullari i AK ka miratuar procedurat e prokurimit pa paraqitjen dhe përpilimin e Raportit Përmbledhës nga KVO, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.</p> <p>Mungon gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit në mënyrë të vazhdueshme, mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe si pasojë nuk është hartuar raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, si dhe nuk janë referuar problemet e hasura gjatë zbatimit me qëllim marrjen e masave për zgjidhjen e tyre. Në përfundim të kontratës nuk është mundësuar as dërgimi i një kopje të këtij raporti APP-së, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914/2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe 4.</p>			
6	<p>Nga auditimi i procedurave për prokurim me objekt ÷Blerje Ushqimesh për periudhën 2019-2021, u konstatua se, nga AK Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallullio, sipasprocesverbaleve të paraqitura për përllogaritjen e fondit limit nga grupet për hartimin e fondit limit, nuk kanë paraqitur argumentimin e vlerave përkatëse si dhe nuk e kanë detajuar, duke e ndarë specifikisht në elementë si (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasitë e kalorive ditore që i duhet çdo fëmije sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 -Për prokurimin Publiko i ndryshuar, neni 28, VKM nr.914 datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar neni 59:</p> <p>(a) Nga auditimi i procedurës së prokurimit ÷Blerje Ushqimesh për fëmijët me Urdhër Prokurimi nr.3 prot 119/1 datë 11.04.2019, me fond limit në vlerën prej 1,070,000 lekë pa TVSH u konstatua se, numri i fëmijëve rezultoi 41 fëmijë (llogaritur me metodën e ponderimit, mesatarizimin për 30 ditë), ku shpenzimi mujor për 41 fëmijë është (1,070,000/3muaj = 356,667 lekë/ në muaj) si dhe shpenzimi ditor për fëmijët (356,667 lekë/muaj/30 ditë= 11,889 lekë/ditë për 41 fëmijë).</p> <p>Ndërsa, në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 -Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëroro, duke u nisur nga grup moshat 6-18 vjeç, shpenzimet ditore janë në vlerën prej 473 lekë/ditë x41 fëmijë =19,393 lekë/në ditë.</p> <p>Sa më sipër, përllogaritja e fondit limit kosto ditore për 41 fëmijë është 11,889 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 19,393 lekë, pra me një diferencë prej 7,504 lekë/ditë për 41 fëmijë, ose e thënë ndryshe 183 lekë më pak për secilin fëmijëo, përgjegjësi e</p>	92-117	E lartë	Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa për ngritjen një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet për nxjerrjen e përgjegjësisë, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përllogaritjen e fondit limit për produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efencë të fondeve buxhetore, në plotësimin e nevojave ushqimore për fëmijët sipas standardeve kohore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>grupit të hartimit të fondit limit.</p> <p>(b) Nga auditimi i procedurës òBlerje artikuj ushqimorë për fëmijë me Urdhër Prokuriminr. I prot 282 datë 11.01.2021, me fond limit në vlerën prej 1,640,000 lekë pa TVSH, u konstatua se, numri i fëmijëve rezultoi 39 fëmijë (llogaritur me metodën e ponderimit, mesatarizimin për 31 ditë), ku shpenzimi mujor për 39 fëmijë është (1,640,005.27 /6 muaj = 273,334 lekë/ në muaj)</p> <p>si dhe shpenzimi ditor për fëmijët (273,334 lekë/muaj/30 ditë= 9111 lekë/ditë për 39 fëmijë), kjo sipas proces verbalit të datës 11.01.2021.</p> <p>Ndërsa, në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorë, duke u nisur nga grup moshat 6-15 vjeç, shpenzimet ditore janë në vlerën prej 460 lekë/ditë x 39 fëmijë =17,940 lekë/në ditë.</p> <p>Sa më sipër, përlllogaritja e fondit limit kosto ditore për 39 fëmijë është 9,111 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 17,940 lekë/në ditë, pra me një diferencë prej 8,829 lekë/ditë për 39 fëmijë, ose e thënë ndryshe 226 lekë më pak për secilin fëmijë, kjo në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorë, përgjegjësi e grupit të hartimit të fondit limit me përbërje (A.H, S.H e F.A).</p> <p>Sa më sipër, për vitin buxhetor 2019 dhe vitin 2021, mënyra e përlllogaritjes së fondit limit nga AK nuk është e saktë dhe si rrjedhim, janë shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore ose e thënë ndryshe 409 lekë më pak të vlerës ditore për secilin fëmijë, duke cenuar detyrimin bazë të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, mbi përkujdesin, respektin dhe përkushtimin ndaj fëmijëve, në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò.</p>			
7	<p>Nga auditimi u konstatua se, në hartimin e kontratave të prokurimeve, nga AK¹, nuk janë parashikuar si detyrime kontraktore për OE-të, disa elemente të rëndësishëm që i shërbejnë forcimit të kontrolleve, konkretisht:</p> <p>-Identifikimi qartësisht i llojit të mjeteve ATV me targat respektive si dhe paraqitja e akteve administrative në lidhje me cilësinë ushqimore, në emër të operatorit ekonomik fitues, mungesa e të cilave, ka mundësuar ekzekutimin e</p>	92-117	E lartë	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò, në cilësinë e autoritetit kontraktor, të marrë masa që strukturat përgjegjëse tenderuese, të caktojnë kriteret e veçanta, për hartimin

¹1. Procedura me objekt “Blerje ushqimesh për institucionin “Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë” realizuar në prill të vitit 2019, lidhur Kontrata nr. 119/9, date 24.04.2019.

2.Procedura me objekt “Blerje ushqimor- vezë, mishi dhe nënproduktet e tij” realizuar në gusht të vitit 2020

3.Procedura me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë” realizuar janar të vitit 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>kontratës nga palë të treta (dhe jo nga OE fitues), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 75 pika 1, pasi në DT nuk është parashikuar nënkontraktimi si opsion.</p> <p>-Gjithashtu, rezultoi se, certifikatat shëndetësore veterinarë, lëshuar nga institucionet përkatëse, ose raport analizat e kryera nga AKU, janë paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të ndryshëm nga ata që kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese. Personat fizikë nuk figurojnë në listë pagesat e OE-së fituese, duke krijuar një situatë të paqartë se mbi çò bazë Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò ka lejuar përfshirjen në zbatimin e kontratës (pra ofrimin e ushqimeve) të disa personave òtë pa përfshirëò më parë në asnjë prej procedurave të ndjekura për prokurimin e mallit në fjalë (Ushqime). Për më tepër që, sipas DST opsioni i nënkontraktimit nuk është i lejuar. Gjithë sa më sipër vë në diskutim cilësinë e ekzekutimit të kontratës.</p>			<p>e kontratave me objekt furnizimin me produkte ushqimore, në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, për të siguruar forcimin e kontrolleve në të gjitha hallkat, me qëllim shmangien e risqeve për abuzime në sigurinë ushqimore dhe përfitimin e mallrave sipas cilësisë së kërkuar.</p>
8	<p>Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, me objekt furnizimin me produkte ushqimore, u konstatua, si më poshtë vijon:</p> <p>1.1 Në faturat e thjeshta të shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues, për çdo furnizim me produkte ushqimore të freskëta, kanë munguar kritere që lidhen me specifikimin e llojit të makinave apo targa të tyre, të cilat janë të ndryshëm nga kriteret e veçanta të kualifikimit në DT., Këto veprime kanë sjellë që komisionet e pritjes së mallit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò, kanë pranuar dërgesat e produkteve ushqimore nga palë të treta, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 75 pika 1, pasi në DT. nuk është i lejuar nënkontraktimi.</p> <p>1.2 Certifikatat shëndetësore veterinarë dhe/ose raport analizat e kryera nga AKU, nuk janë paraqitur në emër të operatorit ekonomik fitues, sikundër përcaktohen në kritereve të veçanta të kualifikimit në DT., të plotësuara nga fituesi në tender, por janë të paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese.</p> <p>1.3 Për rastet e konstatuara, nuk është paraqitur fatura tatimore e blerjes së mallrave për të verifikuar nëse produkti është blerë nga të tretët.</p> <p>1.4 Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas.</p> <p>Sa më sipër, në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò rezultuan: (i) kontrolle të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave; (ii) mosparashikimi si detyrime kontraktore për OE-të, të elementeve, llojin e automjeteve me targa, certifikatat ushqimore, kushtet e transportit me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore; (iii) komisionet në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò të miratuara në fillim viti buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi</p>	92-117	E lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje me monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, economicitet dhe eficientë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në disfavor të Buxhetit të Shtetit.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallra nga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrur);</p> <p>Pra në total nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallulli, vlera 3,936,834 lekë është paguar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö i ndryshuar, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö pika 35 dhe 36, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik ö, i ndryshuar, neni 59, 60, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö i ndryshuar, neni 75 pika 1 dhe neni 77, me Kontratë pika V (Afati i zbatimit) pika 5.</p>			
9	<p>Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, konstatohet se:</p> <p>-Në 3 rastet e procedurave ÷Blerje Ushqime ö, të llojit ÷Negocim pa shpallje paraprake të njoftimitö, të kryera nga SHFSH përkatësisht për vitet 2019, 2020, 2021, Procedura me objekt ÷Blerje ushqimesh për institucionin ÷Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranëö realizuar në prill të vitit 2019, lidhur Kontrata nr. 119/9, datë 24.04.2019;Procedura me objekt ÷Blerje ushqimor- vezë, mishi dhe nënproduktet e tijö realizuar në gusht të vitit 2020; Procedura me objekt ÷Blerje e artikujve ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorëö realizuar janar të vitit 2021, lidhur kontrata me nr. 281/3 prot, datë 18.01.2021 nga Njësia e Prokurimit, rezulton se nuk është justifikuar përzgjedhja e të njëjtëve operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në shkelje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar. Po kështu, në DST, nuk rezulton të jetë përcaktuar grafiku i lëvrimin, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar.</p> <p>2- Në të 3 procedurat e prokurimit, nga NJP është lënë një afat shumë i shkurtër në sjelljen e ofertave nga OE të ftuar për pjesëmarrje në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ÷Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö duke krijuar hapësira dhe dyshime për paracaktim të OE fitues dhe një proces konkurrimi jo transparent.</p> <p>Në DST, në rubrikën ÷Kriteret e veçanta të kualifikimitö është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për çdo mjet motorik (ATV) dhe për ambientin që e përdor për kryerjen e aktivitetit, duhet të paraqesë akt miratimin higjeno ósanitar (AMHS) të miratuar nga institucionet shtetërore, por pa e specifikuar se nga cili institucion duhej të lëshohet ky akt, si dhe nuk është vendosur vlefshmëria në kohë e aktit administrativ.</p> <p>Nisur nga sa më sipër, KVO-të kanë kualifikuar OE-të, të cilët kanë paraqitur aktet administrative AMHS të lëshuara nga Ministria</p>	92-117	E lartë	<p>1-Ministria e Shëndetësisë si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, në cilësinë e institucionit të varësisë, të marrin masa, për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësi, në lidhje me mangësitë e konstatuara në kontratat me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.</p> <p>2- Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në të gjitha procedurat hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) Dega Rajonale/Qarku përkatës, referuar ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 për inspektimin sanitarë i ndryshuar, neni 12. Aktet janë të lëshuara disa vite përpara, pra jo në koherencë me realizimin e procedurës dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, <u>duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës</u>.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se, ligji i mësipërm ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, konkretisht, ndryshimi i fundit është me ligjin nr.54/2020 datë 30.04.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 për inspektim sanitarë, duke shfuqizuar neni 12. Për rrjedhojë, mbas kësaj datë (30.04.2020) KVO nuk duhet të pranonte AMHS, i cili tashmë është i panevojshëm dhe i kundërligjshëm, me aktet nënligjore të mësipërme.</p> <p>Në këto raste OE-të fitues nuk e kanë plotësuar kriterin e mësipërm dhe shpallja e tyre fitues nga KVO-të, është bërë në mospërputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar neni 66 dhe me DST për rrjedhojë, vlera prej 3,936,834 lekë, përbën shpenzim, pa ekonomikitet, pa eficientë dhe pa efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.</p>			konstatohet jo korrekt.
10	<p>Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, të procedurës me objekt ÷ Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr.61/prot, datë 09.04.2020, rezultoi se: grupi për hartimin e fondit limit nuk ka kryer saktë llogaritjen e tij në një vlerë prej 951,91 lekë më pak, fakt ky që nuk është konstatuar nga KVO e ngritur sipas Urdhrit nr. 24, prot. Nr.60, datë 09.04.2020, me përbërje (B. G, K. L e X F). Grupi i punës ka përllogaritur vlerën e fondit limit 310,825.6 lekë ndërkohë që kjo vlerë duhet të ishte 311,777.51 lekë, fakt ky që shoqërohet edhe me një ofertë ekonomike e paraqitur më e vogël nga OE ÷ N. S. ÷ e cila ka ardhur po si pasojë e përllogaritjes gabim të kostos ditore/roje dhe konkretisht në llogaritjen e shtesës së vështirësisë së pagës për roje për turnin e II, të cilën nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por e ka pjesëtuar me një koeficient më të lartë me 4,98 roje, ose me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të kostos së vështirësisë duke e ulur atë, duke e paraqitur në këtë formë</p> <p>1. OE 1x3 x 224.13 x 20%: 4.98=27 lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.</p> <p>Grupi i auditimit: 1x3 x 224.13 x 20%: 3,32= 40, 5 lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.</p> <p>2.OE Paga bazë lekë /roje/ditë 1278,68+27 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,305.68 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.</p> <p>Grupi i auditimit: Paga bazë lekë /roje/ditë 1278,68+40,5 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,319.18 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore =</p>	125-152	E lartë	Nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të ngrihet një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësi, në lidhje me mangësitë e konstatuara në për llogaritjen e fondit limit për shërbim roje civile, si dhe për mos konstatim të KVO të një oferte jo të saktë të paraqitur nga OE fitues, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

<p>220,30 lekë/roje/ ditë.</p> <p>3.OE Paga ditore = 1,305.68 +218,04= 1523.72 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,058.75 lekë për një vëndroje/ditë.</p> <p>Grupi i auditimit: Paga ditore = 1,319.18 +220,30= 1539,48 lekë roje/ditë *3,32= 5,111.07/lekëpër një vëndroje/ditë.</p> <p>4. OE/Kosto 61 ditë 5,058.75*61=308,583.77 + 20% tvsh= 370,300.50 lekë.</p> <p>Grupi i auditimit: 5,111.07*61=311,775.49+20%*311,775.49 =311,775.49 +62,355.09= 374,130.58 lekë pra 3830,08 lekë më pak llogaritur nga OE.</p> <p>Kjo nuk është eficientë pasi jo çdo vlerë më e ulët do të thotë menaxhim me eficientë, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit sepse subjekti paguan më pak sigurime shoqërore e shëndetësore në muaj,në kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë si dhe ka shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 òPër procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.</p> <p>Ky gabim nuk është konstatuar në vijimësi nga KVO pasi në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 58, duke kualifikuar në mënyrë të padrejtë një ofertë të llogaritur gabim të cilat sjellin kosto në pagesa të gabuara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo individ të deklaruar në liste pagesë. Sa më sipër, KVO e krijuar me anëtarë të cilët nuk janë specialistë të fushës ka çuar në një vendim jo të drejtë sepse në parim është pranuar një ofertë ekonomike (e vetmja e paraqitur) pa u analizuar por thjesht pse është me e ulët se fondi limit, ndërkohë nisur nga tipologjia dhe standardi i miratuar mbi mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, për procedurat e prokurimit me objekt òShërbim roje civile ò, koeficientët e marrë për bazë llogaritje janë të mirëpërcaktuar dhe rrjedhimisht oferta ekonomike nuk ka sens të jetë shumë me e vogël se fondi limit. Pikërisht nisur nga ky fakt, duhet që KVO-ja të kontrollonte, përlllogaritjen e ofertës fituese si dhe të arsyetonte, pse OE paraqitet shumë ulët në vlerë krahasuar me fondin limit.</p> <p>Këto risqe shtohen edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura, i cili nga auditimi rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mos njohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 55, pika 3 dhe sjellin një përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficientë të fondeve të buxhetit të shtetit në</p>			
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	vlerën 310,825.6 lekë .			
11	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit të llojit òmarrëveshje kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me një afat 12 muaj, òShërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, sipas Urdhrit të Prokurimi nr. 189/3 datë 18.09.2020, me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, grupi i punës i ngritur për përlogaritjen e fondi limit ka përcaktuar vlerën prej 1,870,910.13 lekë pa TVSH dhe një vlerë prej 46,950.46 lekë/roje/muaj. Në këtë procedurë kanë paraqitur ofertë 13 ofertues ku 12 prej tyre kanë dhënë të njëjtën ofertë mujore prej një vendroje në muaj në vlerën 46,950.46 lekë/roje/muaj dhe vetëm OE òS. Sò ka dhënë vlerën prej 46,939.94 lekë/roje/muaj ose 10,52 lekë më pak dhe si rrjedhim është shpallur fitues për vlerën më të ulët. Por KVO nuk ka vlerësuar saktë këtë ofertë pasi në të njëjtën mënyrë llogaritje vepron edhe OE "S.S", por ai nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje pasi diferenca për të cilën ai është shpallur fitues është vetëm 10,52 lekë më pak në kosto mujore dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes me të njëjtin standard matematikor, dhe konkretisht:</p>	138-152	E lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa në ngritjen e një grupi pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme dhe të pakushtëzuara, për rritjen e efijencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.</p>
12	<p>Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë vitit 2020 për tre procedurat òShërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, përkatësisht</p> <p>1-me fond limit në vlerën 310,825.6 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata me nr. 65, datë 23.04. 2020, ndërmjet SHFSH me òN. Sò, me Nipt xx.</p> <p>2-me fond limit 306,666,4 lekë pa TVSH është lidhur kontrata ndërmjet òN. Sò me NIPT xx dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr, prot 217, datë 09.10.2020.</p> <p>3- me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata ndërmjet òS. Sò me Nipt: xx dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr, prot 247, datë 16.11.2020, u konstatua se:</p> <p>1-Në asnjë nga faturat e sjella nga OE fitues nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat subjekti, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura janë pranuar nga sektori administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 12, pika3/dh dhe e.</p> <p>2- U konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listë pagesat përkatëse të muajve përkatës</p>	125-152	E lartë	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt òShërbim roje civile, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efijencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në disfavor të Buxhetit të Shtetit.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

<p>punonjësit që kryenin shërbimin e rojës, pasi nga verifikimi i listë pagesave të paraqitura nga OE fitues, për muajt janar ómars 2020, kishte mospërputhshmëri në emrat e deklaruar krahasuar me proces verbalet, duke rrisur zbatimin korrekt të kontratës.</p> <p>Grupi i auditimit, vlerëson se, listë pagesat e muajve koherente për të cilët kryhet shërbimi i rojës duhet të ishin pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbimi për të siguruar zbatimin e kontratës me efencë, veprime këto në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 4 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar,</p> <p>3- Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që vlera prej 3,154,550.22 lekë për Shërbim roje civile në Shtëpinë e Fëmijëve shkollorë Tiranë, është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efencë.</p>			
--	--	--	--

2. OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinion mbi pasqyrat financiare (i pakualifikuar)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të subjektit Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dheshënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar deri në datën 31.12.2021 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar”.

Baza për opinionin:

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli” Tiranë, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ~~2~~ Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ISSAI 1700², 2000 dhe ISSAI 4000³.

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIös), Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P

²ISSAI 1700- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.



10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar.

Në gjykimin profesional të audituesve, grupi i punës ka marrë në konsideratë prapenjë dhe materialitetin për vitin 2021 prej 2% (në vlerën 704,480 lekë) për shpenzimet për të konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

b. Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i kualifikuar)⁴

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallullio Tiranë për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallullio Tiranë.

Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, efektet e të cilave janë *materiale por jo të përhapura*, të cilave justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallullio Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale po jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe INTOSAI P 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, të cilat përmenden në ISSAI-n 4000 Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar të**

⁴-Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, dhe MAP të KLSH-së kapitulli VII, pika 7.3.3:Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.



auditimit⁵.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Nga auditimi u konstatua se, VKM nr.518 datë 04.09.2018 oPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë Kreu V dhe Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 oPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorë, kanë përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror sipas grup moshës, **por nuk kanë përcaktuar** sasinë e kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës, duke ndikuar negativisht në sasinë ushqimore dhe kaloritë që duhet të ushqehet një fëmijë. Gjithashtu si pasojë e mos indeksimit të çmimeve prej vitit 2018, përgjegjësi kjo e MSHMS, niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar, duke qëndruar kosto ditore të njëjta për çdo grup moshe të fëmijëve, prej vitit 2018 e në vazhdim, ndonëse përgjatë këtyre viteve ka inflacion të madh dhe rritje çmimesh në produktet ushqimore bazë, si pasojë e situatës së Covid-19 dhe situatave globale.

Kështu, nisur nga të dhënat e INSTAT në faqen zyrtare, në lidhje me **ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit**, nëngrupi Ushqime dhe pije alkoolike nga grupi i auditimit u përlogaritën se si duhet të ishin ndryshuar këto kuota çdo vit, për koston ditore për secilën grup moshë, duke konstatuar se:

Për grup moshën 6-12 vjeç, nga 440 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 487,35 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 47 lekë/ditë.

Për grup moshën 13-15 vjeç, nga 480 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 531,66 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 52 lekë/ditë.

Për grup moshën 16-18 vjeç, nga 500 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 553,81 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 54 lekë në ditë.

Kjo mospërputhje tregon se nga stafi i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, **nuk është zbatuar niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve**, duke sjellë njëkohësisht llogaritje të gabuara të vlerës së fondit limit të audituar në 3 procedurat e prokurimit me objekt oBlerje mallra ushqimorë të realizuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021, me vlerë totale të fondit limit 3,504,935 lekë. Për pasojë vlerat e kuotës së ushqyerjes në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021, për muajt e përzgjedhur për auditim, kanë qenë më të ulëta se kuota e miratuar, kjo e fundit përgjegjësi drejtpërdrejt e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e MSHMS.

- Njësia shpenzuese përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019, 2020 dhe 2021, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për aktivet gjendje në magazine, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël.

- Stafi përkatës i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë nuk ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete nga ofruet të akredituar, pasi nuk është ofruar asnjë i tillë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioni përgjegjës.

-Stafi i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, për periudhën në auditim ka pësuar largime të njëpasnjëshme të punonjësve të cilët kanë braktisur punën pa lajmëruar në kundërshtim me dispozitat e kontratës individuale të punës që lidhet ndërmjet SHSSH dhe punonjësve të saj dhe nga Shërbimi Social Shtetëror nuk është iniciuar asnjë masë disiplinore, duke sjellë

⁵*ISSAI 1500– Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij. Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

mungesë të vazhdueshme të burimeve njerëzore dhe përdorim të tyre pa efikasitet, me ndikim të drejtpërdrejt në edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve.

- Nga auditimi i realizimit të procedurave të prokurimit u konstatua se Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka mungesë të njohurive ligjore/ nënligjore nga ana e personelit të angazhuar në prokurime publike si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP mbi prokurimet publike, për pasojë janë evidentuar mangësi dhe problematika, si vijon:

- Nga Titullari i AK janë vendosur persona të njëjtë në komisionet e hartimit të fondit limit, në njësinë e prokurimit, në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe në vendosjen e emrit të njëjtë të personit, për ndjekjen e ecurisë së kontratës.

- Në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” rezultuan:

(i) kontrole të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave;

(ii) mosparashikimi si detyrime kontraktore për OE-të, të elementëve, llojin e automjeteve me targa, certifikatat ushqimore, kushtet e transportit me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore;

(iii) komisionet në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” të miratuara në fillim të vitit buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallranga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrur);

iv) rezultoi se, certifikatat shëndetësore veterinarë, lëshuar nga institucionet përkatëse, ose raport analizat e kryera nga AKU, janë paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të ndryshëm nga ata që kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese. Personat fizikë nuk figurojnë në listë pagesat e OE-së fituese, duke krijuar një situatë të paqartë se mbi çfarë bazë Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” ka lejuar përfshirjen në zbatimin e kontratës (pra ofrimin e ushqimeve) të disa personave tjetër pa përfshirë më parë në asnjë prej procedurave të ndjekura për prokurimin e mallit në fjalë (Ushqime). Për më tepër që, sipas DST opsioni i nën kontraktimit nuk është i lejuar. Gjithë sa më sipër vë në diskutim cilësinë e ekzekutimit të kontratave të lidhura mbi prokurimet e kryera për “Zyber Hallulli” Ushqimesh.

Për sa më sipërshpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën **3,936,834 lekë**, për 3 procedurat e prokurimit “Zyber Hallulli” produkte ushqimore për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë për periudhën 2019-2020-2021, si rezultat i mospërputhshmërive të konstatuara në kontratat e furnizimit, mënyrës së gabuar dhe të paargumentuar të përllogaritjes së fondit limit nga AK në shpenzimin më pak lekë të vlerës ditore ose e thënë ndryshe 409 lekë më pak të vlerës ditore për ushqyerje për secilin fëmijë, duke cenuar detyrimin bazë të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, mbi përkujdesjen, respektin dhe përkushtimin ndaj fëmijëve, përgjegjësi e grupeve të hartimit të fondit limit.

- Shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën **3,154,550.22 lekë** si rezultat i mospërputhshmërive të konstatuara në kontratat e shërbimit për 3 prokurimet e kryera nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë me objekt “Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë”, në vitin 2020, mospërputhshmëri në kryerjen e procedurave të prokurimit, në përzgjedhjen e OE fitues nga KVO në po këto procedura si dhe në përllogaritjen gabim të vlerës së fondit limit për këtë shërbim.

-Vlera në total e shpenzimeve të kryera pa efikasitet, ekonomikitet dhe efikasitet, nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli” Tiranë është 7,091,384.22 lekë

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), dhe që gabimet apo parregullsitë e vërejtura, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura.

Objektivi ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, kanë aplikuar gjykimin dhe skepticismin profesional në punën.

II. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funkcionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 381/1, datë 30.04.2022, i ndryshuar me nr. 381/2, datë 07.06.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 20.04.2022 deri në 10.07.2022, u krye auditimi òFinanciar dhe i Përputhshmërisë në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, òZyber Hallullio, (SHFSH) nga:

Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.E. Ll, Përgjegjës Grupi
- 2.E. K, Auditues
- 3.F. Xh, Auditues
- 4.K. A, Auditues
- 5.A. V, Auditues

1) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i këtij auditimi ka për qëllim kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim të një vlerësimi i përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm që siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat. Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura për periudhën 2019-2021).

Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj..

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

2. Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, oZyber Hallulliö, (SHFSH)

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime. Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogari dhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

3. Identifikimi i çështjes:

1. Në Shqipëri funksionon një rrjet institucionesh të përkujdesit shoqëror (IPSH), të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, oZyber Hallulliö, (SHFSH), për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar me strukturën e miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, oPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror dhe Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të SHFSH, Tiranë, miratuar nga SHSSH me nr. 2712/prot, datë 31.12.2015. Gjithashtu SHFSH e ka ushtruar veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin nr. 121/2016 oPër shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin nr. 10347, datë 04.11.2010 oPër mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, VKM nr.231, datë 20.3.2013 oPër standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë, në qendrat publike dhe jo-publike, VKM nr. 425, datë 27.06.2012 oPër përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror i ndryshuar dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në përputhje me konventën oMbi të drejtën e fëmijës dhe kartën e të drejtave të fëmijëve.

- Respektimin dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore

- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve nëpërmjet kualifikimit të stafit, menaxhimit



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

efektiv, fuqizimit të burimeve materiale dhe financiare

- Dhënien e shërbimeve të personalizuar, duke vlerësuar nevojat e veçanta sociale, shëndetësore, emocionale, kulturore dhe materiale të përfituesve

-Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat e miratuara etj.. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 381/1, datë 30.04.2022, i ndryshuar me nr. 381/2, datë 07.06.2022.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Drejtimi i SHFSH-shtë përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Drejtimi i SHFSH është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5. Përgjegjësitë e Audituesve. Projekt Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Projekt Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, projekt raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Projekt Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Projekt Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidencat e auditimit të marra janë të mjaftueshme për nxjerrjen e një konkluzioni apo opinionit mbi pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj..

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, etj..

d) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj..;



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 dhe Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publikë paragrafi 41 dhe Materialiteti dhe ISSAI 400 dhe Parimet e auditimit të përputhshmërisë, paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohej material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”

Objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe gjatë kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

6. Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar;
- ✓ Ligjit nr. 109/2017 për buxhetin e vitit 2018
- ✓ Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore;
- ✓ Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021
- ✓ Udhëzimi nr. 7/2 datë 07.07.2018 për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021
- ✓ Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm,
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 për zbatimin e buxhetit 2018
- ✓ Ligj nr. 99, datë 3.12.2018 Për buxhetin e vitit 2019
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.1 datë 17.01.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2019
- ✓ Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit
- ✓ Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm
- ✓ Udhëzimi nr. 8, datë 22.02.2019 të Ministrit të Financës për përgatitjen e PBA-së 2020-2022.
- ✓ Udhëzimi nr. 21, datë 10.07.2019 të Ministrit të Financës për përgatitjen e PBA-së 2020-2022.
- ✓ Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.
- ✓ Ligji nr.88, datë 18.12.2019 për buxhetin e vitit 2020
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 20.01.2020
- ✓ Udhëzimi Plotësues shtesë nr.26 datë 08.07.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollin*, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *ōPër miratimin e manualit të MFK*”,
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *ōPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar,
- ✓ Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 *ōPër sigurimet shoqërore në RSHō*, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, nr. 7870, datë 13.10.1994 *ōPër Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar,
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ōPër miratimin e rregullave të prokurimit publikō*, ligji nr. 8869, dt.. 22.05.2003 .
- ✓ Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 *ōPër prokurimin publikō*, i ndryshuar.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ōPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitō*, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 *ōParimet themelore të auditimit të sektorit publik*” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200-299 *ōParimet bazë të auditimit financiarō*,
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Standardet për auditimin e përputhshmërisë*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA); Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj..
- INTOSAI GOV 9100 *ōUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”;
- INTOSAI GOV 9110 *ōUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëmō*.

8. Metodatat e auditimit, Praktikatat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 2320 dhe ISSAI 2450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0,7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tōu audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu për institucionin SHFSH, niveli i materialitetit për vitin 2020 rezultoi 921,031 lekë dhe për vitin 2021 rezultoi 840,476 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt.. 27.12.2011 *“Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël, ku nga verifikimi rezultoi se Njësia shpenzuese përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019, 2020 dhe 2021, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për aktivet gjendje në magazine, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit.

6. Kontrolli sipas një treguesi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *ōjashtë normalesō*, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

10. Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe trajtimit të observacioneve të sjella nga subjekti i audituar, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

SHFSH *ō*Zyber Hallulli*ō* është një institucion publik rezidencial në varësinë e Shërbimit Social Shtetëror dhe MShMS, i cili e ushtron veprimtarinë e tij me shërbim 24 orë në tre turne. Grup moshë e fëmijëve që trajtohen në SHFSH është 06-16 vjeç bazuar në Vendimin nr.106, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave *ō*Për një ndryshim në vendimin nr.425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, të përkujdesjes shoqërore, i ndryshuar*ō*.

Shërbimet që ofrohen nga institucioni për fëmijët rezidentë janë:

- Zhvillimi i potencialeve të brendshme tek fëmija dhe zhvillimi i talenteve, Mirërritja;
- Mirëqenia;
- Ushqim;
- Veshmbathje;
- Siguri;
- Arsimim;
- Shërbimi shëndetësor;
- Shërbimi psiko-social;
- Aktivitete sportive, argëtuese etj.

Institucioni është i organizuar në modelin *ō*casafamilja*ō* ku është i ndarë në 4 apartamente të cilët janë të vendosur, 2 apartamente në katin e dytë dhe 2 apartamente në katin e tretë, dhe janë të akomoduar fëmijë të grupmoshave të ndryshme, bazuar në lidhjet e gjakut dhe moshës.

Aktualisht në institucion marrin shërbim 37 fëmijë (bashkangjitur evidenca) bazuar në disa kriterë të përcaktuara në VKM nr. 425 datë 27.06.2012 *ō*"Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, të përkujdesjes shoqërore, të ndryshuar"*ō*.

Fëmijët në institucionin e përkujdesit shoqëror pranohen vetëm nëse:

1. U kanë vdekur prindërit e nuk kanë persona të tjerë të afërm të cilët marrin përsipër kujdestarinë ose birësimin e tyre;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

2. Janë të lindur jashtë martese dhe që për rrethanat e gjendjes ekonomike nuk mund t'ia rrisë njëri nga prindërit;
3. Prindërit e të cilëve të dy ose njëri u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;
4. Prindërit e të cilëve janë ndaluar, arrestuar ose dënuar me vendim të formës së prerë me heqje lirie dhe të cilët deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në shërbimet e përkujdesit shoqëror, kur gjykata është shprehur me vendim për vendosjen e tyre në institucionet e përkujdesit shoqëror;
5. Të deklaruar të braktisur nga Gjykata e Rrethit në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;
6. Me vendim të Gjykatës e cila vendos që fëmija të vendoset në institucion të përkujdesit shoqëror pavarësisht situatës familjare;
7. Prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje ekonomike të favorshme;
8. Familjet e të cilëve deklarojnë se janë në krizë të rëndë sociale për shkak se prindërit janë divorcuar ose janë rimartuar;
9. Prindërit e të cilëve shtrohen në spital ose dërgohen për kurim jashtë shtetit e deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në institucione të përkujdesit shoqëror derisa njëri ose të dy prindërit janë fizikisht të aftë për tu kujdesuar për fëmijët;
10. Që nuk mbikëqyren më ose janë larguar nga prindi apo kujdestari deri në momentin e identifikimit dhe gjetjes së prindërit ose kujdestarit ligjor të tyre. Në këto kushte këta fëmijë duhet të vendosen në institucionet e përkujdesit shoqëror.

Përsa i përket dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e fëmijës në institucionet e përkujdesjes shoqërore përfshihen:

- a) certifikata e lindjes;
- b) fotografitë e fëmijës (2 copë);
- c) certifikata familjare;
- ç) certifikata e vdekjes së prindërve;
- d) vendimi i gjykatës për heqjen e së drejtës prindërore ose kopje të noterizuar të tij;
- dh) deklarata e noterizuar e nënës ose, në pamundësi, e drejtorit të institucionit shëndetësor, ku është braktisur fëmija;
- e) epikrizë shëndetësore, kartela mjekësore ose fotokopja e noterizuar, me të dhënat laboratorike dhe për vaksinimin;
- ë) vërtetimi për gjendjen shëndetësore të prindërve, i cili lëshohet nga komisioni mjekësor i lagjes;
- f) procesverbali i dorëzimit të fëmijës institucionit shëndetësor në shtëpinë e foshnjës;
- g) procesverbali dhe urdhri i transferimit të fëmijës, në rastin e lëvizjes së tij nga një institucion në tjetrin, për shkak të moshës;
- gj) fotokopje e kartës së identitetit të prindërve;
- h) dokumenti i shkollës që ka ndjekur fëmija;
- i) deklarata noteriale për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit, për vendosjen e tij në institucion;
- j) vërtetimi për gjendjen social-ekonomike të familjes, të lëshuar nga administratori shoqëror;
- k) dokumentet e noterizuara të pronësisë së banesës, si dhe dokumente të tjera për të drejtat pasurore, kur fëmija është trashëgimtar i drejtpërdrejtë, për rastet kur prindërit kanë vdekur ose kur, me vendim gjykate, iu është hequr e drejta prindërore;
- l) të dhëna nga struktura policore të interesuara sipas rastit, komisariati i policisë, që mbulon territorin ku banon.

➤ Mënyra e akomodimit të fëmijëve në institucion realizohet si më poshtë:

1. Nëpërmjet urdhër-pranimit ose urdhër-transferimit të ShSSH nëse fëmija mbush moshën përkatëse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

2. Nga Gjykata me vendim për vlefshmëri të masës emergjente të mbrojtjes ose urdhër- mbrojtje.
3. Nga Bashkia në përmjet NJMF-se (Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve) në zonat administrative përkatëse të familjeve të fëmijëve të cilat kanë detyrimin të identifikojnë dhe t’i drejtohen gjykatës për ta pajisur fëmijën me masë mbrojtje në rastet kur cenohet mirëqenia apo është në rrezik të lartë për jetën dhe të arrihet në një vendim për akomodim të fëmijësh në një IPSH në varësi të situatës.
4. Nga GTN-ja (Grupet Teknike Ndërsektoriale të atashuara pranë Bashkive) në rastet kur një fëmijë është në situatë rruge ose në risk të lartë në ambientin familjar me vendim të nxjerrë prej tyre.

➤ **Mbi largimet e fëmijëve nga institucioni gjatë viteve 2019-2022 si më poshtë vijon:**

Nr.	Viti	Fëmijë	Rikthim në familjen biologjike	Dalje në jetë të pavarur	Kujdestari me lidhje gjaku	Birësim	Transferim
1	2019	10	3	1	1	1	4
2	2020	2	0	1	0	0	1
3	2021	7	0	1	0	1	5

➤ **SHFSH “Zyber Hallulli” e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në bashkëpunimin e vazhdueshëm e të ndërsjellët dhe me instancat e tjera si:**

- Shërbimit Social Shtetëror (SHSSh), nëpërmjet e-maileve, takimeve, shkresave zyrtare me lëndë òkërkesa për transferimò ònformacioneò òkërkesë për bashkëpunimò etj..;
- Bashkinë, NJMF (nëpërmjet e-maileve, pjesëmarrjes në mbledhjet e GTN-ve ku diskutohet ecuria e rasteve, shkresave të ndryshme zyrtare si òKërkesë për vlerësim social-ekonomik të gjendjes familjare në varësi të të cilave merren vendime, òKërkesa për monitorin në rastet kur fëmijët shkojnë pranë familjes për pushime ose fundjavaò.
- Shkollën që frekuentojnë fëmijët;
- Komisariatit e policisë (129, dhe Inspektorin e Zonës);
- Zyra e Gjendjes Civile për plotësimin e dokumentacionit;
- Gjykata, etj.

Aktiviteti i SHFSH òZyber Hallulliò mbështetet në zbatimin edhe të procedurës së ankimimit bazuar në udhëzimin nr.830 datë 14.4.2008 “ Për zbatimin e Standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijët në Institucionet Rezidenciale, Publike e Jopublike”, Standardi 9. Procedura e ankimimit është një mjet me anë të cilit fëmijët mund të shprehin kërkesa ose ankesa në lidhje me çështje për të cilat ata nuk janë të kënaqur ose që i konsiderojnë të padrejta. Pranë ambienteve të institucionit ekziston kutia e ankesave e aksesueshme për secilin fëmijë, e cila hapet e administrohet nga një përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Sociale një herë në muaj. Procedura e hapjes së kutisë së ankesave realizohet në prani të punonjësit të ngarkuar e përfaqësuesve të institucionit për të cilën plotësohet formulari përkatës. Në rastet e evidentimit të ndonjë ankesë kryhet procedura, e cila konsiston në mbledhjen e grupit multidisiplinar dhe daljen në përfundime rreth çështjes. Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve pa kujdesin prindëror.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Drejtimi 1: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHETPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të ministrisë së financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit;
- b) Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar;
- c) Realizimi i planit të buxhetit.

Projekt Buxheti

Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2019-2021**, ne mbështetje te Ligjit nr. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimit të e Ministrisë së Financave 7, datë 28.02.2018 òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, Shtëpia e Fëmijëve Shkollor òZyber Hallulliò me shkresën nr. 207 prot, datë 19.06.2018 dhe shkresën nr. 207/1 prot, datë 19.06.2018 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 2019-2021, Relacionin për PBA, Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i hartimit të PBA 2019-2021 (pa urdhër te NA).

Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2020-2021**, ne mbështetje te Ligjit nr. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimit të e Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 28.02.2012 òPër Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Shtëpia e Fëmijëve Shkollor òZyber Hallulliò me shkresën nr. 195 prot, datë 27.06.2019 dhe shkresën nr. 195/1 prot, datë 27.06.2019 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 019-2021 se bashku me relacioni përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA 2019-2021, ngritur me Urdhër te Drejtorit nr. 28, datë 09.07.2019. Planifikimi i fondeve sipas PBA 2020-2022 në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2021-2023**, ne mbështetje te Ligjit nr. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimit të e Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 28.02.2017 òPër Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò Shtëpia e Fëmijëve Shkollor òZyber Hallulliò me shkresën (dërguar me email dt. 30.06.2020) dhe shkresën nr. 110 prot, datë 29.06.2019 ka dërguar në Drejtorinë e Financave në SHSSH Pasqyrat e PBA 019-2021 se bashku me relacioni përkatës dhe Formularët e Projekt Investimeve 2019-2021, hartuar nga Komisioni i Hartimit të PBA 2019-2021, ngritur me Urdhër te Drejtorit nr. 46, datë 25.06.2020.

Planifikimi i fondeve sipas PBA 2019-2021; PBA 2020-2022; PBA 2021-2023 në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas PBA 2019-2021 (në mijë lekë):

Emërtimi	Kërkesa PBA 2019-2021	Kërkesa PBA 2020-2022	Kërkesa PBA 2021-2023
-Paga	24,827	29,382	24,903
-Sigurime shoqërore & shëndetësore	4,146	4,032	4,158
-Shërbime	18,150	23,403	23,095
Shp. Operative (A)	47,123	56,817	52,156
-Investime	2,419	2,419	2,419
Shpenzime kapitale (B)	2,419	2,419	2,419
II. Total shpenzime (A)+(B)	49,542	59,236	54,575
Numri punonjësve	38	38	38

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)

Parashikimi i òShpenzimeve për personelinò përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, shtesat mujore mbi pagë si orët për turnet e dyta dhe te treta. Përveç shpenzimeve për page, parashikohen edhe shpenzimet e kontributeve shoqërore dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shëndetësore të punëdhënësve të cilat janë planifikuar në masën 16.7% të nivelit të bazës së pagës bruto.

Parashikimi i shpenzimeve **opër mallra dhe shërbime** është zë i rëndësishëm në funksionimin e këtij institucioni dhe përfshin:

- Zërin òmateriale dhe shërbime te përgjithshmeò ne te cilin parashikohen shpenzime për kancelari, materiale pastrimi, blerje dokumentacioni, blerje detergjente. Shërbime speciale janë parashikuar blerje për veshje për fëmije, medikamente, Ushqime,

- Zërin òshërbimeò për shërbimet që realizohen nga te treten si energji elektrike, shpenzim për ngrohje, posta, telefon, etj.

- Zërin òshpenzime transportiò janë parashikuar shpenzime për blerje karburanti për kaldajën dhe për mjetin e transportit.

- Shpenzime òte tjera operativeò janë parashikuar shpenzimet pet pagesën e taksave vendore.

- Parashikimi i shpenzimeve kapitale, parashikon shpenzimet që do te kryhen për krijimin ose blerjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe patrupëzuara, te cilat parashikojnë realizmit për shkallët e emergjencës në raste zjarri në shumën 1.419 mije leke dhe shpenzime për blerje òkolltukë dhe këndeò për ambientet e shtëpisë se fëmijës.

Burimi kryesor i të ardhurave për funksionimin e institucionit është buxheti i shtetit. Gjatë hartimit të projekt buxhetit kërkesa buxhetore ne PBA 2020-2022 krahasuar me PBA 2019-2021 është rritur në shumën 9,694 mije leke ose rritur ne masën 19.57%, ndërsa kërkesa buxhetore PBA 2021-2023 krahasuar me PBA 2020-2022 është ulur ne shumën 4,461 mije lekë ose me pak në masën 7.87%.

Gjithashtu, ne PBA janë parashikuar **të ardhura të tjera janë “nga qiratë**ò në shumën **36,000 lekë/vit** për vendosjen e një pajisje ATM nga R. Bank, të cilat ne fund të vitit derdhen ne buxhetin e shtetit dhe nuk përdoren nga njësia shpenzuese. Kontrata e qerasë është lidhur në 15.01.2015, me prot nr. 342 për SHFSH. Objekt i kësaj kontrate është vënia ne dispozicion të R. Bank, e një hapësire prej **4m²** në ambientet e jashtme të SHFSH me kohëzgjatje 12 muaj, me te drejte rinovimi (automatikusht), me të njëjtat kushte, për periudha 12 mujore, **me qira** 3000 lekë/ muaj ose 36,000 lekë/ vit. Kontrata konsiderohet e rinovuar automatikusht dhe gjeneron te ardhura për institucionin.

B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2019

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 99, datë 03.12.2018 òPër buxhetin e vitit 2019ò, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 òPër procedurat standard të zbatimit të buxhetitò, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standard të zbatimit të buxhetitò, UMF nr. 1 datë 17.01.2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò.

Buxheti I vitit 2019 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2019-2021 (ne mije leke)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2019-2021	Plani fillestar	Plani rishikuar Shtator	Plani rishikuar Nëntor	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Plani Fillestar)	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Kërkesë Buxhetore)
Shpenzime (A)+(B)	49,542	41,840	42,250	45,850	4,010	(3,692)
Paga	24,827	20,420	20,420	22,820	2,400	(2,007)
Sigurime	4,146	3,420	3,830	4,030	610	(116)
Shërbime	18,150	18,000	18,000	19,000	1,000	850
TotalShp. Operative (A)	47,123	41,840	42,250	45,850	4,010	(1,273)
Investime	2,419	-	-	-	-	(2,419)
Shpenzime kapitale Total (B)	2,419	-	-	-	-	(2,419)

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Numri punonjësve total		36	36	36		
-Me kontrate te përhershme		36	36	36		
-Me kohe te pjesshme		-	-	-		

Me shkresën nr. 306/1 prot, datë 05.02.2019, SHSH ka dërguar buxhetin e vitit 2019 në limit vjetore dhe mujor në shumën vjetore 41,840 mijë lekë dhe numrin e punonjësve me kontrate gjithsej 36 punonjës. Plani fillestar ka ndryshuar sipas me shkresë të SHSSH:

- nr. 68/77 prot, datë 30.09.2019, protokolluar më nr. 252, datë 01.10.2019 duke shtuar shpenzimet për sigurime shoqërore në shumën 410 mije lekë;

- nr. 68/95 dt. 15.11.2019, protokolluar me nr. 309, dt. 15.01.2019, duke shtuar shpenzimet për sigurime shoqërore në shumën 200 mije lekë;

- nr. 68/95, datë 15.11.2019, protokolluar më nr. 309, dt. 15.11.2019 duke shtuar shpenzimet për paga ne shumen 2,400 mije leke; shpenzimet te tjera ne shumën 1,000 mijë lekë

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2019 në shumën 45,850 mijë lekë rakordon me situacionet mujore /progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

Konkluzion: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2019-2021 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar në total 45,850 mijë lekë ka pësuar rritje të shpenzimeve operative ne shumen +4,010 mijë kundrejt planit fillestar. Sipas zërave buxhetor shpenzimet për paga janë rritur në shumën 2,400 mijë lekë, për sigurime shoqërore janë rritur në shumën 610 mijë lekë dhe shpenzimet për shërbime janë rritur në shumën 1,000 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2019 rezulton me diference ndaj kërkesës buxhetore të institucionit në total në shumën 3,692 mijë lekë, dhe sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më pak ne shumën 2,007 mije lekë, shpenzimet për sigurime janë miratuar më pak ne shumën 116 mije lekë, shpenzimeve operative janë rritur më shumë së kërkesa buxhetore në shumën 850 mijë lekë.

Për SHSSH PBA 2019-2021 nuk ka miratuar shpenzime kapitale për vitin 2019, në mosplotësim të kërkesës së njësisë shpenzuese.

Viti 2020

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 03.12.2018 *ËPër buxhetin e vitit 2019*ö, Ligjit nr. 88/2019 *ËPër buxhetin e shtetit të vitit 2020*ö, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 *ËPër procedurat standard të zbatimit të buxhetit*ö, UMF nr. 1 datë 17.01.2019 *ËPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019*ö.

Buxheti i vitit 2020 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2020-2022 (ne mije leke)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2020-2022	Plani fillestar i miratuar	Plani rishikuar Korrik 2020	Plani rishikuar Tetor 2020	Plani rishikuar Nëntor 2020	Ndryshimi (Plani rishikuar/ Planit Fillestar)	Ndryshimi (Plani rishikuar/ Kërkesë Buxhetore)
Shpenzime (A)+(B)	59,236	42,860	44,960	45,310	45,430	2,570	(13,806)
Paga	29,382	21,040	22,940	23,290	23,410	2,370	(5,972)
Sigurime	4,032	3,820	4,020	4,020	4,020	200	(12)
Shërbime	23,403	18,000	18,000	18,000	18,000	-	(5,403)
Transferta	0	0	0	-	-		-
Shp.Operative (A)	56,817	42,860	44,960	45,310	45,430	2,570	(11,387)
Investime	2,419	0	0	0	0		(2,419)
Shpenzime kapitale (B)	2,419	0	0	0	0	0	(2,419)

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

SHSH me shkresën nr. 125/1 prot, datë 10.02.2020 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2020 në limit vjetore dhe mujor në shumën vjetore 42,860 mijë lekë dhe numrin e punonjësve me kontrate gjithsej 36 punonjës. Plani fillestar ka ndryshuar sipas me shkresë të SHSSH:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- nr. 80/81 prot, datë 03.08.2020, protokolluar me nr. 148, datë 03.08.2020 duke shtuar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në shumën 2,100 mijë lekë. Me shkresën nr. 402/3, datë 03.07.2020 miratohet rritja e numrit të punonjësve me 2 persona, me kohe të pjeshme, sipas VKM nr. 47, datë 22.01.2020 *oPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*;
- nr. 80/104 prot, datë 04.11.2020, protokolluar me nr. sçka, duke shtuar shpenzimet për page në shumën 350 mijë lekë;
- nr. 80/16 , datë 25.11.2019, protokolluar më nr. 309, dt. 15.11.2019 duke shtuar shpenzimet për paga në shumën 120 mijë leke.

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2020 në shumën **45,430 mijë lekë rakordon me situacionet mujore /progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë**

Konkluzion: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2020-2022 dhe buxhetit të miratuar për SHSSH, rezulton se plani i rishikuar kundrejt planit fillestar ka miratuar më shumë shpenzime operative në shumën +2,570 mijë. Sipas zërave shpenzimet për paga janë miratuar më shumë në shumën +2,370 mijë lekë, shpenzimet për sigurime shoqërore në shumën +200 mijë lekë. Buxheti i rishikuar i vitit 2020 krahasuar me kërkesën buxhetore në total rezulton me diferencë për më pak shpenzime të miratuara në shumën -13,806 mijë lekë, nga të cilat janë miratuar më pak shpenzimet për paga në shumën -5,972 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore më pak në shumën -12 mijë lekë dhe shpenzimeve operative më pak në shumën -5,403 mijë lekë.

PBA 2020-2022 nuk ka miratuar shpenzime kapitale për vitin 2020, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese

Viti 2021

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzues është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 oPër procedurat standard të zbatimit të buxhetitö, Ligjit 88/2019 oPër buxhetin e shtetit të vitit 2020, oUMF nr. 4 datë 25.01.2021 oPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ö.*

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023 (në mijë leke)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar janar 2021	Plani rishikuar korrik 2021	Plani rishikuar dhjetor 2021	Ndryshimi Plani rishikuar/ Planit Fillestar	Ndryshimi Plani rishikuar/ Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	52,156	46,980	47,480	44,880	(2,100)	(7,276)
Paga	24,903	24,750	24,750	22,150	(2,600)	(2,753)
Sigurime	4,158	4,230	4,230	4,230	-	72
Shërbime	23,095	18,000	18,500	18,500	500	(4,595)
Transferta	0	0	0			-
Shp. Operative (A)		46,980	47,480	44,880	3,100	(7,276)
Investime	2,419			0		(2,419)
Shpenzime kapitale (B)		0	0	0	0	(2419)

(Burimi: SHFSPunoi: KLSH)

SHSH me shkresën nr. 125/1 prot, datë 27.01.2021 ka dërguar plan buxhetin e vitit 2021 në limit vjetore dhe mujor në shumën vjetore 46,980 mijë lekë dhe numrin e punonjësve me kontratë gjithsej 36 punonjës. Plani fillestar ka ndryshuar sipas me shkresë të SHSSH:

- nr. 333/44 prot, datë 06.07.2021, protokolluar me nr. sçka, duke shtuar shpenzimet operative në shumën 500 mijë lekë.
- nr. 333/78 prot, datë 29.12.2021, protokolluar me nr. sçka, duke pakësuar shpenzimet për page në shumën 2,600 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTEPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Buxheti i akorduar nga SHSSH për vitin 2020 në shumën 44,880 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë

Konkluzion: Nga krahasimi kërkesës buxhetore PBA 2021-2023 dhe buxhetit të miratuar, rezulton se buxheti i rishikuar në vitin 2021 në total 45,430 mijë krahasuar me planin fillestar ka pësuar rritje shpenzimesh operative në shumën 2,570 mijë lekë. Zërat buxhetore të vitit 2021, kanë pësuar ndryshim kundrejt buxhetit fillestar për paga më shumë në shumën +2,370 mijë lekë dhe shpenzime për sigurime në shumën +200 mijë lekë,

Buxheti i miratuar i vitit 2021 rezulton me diferencë ndaj kërkesës buxhetore në total për më pak në shumën -13,806 mijë lekë, nga të cilat shpenzimet për paga janë miratuar më pak në shumën 5,972 mijë lekë, shpenzimet për sigurime më pak në shumën 12 mijë lekë dhe shpenzimeve shërbime më pak në shumën -5,403 mijë lekë .

Përsa i përket shpenzimeve kapitale për SHSSH nuk janë miratuar shpenzime kapitale për vitin 2021, sipas kërkesës së njësisë shpenzuese.

C. Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2019

Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2019, krahasuar me kërkesat e vitit 2019, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2019-2021, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2019 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2019-2021	Plani fillestar	Plani rishikuar Nëntor 2019	Realizimi 2019	Realizimi 2019 (%)	
II Shpenzime (A)+(B)	49,542	41,840	45,850	45,689	99.65%	
Shp.Operative (A)	Paga	24,827	20,420	22,820	22,723	99.57%
	Sigurime	4,146	3,420	4,030	3,967	98.44%
	Shërbime	18,150	18,000	19,000	19,000	100.00%
	Transferta	-	-	-	-	-
Total (A)	47,123	41,840	45,850	45,689	99.65%	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	2,419	-	-	-	-
Total (B)	2,419	-	-	-	-	

(Burimi: SHF/SH Punoi: KLSH)

Sipas PBA 2019-2021 të SHSSH, për vitin 2019 në total janë kërkuar 49,542 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 41,840 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 45,850 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore u krye në vlerën **45,689 mijë lekë** ose me një përqindje realizimi prej **99.65%**.

Për shpenzimet operative, ku sipas PBA 2019-2021 janë kërkuar prej 47,123 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 41,840 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 45,850 mijë lekë. Për vitin 2019 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 49.73%, shpenzimet për sigurime shoqërore 8.68% dhe shpenzimet për shërbime zënë 41.59% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Viti 2020

Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2020, krahasuar me kërkesat e vitit 2020, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2020-2022, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2020 (në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2020-2022	Plani fillestar	Plani rishikuar Nëntor 2020	Realizimi 2020	Realizimi %

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Shpenzime (A)+(B)		59,236	42,860	45,430	45,270	99.65%
Shp. Operative (A)	Paga	29,382	21,040	23,410	23,401	99.96%
	Sigurime	4,032	3,820	4,020	3,922	97.57%
	Shërbime	23,403	18,000	18,000	17,946	99.70%
	Transferta	0	0	-		
Total (A)		56,817	42,860	45,430	45,270	99.65%
Shpenzime kapitale (B)	Investime	2,419	0	0	-	0.00%
Total (B)		2,419	0	0	-	0.00%

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)

Në total për vitin 2020, ku sipas PBA 2020-2023, nga SHSSH janë kërkuar 56,817 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 42,860 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar **45,430 mijë lekë**. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën **45,270 mijë lekë**, ose me një përqindje realizimi prej 99.65%.

Shpenzimet operative janë kërkuar prej 56,817 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 42,860 mije lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 45,430 mijë lekë.

Për vitin 2020 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 51.69%, shpenzimet për sigurime shoqërore 8.66% dhe shpenzimet për shërbime zënë 39.64% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor

Viti 2021

Realizimi i buxhetit të SHSSH për vitin 2021, krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2021 (Ne mijë lekë)

Emërtimi		Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar	Plani rishikuar Dhjetor 2021	Realizimi 2021	Realizimi 2021 (%)
II Shpenzime (A)+(B)		52,156	46,980	44,880	43,669	97.30%
Shp. Operative (A)	Paga	24,903	24,750	22,150	21,450	96.84%
	Sigurime	4,158	4,230	4,230	3,612	85.38%
	Shërbime	23,095	18,000	18,500	18,608	100.58%
	Transferta	0	0		0	0
Total (A)			46,980	44,880	43,669	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	2,419		0	0	0
Total (B)			0	0	0	0

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)

Në total për vitin 2021, ku sipas PBA 2021-2023, nga SHSSH janë kërkuar 52,156 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 46,980 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 44,880mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën 43,669 mijë lekë, ose me një përqindje realizimi prej 97.30%.

Për shpenzimet operative, janë kërkuar prej 52,156 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 46,980 mije lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 44,880 mijë lekë. Shpenzime nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën 43,669 mijë lekë, ose me një përqindje realizimi prej 97.30%.

Realizimi shpenzimeve sipas zërave buxhetore për paga rezulton 21,450 mijë lekë ose realizim 96.84%, për sigurime shoqërore rezulton 3,612 mije lekë ose realizim 85.38% dhe shpenzimet për shërbime rezultojnë 18,608 mijë lekë ose realizim 100.58% të shpenzimeve te vitit buxhetor

Për vitin 2021 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga zënë 49.12% te shpenzimeve operative, shpenzimet për sigurime shoqërore zënë 8.27% dhe shpenzimet për shërbime zënë 42.61% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË****Zbatimi i buxhetit për të ardhurat:**

Subjekti ka lidhur kontratë qiraje me datë 05.11.2015, në vlerë 36,000 lekë /vit, për vendosjen e një ATM-je bankare, referuar ne VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve e të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, sipas Akt-marrëveshje te lidhur me R. Bank sha me nr.342 prot, datë 15.01.2015. Këto të ardhura derdhen 100 % në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu njësia shpenzuese ka të ardhura që lidhen me sponsorizime nga private. Të ardhurat janë derdhur në Degën e Thesarit Tiranë, në llogarinë e institucionit bazuar në Faturën për Arkëtim. Të ardhurat e krijuara, të derdhura ne buxhet dhe të ardhurat që trashëgohen sipas ligjit, bazuar në regjistrimet në ditari te ardhurave, akt -rakordimi me thesarin janë:

Te ardhurat e institucionit (ne mije lekë)

Viti	Emërtimi	Bilanci	Të ardhurat progresive	Pjesa e institucionit	Rritje autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbeten për tu trashëguar
2019	Te ardhura	36	36	36	0	36	0
	Nga qiraja	36	36	36	0	36	0
	Nga sponsorizimet	0	0	0	0	0	0
2020	Te ardhura	321	321	275	275	46	0
	Nga qiraja ⁶	46	46	0	0	46	0
	Nga sponsorizimet	275	275	275	275	0	0
2021	Te ardhura	328	328	282	282	46	0
	Nga qiraja	46	46	0	0	46	0
	Nga sponsorizimet individit	168	168	168	168	0	0
	Nga sponsorizimet shtet & privat	114	114	114	114	0	0

(Burimi : SHFSH, Akt –Rakordimi me Degën e Thesarit)

Rakordimi me Degën e Thesarit është bërë mujor/progresiv për çdo muaj deri në dhjetor te vitit kalendarik. Një kopje e akt-rakordimit dërgohet çdo muaj në SHSSH. Regjistrimi të ardhurave behet sipas faturës për arkëtim dhe sipas rendit kronologjik.

Konkluzion: Subjekti ka lidhur kontratë qiraje me R. Bankme datë 05.11.2015, në vlerë 36,000 lekë /vit, për vendosjen e një ATM-je bankare, referuar ne VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve e të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, sipas Akt-marrëveshje te lidhur me R. Banksha me nr.342 prot, datë 15.01.2015. Këto të ardhura derdhen 100 % në buxhetin e shtetit.

Zbatimi i buxhetit për shpenzimet:

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor e progresiv për çdo muaj deri në dhjetor te vitit kalendarik. Një kopje e situacionit dërgohet çdo muaj në SHSSH. Regjistrimi shpenzimeve behet sipas Urdhër Pagesës dhe sipas rendit kronologjik.

Për vitet 2019, 2020 dhe 2021, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore llogaria 600, llogaria 601 dhe llogaria 602, kemi këtë situatë:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore (ne mijë lekë)

Artikulli	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
600	Shpenzime paga	22,820	22,724	23,410	23,401	22,150	21,450
601	Kont. për sig. shoq dhe shend	4,030	3,967	4,020	3,922	4,230	3,612

⁶ Te ardhurat nga qiraja jane 36,000 lekë, dhe 10,000 lekë janë të ardhura të tjera te pidentifikuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

602	Shpenzime operative	19,000	19,000	18,000	17,946	18,500	18,494
602	Materiale zyre	535	535	599	599	559	559
60201	Kancelari. printim	120	120	119	119	-	-
60202	Materiale pastrimi dezinfektim	415	415	480	480	559	559
6021	Materiale shërbim social	6,868	6,868	7,374	7,374	7,508	7,508
602101	Veshje uniform	120	120	120	120	119	119
602102	Medikamente	99	99	104	104	90	90
602104	Ushqime	6,177	6,177	6,560	6,560	6,783	6,783
602109	Te tjera	472	472	497	497	517	517
6022	Shërbime nga të tretë	9,087	9,087	8,502	8,448	8,339	8,333
602201	Energji	3,968	3,968	3,717	3,663	36,745	3,675
602202	Ujë	2,265	2,265	2,066	2,066	1,345	1,345
602203	Telefon. internet	48	48	57	57	52	51,502
602204	Poste	8	8	6	6	8	8,445
602207	Shërbim ruajtjes së sigurisë	2,089	2,089	1,310	1,310	2,619	2,613
602099	Të tjera	709	709	1,345	1,345	640	639
6023	Shpenzime transporti	2,108	2,108	1,500	1,500	2,018	2,018
602301	Karburant. vaj	2,100	2,100	1,494	1,494	2,018	2,018
602	Pjese këmbimi	-	-	-	-	-	-
602302	Siguracion. taksa	8	8	6	6	6	6
6024	Udhëtim i brendshëm	238	238	9	9	70	70
6029	Te tjera operative	162	162	15	15	-	-
602903	Shpenzime gjyqësore	99	99	-	-	-	-
602908	Tatime taksa	63	63	-	-	-	-
606	Transfera për buxhetet familjare						
	Totali shpenzimeve	45,850	45,691	45,430	45,269	44,880	43,555
	Realizimi (Fakt/Plan)		99.65%		99.65%		
231	Blerje pajisje	300	-	300	-	468	-
602	shpenzime	25	-	25	-	139	114

(Burimi : SHFSH, situacioni për realizim shpenzimesh)

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore shoqërohen me dokument justifikues si listë pagesa e firmosur nga NZ , nga NA dhe firmosur dhe vulosur nga punonjësi Degës së Thesarit. Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë **rreth 60 % të shpenzimeve** korrente të vitit buxhetor.

Shpenzimet operative shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, fature blerje, flete hyrje ne magazine, urdhër prokurimi, kontrate furnizimi, proces verbal, etj.. Në strukture shpenzimet operative zënë 40 % të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.

-**Shpenzime për materiale zyre zënë rreth 2.82%** të shpenzimeve operative, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, flete hyrje ne magazine, etj.

-**Shpenzime për materiale dhe shërbime sociale zënë rreth 47.83 %** të shpenzimeve operative, dhe këtu përfshihen shpenzimet për furnizim me ushqim, veshje uniforme, ilaçe për fëmijët, etj., mbështet ne dokumentacion vërtetues si: kontrata e shpallur fituese me OK, fature tatimore shitje, flete hyrje në magazine, etj..

-**Shpenzime nga të trete zënë rreth 47.83% të shpenzimeve korrente.** Shpenzimet përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes se sigurisë, etj.. Shpenzimet bazohen ne urdhër shpenzim, fature shitje, urdhër prokurimi, kontrate shërbimi, etj.

-**Shpenzimet e transportit** përbejnë **11.09%** te shpenzimeve operative. Ato paraqesin shpenzime për blerje karburanti për ngrohje me kaldajë dhe për automjetin e institucionit. Dokument vërtetues urdhër prokurimi, fatura e shitjes, flete hyrje ne magazine, etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

-**Shpenzime për udhëtim** përbejnë **1.25%** te shpenzimeve korrente te vitit 2019, dhe më pas ka rënie te këtij shpenzimi. Ai paraqet shpenzimeve për udhëtime brenda vendit, jashtë qendrës se punës, për dërgimin e fëmijëve në shkollë, feste, dhe ne funksione te tjera, mbështetur ne dokumente vërtetues autorizim nga NA, Urdhër Shërbimi për punonjësin udhëtues.

-Te tjera shpenzime operative, janë për shpenzime gjyqësore dhe për tatime dhe taksa Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1.znj. S. L për periudhën 15.07.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NA të institucionit

2.znj. A. H për periudhën 01.01.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NZ të institucionit

Për sa me sipër u mbajt Akt Konstatimi nr.8, datë 12.07.2022

Në lidhje Akt Konstatimin Nr.8, datë 12.07.2022 ka bërë komente dhe shpjegime znj. S.L, në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A.H në cilësinë e përgjegjës se Administratës, si më poshtë:

Ne lidhje me hartimin dhe zbatimin e buxhetit në SHFSH, do të vijohet në respektim të legjislacionit në fuqi si dhe koordinimit me instancat eprore për të identifikuar nevojat e rezidentëve dhe përmbushjen e nevojave të tyre

NZ shprehet se në vijim do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të kryer procedurën për ngritjen e Komisionit të Hartimit të PBA, konformë legjislacionit në fuqi.

NZ shprehet se në vijim do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të kryer procedurën për raportet e monitorimit 4-8-12 mujore, konformë legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{rsë}:

Ne lidhje me sa është pretenduar , subjekti i audituar shpreh dakordësinë me qëndrimin e grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara në përgatitjen e PBA-ve
Situata	<p>Sipas PBA 2019-2021 të SHSSH, për vitin 2019 në total janë kërkuar 49,542 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 41,840 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë miratuar 45,850 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore u krye në vlerën 45,689 mijë lekë ose me një përqindje realizimi prej 99.65%. Shpenzimet operative janë kërkuar prej 47,123 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 41,840 mije lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 45,850 mijë lekë. Për vitin 2019 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 49.73%, shpenzimet për sigurime shoqërore 8.68% dhe shpenzimet për shërbime zënë 41.59% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor.</p> <p>Në total për vitin 2020, ku sipas PBA 2020-2023, nga SHSSH janë kërkuar 56,817 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 42,860 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar 45,430 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën 45,270 mijë lekë, ose me një përqindje realizimi prej 99.65%. Shpenzimet operative janë kërkuar prej 56,817 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 42,860 mije lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 45,430 mijë lekë. Për vitin 2020 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 51.69%, shpenzimet për sigurime shoqërore 8.66% dhe shpenzimet për shërbime zënë 39.64% të shpenzimeve korrente te vitit buxhetor</p> <p>Sipas PBA 2021-2023 për vitin 2021, nga SHSSH janë kërkuar 52,156 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 46,980 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 44,880mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezultojnë të kryera në vlerën 43,669 mijë lekë, ose me një përqindje realizimi prej 97.30%. Realizimi shpenzimeve sipas zërave</p>

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	<p>buxhetore për paga rezulton 21,450 mijë lekë ose realizim 96.84%, për sigurime shoqërore rezulton 3,612 mijë lekë ose realizim 85.38% dhe shpenzimet për shërbime rezultojnë 18,608 mijë lekë ose realizim 100,58% të shpenzimeve të vitit buxhetor. Për vitin 2021 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga zënë 49,12% të shpenzimeve operative, shpenzimet për sigurime shoqërore zënë 8,27% dhe shpenzimet për shërbime zënë 42,61% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor</p> <p>Nga auditimi rezultoi se Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tirane ka paraqitur kërkesë për shpenzime për investime për shumën 2,419 mijë lekë në PBA 2019-2021, PBA 2020-2022, PBA 2021-2023, të cilat nuk u miratuan në buxhetin vjetor të shpenzimeve.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò;</p> <p>Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 òPër procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesmeò, kreu 7.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mos miratimi i fondeve për investime në qendrën rezidenciale për ndërtimin e shkallëve të emergjencës çon në rrezikimin e jetës së fëmijëve në rastet e rënies së zjarrit, dhe mos përmirësimi mobilimit në apartamentet e fëmijëve ndikon në uljen e cilësisë së kushteve të jetesës për fëmijët rezident.</p>
Shkaku:	<p>Mos miratimi i fondeve për investime në PBA i shumës së fondeve për investime të klasifikuara në llogarinë 231, pa vlerësuar shkallën e domosdoshmërisë së tyre.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme</p>
Rekomandime:	<p>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, përpara miratimit të VKM-së për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesës për zërin òInvestimeò në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenien e fëmijëve rezident në institucion.</p>

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore
Situata	<p>Nga auditimi konstatohet se NA dhe NZ, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të SHFSH, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror.</p> <p>Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenonë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve masat korrigjuese për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreò.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò;</p> <p>Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 65, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit:</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<ul style="list-style-type: none">- Nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik;- Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve;- Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme;- Nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, për shpenzimet e saj, të marrë masa, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8 - mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Drejtimi 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

2.1. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

2.2. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në zbatim të pikës nr.2 të programit të auditimit nr. 381/1, datë 20.04.2022, mbi ÷Auditimin Financiar dhe Përputhshmërinë në Shtëpinë e Fëmijëve Zyber Hallulli, është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Struktura organizative e SHFSH-së;

b) Rekrutimet, largimet dhe zbatimi i strukturave organizative, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021;

c) Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;

d) Listëpagesat mujore dhe librat e pagave për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021.

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura organizative

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë. SHFSH është një institucion rezidencial kombëtar në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Organika dhe struktura e SHFSH-së përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit.

SHFSH funksionon në bazë të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 ÷Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, Ligjit nr. 121/2016 ÷Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 ÷Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe akteve nënligjore përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ka kryer funksionet e saj me 36 punonjës, duke u bazuar në organigramën e miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, ÷Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme në zbatim të VKM nr. 16, datë 16.01.2019 ÷Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore, VKM nr. 47, datë 22.01.2020 ÷Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore dhe VKM nr. 1151, datë 24.12.2020 për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore, i ndryshuar. Sipas kësaj strukture, SHFSH-ja është organizuar mbi bazën e 2 sektorëve të varur direkt nga Drejtori i Institucionit: Sektori i Shërbimit Social dhe Sektori i Administratës.

Edhe pas ndryshimeve në Urdhrin e Kryeministrit (të fundit me Urdhrin e KM nr. 135, datë 21.10.2019), numri total i punonjësve ka mbetur i pandryshuar për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë. Organigrama e SHFSH ka funksionuar si më poshtë:



Organigrama e SHFSH-së

Në tabelën më poshtë paraqitet numri i punonjësve dhe pozicionet sipas organikës së miratuar:

Nr. rend	Pozicioni	Nr. punonjësve
a	b	1
II	Punonjës me sistem page	12
II.1	Drejtor institucioni	1
II.2	Përgjegjës sektori	2
II.3	Specialist	9
II.4	Specialist	0
II.5	Specialist	0
III	Punonjës sipas klasave	26
II.1	K/kujdestar	1
II.2	Kujdestar	12
II.2	Kujdestar	1
II.3	Magaznier	1
II.4	Kuzhinier	3
II.5	Pastrues	5



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

II.6	Pastrues	1
II.7	Roje	1
II.8	Mirëmbajtës	1
	TOTALI	38

Gjatë periudhës në auditim, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka pësuar ndryshime në strukturë, duke funksionuar me 36 punonjës me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme.

Nga auditimi konstatohet se qëndrueshmëria e stafit në SHFSH është shumë e ulët. Gjatë periudhës 2019-2021, vihen re lëvizje të shumta të stafit dhe punonjës që largohen nga pozicioni pas një periudhe shumë të shkurtër (p.sh. 2 muaj). Duke gjykuar mbi emërimet dhe largimet në institucion, rezulton se në SHFSH çdo vit ndryshon mesatarisht rreth 31.5% e stafit, ku ndryshimet me të shpeshta konstatohen në pozicionet e punës kujdestarë. Këto lëvizje kanë krijuar vazhdimisht pozicione vakante në institucion dhe njëkohësisht stafi që rekrutohet ka pasur nevojë për kohë për t'u përshtatur me procesin e punës. Në këtë mënyrë cenohet zbatimi i detyrave funksionale të stafit të SHFSH, të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, parashikohet që brenda dy vitesh të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale të transferohen në qeverisjes vendore (Neni 52, pika 1). Megjithatë, në këtë drejtim nuk është bërë asnjë hap konkret nga institucionet përgjegjëse, kështu që SHFSH vazhdon të funksionojë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror.

b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen në Shërbimin Social Shtetëror, i cili është përgjegjës edhe për rekrutimin e stafit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Sektori i Administratës në SHFSH mban një kopje të dosjeve të stafit. Dosjet e personelit duhet të administrohen në përputhje me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, ku përcaktohet se:

1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezat e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 12 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar mangësi në dokumentacion si më poshtë:

Punonjësi	Pozicioni i punës	Mangësi në dosjen personale
S.L.	Drejtor	Certifikata personale
E.D.	Përgjegjës sektori	Certifikata personale
A.H.	Përgjegjës sektori	Certifikata personale
M.I.	Psikolog	Certifikata personale
S.S.	Edukator	Fleta prezantuese
S.H.	Edukatore	Certifikata personale
D.N.	Kujdestare	Certifikata personale
S.C.	Kujdestare	Libreza e punës
Z.H.	Sanitare	Libreza e punës

Në shqyrtimin e dosjeve të personelit, grupi i auditimit ka konstatuar mangësi të dokumentacionit, si:

- në 1 nga dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit;
- në 6 nga dosjet mungojnë certifikatat personale të punonjësve;
- në 2 nga dosjet mungon librezat e punës.

Observacioni mbi Akt Konstatimin Nr. 4 për auditimin e kryer në “Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallulli”.

Pretendimi i subjektit

Në shqyrtimin e dosjeve të personelit, grupi i auditimit ka konstatuar mangësi të dokumentacionit, si:

- në 1 nga dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit;
- në 6 nga dosjet mungojnë certifikatat personale të punonjësve;
- në 2 nga dosjet mungon librezat e punës.

Në lidhje me këtë pjesë, SHFSH parashtroi si më poshtë:

Dokumentet origjinal administrohen në SH.S.SH dhe punonjësit i kanë dorëzuar në Burime Njerëzore. Një kopje e dokumenteve të dosjes e dërgojnë në IPSh dhe administrohet nga punonjësi i autorizuar me urdhër të titullarit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Observacioni i SHFSH është marrë parasysh nga grupi i auditimit në hartimin e rekomandimit



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

përkatës, ku ngarkohet SHSSH për plotësimin e dokumenteve që mungojnë, në cilësinë e institucionit që disponon dosjet e punonjësve

Titulli i gjetjes	Mangësi në dosjen personale të punonjësve të institucionit
Situata:	Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 12 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi. Në shqyrtimin e dosjeve të personelit, grupi i auditimit ka konstatuar mangësi të dokumentacionit, si: - në 1 nga dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit; - në 6 nga dosjet mungojnë certifikatat personale të punonjësve; - në 2 nga dosjet mungon librezja e punës.
Kriteri:	VKM nr. 117, datë 05.03.2014 òPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelitò; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelitò.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në dosjet e personelit, përmbajtja e të cilave përcaktohet me VKM.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Marrëdhëniet e Punës

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të SHFSH-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar.

Kontratat e punës

Grupi i auditimit ka përzgjedhur 8 Kontrata Individuale të Punës të punonjësve pjesë e strukturës së SHFSH-së, të lidhura ndërmjet punonjësve dhe Shërbimit Social Shtetëror. Në Kodin e Punës, Neni 21 pika 3 përcaktohet se:

Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos:

a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive;

Në shqyrtimin e elementëve që duhet të jenë pjesë e kontratës, u konstatua se Kontratat Individuale e Punës përmbanin elementët e kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Emërimet

**Procedura e punësimit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë* është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar dhe në linjë me VKM nr. 542, datë 27.07.2005 òPër miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror dhe Udhëzimet/Urdhrat e Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Punonjësit e rekrutuar duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a. të kenë shtetësinë shqiptare;

b. të zotërojnë aftësinë profesionale të domosdoshme, si dhe arsimin e nevojshëm për vendin përkatës të punës;

c. të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;

d. të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna nga subjektet ku kanë qenë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

të punësuar më parë, për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore.

Punonjësit e SHFSH emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në SHFSH janë emëruar gjithsej 10 punonjës, nga të cilët 1 drejtues, 6 specialistë/teknikë dhe 3 punonjës me kohë të pjesshme.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në SHFSH janë emëruar gjithsej 14 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori, 10 specialistë/teknikë dhe 3 punonjës me kohë të pjesshme.

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në SHFSH janë emëruar gjithsej 12 punonjës, nga të cilët 10 specialistë/teknikë dhe 2 punonjës me kohë të pjesshme.

Ligji nr. 121/2016 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë përcakton në nenin 42 se Ministria përgjegjëse për çështjet sociale (sot MSHMS) krijon një program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur òProgrami i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ky program funksionon si një sistem me cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që të nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 42 të ligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 121/2016, Këshilli i Ministrave me propozim të MSHMS ka miratuar VKM nr. 624, datë 29.07.2020 òPër kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Pika 3 e këtij vendimi përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Megjithëse procesi i certifikimit ndahet në cikle 5-vjeçare, profesionistët e shërbimeve shoqërore duhet të marrin një numër minimal kreditesh çdo vit. Nga dokumentacioni i administruar në auditim, stafi përkatës i SHFSH nuk ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit, pasi nuk është ofruar asnjë i tillë. Niveli i zbatimit të procesit të certifikimit sipas ligjit nr. 121/2016 paraqet shumë mangësi dhe procesi i rekrutimit ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror.

Observacioni mbi Akt Konstatimin Nr. 5 për auditimin e kryer në “Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallulli”.

Pretendimi i subjektit

Në bazë të dokumentit të Rregullores së Brendshme, pika 11 e detyrave të Drejtorit përcakton se òDrejtori vlerëson në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, performancën e të gjithë punonjësve, duke vënë në dijeni çdo punonjës dhe depoziton vlerësimin në dosjen personale të punonjësit. ò Nga auditimi i dosjeve personale të stafit konstatohet se gjatë periudhës së audituar, nuk janë përfshirë vlerësime periodike të punonjësve të institucionit.

Në lidhje me këtë pjesë, SHFSH parashtron si më poshtë:

Mbi këtë konstatim sqarojmë se performancat e punonjësve të SHFSH janë kryer çdo vit por nuk administrohen në dosjet e personelit por në një dosje të veçantë në zyrat e sektorit të administratës dhe sektorit social.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Observacioni i SHFSH është marrë parasysh nga grupi i auditimit në hartimin e rekomandimit përkatës, ku kërkohet që në bashkëpunim me SHSSH të plotësohen vlerësimet në dosjet e punonjësve, sipas kërkesave të Rregullores së Brendshme të institucionit.

Titulli i gjetjes	Mos aplikimi i sistemit të krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror
Situata:	Në zbatim të ligjit nr. 121/2016, Këshilli i Ministrave me propozim të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	MSHMS ka miratuar VKM nr. 624, datë 29.07.2020 për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Pika 3 e këtij vendimi përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Megjithatë procesi i certifikimit ndahet në cikle 5-vjeçare, profesionistët e shërbimeve shoqërore duhet të marrin një numër minimal kreditesh çdo vit. Nga dokumentacioni i administruar në auditim, stafi përkatës i SHFSH nuk ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit, pasi nuk është ofruar asnjë i tillë.
Kriteri:	Ligji nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 624, datë 29.07.2020 për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror
Ndikimi/Efekti:	Procesi i rekrutimit ende bëhet pa mbajtur parasysh kërkesat e ligjit për trajnimin e vazhduar të profesionistëve të përkujdesit shoqëror.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Shërbimi Social Shtetëror të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, të cilët janë subjekt i VKM nr. 624, datë 29.07.2020.

Largimet

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në SHFSH i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 3 punonjësve, për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Dorëheqje	1
Mosparaqitje në punë	0
Dalje në pension	0
Emërim i përkohshëm/Transferim	2
Totali	3

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në SHFSH i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 14 punonjësve, për arsyet e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Dorëheqje	9
Mosparaqitje në punë	3
Dalje në pension	2
Emërim i përkohshëm/Transferim	0
Totali	14

Gjatë vitit 2020 konstatohen 3 punonjës, të cilët nuk janë paraqitur në punë pa asnjë njoftim paraprak se do të shkëputeshin prej saj. Ata janë liruar nga detyra me Urdhrat e SHSSH nr. 142, datë 15.07.2020, nr. 214, datë 10.11.2020 dhe nr. 219, datë 10.11.2020. Braktisja e punës në këtë mënyrë bie në kundërshtim me dispozitat e kontratës individuale të punës që lidhet ndërmjet SHSSH dhe punonjësve të saj.

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në SHFSH i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 7 punonjësve, për arsyet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Arsyeja	Nr. i punonjësve
Dorëheqje	6
Mosparaqitje në punë	0
Dalje në pension	1
Emërim i përkohshëm/Transferim	0
Totali	7

Vendimet gjyqësore

Sa i takon marrëdhënieve të punës nuk ka asnjë çështje gjyqësore në proces gjykimi apo vendime të formës së prerë në Gjykatën Administrative, për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 ó 31.12.2021.

Marrëdhëniet e pagave

Marrëdhëniet e pagave në SHFSH janë të përcaktuara sipas funksionit dhe kategorisë referuar ligjit Nr. 152/2013, òPër NËpunësin Civilò, VKM Nr.187, datë 8.3.2017 òPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektitò, VKM nr. 717, datë 23.06.2009, òPër pagat e punonjësve mbështetës të institucionit dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetoreò, të ndryshuar.

Pas auditimit të dokumentacionit (përmbledhëseve mujore të listëpagesave të punonjësve; borderotë e pagave), fondi i pagave jepet në tabelën e mëposhtme:

Viti 2019

Nr	Muaji	Paga Bruto Total (Lekë)
1	Janar	1,968,232
2	Shkurt	1,922,560
3	Mars	1,943,063
4	Prill	1,909,505
5	Maj	1,892,732
6	Qershor	1,828,457
7	Korrik	1,788,306
8	Gusht	1,944,026
9	Shtator	1,900,236
10	Tetor	1,896,627
11	Nëntor	1,920,720
12	Dhjetor	1,740,530
	Totali	22,654,994

Viti 2020

Nr	Muaji	Paga Bruto Total (Lekë)
1	Janar	1,929,683
2	Shkurt	1,975,462
3	Mars	2,121,772
4	Prill	2,167,926
5	Maj	2,218,392
6	Qershor	2,064,441
7	Korrik	1,877,285
8	Gusht	1,794,564
9	Shtator	1,839,940
10	Tetor	1,796,797
11	Nëntor	1,746,837

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

12	Dhjetor	1,852,933
	Totali	23,386,032

Viti 2021

Nr.	Muaji	Paga Bruto Total (Lekë)
1	Janar	1,724,288
2	Shkurt	1,774,235
3	Mars	1,904,912
4	Prill	1,811,560
5	Maj	1,874,212
6	Qershor	1,803,172
7	Korrik	1,762,161
8	Gusht	1,758,136
9	Shtator	1,830,618
10	Tetor	1,758,987
11	Nëntor	1,772,808
12	Dhjetor	1,812,822
	Totali	21,587,911

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Tetor, Nëntor, Dhjetor 2019; Shtator, Tetor, Nëntor 2020, si dhe Janar, Shkurt, Mars 2021. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të nënshkuara nga Përgjegjësja e Sektorit të Administratës, si dhe Drejtoresha e SHFSH. Punonjësit që përfitojnë shtesë për vështirësi pune janë përcaktuar me shkresat nr. 2032/3 prot, datë 16.11.2006 dhe nr. 2611/1 prot, datë 15.01.2007 të ministrisë përgjegjëse për punësimin (atëherë emërtuar Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta).

Në sektorin përkatës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 òPër tatimin mbi të ardhurat.

Drejtimi 3: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në lekë dhe valutë.

b) Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

c) Inventarizimi Pronës Shtetërore.

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në lekë dhe valutë, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2019-2021 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj..) të realizuara në Shtëpinë e Fëmijës òZyber Hallulli, Tiranë, rezultoi se, veprimet janë kryer konformë kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësiti të qeverisjes së përgjithshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konformë pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë në vlerën totale 45,690,141.00 lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë në vlerën totale 45,269,659.00 lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-30.06.2021 janë në vlerën totale 43,669,280.00 lekë;

Grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara në muajt Qershor, Korrik, Dhjetor të vitit 2019, muajt Korrik, Tetor, Dhjetor të vitit 2020 dhe Janar, Shkurt, Mars të vitit 2021. Grupi i auditimit përzgjedhi këto muaj pasi kanë përqindjen më të lartë të shpenzimeve mujore ndaj totalit. Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.* Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime, në përgjithësi nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre.

Nga financierja është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë viteve 2019-2021.

Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve në ditarin e bankës, shpenzimet janë regjistruar me numër rendor, në mënyrë kronologjike në kohë, në program të thjeshtë Excel dhe jo në program kompjuterik specifik për mbajtjen e kontabiliteti të njësisë shpenzuese, veprime të cilat nuk japin siguri në saktësinë dhe ruajtjen e të dhënave në kohe.

Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të përshkruar dhe të bashkëlidhur dokumentin justifikues si fatura tatimore, kontratat e lidhura për blerje/shërbim, flete-hyrje magazine. **Urdhër shpenzimi nuk përmban proces verbalin ose aktin e marrjes në dorëzim**, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", paragrafi 37.

37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontrate).

b. Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Grupi i auditimit, auditoi me zgjedhje dokumentacionin e magazinës për vitin 2019, 2020, 2021. Nga auditimi rezultoi se:

-Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

-Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar.

-Kontabilizimi i fletëve hyrjeve dhe fletëve daljeve është bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

veprimeve kryhet nga një specialistja financës. Fletë hyrje dhe fletë dalje, ndjekin rendin kronologjik (*me përjashtim të magazinës nr.3 dhe nr.4 për donacione, arsyetuar më poshtë*), ku ka adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë-shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; faturën tatimore të blerjes së mallit.

-Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina bëhet program Excel.

Nga auditimi rezultoi se:

Pas kontrollit të ditareve të magazinave 1, 2, 3 dhe 4, grupi i auditimit ka konstatuar se për hyrjet si dhe për daljet nga magazinat, magazinieri nuk kryen regjistrimin për hyrjet dhe daljet e artikujve sipas datave të hyrjes apo të daljes, por regjistrimi kryet sipas muajit në kundërshtim me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”*.

Lidhur me donacione, dhurime sponsorizime nga organizata, persona fizik ose juridik, në zbatim të Ligjit të Buxhetit Nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Ligjit nr.121/2016 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, Shtëpia e Fëmijës *“Zyber Hallulli”*, zhvillon aktivitetin e saj ku nuk gjeneron të ardhura. Burimi kryesor i të ardhurave është Buxheti i Shtetit si edhe disa donacione, dhurime sponsorizime nga organizata, persona fizik ose juridik të cilat shprehin dëshirën të ndihmojnë në plotësimin dhe cilësinë e nevojave të fëmijëve.

Nga auditimi rezultoi se: Për vitin 2019, NA me Urdhër nr. 10 prot, datë 03.01.2019, ka ngritur **komisionit për pritje donacioneve** i përbërë nga tre anëtarë, znj. B. Gj (Kryetar), znj. Xh. F (anëtar) dhe znj. K. L. (anëtar). Gjithashtu në datë 03.01.2019 me Urdhër nr.11 prot datë 03.2019 është ngritur **komisioni për vlerësimin e donacioneve**, i përbërë nga tre anëtare: znj. A. H (kryetar), znj. Xh. F (anëtar), z. E. S. (anëtar). Këto komisione kanë funksionuar për periudhën 03.01.2019-31.12.2019.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Anëtarët e komisionit nuk kanë firmosur deklaratën e konfliktit të interesit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, paragrafi nr. 82.

Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011

Pika 82: “Komisioni nuk duhet te jete me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi.”

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 në subjektin Shtëpia e Fëmijës *“Zyber Hallulli”*, totali i hyrjes si donacione, dhurime sponsorizime nga organizata, persona fizik ose juridik ka qenë **në vlerën 1,102,336 lekë**, për 22 fletë-hyrjesh (donacione) të kryera gjatë këtij viti.

Në thesar e trashëguar prej vitit 2018 e papërdorur gjendja si me poshtë:

Gjendje disponibël në thesar	50,230 (lekë)
Të ardhura nga sponsorë (2019)	0 (lekë)

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)

Gjithashtu u konstatua se shpërndarja e donacioneve sipas nevojave të institucionit për vitin 2019 ka qenë si më poshtë:

- Shpërndarja në **artikuj ushqimorë** ka qenë në vlerën 176,277 lekë për një total prej 98 fletë-daljesh.

- Shpërndarja në material industrialë ka qenë në vlerën 193,791 lekë për një total prej 59 fletë-daljesh.

Nga auditimi rezultoi se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka konstatuar se fletë-hyrjet apo fletë-daljet nuk kanë një rend kronologjik si dhe ekzistojnë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

fletë-hyrje pa numër, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 53.

Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011

Pika 53:” Kontrolllohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.”

Për vitin 2020, me urdhrin nr.5 prot, datë 09.01.2020, u ngrit **komisionit për pritje donacioneve** i përberë nga tre anëtarë: znj. B. Gj (Kryetar), znj. Xh F (anëtar) dhe znj. E. D (anëtar). Gjithashtu me urdhrin nr.7 prot, datë 09.01.2020 u ngrit urdhri u ngrit **komisioni për vlerësimin e donacioneve** i përbërë nga tre anëtare: znj. A. H (kryetar), znj. K. L (anëtar), z. E. S (anëtar). Këto komisione kanë funksionuar për periudhën 09.01.2020-31.12.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në subjektin Shtëpia e Fëmijës òZyber Hallulliò, totali i hyrjes si donacione, dhurime sponsorizime nga organizata, persona fizik ose juridikka qenë në vlerën 1,246,034 lekë, për 21 fletë-hyrjesh (donacione) të kryera gjatë këtij viti.

Në thesar e trashëguar prej vitit 2019 e papërdorur gjendja si me poshtë:

Gjendje disponibël në thesar	324,830 (lekë)
Të ardhura nga sponsorizimi (2019)	274,600 (lekë)

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)

Gjithashtu u konstatua se shpërndarja e donacioneve sipas nevojave te institucionit për vitin 2020 ka qenë si më poshtë:

- Shpërndarja në artikuj ushqimorë ka qenë në vlerën 211,011.50 lekë për një total prej 104 fletë-daljesh.

- Shpërndarja në material industrialë ka qenë në vlerën 170,342.6lekë për një total prej 31 fletë-daljesh.

Nga auditimi rezultoi se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka konstatuar se fletë-hyrjet apo fletë-daljet nuk kanë një rend kronologjik si dhe ekzistojnë fletë-hyrje pa numër, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 53.

Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011

Pika 53:” Kontrolllohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.”

Për vitin 2021 me Urdhrin nr.3 prot, datë 05.01.2021, u ngrit **komisionit për pritje donacioneve** i përberë nga tre anëtarë: znj. E.D (Kryetar), znj. M.I (anëtar) dhe znj. K. L (anëtar). Gjithashtu me Urdhrin nr.2 prot, datë 05.01.2021 u ngrit **komisioni për vlerësimin e donacioneve** i përbërë nga tre anëtare: znj. A.H (kryetare), znj. K. L. (anëtare), z. E. S (anëtarë). Këto komisione kanë funksionuar për periudhën 05.01.2021-31.12.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në subjektin Shtëpia e Fëmijës ”Zyber Hallulli”, totali i hyrjes si donacione, dhurime sponsorizime nga organizata, persona fizik ose juridikka qenë në vlerën 3,353,083 lekë për 34 fletë-hyrjesh (donacione) të kryera gjatë këtij viti.

Në thesar e trashëguar prej vitit 2020 e papërdorur gjendja si me poshtë:

Gjendje disponibël në thesar	492,790 (lekë)
Të ardhura nga sponsorizimi (2019)	167,960 (lekë)

(Burimi: SHFSHPunoi: KLSH)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Gjithashtu u konstatua se shpërndarja e donacioneve sipas nevojave të institucionit për vitin 2021 ka qenë si më poshtë:

- Shpërndarja në artikuj ushqimorë ka qenë në vlerën 94,340.00 lekë për një total prej 69 fletë-daljesh.

- Shpërndarja në material industrialë ka qenë në vlerën 2,347,892.47 lekë për një total prej 62 fletë-daljesh.

Nga auditimi rezultoi se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka konstatuar se fletë-hyrjet apo fletë-daljet nuk kanë një rend kronologjik si dhe ekzistojnë fletë-hyrje pa numër, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 53.

Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011

Pika 53:” Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.”

Më hollësisht hyrjet si donacione si dhe daljet për nevoja të institucionit për periudhën objekt auditimi në Aneksin nr. 1

c-Inventarizimi Pronës Shtetërore.

Objekti i këtij akt konstatimi është përputhshmëria në kryerjen e procesit të inventarizimit sipas me kriteret e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon Inventarizimi është kryer nga:

Për vitin 2019

Njësia shpenzuese ka kryer inventarizim sipas dokumentit òFlete inventari datë 31.12.2019ò nga Komisioni i Inventarizimit i përbërë nga: znj. A. H (Kryetare), F. A (anëtar) dhe Z. H (anëtar).

Për inventarizimin e aktiveve Komisioni i inventarizimit nuk ka mbajtur Proces Verbal, por në vend të tij ka mbajtur dokument të titulluar òFletë Inventariò.

Inventari fizik i kryer nga Komisioni i Inventarizimit për vitin 2019 paraqitet si më poshtë vijon:

- òFlete inventari datë 31.12.2019 “Ilogaria 312 “Materiale”, për 171 artikuj, në vlerë kontabël dhe fizike datë 31.12.2019 në shumën 6,793,812 leke , firmosur nga A. H, F. A dhe Z. H, pasqyruar korrekt në Formatin nr.1.

Në këtë llogari janë përfshirë dhe gjendjet kontabël të inventarit të Magazinës nr. 1 (Ushqimore –Shtet) në vlerë 942,566 leke; Magazinës nr. 2 (Industriale – Shtet) në vlerë 2,311,056 leke; Magazinës nr. 3 (Ushqimore - Donacion) në vlerë 90,356 lekë dhe Magazinës nr. 4 (Industriale ó Donacion) në vlerë 719,299 lekë.

Gjendja kontabël në shumën 4,063,277 lekë, për Magazinën nr.1; nr.2; nr.3; dhe nr.4, datë 31.12.2019, bashkëlidhur Pasqyrave Financiare 2019, përputhet me gjendjen kontabël datë 31.12.2019.

Flete Inventari për òMallra dhe materiale datë 31.12.2019							
Ilogaria 312		Inventar Fizik			Inventar Kontabël		
Flete Inventari (Nr. Rendor)	Përshkrimi	Sasi	Çmim	Vlere	Sasi	Çmim	Vlere
69	Magazina 1	-	-	942,566	-	-	942,566



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

70	Magazina 2	-	-	2,311,056	-	-	2,311,056
71	Magazina 3	-	-	90,356	-	-	90,356
72	Magazina 4	-	-	719,299	-	-	719,299

(Burimi: SHFSH/ Flete –Inventari 2019)

- òFlete inventari datë 31.12.2019ò **llogaria 327 “Inventar i imët”**, për 112 artikuj, në sasi dhe vlere, datë 31.12.2019 në shumen 3,189,239 leke, firmosur nga A. H, F. A dhe Z. H, pasqyruar korrekt ne Formatin nr.1

- “Flete inventari datë 31.12.2019” **llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”**, për 1 artikull òNdërtesëò, datë 31.12.2019, ne vlere fizike dhe kontabël në shumen 85,741,760 leke, firmosur nga A. H, F. A dhe Z. H. Vlora e mbetur e aktivitet ne 31.12.2018 është 73,185,912 leke. Amortizimi vjetor 5%=3,659,346 leke, vlerë qe i shtohet amortizimit te akumuluar ne total 6,214,193 lekë. Vlora neto e aktivitet mbetet 69,527,567 leke, pasqyruar korrekt ne llogarinë 212 të Formatit nr.1 .

- “Flete inventari datë 31.12.2019” **llogaria 214 “Instalime, makineri dhe pajisje”**, për 51 artikuj , datë 31.12.2019, ne vlere fizike dhe kontabël në shumen 17,837,985 leke , firmosur nga A. H, F. A dhe Z. H. Kosto historike e llogarisë 214 në shumën 17,837,985 leke, përputhet me koston historike te Formatit nr.7/b, amortizimi akumuluar ne vlere 8,891,582 lekë, vera neto e aktivitet në shumën 6,946,403 leke përputhet me llogarinë 214 te pasqyror ne zërin AAM , Formatit nr.1

Në këtë dokument është përfshire ne vlerë dhe zëri òMagazina 214ò ne vlere 300,641 lekë. Kjo vlerë përputhet me dokumentin òGjendje në magazine, llogaria 214ò bashkëlidhur bilancit 2019, vlere që paraqet gjendjen kontabël për:- (8 cope) pajisjeve kompjuterike (cilësuar jashtë përdorimi, (2 cope) frigorifer, (2 cope) frigorifer-banak, pasqyruar ne vlere kontabël ne gjendjen e llogarisë 214, bashkëlidhur bilancit 2019, firmosur nga magazinieri z. A. D. Grupi i Auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka konstatuar se **Komisioni i Inventarizimit nuk ka kryer inventarizim fizik për këto aktive.**

“Flete inventari datë 31.12.2019” **llogaria 215 “Mjete transporti”**, për 1 artikull (Furgoni), datë 31.12.2019, ne vlere fizike dhe kontabël në shumen 2,820,000 leke , firmosur nga A.H, F. A dhe Z. H. Amortizimi vjetor është llogaritur me norme vjetore =5% ne shumen 95,900 leke duhet 20%, vlere qe i shtohet amortizimit te akumuluar dhe ne total vlora e mbetur e aktivitet rezulton 1,622,099 leke, pasqyruar korrekt ne shumen 1,822,099 lek në Formatit nr.1 (efektet e normës se amortizimit do te pasqyrohen ne pjesën e trajtimit te bilancit)

- “Flete inventari datë 31.12.2019” **llogaria 218**, òInventar ekonomikò për 50 artikuj, datë 31.12.2019, ne vlere kontabël historike në shumen 9, 513,619 leke , firmosur nga A. H, F. A dhe Z.H.

Këtu përfshihet gjendja ne magazine e aktiveve në vlerë ne total 1,419,971 lekë, për zyra për 3 artikuj ne shume 41,400 leke dhe për te tjera gjendje ne magazine (28 artikuj) ne shumën 1,378,571 lekë. Për aktivet e trashëguara, shtesat/pakësimit e vitit amortizim vjetor llogaritet ne shumen 799,606 leke dhe amortizim i akumuluar ne shumen 5.312.299 lekë. Vlora e mbetur e aktivitet rezulton ne shumen 4,201,320 leke dhe përputhet me gjendjen e Inventarit Ekonomik, Formatit nr.1. Komisioni inventarizimit për aktivet e përfshira në òllogarinë 2018ò, nuk ka pasqyruar të dhëna mbi verifikimin e sasisë dhe vlerës se aktiveve të pasqyruar në këtë dokument, tregues ky për mos kryerjen e inventarit fizik.

Njësia shpenzuese për daljet jashtë përdorimi ka ngritur komisionet:

1. Komisioni Inventarizimit përbërë nga: 1. A. H (Kryetare); 2. F. A; 3. Z. H
2. Komisioni Vlerësimit për daljet jashtë përdorimi nga: 1. A. H (kryetare); 2. Xh. F; 3. F. R; 4. F. A; 5. Z. H.
3. Komisioni nxjerrjes jashtë përdorimi nga: 1. A. Zh (kryetare); 2. E S; 3. A. D.

Komisioni inventarizimitpër daljet jashtë përdorimi, ka mbajtur **Proces Verbal nr.1, datë 20.12.2019**, në të cilin ka pasqyruar listën e aktiveve (gjendje kontabël) ne vlere 376.037 leke që do ti nënshtrohen vlerësimit për llogarinë 214 ne vlere 62.000 leke për dy artikuj; llogarinë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

218 për 9 artikuj, ne vlere 104.639 leke; llogarinë 327 për 54 artikuj ne vlere 209.398 leke. Njësia Shpenzuese nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve, ka kryer procesin e vlerësimit sipas **Proces Verbalit Vlerësimit nr.2, datë 20.12.2019**, mbështetur ne listën e aktiveve për vlerësim (proces verbali nr.1) dhe gjendjes teknike të aktiveve, kohën e vënies ne shfrytëzim, duke vlerësuar rast për rast artikujt që do të asgjësohen, dhe përcaktuar shkakun për asgjësim (nuk punon, thyer, e vjetër),. Komisioni i Vlerësimit këtij proces verbalit, ka vlerësuar për asgjësim vlerën e aktiveve **ne total 376.037 leke**.

Për asgjësimin e aktiveve, njësia shpenzuese ka ngritur **Komisionin e Asgjësimit të Aseteve**, përberë nga znj. K. L (Kryetar); Xh. F (anëtar); E. S (anëtar). Komisioni Asgjësimit ka mbajtur **Proces Verbal nr. 3, datë 23.12.2019**, mbi asgjësimin e asetëve listuar ne Proces verbalin nr. 2 datë 20.12.2019. Komisioni Asgjësimit ka përpiluar Relacion (pa numër dhe datë) për objektet e asgjësuar, firmosur nga Komisioni Asgjësimit, miratuar nga Drejtori znj. S. L.

Nga auditimi rezulton se:

1. N. Z nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, Kreun III, paragrafi nr. 26; 27; 28 dhe 30, sipas të cilit:

26. *Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka ne administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet ne formën e kartelave ose ne formë të sintetizuar.*

27. *Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e Regjistrit.*

28. *“Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë”;*

30. *“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

2.Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit për anëtarët e Komisionit të Inventarizimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafin 82.

82. Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi sipas Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”*. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara ne paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.

3.Komisioni inventarizimit ka funksionuar ne mungesë të një urdhri të posaçëm të lëshuar nga NA, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafin 81. Ne Komisionin e Inventarizimit bën pjese znj. A. H, e cila është përgjegjëse e Sektorit të Administratës dhe financiere e njësisë shpenzuese. Veprimi i vendosjes së drejtuesit dhe specialistit të financës në komisionin e inventarizimit, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 22, germa 3.b të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar-

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Neni 22, germa 3.b: *“ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin,*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave”.

81. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të Titullarit të njësisë publike ose Nëpunësit Autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

4. Në mungesë të një Urdhri të NA, rezulton se njësi shpenzuese ka ngritur dy komisione inventarizimi, përkatësisht Komisioni Inventarizimit (dokument Flete-Inventari datë 31.12.2019) dhe Komisioni Inventarizimit dhe Vlerësimit për daljet jashtë përdorimi (dokument proces verbalit nr.1, datë 20.12.2019), në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* paragrafi 81, i cili kërkon ngritjen vetëm të një komisioni. Fletët e Inventarit nuk janë firmosur nga punonjësi që ka në ngarkim aktivitet, veprime në kundërshtim të Ministrisë së Financave me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* paragrafin 82.

82. Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivitet, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.

5. Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventarizim fizik dhe mbajtur Proces Verbal për gjendjen në sasi dhe vlerë të magazinës nr. 1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 *“Mallra ushqimore”* dhe llogarisë 327 *“Inventar i imët”,* veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* paragrafin 83.

Grupi i auditimit ka konstatuar se në fletë inventarin për;

-llogarinë 214 *“Instalime, makineri dhe pajisje”* zëri magazina 214 është shprehur vetëm në vlerë kontabël dhe nuk shprehet sasia, çmimi artikujve.

-llogarinë 218 *“Inventar ekonomik”* zëri magazina 218 është shprehur vetëm në vlerë kontabël dhe nuk shprehet sasia, çmimi artikujve.

-llogarinë 312 *“Materiale”* zëri magazina 1, 2, 3 dhe 4 është shprehur vetëm në vlerë kontabël dhe nuk shprehet sasia, çmimi artikujve.

83. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbal të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.

6. Grupi i Inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal mbi të dhënat e inventarizimit, mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes në ngarkim/ përdorim **te personelit të njësisë publike**, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* paragrafin 85 germa *“a”*.

85, germa “a”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a-Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..

7. Lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, Komisioni Inventarizimit nuk ka përpiluar një Raport për NA, për kushtet e ruajtjes së aktiveve, gjendjen fizike të konstatuar, aktivitetet e dëmtuara, personat përgjegjës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* paragrafit 85 germa *“c”*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

85, germa “c”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :c.-Te përpiloje një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje përveprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

8. Për daljet jashtë përdorimi nga N.Z mungon propozimi për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve dhe nga NA mungon lëshimi i Urdhrit për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit. Anëtar i komisionit është edhe magazinieri në njësi publike z. A. D, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 99.

99. Komisioni Vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxhere ose specialistë të financës si dhe specialiste të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit..

9.NA nuk ka lëshuar urdhër për ngritjen e Komisionit e Nxjerrjes jashtë përdorimi. Komisioni Vlerësimit (pa Urdhër titullari) përbëhet nga 3 vete dhe jo 5 vete, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 100.

100. Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vete, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari në varësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi.

10.Për daljet jashtë përdorimi Komisioni i Vlerësimit ka nënshkruar Proces Verbal Vlerësimi nr. 2, datë 20.12.2015 (pa numër dhe datë protokoll). Por ky proces verbal nuk është nënshkruar nga përgjegjësi material, nuk është hartuar në tre kopje, dhe nuk është protokolluar në arkiv, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 102.

102. Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

11. Proces Verbal Vlerësimit nr. 2, datë 20.12.2015 nuk ka argumentuar arsyet e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi, dhe pas vlerësimit mungesë për përcaktimin nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 104 germa òcò.

104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

- nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë;
- nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;
- nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.

12. Proces Verbal Vlerësimit nr. 2, datë 20.12.2015 i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, nuk është mbajtur në 3 kopje, nuk është nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nuk është miratuar nga titullari i njësisë publike,veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 105.

105. Proces Verbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Proces verbali miratohet nga titullari i njësisë publike.

13. Komisioni i Vlerësimit nuk ka hartuar dhe njoftuar Relacion Vlerësimi, për te treguar procesin vlerësimit, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafi 106.

106. Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit te vlerësimit.

12. Komisioni Asgjësimit ka hartuar Relacion (*pa numër dhe datë*) për objektet e asgjësuar, për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi me shkatërrim, por nuk ka evidentuar mënyrën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafi 109.

109. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshëm, hiqen nga regjistri i aktiveve ne përdorim, bëhen hyrje ne magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre

Viti 2020

Ne kuadrin e menaxhimit te aktiveve, njësia shpenzuese ka kryer inventarizimin e aktiveve të saj, në përmbushje të zbatimit të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011,

NA ka krijuar Komisionin e Inventarizimit të Aseve, me **Urdhër nr.10 prot, datë 09.01.2020**. Komisioni përbehet nga znj. Xh. F (anëtar), F. A (anëtar) dhe Z. H (anëtar), duke funksionuar për periudhën 05.01.2020 deri 31.12.2020.

Komisioni Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve sipas dokumentit *“Flete-Inventari datë 31.12.2020”* për artikujt që i përkasin:

- *“Flete inventari datë 31.12.2020”*, **llogaria 312 “Materiale”**, firmosur nga Komisioni Inventarizimit dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues z. S. L, për ekzistencën në sasi 141 artikuj inventari, në vlerë kontabël dhe fizike në shumën **6,353,192 lekë**. Totali i llogarisë 312 rakordon me postin e Aktivit te Bilancit 2020.

Në këtë *“Flete Inventari”* konstatohet se nga Komisioni Inventarizimit nuk janë verifikuar fizikisht dhe cilësisht gjendja e aktiveve *“Magazina 1”* në vlere 525,352 lekë; *“Magazina 2”* në vlere 2,152,228 leke; *“Magazina 3”* në vlere 10,330 lekë, *“Magazina 4”* në vlere 1,002,436 leke, ne total **3,690,346 lekë**, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafi 73.

Flete Inventari për *“Mallra dhe materiale datë 31.12.2020”*

Llogaria 312		Inventar Fizik			Inventar Kontabël		
Nr. rendor	Përshkrimi	Sasi	Çmim	Vlere	Sasi	Çmim	Vlere
61	Magazina 1	-	-	525,352	-	-	525,352
62	Magazina 2	-	-	2,152,228	-	-	2,152,228
63	Magazina 3	-	-	10,330	-	-	10,330
64	Magazina 4	-	-	1,002,436	-	-	1,002,436

(Burimi: SHFSH/ Flete –Inventari 2020)

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.

- ÷Flete inventari datë 31.12.2020, **llogaria 327 “Inventar i imët”**, për 77 artikuj, në sasi dhe vlerë, datë 31.12.2020 në shumën **2,815,292 lekë**, firmosur nga Komisioni Inventarizimit për vitin 2020, miratuar nga NA, pasqyruar korrekt në Formatin nr.1.

-÷Flete inventari datë 31.12.2020, llogaria **212 “Ndërtesa dhe konstruksione”**, për 1 artikull ÷Ndërtesë, datë 31.12.2020, në vlerë fizike dhe kontabël në shumën **85,741,760 leke**, firmosur nga Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Vlera e mbetur e aktivitetit në 31.12.2020 është 66,051,189 leke. Amortizimi vjetor 5%=3,476,378 leke, vlerë që i shtohet amortizimit të akumuluar e cila në total arin shumën 19,690,571 lekë. Vlera neto e aktivitetit mbetet 66,051,189 leke, pasqyruar korrekt në llogarinë 212 të Formatit nr.1 .

-÷Flete inventari datë 31.12.2020, **llogaria 214 “Instalime, makineri dhe pajisje”**, për 49 artikuj, datë 31.12.2020, në vlerë fizike dhe kontabël në shumën **17,812,985 leke**, firmosur nga Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Vlera neto e aktivitetit llogaritur në shumën 7,122,508 lekë, përputhet me llogarinë 214 të pasqyror në zërin AAM, Formatin nr.1

-÷Flete inventari datë 31.12.2020, **llogaria 215 “Mjete transporti”**, për 1 artikull (Furgoni), datë 31.12.2019, në vlerë fizike dhe kontabël në shumën 2,820,000 leke, firmosur Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Amortizimi vjetor është llogaritur me norme vjetore =20% në shumën 364,324 leke . Vlera e mbetur e aktivitetit rezulton 1,457,679 leke, pasqyruar korrekt Formatin nr.1.

- ÷Flete inventari datë 31.12.2020, **llogaria 218, “Inventar ekonomik”** për 51 artikuj, datë 31.12.2020, në vlerë kontabël historike në shumën **10,186,619 leke**, firmosur Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA.

Në këtë Flete- Inventari janë përfshirë vlera e aktiveve gjendje në magazine “Magazina 218 gjendje 31.12.2019” për zyra për 3 artikuj në shume 41,400 leke dhe për të tjera gjendje në magazine (31 artikuj) në shumën 2.001.571 leke, në total **2.042.971 lekë**.

Flete Inventari për ÷Mallra dhe materiale datë 31.12.2020,							
llogaria 218		Inventar Fizik			Inventar Kontabël		
Nr rendor	Përshkrimi	Sasi	Çmim	Vlerë	Sasi	Çmim	Vlerë
23	Magazina 218	-	-	2,042,971	-	-	2,042,971

Për aktivitetet e trashëguara, shtesat/pakësimi gjatë vitit është llogaritur amortizim vjetor në shumën 935,324 leke dhe amortizim i akumuluar në shumën 6.247.623 lekë. Vlera e mbetur e aktivitetit rezulton **në shumën 3,938,996 leke** dhe përputhet me gjendjen e Inventarit ekonomik në formatin nr.1. Komisioni inventarizimit dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Nga Flete-Inventarit vitit 2020, ka rezultuar se nuk ka diferencë të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet, të mallrave në magazinë dhe në përdorim

Njësia shpenzuese për vitin 2020 për daljet jashtë përdorimi ka ngritur komisionet:

1. Komisionin e Inventarizimit ngritur me **Urdhër nr. 10 prot, datë 09.01.2020**. Komisioni përbehet nga znj. Xh. F (anëtar), F. A (anëtar) dhe Z. H (anëtar), duke funksionuar për periudhën 05.01.2020 deri 31.12.2020. Komisioni ka kryer inventarizimin dhe me pas me Proces Verbal nr. 1, datë 20.08.2020 identifikuar aktivitetet që do të dalin jashtë përdorimi.

2. Komisioni Vlerësimit për Daljet Jashtë përdorimi ngritur me **Urdhrit nr. 12, datë 09.01.2020**, datë 09.01.2020. nga: 1. A. H (Kryetare); 2. M. H; 3. L. B.

3. NA me **Urdhër nr. 9, datë 09.01.2020**, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Asgjësimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

të Aktiveve, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2020 deri 31.12.2020 .Në përbërje të tij janë 5 anëtarë, përkatësisht: 1. znj. K. L (Kryetar); 2. z.E. S (anëtar); 3. znj. B. I (anëtar); 4. Znj. Xh. F (anëtar) dhe 5.znj. A. Xh (anëtar). Komisioni Asgjësimit, ndryshuar përbërje me Urdhrin nr. 9/1 prot, datë 10.11.2020, për shkak të largimit nga detyra të anëtares së komisionit znj. Xh. F (me dorëheqje datë 10.11.2020) dhe zëvendësimin e anëtares së larguar me znj. K. R.

Komisioni Inventarizimit ngritur nga NA me Urdhër nr. 10 prot, datë 09.01.2020 ka mbajtur **Proces Verbal nr.1**, datë 20.08.2020, në të cilin ka pasqyruar listën e aktiveve (*gjendje kontabël*) në vlerë totale **516,877 leke**, për aktive që do të nënshtrohen vlerësimit nga njësia shpenzuese për llogarinë 214 në vlerë 25.000 leke për 1 artikull; llogarinë 218 në vlerë 67,690 leke për 29 artikuj, për llogarinë 327 në vlerë 424,187 leke për 16 artikuj.

NA nëpërmjet **Urdhrit nr. 12, datë 09.01.2020** urdhëron ngritjen e **Komisionit për Vlerësim të Aktiveve** që do të dalin jashtë përdorimi. Komisioni përbëhet nga kryetari që është edhe NZ dhe 2 anëtare. Komisioni të Vlerësimit për aktivet që do të dalin jashtë përdorimi, ka mbajtur **Procesin Verbal nr.2, datë 20.11.2020**, duke vlerësuar për asgjësim vlerën e aktiveve **ne total 516.677 leke**, mbështetur në listën e aktiveve për vlerësim (proces verbali nr.1, datë 20.08.2020), bazuar në gjendjen teknike të aktiveve, kohën e vënies në shfrytëzim, duke vlerësuar rast për rast artikujt që do të asgjësohen, dhe përcaktuar shkakun për asgjësim (nuk punon, thyer, e vjetër).

NA me **Urdhër nr. 9, datë 09.01.2020**, ka urdhëruar ngritjen e **Komisionit për Asgjësim të Aktiveve**, në përbërje të të cilit janë kryetari plus 4 anëtarë. Komisioni Asgjësimit do të funksionojë për periudhën 05.01.2020 deri 31.12.2020, ndryshuar me Urdhrin nr. 9/1 prot, datë 10.11.2020, për shkak të largimit nga detyra të anëtares së komisionit znj. Xh. F (me dorëheqje datë 10.11.2020) dhe zëvendësimin e anëtares së larguar me znj. K. R. Komisioni Asgjësimit ka mbajtur **Proces Verbal nr. 3, datë 23.12.2020**, për asgjësimin e Aktiveve të listuar në Proces Verbalin nr. 2 datë 20.12.2019 dhe ka përpiluar Relacion (*pa numër dhe datë, pa firmosur nga Kryetare e Komisionit*), miratuar nga NA.

Komisioni i Asgjësimit mbështetur Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve, vendosi të asgjësojë aktivet në vlerë 516,677 lekë, në prani të gjithë Komisionit për aktivet e listuar në Proces Verbalin nr. 2, dt. 23.12.2020, duke dhënë arsyen e vlerësimit për çdo artikull.

Nga auditimi rezulton se:

1. N. Z nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”*, Kreun III, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30, sipas të cilit:

26. *Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.*

28. *“Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë”;*

30. *“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

2. Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit për anëtarët e Komisionit të Inventarizimit sipas Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”*,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

paragrafin 82.

82. Komisioni nuk duhet te jete me pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi sipas Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 òPër parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publikeò. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara ne paragrafin 13 dhe 14 te këtij udhëzimi.

3. Me Urdhër nr. 10 prot, datë 09.01.2020, NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit. Komisioni ka në përbërje të tij znj. F. A (anëtar) dhe Z. H (anëtar), të cilët janë anëtarë të Komisionit të Inventarizimit edhe në vitin paraardhës 2019, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publikò, paragrafi 84.

84. Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhe në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

4. Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventarizim dhe mbajtur Proces Verbal për gjendjen ne sasi dhe vlere e magazinës nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 òMallra ushqimoreò dhe llogarisë 327 òInventar i imëtò, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publikò, paragrafin 83.

83. *Para fillimit te inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbali te mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit te inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet ne prani te komisionit dhe përgjegjësit material.*

5. Komisioni Inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal mbi të dhënat e inventarizimit, mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes në ngarkim/përdorim te personelit te njësisë publike, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publikò, paragrafin 85 germa òaò.

85, germa “a”: *Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a-Verifikimin fizik dhe cilësor te gjendjes se aktiveve ne ngarkim/përdorim te personelit te njësisë publike dhe pasqyrimin e te dhënave te inventarizimit ne proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjate periudhës se inventarizimit.*

6. Lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, Komisioni Inventarizimit nuk ka përpiluar një Raport për NA, për kushtet e ruajtjes se aktiveve, gjendjen fizike te konstatuar, aktivet e dëmtuara, personat përgjegjës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafit 85 germa òcò .

85, germa “c”: *Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :c.-Te përpiloje një raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje për veprime te mëtejshme Nëpunësit Autorizues-*

7. Për daljet jashtë përdorimi, Komisioni i Vlerësimit ka nënshkruar Proces Verbal Vlerësimi nr.2, datë 20.12.2020 (pa numër dhe datë protokolli). Ky proces verbal nuk është nënshkruar nga përgjegjësi material. Komisioni Vlerësimit nuk ka argumentuar arsyet e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi, dhe pas vlerësimit nuk ka përcaktuar nëse këto aktive duhet te dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbal nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar ne arkiv, nuk është miratuar nga NA, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”, paragrafi 100, 104 germa òcò, 105.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTRËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar se nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet, të mallrave në magazinë dhe në përdorim, por prej tij nuk është hartuar Raport mbi inventarizimin fizik në njësinë shpenzuese për vitin 2020, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 106.

102. Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

105. Proces Verballi hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Proces verballi miratohet nga titullari i njësisë publike

104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

a. nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë;

b. nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;

c. nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.

106. Relacioni i vlerësimit përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

8. Komisioni Asgjësimit ka hartuar Relacion (pa numër dhe datë) për objektet e asgjësuar, për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimit, por nuk ka përcaktuar mënyrën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies).

109. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshëm, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

Viti 2021

Në kuadrin e menaxhimit të aktiveve, njësi shpenzuese ka kryer inventarizimin e aktiveve të saj.

NA, në zbatim të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, ka krijuar Komisionin e Inventarizimit me **Urdhër nr. 44 prot, datë 11.11.2021**. Komisioni përbehet nga znj. A. H (Kryetar), E. D (anëtar) dhe Z. H (anëtar), dhe ka funksionuar për periudhën 11.11.2021 deri 31.12.2021. Komisioni Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve sipas dokumentit oflete- Inventari datë 31.12.2020 për artikujt që i përkasin:

- “Flete inventari datë 31.12.2021, llogaria 312 “Mallra dhe Materiale”, firmosur nga Komisioni Inventarizimit dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues z. S. L, për ekzistencën në sasi 56 artikuj inventari, në vlerë kontabël dhe fizike në shumën **5,988,118 lekë**. Totali i llogarisë 312 rakordon me postin e Aktivitet të Bilancit 2021. Në këtë Fletë Inventari konstatohet se nga Komisioni Inventarizimit nuk janë verifikuar fizikisht dhe cilësisht gjendja e aktiveve: Magazina 10 në vlerë 907,420 lekë; Magazina 20 në vlerë 2,224,340 leke; Magazina 30 në vlerë 21,310 lekë, Magazina 40 në vlerë 1,440,955 leke, në total **4,594,026 lekë**, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 73.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Flete Inventari për òMallra dhe materiale datë 31.12.2020ò							
Llogaria 312		Inventar Fizik			Inventar Kontabël		
Nr. Rendor	Përshkrimi	Sasi	Çmim	Vlere	Sasi	Çmim	Vlere
61	Magazina 1	-	N/A	907,420	-	-	907,420
62	Magazina 2	-	N/A	2,224,340	-	-	2,224,340
63	Magazina 3	-	N/A	21,310	-	-	21,310
64	Magazina 4	-	N/A	1,440,955	-	-	1,440,955
	Total						4,594,026

(Burimi: SHFSH/ Flete –Inventari 2021)

73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli ne kuadrin e menaxhimit te aktiveve te njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin ne mënyrën e duhur dhe me eficencë te tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.

-òFlete inventari datë 31.12.2021ò, **llogaria 327 “Inventar i imët”**, për 167 artikuj, në sasi dhe vlere, datë 31.12.2021 në shumen **4,642,962 lekë**, firmosur nga Komisioni Inventarizimit për vitin 2021, miratuar nga NA, vlerë e cila rakordon me gjendjen e aktivitet në Formatin nr.1. Nga flete inventari konstatohet se Financieri ka kryer sistemime të llogarisë 327 (inventar i imët) duke kaluar nga llogaria 214 (makineri dhe pajisje) dhe llogaria 218 (Inventar ekonomik) aktive me vlerë nën 10,000 lekë. Gjendja e pas sistemimit datë 31.12.2021 rezulton:

Gjendja 31.12.2021 (llogaria 327)

Gjendja 31.12.2020	2,815,292
Dalje jashtë përdorimi	-88,624
Sistemim nga òllogaria 218ò	-851,436
Sistemim nga òllogaria 312ò	870,436
Hyrje gjate vitit 2021	1,896,835
Gjendje 31.12.2021	4,642,962

-òFlete inventari datë 31.12.2021ò, **llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”**, për 1 artikull òNdërteseò, datë 31.12.2021, ne vlere fizike dhe kontabël në shumen 85,741,760 leke, firmosur nga Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Vlora e mbetur e aktivitet në 31.12.2020 është 66,051,189 leke. Amortizimi vjetor 5%=3.302.559 leke, vlerë që i shtohet amortizimit të akumuluar e cila ne total arin shumen 22.993.130 lekë. Vlora neto e aktivitet mbetet 62.748.630 leke, përputhen me llogarinë 212 gjendjen në Formatin nr.1.

-òFlete inventari datë 31.12.2021ò, **llogaria 214 “Instalime, makineri dhe pajisje”**, për 49 artikuj , datë 31.12.2021, ne vlere fizike dhe kontabël në shumen 17.471.705 leke , firmosur nga Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Vera neto e aktivitet llogaritur në shumën 7,122,508 lekë, përputhet me llogarinë 214 te pasqyror ne zërin AAM , Formatin nr.1

Në këtë òFletë Inventariò konstatohet se nga Komisioni Inventarizimit nuk ka verifikuar fizikisht gjendjen e aktiveve òMagazina 214ò për vlerën 300.641 lekë, vlere e pasqyruar ne gjendjen e magazinës 218, firmosur nga magazinieri i institucioni dhe bashkëlidhur Bilancit 2021.

-òFlete inventari datë 31.12.2021ò, **llogaria 215 “Mjete transportiò**, për 1 artikull (Furgoni), datë 31.12.2021, ne vlerë fizike dhe kontabël në shumen 2,820,000 leke, firmosur Komisioni Inventarizimit, miratuar nga NA. Amortizimi vjetor është llogaritur me norme vjetore =5% dhe jo 20% ne shumen 72.884 leke , amortizimi akumuluar llogaritet 1.435.205 lekë. Vlora e mbetur e aktivitet rezulton 1.384.795 leke, përputhet me gjendjen e llogarisë 214, Formatin nr.1. (efektet e normës se amortizimit trajtuar ne analizën e bilancit 2021).

- òFlete inventari datë 31.12.2021ò, **llogaria 218, “Inventar ekonomikò** për 68 artikuj, datë 31.12.2021, ne vlere kontabël historike në shumen **11.893.712 leke** , firmosur Komisioni

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Inventarizimit, miratuar nga NA. Ne këtë gjendje inventari është përfshirë òMagazina 218ò, ne vlere kontabël **2,632,971 lekë, e cila paraqet gjendjen kontabël të aktiveve** ne ngarkim të magazinierit, që paraqet aktivet karrige (tre), komodin (një), tavolinë (dy) **ne total 41,400 leke**; kompjuter (tete), frigorifer (dy) dhe frigorifer banak (dy) ne totale **300,641 lekë** si dhe aktive të tjera gjendje ne magazine òLlogaria 218ò,për 40 artikuj, **në total 2.591.571 leke**. Për aktivet e trashëguara, shtesat/pakësimi gjatë vitit është llogaritur amortizim vjetor ne shumen 858.020 leke dhe amortizim i akumuluar ne shumen 7.105.643 lekë. Vlera e mbetur e aktivitet rezulton ne shumen 4.788.069 leke, përputhet me gjendjen e aktivitet në Formatin nr.1.

Flete Inventari për òMallra dhe materiale datë 31.12.2020ò,							
Llogaria 218		Inventar Fizik			Inventar Kontabël		
Nr. rendor	Përshkrimi	Sasi	Çmim	Vlere	Sasi	Çmim	Vlere
23	Magazina 218	-	-	2.632.971	-	-	2.632.971

Nga flete inventari konstatohet se Financieri ka kryer sistemime të llogarisë 218 (inventar ekonomik) duke shtuar llogarinë 2018 në vlere 397,860 lekë dhe duke pakësuar në të njëjtën vlere llogarinë 312, duke shtuar llogarinë 2018 ne vlere 851,436 lekë duke pakësuar llogarinë në të njëjtën vlere llogarinë 327; hyrje gjate vitit ne vlere 882,797 lekë si dhe pakësim për dalje jashtë përdorimi në vlerë 425,000. Gjendja në fund te vitit 2021, rakordon me inventarët datë 31.12.2021 si më poshtë: (llogaria 218)

Gjendja 31.12.2020	10,186,619
Dalje jashtë përdorimi	-425,000
Sistemim nga òllogaria 312ò	397,860
Sistemim nga òllogaria 327ò	851,436
Hyrje gjate vitit 2021	882,797
Gjendje 31.12.2021(llogaria 218)	11,893,712

Komisioni inventarizimit ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit. Nga Flete-Inventarit të vitit 2021, ka rezultuar se nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet, të mallrave në magazinë dhe në përdorim.

Nga auditimi konstatohet se Financieri ka kontabilizuar të njëjtin aktiv ne llogari të ndryshme si:

Artikulli	Llogaria	Gjendja Fizike/ Kontabël		
		Sasi	Çmimi	Vlere
Kalceto	Llogaria.218	3	80,000	240,000
Kalceto	Llogaria 214	2	400,000	800.000
TV	Llogaria 218	1	10,000	10,000
TV Përdorur	Llogaria 218	1	10,000	10,000
TV	Llogaria 214	1	50,000	50,000
TV	Llogaria 214	1	30,000	30,000
TV Philips	Llogaria 214	1	36,000	36,000
Kompjuter	Llogaria 218	3	65,199	195,597
Kompjuter	Llogaria 214	1	41,000	41,000
Kompjuter	Llogaria 214	13	41,020	533,260
Kompjuter Agis	Llogaria 214	1	100,000	100.000
Kompjuter Samsung	Llogaria 214	1	25.000	25.000
Kompjuter Samsung	Llogaria 214	2	69.369	138.738
Kompjuter Likom	Llogaria 214	1	53.000	53.000
Etj....	Llogaria 218			
Etj....	Llogaria 214			



Komisioni i Inventarizimit i përbërë nga znj. A. H (kryetare); zj. E. D (anëtare); znj. Z. H (anëtare), ka mbajtur në **Proces Verbal nr.1, datë 20.12.2021**, sipas të cilit ka përcaktuar listën e aktiveve (*gjendje kontabël*) ne vlere totale **854.904 leke** që do ti nënshtrohen vlerësimit për dalje jashtë përdorimi nga njësia shpenzuese. Aktivet për dalje jashtë përdorimi përbëhen nga: për 1 artikull ÷llogari 2140 ne vlere 341.280 leke; për 3 artikuj ÷llogari 2180 ne vlere 425.000 leke, për 13 artikuj ÷llogari 3270.

Komisionit për Vlerësim të Aktiveve, ngritur me **Urdhër nr. 44, datë 11.11.2021** nëpërmjet **Procesin Verbal nr.2, datë 20.11.2020**, ka vlerësuar për asgjësim vlerën e aktiveve ne total **854,904 leke**, mbështetur ne listën e aktiveve për vlerësim (proces verbali nr.1, datë 20.12.2021), bazuar ne gjendjen teknike te aktiveve, kohën e vënies ne shfrytëzim, duke vlerësuar rast për rast artikujt qe do te asgjësohen, dhe përcaktuar shkakun për asgjësim (nuk punon, thyer, e vjetër).

NA me **Urdhër nr. 43, datë 11.11.2021**, ka ngritur **Komisionin e Asgjësimit të Aktiveve**, në përbërje të të cilit janë: 1- E. S (Kryetar); 2- M. H (anëtar); 3-A. M (anëtar); 4- L. B (anëtar); 5- A. Xh (anëtar), i cili ka funksionuar për periudhën 11.11.2021 deri 31.12.2021.

Komisioni Asgjësimit ka mbajtur **Proces Verbal nr. 3, datë 23.12.2021**, për asgjësimin e aktiveve të përcaktuara sipas listës se aktiveve, Proces verbalin nr. 2 datë 21.12.2021, dhe ka vendosur asgjësimin e aktive te vlerësuar për dalje jashtë përdorimit, me përjashtim të 6(gjashtë) artikujve elektronik, në vlerë totale 451.280 leke. Këto aktive (elektronike), janë në ruajtje në magazinën e njësisë shpenzuese, deri në moment të dytë, për asgjësimin e tyre sipas procedurës se përcaktuar për asgjësim në VKM nr.957, datë 19.12.2012 ÷Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

Komisioni i Asgjësimit ka përpiluar Relacion për objektet e asgjësuar (pa numër dhe datë protokolli). Relacioni është firmosur nga Komisioni Asgjësimit dhe miratuar nga NA.

Grupi i auditimit kreu **sondazhe të kontrollit fizik të magazinave**, për të verifikuar kryerjen e sakte të inventarizimit dhe përputhjet e tij me inventarin kontabël. Vlen të përmendet se nga sondazhi me përzgjedhje për aktive të ndryshëm në **llogaria 214 “Instalime, makineri dhe pajisje”** si dhe në **llogarinë 218, “Inventar ekonomikë nuk rezultuan diferenca ndërmjet gjendjes fizike në magazinë dhe asaj kontabël.**

Nga verifikimi i magazinës u konstatuan 6 (gjashtë) pajisje elektronike në vlerë 451,280 lekë, të cilat janë të pa papërdorshme, gjendje në magazinë dhe vlerësuar për asgjësim sipas procedurës se përcaktuar për asgjësim në VKM nr.957, datë 19.12.2012 ÷Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

Nga auditimi rezulton se:

1. NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për *menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*”, Kreun III, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30, sipas të cilit:

26. *Çdo njësi publike duhet te krijojë dhe te përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve qe zotëron apo ka ne administrim, përfshi dhe pronat publike nga te cilat siguron te ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.*

28. *“Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë”;*

30. *“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”*

2. Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit për anëtarët e Komisionit të Inventarizimit,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*, paragrafin 82.

82. Komisioni nuk duhet te jete me pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi sipas Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara ne paragrafin 13 dhe 14 te këtij udhëzimi.

3. Me Urdhër nr. 10 prot, datë 09.01.2020, NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit. Komisioni ka në përbërje të tij znj. Z. H (anëtar), e cila rezulton anëtare të Komisionit të Inventarizimit edhe në vitin paraardhës 2020, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*, paragrafi 84.

84. Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

4. Komisioni Inventarizimit nuk ka kryer inventar për gjendjen ne sasi dhe vlere e magazinës nr.1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve gjendje e llogarisë 310 *ËMallra ushqimore* dhe llogarisë 327 *ËInventar i imët*, firmosur nga përgjegjësi material (magazineri), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*, paragrafin 83.

83. Para fillimit te inventarit fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve nëpërmjet një proces verbali te mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit te inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet ne prani te komisionit dhe përgjegjësit material.

5. Komisioni Inventarizimit nuk ka mbajtur proces verbal mbi të dhënat e inventarizimit, mbi verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes në ngarkim/përdorim te personelit te njësisë publike, nuk ka përpiluar raport lidhur me inventarizimin, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*, paragrafin 85 germa *Ëa* dhe germa *Ëc*.

85, germa “a”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a-Verifikimin fizik dhe cilësor te gjendjes se aktiveve ne ngarkim/përdorim te personelit te njësisë publike dhe pasqyrimin e te dhënave te inventarizimit ne proces verbalin përkatës, i cili ruhet gjate periudhës se inventarizimit..

85, germa “c”: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë te përpiloje një raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzoje për veprime te mëtejshme Nëpunësit Autorizues-

6. Komisioni i Vlerësimit ka nënshkruar Proces Verbali Vlerësimi nr. 2, datë 21.12.2021, pa nënshkruar nga përgjegjësi material që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet te dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimi përfundimtar. Proces Verbali nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar ne arkiv, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik”*, paragrafi 100, 104 germa *Ëc*, 105.

Komisioni i inventarizimit për vitin 2021 nuk ka hartuar *ËRelacion* mbi inventarizimin fizik ne njësinë shpenzuese, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik*, paragrafi 106.

102. Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve te rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit te skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv.

104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:

a. nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë;

b. nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtijshëm në njësi të tjera;

c. nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar.

105. Proces Verbal hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Proces verbal miratohet nga titullari i njësisë publike

106. Relacioni i vlerësimit përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

7. Komisioni Asgjësimit ka përpiluar Proces Verbal nr.3, datë 23.12.2021 (pa numër dhe datë) për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi ose në ruajtje për asgjësim, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 109; 110.

109. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshëm, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

110. Proces Verbal për nxjerrjen jashtë përdorimi hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tre kopje, ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënie në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1. Znj. S. L për periudhën 15.07.2019 e në vazhdim në cilësinë e NA të institucionit.

2. Znj. A. H për periudhën 01.01.2019 e në vazhdim në cilësinë e NZ të institucionit.

3. Z. A. D magazinier.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 6, datë 12.07.2022

Në lidhje Akt Konstatimin Nr.6, datë 12.07.2022 ka bërë komente dhe shpjegime znj. A.H, në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Administratës, si më poshtë:

Në urdhër shpenzime bashkëlidhen dokumentet bazë të cilat miratohen edhe nga dega e thesarit të cilat autorizojnë dhe kryejnë pagesat . Për blerjen nën 100 mijë lekë proces verbal i marrjes në dorëzim është firmosur nga komisioni i pritjes së mallit. Në rastin e pagesave të ushqimeve bashkëlidhur është fatura tatimore me listën e sasive të marra e rakorduar me flete hyrjen e magazinës.

Nuk është paraqitur një proces verbal përmbledhës i sasive pasi pagesat janë për sasinë mujore. Ndërkohë që institucioni pret ushqimet çdo javë dhe paraqet proces verbal pjesor për çdo pritje malli, ku paraqitet sasia e pranuar e mallit. Këto proces verbale janë administruar në dosje të veçantë, hyrje magazinë (sipas muajit) dhe tregojnë transparencë për gjithë sasinë e hyre. Ato nuk mund të bashkëlidhen në Urdhër shpenzim sepse është e vështirë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

administrohen teknikisht Në institucion nuk është praktikuar një ndër vite mbajtja e një proces verbali përmbledhës.

Urdhër shpenzimet nuk përmbajnë proces verbalin ose aktin e marrjes në dorëzim. Në vitin 2019 ka patur disa raste që magazinieri nuk ka ruajtur rendin kronologjik, por kjo ka ardhur si pasoje e mos eksperiencës, e cila është përmirësuar në vazhdim. Mos ndjekja e rendit në pamje të parë vjen edhe nga praktika e ndjekur nga institucioni me procedimin e katër magazinave magazina 1 (ushqimore shtet); magazina 2 (Industriale shtet); magazina 3 (ushqimore donacion); magazina 4 (industriale donacion). Secila hyrje dalje ka rendin e vet kronologjik ne secilën magazinë.

Është kryer inventarizim i magazinës dhe është evidentuar dhe gjendja fizike e tyre e printuar në të katër magazinat, te cilat janë bashkëlidhur në raportet e bilancit dhe janë firmosur nga magazinieri z. A.D.

Materialet për dalje jashtë përdorimi janë materiale konsumi, dhe janë konstatuar si të pavlefshëm apo të papërdorshëm për shkak të vjetërsisë nga komisioni. Gjate viti kalendarik janë mbajtur proces verbale për prishjen apo thyerjen e tyre. Materialet që duhet të shiten në ankand, janë gjendje në magazine.

Ne relacioni përmbledhës të paraqitur për NA se bashku me dy proces verbalet (vlerësim dhe asgjësim) është cituar dhe mënyra e asgjësimit të mallrave (groposje, djegje)

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së} :

Në lidhje me sa është pretenduar , subjekti i audituar shpreh dakordësinë me qëndrimin e grupit të auditimit.

Autoriteti Kontraktor, duhet të mbajë një Proces Verbal (përmbledhës) me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi te cilën është pranuar fatura tatimore. Gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatë/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, bazuar në përputhje me standardet shtetërorë të te cilësisë dhe kriterëve të kualifikimit të OE.

Dokumentacioni i pranimit të mallit të prokuruar duhet të evidentohet në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Proces verbali të hartohet në tre kopje, njëra prej te cilave të behet pjese e dosjes se prokurimit.

Për sa me sipër observacioni juaj nuk pranohet.

Titulli i Gjetjes:	Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara nga institucioni.
Situata	<p>Njësisia shpenzuese përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019, 2020 dhe 2021, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për aktivet gjendje në magazine, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.</p> <p>Urdhri/at e NA òPër ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionitò (vitin 2019 pa urdhër te NA), kanë patur për detyrë kryerjen e inventarizimit për aktivet e njësisë shpenzuese, por nuk ka përcaktuar një datë të përfundimit të procesit të inventarizimit. Komisioni nuk ka bërë përmbledhje në një relacion për NA, lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në përdorim, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, dhe me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publikò,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTRËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>paragrafin 85 germa òaò dhe germa òcò.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbal nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar në arkiv, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 100, 104 germa òcò, 105.</p> <p>NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreun III, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30, sipas të cilit:</p> <p>Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën së konfliktit të interesit për anëtarët e veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafin 82.</p> <p>NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Inventarizimit (vitit 2019 nuk ka Urdhër), por në përbërje të tij rezultojnë të njëjtët anëtarë me komisionin e inventarizimit të vitit paraardhës, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 84.</p> <p>Komisioni Asgjësimit ka mbajtur Proces Verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 109; 110.</p>
Kriteri:	<p><i>Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;</i></p> <p><i>- Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;</i></p> <p><i>-Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “ Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.”</i></p>
Ndikimi/Efekt:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të asetëve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Titullari i institucionit të SHFSH në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me përgjegjësen e Sektorit të Administratës (Financiere) në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, në vazhdimësi të marrë masa që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të kërkojë dhe zbatojë me përpikmëri procedurën e parashikuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke eliminuar problematiken e hasur gjatë këtij auditimi të konstatimit të mungesës së urdhrimit për ngritje komisioni, mungese e deklaratës së shmangies së konfliktit të interesit, mungesës së mbajtjes së proces verbalit, të shmangies së të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite resht, mungese e firmosjes nga personat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesës se relacionit për titullarin, etj..

Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve të SHFSH Tirane.

Drejtimi 4: Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën 2019-2020-2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 08 datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

4.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

4.2. Plotësia e pasqyrave financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

4.3. Inventarizimi i pronës.

4.4. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Në zbatim të pikës nr.4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formatit 1- Pasqyra e pozicionit financiar.

2. Formatit 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Formatit 3- Pasqyra e flukseve monetare.

4. Formatit 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto.

5. Formatit 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

6. Formatit 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre.

7. Formatit 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve).

8. Formatit 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga realizuara nga Financierja e Institucionit, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2020 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën me shkresën nr. 20, datë 26.02.2021 òPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorò

- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 56, datë 24.02.2022 òPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorò duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Auditimi i përlllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në òPasqyrën e Përformancësò është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 43,654,373 lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 42,023,818 lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 1,630,555 lekë

Totali ii + iii = 43,654,373 lekë

Për vitin 2021, llogaria 63 òNdryshimit të gjendjes së inventaritò në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2020 me 31.12.2021, përkatësisht 9,168,485 lekë ó 10,631,080 lekë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 òNdryshim i gjendjeve të inventaritò në Pasqyrën nr. 2 òPerformance financiare e institucionitò prej (1,462,595) lekë.

Llogaria 85 òRezultati i veprimtarisë ushtrimoreò e pasqyruar dhe në kolonën nr.100 të pasqyrës së òPozicionit Financiarò (F1), përfaqëson vlerën e ndryshimit të gjendjes së inventarit në shumën prej 1,462,595 lekë, si dhe vlerën sponsorizimeve të vitit 2021 në shumën prej 167,960 lekë të papërdorur gjatë vitit 2021 dhe gjendje në llogarinë 520 òDisponibilitete në Thesar”.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

sintetike dhe ato analitike. Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2021, janë plotësuar si më poshtë:

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2021, në vlerën 43,654,373 lekë analizuar si më poshtë:

- Në llogarinë 72 òGrande Korrente të brendshmeò në vlerën 43,654,373 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për NJQP (Qendrore) në vlerën 40,867,155 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 2,619,258 lekë, (7207) sponsorizime nga organizata joqeveritare në vlerën 167,960 lekë.

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2021 kapin vlerën 42,023,818 lekë. analizuar si më poshtë:

Llogaria 600 òPaga e shpenzime personeliò për 21,202,051 lekë, në këtë zë janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2021, përgjatë muajve Janar 2021-Dhjetor 2021.

Llogaria 601 òKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò për 3,604,525 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

Llogaria 6020 òMateriale dhe shërbime zyre të përgjithshmeò për 672,888 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje materialesh kancelari dhe zyre.

Llogaria 6021 òMateriale dhe shërbime specialò për shumën 7,508,182 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje uniforma dhe veshje speciale në vlerën 119,472 lekë; ilaçe dhe pajisje mjekësore në vlerën 89,673 lekë; furnizim dhe shërbim me ushqim për mensat në vlerën 6,782,537 lekë dhe të tjera materiale në vlerën 516,500 lekë.

Llogaria 6022 òShërbime nga të tretëtò për shumën 8,172,848 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni i ka realizuar për shërbime nga të tretët për energji elektrike, ujë, telefon, komisione bankare, shërbim roje dhe shërbime të tjera.

Llogaria 6023 òShpenzime transportiò për shumën 2,024,064 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si karburant, pjesë këmbimi dhe riparime mjtesh, sigurim i automjeteve.

Llogaria 6024 òShpenzime udhëtimiò për shumën 70,000 lekë përfaqësojnë shpenzimet dieta brenda vendit.

Llogaria 63 òNdryshim i gjendjes së inventaritò me vlerën (1,462,595) lekë, zë i cili nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

c. Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezultojnë se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezultojnë se:

- òAktivet afatgjataò zënë 84% të vlerës totale të aktivit, ndërsa òAktivet Afatshkurtraò zënë 16% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
2		I. Aktivet Afat shkurtra	14,247,678	12,799,990
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	492,790	324,830
4	531	Mjete monetare në Arkë	492,790	324,830
6	520	Disponibilitete në Thesar		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	10,631,080	9,168,485
12	31	Materiale	5,988,118	6,353,193
13	32	Inventar i imët	4,642,962	2,815,292

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

21		3.Llogari te Arkëtueshme	3,123,808	3,306,675
22	411	Klientë e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	270,989	270,989
24	431	Tatim e Taksa		
32	468	Debitorë të ndryshëm	233,561	233,561
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	2,619,258	2,802,125
36		4.Të tjera aktive afatshkurtra	0	0
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		

(Burimi: Sektori i Administratës pranë Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” përpunuar nga grupi i auditimit)

- Llogaria 520 ÷Disponibilitete në Thesarö: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49: Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepicën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 492,790 lekë përfaqëson të ardhura nga sponsorizime, ku për vitin 2021 është shtuar në vlerën prej 167,960 lekë.

Vlera e pasqyruar në llogarinë 520 ÷Disponibilitete në Thesarö në Pasqyrën e Pozicionit Financiar përputhet me vlerën e përllogaritur në ÷Pasqyrën e flukseve monetare(cash flow), rreshti nr. 34 ÷Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimorö.

Klasa 3 ÷Gjendja e inventaritö, në fund të vitit 2021, rezulton në vlerën 10,631,080lekë. Në krahasim me vitin 2020 është rritur në vlerën 1,462,595 lekë, nga rritja e zërit ÷Inventar i Imëtö në vlerën 1,827,670 lekë dhe nga zvogëlimi i zërit ÷Materialeö në vlerën 365,075 lekë. Diferenca 1,462,595 lekë lekë përkon me llogarinë 63 ÷Ndryshimi i gjendjeve të inventaritö.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.**Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 ÷Personeli, paradhënie, deficite, gjobaö në vlerën 270,989 lekë, përbëhet nga detyrime të punonjësve të dalë nga kontrolli I KLSH-së që nga viti 2011.

- Llogaria 4342 ÷Të tjera operacione me shtetit debitorö paraqitet në vlerën 2,619,258 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka subjekti Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat në vlerën 1,697,439 lekë, për tatim taksa në vlerën 112,736 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 271,601 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 30,817 lekë si dhe vlera prej 504,550 lekë të shpenzimeve utilitare të dhjetorit të cilat paguhet në janar 2022. Llogaria 4342 ÷Operacione me shtetin (të drejta)ö kuadron me vlerën 7206 ÷Financim i pritshëm nga buxhetiö në vlerën **prej** 2,619,258 lekë.

- Llogaria 468 ÷Debitor të ndryshëmö, në vlerën 233,561 lekë, e cila përbëhet nga detyrime të lëna nga kontrolli I KLSH-së që nga viti 2011.

Aktivitet afatgjata

Në analizë aktivitet:

Në formatin nr. 1 ÷Aktivitet e Afatgjataö në vlerën neto prej 74,350 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ÷Aktive Afatgjata jo materialeö në vlerën neto 503 milion dhe ÷Aktive Afatgjata materialeö në vlerën neto 298 milion lekë, si dhe investimet në vlerën 20,831 milion lekë.

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
42		II. Aktivitet Afat gjata	74,350,794	78,570,371
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	74,350,794	78,570,371
48	210	Toka, Troje, Terrene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	62,748,630	66,051,189
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	5,429,301	7,122,508
53	215	Mjete Transporti	1,384,795	1,457,679

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	4,788,069	3,938,996
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
62		4.Investime		

(Burimi: Sektori i Administratës pranë Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” përpunuar nga grupi i auditimit)

- Llogaria 212 òNdërtime e konstruksioneo, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 62,748,630 lekë, përbërë nga vlera e godinës së institucionit Shtëpia e Fëmijës òZyber Hallulli. Gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020 nuk ka pësuar ndryshime, përveç amortizimit vjetor të llogaritur në vlerën prej 3,302,559 lekë.

- Llogaria 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeo, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 5,429,301 lekë, e cila krahasuar me vitin 2020 ka pësuar ndryshime në vlerën 341,280 lekë, si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi.

Konstatim:

Nga analiza e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj netoò konstatohet se Llogaria 214 òInventar ekonomikò, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (historike)ò duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 3.6 òRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet netoò, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

Titulli i gjetjes:	Mospasqyrimi i saktë në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” për aktivet e dala jashtë përdorimi.
Situata:	Nga analiza e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj netoò konstatohet se Llogaria 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeo, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 3.6 òRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet netoò, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 3.6 òRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet netoò, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	në vlerën e fondit neto të institucionit.
Shkaku	Mos sqarimi nëse ulja e Llogarisë 214 ÷ Instalime Teknike makineri, pajisje, si pasojë e nxjerrjes së disa aktiveve jashtë përdorimi, është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve.
Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

- Llogaria 215 ÷ Mjete Transporti, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 1,384,795 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të institucionit Shtëpia e Fëmijës ÷ Zyber Hallulli, e cila nuk ka ndryshime nga viti paraardhës në vlerën bruto.

Konstatim:

Nga analiza e pasqyrës ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) konstatohet se subjekti ka përdorur normën 5% për përlllogaritjen e amortizimit vjetor të ÷ Mjeteve të Transporti, dhe jo normën 20%, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme paragrafi 36.

Titulli i gjetjes:	Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit në pasqyrën ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për llogarinë 215 ÷ Mjete të Transporti.
Situata:	Llogaria 215 ÷ Mjete Transporti, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 1,384,795 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të institucionit Shtëpia e Fëmijës ÷ Zyber Hallulli, e cila nuk ka ndryshime nga viti paraardhës në vlerën bruto. Nga analiza e pasqyrës ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) konstatohet se subjekti ka përdorur normën 5% për përlllogaritjen e amortizimit vjetor të ÷ Mjeteve të Transporti, dhe jo normën 20%, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme paragrafi 36.
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷ Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme paragrafi 36.
Ndikimi/Efekti	Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit në pasqyrën ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për llogarinë 215 ÷ Mjete të Transporti ndikon në pasqyrimin jo të saktë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.
Shkaku	Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit në pasqyrën ÷ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) për llogarinë 215 ÷ Mjete të Transporti

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHETPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	Të bëhet sistemimi dhe përlloraritja e saktë e amortizimit vjetor të ÷Mjeteve të transportit me normën 20% në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

- Llogaria 218 ÷Inventar ekonomik, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 4,788,069 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit në vlerën 2,132,093 lekë, si rezultat i sistemimeve të aktiveve regjistruar gabim në llogarinë 312 ÷Materiale në shumën prej 397,860 lekë dhe në llogarinë 327 ÷Inventar i imët në shumën prej 851,436 lekë, si dhe transferime kapitale pa pagesë në vlerën prej 882,797 lekë.

Konstatim:

Nga analiza e pasqyrës ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto konstatohet se Llogaria 218 ÷Inventar ekonomik, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 425,000 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) ÷ duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme ÷ paragrafi 3.6 ÷Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

- Gjithashtu për një pjesë të aktiveve të regjistruar në këtë llogari është përlloritur amortizimi vjetor në vlerën prej 5% dhe jo në vlerën 20% nëse nuk janë pajisje elektronike, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit Financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36.

Titulli i gjetjes	Mospasqyrimi i saktë në llogarinë 218 ÷Inventar ekonomik për aktivet e dala jashtë përdorimi.
Situata:	<p>Nga analiza e pasqyrës ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto konstatohet se Llogaria 218 ÷Inventar ekonomik, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 425,000 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a ÷Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) ÷ duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.</p> <p>- Gjithashtu për një pjesë të aktiveve të regjistruar në këtë llogari është përlloritur amortizimi vjetor në vlerën prej 5% dhe jo në vlerën 20% nëse nuk janë pajisje elektronike, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit Financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36.</p>
Kriteri:	- Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	<i>Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> paragrafi 3.6 <i>ËRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto</i> , si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 <i>ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> - Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 36.
Ndikimi/Efekti	- Mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. - Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit për disa aktive në pasqyrën <i>ËGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)</i> për Llogaria 218 <i>ËInventar ekonomik</i> e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.
Shkaku	- Nga analiza e pasqyrës <i>ËGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)</i> dhe asaj neto konstatohet se Llogaria 218 <i>ËInventar ekonomik</i> , ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. - Mospasqyrimi i saktë i normës së amortizimit për disa aktive në pasqyrën <i>ËGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)</i> për llogarinë 218 <i>ËInventar ekonomik</i> .
Rëndësia	E Mesme
Rekomandime	- Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën <i>ËGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)</i> dhe asaj neto dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022. - Të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 <i>ËInventar ekonomik</i> në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Konstatim:

Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2021 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve elektronike janë regjistruar në llogarinë 214 *ËInstalime Teknike makineri, pajisje dhe jo në llogarinë në llogarinë 218600* pajisjeve elektronike pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është llogaritur me normën 25 % dhe jo 20%.

Një pjesë e pajisjeve të orenditjeve janë regjistruar në llogarinë 214 *ËInstalime Teknike makineri, pajisje dhe jo në llogarinë në llogarinë 218* *ËInventar ekonomik*, por pa ndikim material në pasqyrat financiare. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *ËPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme* dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 *ËPër disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik* ò.

Titulli i gjetjes:	Klasifikim në llogari të gabuar të aktiveve të ndryshme
Situata:	Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2021 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur. - Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>pajisje òpajisjeve elektronikeò janë regjistruar në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe jo në llogarinë në llogarinë 218600 òpajisjeve elektronikeò pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është llogaritur me normën 25 % dhe jo 20%.</p> <p>Një pjesë e pajisje òzyre orendiò janë regjistruar në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe jo në llogarinë në llogarinë 218 òInventarë ekonomikò, por pa ndikim material në pasqyrat financiare. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 òPër disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik”.</p>
Kriteri:	<p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 òPër disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik”.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Klasifikim jo i saktë i disa zërave në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe 218 òInventarë ekonomikò mund të sjellë pasaktësi në përlllogaritjen e normës së amortizimit.</p>
Shkaku	<p>Klasifikim jo i saktë i disa zërave në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe 218 òInventarë ekonomikò që në momentin e blerjes.</p>
Rëndësia	<p>E Mesme</p>
Rekomandime	<p>Të bëhet një klasifikim i saktë në llogaritë përkatëse për çdo aktiv që në momentin e hyrjes në magazinë.</p>

Konstatim:

Nga auditimi mbi pasqyrat financiar , grupi i auditimit konstatoj se nuk është plotësuar Formati nr. 5 i pasqyrave financiare òShënimet Shpjegueseò, Veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 25 i cili thotë;

Pasqyratfinanciare vjetoretënjësivetëqeverisjes sëpërgjithshme përbëhennga:

Formati1-Pasqyraepozicionitfinanciar;

Formati2-Pasqyraepformancësfinanciareosepasqyraetëardhuravedheshpenzimeve;

Formati3-Pasqyraefluksevemonetare;

Formati4-Pasqyraendryshimevenëaktivetneto/fondetneto;

Formati5-Shënimetshpjeguesepërhartimindheraportiminepasqyravefinanciarevjetore.

Drejtimi 5: Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

a) Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.

b) Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Më hollësisht rezultatet e auditimit për këtë drejtim paraqiten si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr.381/1, datë 30.04.2022, i ndryshuar me nr. 381/2, datë 07.06.2022, u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi procedurat e prokurimit të parashikuara dhe realizuara nga Shtëpia e Fëmijëve Zyber Hallulli Tiranë, për periudhën 01.09.2019-31.12.2021, si më poshtë:

- Shkresat dhe Urdhrat e titullarit të AK mbi caktimin e personave përgjegjës për prokurimet;
- Regjistrat e Parashikimit për periudhën objekt auditimi;
- Regjistrat e Realizimit për periudhën objekt auditimi;
- Të dhënat e Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) të APP-së, për SHFSH.

Nga subjekti janë paraqitur:

- Regjistri i parashikimit të prokurimeve 2019-2021
- Regjistri i realizimit të prokurimeve 2019-2021

Nga dokumentacioni i grumbulluar për prokurimet e realizuara rezulton se:

A. Për vitin 2019, SHFSH ka realizuar 15 procedura prokurimi, me vlerë totale ekonomike 9,463,158 lekë (me TVSH), ndër të cilat:

- 1- Procedurë prokurimi ò**Prokurim me vlerë të vogël**ò, në total **2 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 346,000 lekë me TVSH.
- 2- Procedurë prokurimi ò**Prokurim nën 100,000**ò në total **12 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 920,311 lekë me TVSH.
- 3- Procedurë prokurimi ò**Negocim pa Shpallje**ò, në total **1 procedurë** prokurimi me vlerë ekonomike 1,085,355 lekë me TVSH.
- 4- Procedurë prokurimi zhvilluar nga **Shërbimi Social Shtetëror**, në total **2 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 5,031,492 lekë me TVSH.
- 5- Procedurë prokurimi zhvilluar nga **ABP**, në total **1 procedurë** prokurimi me vlerë ekonomike 2,100,000 lekë me TVSH.

B. Për vitin 2020 në SHFSH ka realizuar 24 procedura prokurimi, me vlerë totale ekonomike 10,635,990 lekë, ndër të cilat:

- 1- Procedurë prokurimi «**Prokurim nën 100,000**» në total **18 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 1,447,516 lekë me TVSH.
- 2- Procedurë prokurimi «**Prokurim me vlerë të vogël**», në total **2 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 400,281 lekë me TVSH.
- 3- Procedurë prokurimi ò**Negocim pa Shpallje**ò, në total **3 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 1,407,647 lekë me TVSH.
- 4- Procedurë Prokurimi ò**Kërkesë për Propozim**ò, në total **1 procedurë** prokurimi **276,731** lekë me TVSH.
- 5- Procedurë prokurimi zhvilluar nga **Shërbimi Social Shtetëror**, në total **1 procedurë** prokurimi me vlerë ekonomike 3,302,131 lekë me TVSH.
- 6- Procedurë prokurimi zhvilluar nga **ABP**, në total **5 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 3,801,684 lekë me TVSH.

C. Për vitin 2021 në SHFSH ka realizuar 24 procedura prokurimi, me vlerë totale ekonomike 9,826,134 lekë, ndër të cilat:

- 1- Procedurë prokurimi « **Prokurim nën 100,000 lekë**» në total **11 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 711,603 lekë me TVSH.
- 2- Procedurë prokurimi «**Prokurim me vlerë të vogël**», në total **3 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 560,740 lekë me TVSH.
- 3- Procedurë prokurimi ò**Negocim pa Shpallje**ò, në total **1 procedurë** prokurimi me vlerë ekonomike 1,625,087 lekë me TVSH.
- 4- Procedurë prokurimi zhvilluar nga **ABP**, në total **7 procedura** prokurimi me vlerë ekonomike 9,826,134 lekë me TVSH.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË****Parashikimi dhe Realizimi i Prokurimeve Publike**

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se parashikimi dhe realizimi i prokurimeve publike për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2021), paraqitet si më poshtë vijon:

Viti	Parashikuar		Realizuar			Parashikuar për auditim		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	% ndaj parashikimit	Numër	Vlerë	% ndaj realizimit
Janar -dhjetor 2019	17	2,749,280	13	2,331,666	84.81%	4	1,508,003	64.67%
Janar -dhjetor 2020	26	7,152,440	23	3,532,175	49.38%	7	2,130,493	60.32%
Janar -dhjetor 2021	18	3,530,000	14	2,897,430	82.08%	4	2,180,501	75.26%
Totali	61	13,431,720	50	8,761,271		15	5,818,997	66,75 %

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme, konstatohet se për periudhën janar-dhjetor 2019, janë parashikuar për tu realizuar 17 procedura prokurimi me vlerë totale 2,749 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 13 procedura me vlerë 2,332 mijë lekë, ose prokuruar 84,81% e fondeve të planifikuara.

Për vitin 2020, janë parashikuar për tu realizuar 26 procedura prokurimi me vlerë 7,152 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 23 procedura me vlerë 3,532 mijë lekë, ose prokuruar 49,38% e fondeve të planifikuara.

Për vitin 2021, janë parashikuar për tu realizuar 18 procedura prokurimi me vlerë 3,530 mijë lekë, nga të cilat deri më 31.12.2021, janë realizuar 14 procedura me vlerë 2,897 mijë lekë, ose prokuruar 82,08% e fondeve të planifikuara.

Viti 2019

Nga dokumentacioni dhe informacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, nuk janë kryer ndryshime të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike në SHFSH.

Viti 2020

Në varësi të dinamikës së institucionit dhe nevojave të krijuara AK ka bërë disa ndryshime në regjistrin e prokurimeve publike për të cilat ka njoftuar degën e thesarit Tiranë, përkatësishtme shkresat nr. 64 prot, datë 23.04.2020, shkresa nr. 112 prot, datë 30.06.2020, shkresa me nr. 185 prot, datë 14.09.2020 nga AK është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike, i ndryshuar:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi i përlogaritur	Lloji i procedurës së prokurimit
1	Shërbim roje civile	310,826	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit
2	Shërbim roje civile	1,090,438	Kërkesë për propozim
3	Blerje pajisje dhe element mbrojtës për covid-19	80,000	Blerje deri në 100,000 lekë
4	Shërbim roje civile	1,090,438	Kërkesë për propozim
5	Shërbim roje civile për SHFSH Tiranë	1,870,910	Kërkesë për propozim
6	Shërbim disinfektimi covid-19	100,000	Blerje deri në 100.000 lekë
7	Blerje artikuj ushqimor vezë mish dhe nënprodukte të tij.	799,600	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit
8	Shërbim roje civile	306,666	Negocim pa njoftim

Viti 2021

Për vitin 2021, me anë të shkresës nr. 47 datë 15.01.2021, SHFSH ka dërguar në Degën e Thesarit Tiranë ndryshimet në RPPP, sipas të cilit janë shtuar për publikim, procedura e mëposhtme:

NR.	Përshkrimi	Vlera	Shënime
-----	------------	-------	---------

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

1	Kontroll teknik i kaldajës	50,000	Blerje deri ne 100,000 lekë.
---	----------------------------	--------	------------------------------

AUDITIMI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME VLERË NËN 100, 000 LEKË (PA TVSH) PËR BLERJE MEDIKAMENTESH.

Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë, mbështetur ne Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *oPër prokurimin publik*, i ndryshuar, dhe në nenin 8 pika 2 të **VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në cilësinë e AK ka përdorur procedurën e prokurimit **me vlerë nën 100, 000 lekë (pa TVSH)** për blerje medikamentesh, për përdorim nga fëmijët rezident në këtë institucion publik..

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 8 pika 2
Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit.
Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik.
Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.

- Planifikimi dhe realizimi i prokurimeve me vlere nën 100,000 lekë

Planifikimi i blerjes se medikamenteve dhe vlerat përkatëse janë evidentuar në regjistrin e parashikimeve me fond te llogaritur dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik me të njëjtin fond limit 99,900 lekë (pa TVSH), miratuar nga APP. Evidenca me të dhëna për planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit të barnave për përdorim nga fëmijët rezident në SFSH Tiranë, rezulton i më poshtë vijon:

Prokurime blerje medikamente

Viti	Fondi planifikuar	Fondi realizuar	Realizuar (%)
Viti 2019	100,000	96,648	96.64%
Viti 2020	100,000	45,834	45.83%
Viti 2021	100,000	89,674	89.67%

(Burimi: SHSSH, Punoi KLSH)

Nga auditimi rezulton se planifikimi për blerje medikamente është parashikuar për vitin 2019 është parashikuar në 100,000 dhe është realizuar në shumën 96,648 lekë ose realizuar në masën 96.64%. Për vitin 2020 është parashikuar në shumën 100,000 lekë dhe realizuar në shumën 45,834 lekë ose realizuar 45.83%. Për vitin 2021 blerja e medikamenteve është planifikuar në vlerën 100,000 lekë dhe realizuar në shumën 89,674 lekë ose realizuar 89.67%. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se NZ, për periudhën objekt auditimi , ka urdhëruar përdorimin e procedurës së prokurimit publik me vlere **nën 100,000 lekë** për blerje medikamente, duke lëshuar **Urdhër të Brendshëm**, bazuar në nenin 25 pika 9 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *oPër prokurimin publik* dhe Kreun IV, neni 40 pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *oPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*.

Blerjet e medikamenteve për vitet 2019-2021, paraqiten si më poshtë vijon:

Blerje medikamente 2019-2021

Nr.	Urdhër i brendshëm	Fondi limit (pa TVSH)	Nr. artikujve
1	Nr. 08, datë 16.05.2019	96,648	50
2	Nr. 28, datë 04.03.2020	45,835	27



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

3	Nr. 18, datë 09.10.2020	54,084	48
4	Nr. 09, datë 30.07.2021	11,627	20
5	Nr. 11, datë 01.09.2021	10,310	21
6	Nr. 13, datë 30.09.2021	16,036	20
7	Nr. 15, datë 01.11.2021	7,765	18
8	Nr. 18, datë 24.11.2021	34,998	28

Nga auditimi rezulton se AK për shpenzimet e kryera për blerje medikamente, për çdo vit buxhetor, fondi prokuruar për blerje medikamentesh nuk ka tejkalar vlerën 100,000 lekë (pa TVSH), konform nenin 8 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

A. Blerja e medikamenteve

Kuadri rregullator ka parashikuar se AK për blerjet nën 100.000 lekë nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Pagesat në këto raste bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar kontratë të tillë.

Procedura e ndjekur për blerje të medikamenteve bazohet në parashikimin e blerjes së medikamenteve, të vlerësuara të domosdoshme nga mjekja e institucionit Znj. K. L, e cila i drejtohet zyrës së financës me kërkesë me shkrim për sasinë e nevojshme të medikamenteve. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes realizohet blerje me faturë tatimore shitjes lëshuar nga farmacia e kontaktuar.

NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit me urdhër të, Medikamentet pranohen nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të mallit cili mban Proces Verbal për marrjen në dorëzim të medikamenteve, duke hartuar listuar e medikamenteve të dorëzuara në magazinë.

Blerjet bëhen me faturë tatimore shoqëruar me listën e medikamenteve, konform legjislacionit tatimor. Malli bëhet hyrje nga magazine me flete ó hyrje dhe dalje për përdorim për ish-mjekin e institucionit.

Për vitin 2019

➤ NA me **Urdhër nr. 7, datë 03.01.2019** ka krijuar **Komisionin** për marrjen në dorëzim të mallit, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*. Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga znj. Xh. F (kryetare), Znj. B. Gj (anëtare) dhe z. E. S (anëtar), dhe ka funksionuar për gjithë vitin 2019. Procedura e blerjes fillon nga Mjekja e Institucionit znj. K. L, e cila me kërkesën nr. 155, datë 16.05.2019 drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 50 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm prej saj për përdorim nga fëmijët rezident. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes së institucionit, Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës znj. A.H nëpërmjet të Memoö nr. 155/1 prot, datë 16.05.2019 i është drejtuar NA znj. L.Ç për aprovimin e kërkesës së ish-mjekes. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.8, datë 16.05.2019, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.

Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K. L, me fature tatimore nr.388, datë 20.05.2019, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave të blera, në sasi dhe çmim përkatës. Në total vlera 96,647 leke (pa TVSH) ose **98,886 leke (me TVSH)**. Fatura tatimore është nënshkruar nga shitësi me farmaci tëE. Gö NIPT xx.

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes në Dorëzim të mallit, i cili ka mbajtur **Proces Verbal nr. 155/3, datë 20.05.2019**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci tëE. Gö me NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të blera të medikamenteve. Në datën e dorëzimit të mallit medikamentet bëhen hyrje në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

magazinë me fleteóhyrje dhe dalje me Fleteódalje me destinacion për përdorim për ish-mjekën e institucionit.

Shpenzimet për blerje medikamente 2020

Nr.	Paguuar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT	Proces Verbal “Për marrje në dorëzim malli”
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë			
1	70	29.05.2019	98,886	388	20.05.2019	98,886	E. G	xx	Proces verbal nr. 155/3, datë 20.05.2019
SHUMA			98,886			98,886			

(Burimi: SHFSH Punoi : KLSH)

Nga auditimi rezulton se:

- Kërkesa nr. 155, datë 16.05.2019 e ish-mjekes së Institucionit znj. K. L, për blerje vjetore të medikamenteve për 50 artikuj, konsideruar të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident, nuk ka arsyetuar domosdoshmërinë e blerjes se menjëhershme te medikamenteve, nuk ka përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blere sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist (përveç atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte), veprime në kundërshtim me kërkesat e Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor óZyber Hallullió, paragrafi 4, pika 2 dhe 6, si dhe paragrafi 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó, ku citohet se:

Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor “Zyber Hallulli”

Paragrafi 4. Procedurat e Kujdesit Shëndetësor

Pika 2: Mjeku vlerëson gjendjen shëndetësore të fëmijës, mbi bazën e dokumentacionit mjekësor shoqërues. (vlerësimi paraprak i nevojave).

Pika 6: Institucioni siguron medikamentet e nevojshme të parashikuara për rimbursim si dhe blerjen e medikamenteve të tjera rekomanduara nga ish-mjeket.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

18. Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.

-Komisioni për marrjen në dorëzim te mallit, ngritur nga NA znj. S. L me Urdhër nr. 11, datë 09.01.2020 ka urdhëruar ngritjen e komisionit për pranimin e mallit (medikamente) të përberë nga znj. B. B (kryetare); znj. N. M (anëtare); znj. A. D (anëtare). Në përbërje të tij nuk ka punonjës me njohuri mbi medikamentet si dhe nuk ka të përfshirë punonjësin me përgjegjësi materiale, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale

- Komisioni i marrjes ne dorëzim te medikamenteve, me proces verbal nr. 155/1 prot, datë 20.05.2019 ka marre në dorëzim medikamentet, sipas listës së medikamenteve duke evidentuar medikamentin, njësinë dhe sasinë e tij. Medikamentet janë mallra te ambalazhuara, dhe ne secilin prej tij është vendosur pulla fiskale që tregon çmimin e blerjes, dhe datën e skadencës se tij. **Ne proces verbal mungon evidentimi çmimi i mallit, data e skadencës se tij,** veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 44 germa ógö të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

44. Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

d. Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarde, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje dhe, kur ka diferencë, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një.

- Proces Verbal nuk pasqyron numrin e kopje që janë mbajtur, nuk përcakton destinacionin e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 50 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

50. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje sipas dispozitave në fuqi në rastet e nevojshme.

Viti 2020

Për vitin 2020, me urdhër të NA nr. 11 prot, datë 29.01.2020 ka urdhëruar ngritjen e Komisioni për marrje në dorëzim të mallit, përbërë nga: 1. znj. B. B (kryetar); 2. znj. N. M (anëtar) dhe znj. A. D (anëtar). Komisioni ka funksionuar për periudhën deri 31.12.2020. Nëpërmjet Urdhrit nr. 55 prot, datë 11.09.2020 u zëvendësua Znj. N.M (leje lindje dt. 09.07.2020) me znj. K. R. Gjithashtu me Urdhër nr.57, datë 14.09.2020 u zëvendësua Znj. B. B (dorëheqje datë 14.09.2020) me znj. L. A.

Pas ndryshimeve të miratuara nga NA, komisioni ka funksionuar me përbërje: 1. L.A, kryetar; 2. A. D, anëtar; 3. K. R, anëtar.

➤ Mjekja e Institucionit znj. K. L, me kërkesën nr. 43, datë 04.03.2020 drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 37 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes së institucionit, Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës znj. A.H nëpërmjet òMemoò nr. 43/2 prot, datë 04.03.2020 i është drejtuar NA znj. S.L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.2, datë 04.03.2020, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.

Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K. L, me fature tatimore nr. 411, datë 04.03.2020, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave të blera, në sasi dhe çmim përkatës. Në total vlera 45,835 leke (pa tvsh) ose **47,251 leke (me tvsh)**. Fatura tatimore është nënshkruar nga shitësi me Farmaci òE. Gö NIPT X.

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes në Dorëzim të mallit i përbërë nga znj. B. B; znj. A. D dhe znj. N. M, ka mbajtur **Proces Verbal nr. 43/4, datë 04.03.2020**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci òE. Gö me NIPT X. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të blera të medikamenteve. Medikamentet janë bërë hyrje në magazine me flet ò hyrje dhe dalje për përdorim me flete- dalje për ish-mjekën e institucionit.

➤ Mjekja e Institucionit znj. K.L, me kërkesën nr. (sòka), datë (sòka) drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 48 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes së institucionit, Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës znj. A. H nëpërmjet òMemoò nr. 219 prot, datë 09.10.2020 i është drejtuar NA znj. S. L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.18, datë 09.10.2020, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.

Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K. L, me fature tatimore nr. 34, datë 21.10.2020, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave të blera, në sasi dhe çmim përkatës. Në total vlera 54,084 leke (pa TVSH) ose **56,991 leke (me TVSH)**. Fatura tatimore është nënshkruar nga shitësi me Farmaci òB. Çò NIPT X.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes ne Dorëzim te mallit i përbërë nga znj. L. A; znj. A.D dhe znj. K. R, ka mbajtur **Proces Verbal nr. (nuk ka), datë 21.10.2020**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci òB.Çò me NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të e blera te medikamenteve. Në datën e dorëzimit te mallit medikamentet bëhen hyrje në magazinë me flete ó hyrje dhe dalje me flete ó dalje me destinacion për përdorim për ish-mjeket e institucionit

Shpenzimet për blerje medikamente 2020

Nr.	Paguarr: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT	Proces Verbal “Për marrje në dorëzim malli”
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë			
2	51	02.04.2020	47,251	411	04.03.2020	47,251	B. Ç	xx	Proces verbal nr. 43/4, datë 04.03.2019
3	167	03.11.2020	56,991	34	21.10.2020	56,991	B. Ç	xx	Proces verbal nr. N/A, datë 21.10..2020
SHUMA			92,212			92,212			

Nga auditimi rezulton se:

Kërkesa nr. 155, datë 16.05.2019 dhe kërkesa nr. (saka), datë (saka) e vitit 2020, hartuar nga mjekja e Institucionit znj. K.L, për blerje medikamentesh për 50 artikuj, të konsideruar të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident, pa arsyetuar domosdoshmërinë e blerjes së menjëhershme të medikamenteve, pa përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blere sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist (përveç atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte), veprime në kundërshtim me kërkesat e Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor òZyber Hallulliò, paragrafi 4, pika 2 dhe 6, si dhe paragrafi 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

18. Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.

Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor “Zyber Hallulli”

Paragrafi 4. Procedurat e Kujdesit Shëndetësor

Pika 2: Mjeku vlerëson gjendjen shëndetësore të fëmijës, mbi bazën e dokumentacionit mjekësor shoqëruar. (vlerësimi paraprak i nevojave).

Pika 6: Institucioni siguron medikamentet e nevojshme të parashikuara për rimbursim si dhe blerjen e medikamenteve të tjera rekomanduara nga ish-mjeket.

Komisioni për marrjen në dorëzim te mallit i përberë me përbërje: 1. L. A, kryetar; 2. A. D, anëtar; 3. K. R, anëtar, ngritur nga NA znj. S. L me Urdhër nr. 11, datë 09.01.2020, të ndryshuar, në përbërje të tij nuk ka punonjës me njohuri mbi medikamentet si dhe nuk ka të përfshirë punonjës me përgjegjësi materiale, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës me përgjegjësi materiale

Komisioni i marrjes ne dorëzim te medikamenteve, i përbërë nga znj. B. B; znj. A. D dhe znj. N. M, në Proces Verbal nr. 43/4, datë 04.03.2020, dhe Komisioni i Marrjes në Dorëzim (i ndryshuar) i përbërë nga znj. L. A; znj. A. D dhe znj. K. R, në mbajtur Proces Verbal nr. (nuk ka), datë 21.10.2020, kanë marrë në dorëzim medikamentet, sipas listës së medikamenteve duke evidentuar medikamentin, njësinë dhe sasinë e tij. **Medikamentet janë mallra te**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

ambalazhuara, dhe në secilin prej tij është vendosur pulla që tregon çmimin e blerjes, dhe datën e skadencës së tij. Ne proces verbal mungon evidentimi çmimi i mallit, data e skadencës së tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 44 germa ogö të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*
Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

44. Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë:

d. Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarde, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje dhe, kur ka diferencë, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një.

Proces Verballi nuk pasqyron numrin e kopje të mbajtura dhe nuk përcakton destinacionin e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 50 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

50. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje sipas dispozitave në fuqi në rastet e nevojshme

Viti 2021

NA me Urdhër nr. 27, datë 03.08.2021 ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të mallit, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*. Komisionin për marrjen në dorëzim të mallit i përberë nga znj. K. L (kryetare), Znj. F.A (anëtare) dhe z. L.B (anëtar) do të funksionojë për gjithë deri në 31.12.2021.

Blerjet e medikamenteve për vitin 2021 janë pasqyruar si me poshtë vijon:

➤ Mjekja e Institucionit znj. K. L, me kërkesën nr. (soka), datë (soka)drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 16 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes së institucionit, Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës znj. A. H nëpërmjet oMemoö nr. 114 prot, datë 21.06.2021 i është drejtuar NA znj. S.L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.114/1, datë 30.07.2021, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve. Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K.L, me fature tatimore nr. 1897/2021, datë 30.07.2020, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave të blera, në sasi dhe çmim përkatës. Në total vlera 11,627 leke (pa TVSH) ose **13,952 leke (me TVSH)**. Fatura tatimore është elektronike lëshuar nga shitësi me Farmaci oJ.Mö NIPT

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes në Dorëzim të mallit i nga znj. K. L (kryetare), Znj. F. A (anëtare) dhe z. L. B (anëtar), ka mbajtur **Proces Verbal nr. (s'ka), datë 30.07.2021**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci oJ.Mö NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të blera të medikamenteve. Mjekja e Institucionit znj. K. L, me kërkesën nr. (soka), datë (soka) drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 21 artikuj, të cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. Ne kërkesën e saj mjekja përveç sasisë së kërkuar, kërkon që barnat të jenë cilësore dhe me afat skadence më të madh se një vit. Bazuar në kërkesën e ish-mjekes së institucionit, Përgjegjësjë e Sektorit të Administratës znj. A. H nëpërmjet oMemoö nr. 162 prot, datë 01.09.2021 i është drejtuar NA znj. S. L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr.11, datë 30.07.2021, me të cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K.L, me fature tatimore nr.1897/2021, datë 30.07.2020, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave te blera, ne sasi dhe çmim përkatës. Ne total vlera 11,627 leke (pa TVSH) ose **13,952 leke (me TVSH)**. Fatura tatimore është elektronike lëshuar nga shitësi me Farmaci òJ. Mò NIPT xx. Fatura tatimore është elektronike lëshuar nga shitësi me Farmaci òJ. Mò NIPT Xx.

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes ne Dorëzim te mallit i nga znj. K. L (kryetare), Znj. F. A (anëtare) dhe z. L. B (anëtar), ka mbajtur **Proces Verbal nr. (s'ka), datë 02.09.2021**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci òJ. Mò NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të e blera te medikamenteve.

Mjekja e Institucionit znj. K. L, me kërkesën nr. (sòka), datë (sòka)drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 20 artikuj, te cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. N137 kërkesën e saj mjekja përveç sasisë së kërkuar, kërkon që barnat të jenë cilësore dhe me afat skadence më të madh se një vit. Bazuar ne kërkesën e ish-mjekes se institucionit, Përgjegjësj e Sektorit të Administratës znj. A. H nëpërmjet òMemoò nr. 162/4 prot, datë 30.09.2021 i është drejtuar NA znj. S.L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr. 13, datë 30.09.2021, me te cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.

Blerja e mallit është kryer nga mjekja e institucionit, znj. K.L, me fature tatimore nr. 3379/2021, datë 30.09.2020, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave te blera, ne sasi dhe çmim përkatës. Ne total vlera 16,036 leke (pa TVSH) ose **16,316 leke (me tvsh)**. Fatura tatimore është elektronike lëshuar nga shitësi me Farmaci òJ.Mò NIPT X.

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes ne Dorëzim te mallit i nga znj. K. L (kryetare), Znj. F. A (anëtare) dhe z. L. B (anëtar), ka mbajtur **Proces Verbal nr. (s'ka), datë 02.09.2021**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci òJ. Mò NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të e blera te medikamenteve.

➤ Mjekja e Institucionit znj. K. L, me kërkesën nr. (sòka), datë (sòka)drejtuar Sektorit të Financës, ka kërkuar blerjen e medikamenteve për 20 artikuj, te cilat konsiderohen të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident. Në kërkesën e saj mjekja përveç sasisë së kërkuar, kërkon që barnat të jenë cilësore dhe me afat skadence më të madh se një vit. Bazuar ne kërkesën e ish-mjekes se institucionit, Përgjegjësj e Sektorit të Administratës znj. A. H nëpërmjet òMemoò nr. 162/5 prot, datë 01.11.2021 i është drejtuar NA znj. S. L për aprovimin e kërkesës për blerje medikamente. Kërkesa është miratuar nga NA, nëpërmjet lëshimit të Urdhër të Brendshëm nr. 15, datë 01.11.2021, me te cilin urdhërohet blerja e sasisë së kërkuar të medikamenteve.

Blerja e mallit është kryer sipas kërkesës dhe specifikimeve të përcaktuara nga mjekja e institucionit, znj. K.L, me fature tatimore nr. 4414/2021, datë 31.10.2021, bashkëlidhur të cilës është lista e barnave te blera, ne sasi dhe çmim përkatës. Ne total vlera 7,765 leke (pa tvsh) ose **9,318 leke (me TVSH)**.

Blerjet janë pranuar nga Komisioni Marrjes ne Dorëzim te mallit i nga znj. K. L (kryetare), Znj. F. A (anëtare) dhe z. L. B (anëtar), ka mbajtur **Proces Verbal nr. (s'ka), datë 24.11.2011**, për marrjen në dorëzim të medikamenteve të ardhura nga furnitori farmaci òJ.Mò NIPT xx. Komisioni në Proces Verbal, ka evidentuar një për një sasi të e blera te medikamenteve.

Faturat e Furnizimit për òBlerje medikamenteò.

Nr.	Paguuar: Urdhër shpenzimi			Faturuar: Fatura			Furnitori/ Farmaci	NIPT	Proces Verbal “Për marrje në dorëzim malli ”
	nr.	datë	vlerë	nr.	datë	vlerë			
	153	04.08.2021	13,952	1897	30.07.2021	13,952	J.M	xx	Proces verbal datë 30.07.2021
	181	22.09.2021	12,372	2471	02.09.2021	12,372	J.M	xx	Proces verbal datë 02.09.2021

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHËTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	202	19.10.2021	16,316	3379	30.09.2021	16,316	J.M	xx	Proces verbal datë 30.09.2021
	231	18.11.2021	9,318	4414	01.11.2021	9,318	J.M	xx	Proces verbal datë 01.11.2021
	246	15.12.2021	37,715	5165	24.11.2021	37,715	J.M	xx	Proces verbal datë 24.11.2021
SHUMA			89,673			89,673			

(Burimi: SHFSH Punoi : KLSH)

Urdhër shpenzimet për pagesën e furnitorit janë kryer brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore.

Nga auditimi rezulton se:

- Kërkesa për medikamente për fëmijët e SHFSH, Tiranë, hartuar nga mjekja e Institucionit znj. K. L, nuk ka përshkrim mbi domosdoshmërinë e blerjes së medikamenteve, nuk përcakton nëse barnat janë medikamente të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blere sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist (përveç atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte), kërkesat nuk kanë numër dhe datë protokollit, veprime në kundërshtim me kërkesat e Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor “Zyber Hallulli”, paragrafi 4, pika 2 dhe 6, si dhe paragrafi 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

18. Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë, dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.

Rregullore e Brendshme e Fëmijëve shkollor “Zyber Hallulli”**Paragrafi 4. Procedurat e Kujdesit Shëndetësor**

Pika 2: Mjeku vlerëson gjendjen shëndetësore të fëmijës, mbi bazën e dokumentacionit mjekësor shoqërues. (vlerësimi paraprak i nevojave).

Pika 6: Institucioni siguron medikamentet e nevojshme të parashikuara për rimbursim si dhe blerjen e medikamenteve të tjera rekomanduara nga ish-mjeket.

Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit i përberë nga Komisioni Marrjes në Dorëzim të mallit i nga znj. K. L (kryetare), Znj. F. A (anëtare) dhe z. L. B (anëtar), ngritur nga NA znj. S. L me Urdhër nr. 27, datë 03.08.2021, në përbërje të tij nuk ka punonjës me njohuri mbi medikamentet si dhe nuk ka të përfshirë punonjësin me përgjegjësi materiale, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale

Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve, i përbërë nga znj. B. B; znj. A. D dhe znj. N. M, në Proces Verbal nr. 43/4, datë 04.03.2020, dhe Komisioni Marrjes në Dorëzim (i ndryshuar) i përbërë nga znj. L. A; znj. A. D dhe znj. K. R, në mbajtje Proces Verbal nr. (nuk ka), datë 21.10.2020, kanë marrë në dorëzim medikamentet, sipas listës së medikamenteve duke evidentuar medikamentin, njësinë dhe sasinë e tij. Medikamentet janë mallra të ambalazuara, dhe në secilin prej tyre është vendosur pulla që tregon çmimin e blerjes, dhe datën e skadencës së tij. Në proces verbal mungon evidentimi çmimi i mallit, data e skadencës së tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 44 germa të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

44. Marrja në dorëzim e aktiveve bëhet në magazinën e blerësit dhe në varësi të ambalazhimit të tyre, në këtë mënyrë:

d. Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarde, merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje dhe, kur ka diferencë, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një.

Proces Verballi nuk pasqyron numrin e kopje të mbajtura dhe nuk përcakton destinacionin e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 50 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

50. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje sipas dispozitave në fuqi në rastet e nevojshme

B. Bilanci material për gjendjen dhe sasinë e medikamenteve.

Pas lëshimit të faturës tatimore, artikujt e medikamenteve, pas marrjes në dorëzim nga Komisioni, bëhen hyrje në magazinë flet hyrjen përkatëse. Për vitin 2019 dhe vitin 2020, medikamentet janë bërë hyrje në total, me dokument flet-hyrje e cila referon në listën e barnave që shoqërojnë faturën tatimore. Për vitin 2021 kemi përmirësim në regjistrim, pasi hyrjet janë bërë me artikuj. Regjistrimi i hyrjeve jo sipas artikujve të faturës, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 15.

37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre.

Po ne të njëjtën datë ato bëhen dalje, me dokument flete-dalje, në ngarkim të ish-mjekes së institucionit, znj K. L, e cila për vitet 2019-2020, i përdor ato sipas rastit, duke lëshuar recete mjekësore dhe nënshkruhet nga edukatorja dhe kujdestarja. Marrja në ngarkim e medikamenteve nga mjekja e institucionit, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 15.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

5. Menaxheri që urdhëron për hyrjen dhe daljen e aktiveve nuk mund të ngarkohet edhe me detyrën e arkëtarit dhe/ose magazinierit...

Gjendja kontabël e barnave në magazine për vitin 2019 është zero lekë, për vitin 2020 është zero lekë, dhe për vitin 2021 është **37,418 lekë**, e cila është pasqyruar gjendjen e inventarit të vitit 2021 në sasi dhe vlere. Për vitin 2021, blerjet e medikamenteve kryhen në sasi me të vogla dhe me afër nevojave, por gjendja në medikamenteve në fund të vitit në vlere **37,418 lekë ose 41.7% e blerjes**, tregues ky që evidenton se blerja e medikamenteve është me e madhe se nevojat për përdorim, ndërkohë që VKM nr. 285/2011 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 11, pika 3, lejon që për blerjet e medikamenteve AK mund të bëjë blerje me faturë tatimore në çdo kohë, mjafton që fondi limit të mos tejkalojë 100,000 lekë.

Te dhënat për blerje, hyrje dhe dalje të artikullit të medikamentëve, janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Faturat e Furnizimit për blerje medikamenteve.

Faturuar: Fatura			Fletë Hyrje	Shuma	Fletë Dalje	Shuma	Destinacion
Nr.	Datë	Vlerë					
388	20.05.2019	98,886	Nr.4, dt. 20.05.2021	98,886	Nr.77, datë 22.05.2019	98,886	Doktoresha
		98,886		98,886		98,886	
411	04.03.2020	47,251	Nr.3, dt. 04.03.2020	47,251	Nr. 39, dt. 04.03.2020	47,251	Doktoresha
34	21.10.2020	56,991	Nr.9, dt. 21.10.2020	56,991	Nr.117, dt. 26.10.2020	56,991	Doktoresha
		104,242		104,242		104,242	
1897	30.07.2021	13,952	Nr.6, dt. 30.07.2021	13,952	Nr. 125, datë 04.08.2021	1,825	Ap1

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHETPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

					Nr. 126, datë 04.08.2021	3,204	Ap2
					Nr. 127, datë 04.08.2021	1,820	Ap3
					Nr. 128, datë 04.08.2021	3,974	Ap4
					Nr. 129, datë 04.08.2021	4,650	Krye/ Kujdestare
2471	02.09.2021	12,372	Nr.7, dt. 02.09.2021	12,372	Nr. 150, datë 10.09.2021	2,971	Ap2
					Nr. 152, datë 10.09.2021	3,360	Ap1
3379	30.09.2021	16,316	Nr.13, dt. 30.09.2021	16,316	Nr. 154, datë 10.09.2021	882	Ap3
					Nr. 155, datë 10.09.2021	4,304	Ap1
					Nr. 167, datë 08.10.2021	5,159	Ap1
					Nr. 168, datë 08.10.2021	11,490	Ap4
					Nr. 169, datë 08.10.2021	522	Ap3
4414	01.11.2021	9,318	Nr. 17, dt. 01.11.2021	9,318	Nr. 196, datë 25.11.2021	1,157	Ap1
5165	24.11.2021	37,715	Nr. 18 dhe nr. 18/1 dt. 24.01.2021	37,715	Nr. 198, datë 25.11.2021	6,936	Ap4
		89,673		89,673		52,255	

(Burimi: SHFSH Punoi : KLSH)

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

- 1) znj. S.L për periudhën 15.07.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NA të institucionit
- 2) znj. A.H për periudhën 01.01.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NZ të institucionit
- 3) znj K. L me detyrë ish-ish-mjeke institucioni për periudhën 01.01.2019 deri në 01.12.2021, në cilësinë e mjekut të institucionit, dhe kryetare e Komisionit të marrjes në dorëzim për vitin 2021
- 4) znj.Xh.F me detyrë ish-krye kujdestare, kryetare e Komisioni i marrjes në dorëzim te medikamenteve për vitin 2019
- 5) znj.B.Gj me detyrë ish-punonjëse sociale, anëtar i Komisionit të marrjes në dorëzim te medikamenteve për vitin 2019
- 6) znj.E.S me detyrë mirëmbajtës, anëtar i Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2019
- 7) znj.L.A me detyrë kujdestare, kryetare e Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2020
- 8) znj.A.D me detyrë ish-sanitare, anëtar i Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2019
- 9) znj. K.R me detyrë kujdestare, anëtar i Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2020
- 10) znj.F.A me detyrë ish-edukatore, anëtar i Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2021
- 11) z. L.B me detyrë kujdestar, anëtar i Komisioni i marrjes në dorëzim të medikamenteve për vitin 2021.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 7, datë 12.07.2022.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 9, datë 12.07.2022.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në mbajtjen e dokumentacionit për blerje nën 100 mije leke.
Situata	Për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, kërkesat e ish-mjekes së Institucionit për blerje të medikamenteve, konsideruar të nevojshëm për përdorim nga fëmijët rezident, nuk kanë të argumentuar domosdoshmërinë e blerjes se menjëhershme te medikamenteve, nuk ka përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blere sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist (përveç atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte), veprime në kundërshtim me kërkesat e Rregullore e Brendshme e Fëmijëve Shkollor ëZyber Hallulliö, paragrafi 4, pika 2 dhe 6, si dhe paragrafi 18, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 öPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö. Komisioni/et për marrjen në dorëzim te mallit, ngritur nga NA përveç



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>ish-mjekes se institucionit, në përbërje të tij nuk ka punonjës me njohuri mbi medikamentet si dhe nuk ka të përfshirë punonjës me përgjegjësi materiale, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 30 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.</p> <p>Medikamentet janë mallra të ambalazuara, dhe në secilin prej tyre është vendosur pulla fiskale që tregon çmimin e blerjes, dhe datën e skadencës së tij. Ne proces verbal mungon evidentimi çmimi i mallit, data e skadencës së tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 44 germa ògò të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.</p> <p>Proces Verbal mbajtur për blerje medikamentesh, nuk pasqyron numrin e kopjeve që janë mbajtur, nuk përcakton destinacionin e tij, veprime në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 50 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò</p> <p>Pas lëshimit të faturës tatimore, artikujt òMedikamenteò, pas marrjes në dorëzim nga Komisioni, bëhen hyrje në magazinë flet hyrjen përkatëse. Për vitin 2019 dhe vitin 2020, medikamentet janë bërë hyrje në total, me dokument flet-hyrje e cila referon në listën e barnave që shoqërojnë faturën tatimore. Për vitin 2021 kemi përmirësim në regjistrim, pasi hyrjet janë bërë me artikuj. Regjistrimi i hyrjeve jo sipas artikujve të faturës, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 15. Po në të njëjtën datë ato bëhen dalje, me dokument flete- dalje, në ngarkim të ish-mjekes së institucionit, e cila për vitet 2019-2020, i përdor ato sipas rastit, duke lëshuar recete mjekësore dhe nënshkruhet nga edukatorja dhe kujdestarja. Marrja në ngarkim e medikamenteve nga mjekja e institucionit, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi 15.</p>
Kriteri:	<p>Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë, mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, dhe në nenin 8 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, në cilësinë e AK ka përdorur procedurën e prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë (pa TVSH) për blerje medikamentesh, për përdorim nga fëmijët rezident në këtë institucion publik.</p>
Ndikimi/Efekt:	<p>Gjendja kontabël e barnave në magazine për vitin 2019 është zero lekë, për vitin 2020 është zero lekë, dhe për vitin 2021 është 37,418 lekë. Për vitin 2021, blerjet e medikamenteve kryhen në sasi më të vogla dhe me afër nevojave, por gjendja në medikamenteve në fund të vitit në vlerë 37,418 lekë ose 41.7% e blerjes, tregues ky që evidenton se blerja e medikamenteve është më e madhe se nevojat për përdorim, ndërkohë që VKM nr. 285/2011 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 11, pika 3, lejon që për blerjet e medikamenteve AK mund të bëjë blerje me faturë tatimore në çdo kohë, mjafton që fondi limit të mos tejkalojë 100,000 lekë.</p>
Shkaku:	<p>Paqartësi e punonjësve të institucionit, në lidhje me zbatimin e procedurës së blerjeve nën 100 mijë lekë referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, i cili për blerjet nën 100.000 lekë nuk përcakton procedura</p>

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHETËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	prokurimit. Pagesat në këto raste bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar kontratë të tillë.
Rëndësia:	Siguria e cilësisë së shëndetit të fëmijëve
Rekomandime:	Nga ana e Autoriteti Kontraktor, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi me vlerë nën 100 mijë lekë, Komisioni i Blerjeve të Vogla duhet të dokumentojë me anë të një procesverbali domosdoshmërinë e blerjes së medikamenteve duke përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blere sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist sipas nevojës imediate për medikament, përveç të rasteve të sëmundjeve kronike ose atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte. Për çdo blerje medikamenti duhet të verifikohet dhe evidentohet afati skadencës së medikamentit, sipas i cili minimalisht duhet të jetë mbi një vit nga data e blerjes së tij. Te ndërpritet përfundimisht mbajtja e medikamenteve nga mjeku i institucionit dhe mbajtja e tij të bëhet sipas rregullave të Udhëzimit nr.30/2011.

Nga procedurat e realizuara, grupi i auditimit përzgjedhi për auditim procedurat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i procedurës	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Realizimi (në %)	Viti
1	Blerje materiale pastrimi	Vlerë e vogël	400,000	68,000	86,5	2019
2	Blerje materiale pastrimi	Vlerë e vogël		278,000		2019
3	Blerje medikamentesh	Deri në 100,000 lekë	99,900	96,648	96,7	2019
4	Blerje produktesh ushqimore	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit	1,070,000	1,065,355	99,56	2019
5	Blerje produktesh ushqimore	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit	799,600	792,400	99	2020
6	Blerje materiale pastrimi	Vlerë e vogël	450,000	191,191	88,95	2020
7	Blerje materiale pastrimi			209,090		2020
8	Blerje medikamente	Deri në 100,000 lekë	100,000	45,834	45,8	2020
9	Shërbim roje civile	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit	306,666	306,664	99,99	2020
10	Shërbim roje civile	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit	310,826	308,583	99,27	2020
11	Shërbim roje civile	Kërkesë për propozim	1,870,910	276,731	14,79	2020
12	Blerje materiale pastrimi	Vlerë e vogël	500,000	193,700	93,14	2021
13	Blerje materiale pastrimi			272,040		2021
14	Blerje produkte ushqimore	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit	1,640,000	1,625,087	99	2021
15	Blerje medikamente	Deri në 100,000 lekë	100,000	89,674	89,67	2021
SHUMA			7,647,902	5,818,997		

Nga procedurat e zhvilluara nga MASR, nga grupi i auditimit janë përzgjedhur për tu audituar 15 procedura prokurimi, nga auditimi i të cilave është konstatuar si më poshtë vijon:

Janë audituar tre procedura prokurimi të realizuara përkatësisht në vitin 2019, 2020, 2021, të tipit **“Blerje artikuj ushqimor”** dhe lloji i procedurës **“Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”**.

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit u fokusua, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, në lidhje me procesin e realizimit të procedurave të prokurimit



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

për periudhën e auditimit 2019-2021, sipas Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik ÷ ndryshuar, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ÷ ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ÷ ndryshuar, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ÷ ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik si dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje me kontratat e prokurimit, duke konstatuar se:

1. Auditimi i procedurës me objekt “Blerje ushqimesh për institucionin “Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë” realizuar në prill të vitit 2019, me fond limit në vlerën prej 1,070,000.0 lekë pa TVSH.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ÷Blerje artikuj ushqimor” realizuar në vitin 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr.3 prot 119/1 datë 11.04.2019, titullari i AK ka miratuar arsyet përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT. 1. E.K 2. A.H 3. Xh. F	3. Urdhër nr.2 prot. 119 datë 11.04.2019 ÷Përgatitja e hartimit të fondit limit të komision : 1. A.H Kryetar 2. XH.F 3. E.D	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur në bazë të urdhër nr.4, prot 119/2, datë 11.04.2019 1. E.K -Kryetar 2. A.H- anëtar 3. XH.F-anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ÷Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 1,070,000.0(njëmilion e shtatëdhjetëmijë) lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,065,355 (një milionë gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 4,645.0(katërmijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 15.04.2019, ora 11:30	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1. ÷Së shpk me NIPT XX me vlerë prej 1,065,355.0 lekë pa TVSH 2. ÷D.P. ...÷shpk me NIPT XX me vlerë prej 1,069,621.0 lekë pa TVSH.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ÷nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ÷nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontratë nr.24.042019 prot119/9 datë 24.04.2019, fillon më datë 24.04.2019 dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re për vitin 2019.	15.Komisioni i marrjes në dorëzim: Në bazë të kontratës nr.119/9, prot datë 24.04.2019, është përcaktuar, përfaqësuesi i autorizuar për AK zj. L.Ç., si dhe në bazë të nenit 5, kryerja e furnizimit ÷lëvrimi i mallit.	

Nga auditimi u konstatua se kjo procedurë është shpallur me Urdhër prokurimi nr. 3, 119/1, prot, datë 11.04.2019, me fond limit prej 1,070,000.0 (njëmilion e shtatëdhjetëmijë) lekë akorduar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2019.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë:

- 1) S me NIPT xx, me vlerë oferte prej 1,065,355.0 lekë pa TVSH.
- 2)D.P. ...shpk me NIPT xx me vlerë prej 1,069,621.0 lekë pa TVSH.

*Me anë të Urdhrit nr. 3, 119/1, prot, datë 11.04.2019, është ngritur njësia e prokurimit për kryerjen e procedurës së prokurimit me fond limit në vlerën 1,070,000.00 (njëmilion e shtatëdhjetë mijë) lekë, nga Titullari i AK znj. L.Ç., (e komanduar) përgjegjëse e sektorit social në SHFSH Tiranë, me këtë përbërje:

Njësia e prokurimit:

1. Znj. E.K, me detyrë juriste, në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

2. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të administratës në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.
3. Znj. Xh.F, me detyrë kryekujdestare në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.

-Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit të kontratës me objekt **“Blerje artikuj ushqimor”**, Titullari i AK, ka urdhëruar ngritjen e grupit sipas Urdhrit nr. 119, datë 11.04.2019, të përbërë nga:

1. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të administratës në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.
2. Znj. Xh.F, me detyrë kryekujdestare në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.
3. Znj. E.D, me detyrë përgjegjëse e sektorit social.

-Për **Komisionin e vlerësimit të ofertave**, Titullari i AK, ka urdhëruar me anë të urdhrit nr 4, 119/2, prot, dt. 11.04.2019, grupin e punës me përbërje:

1. Znj. E.K, me detyrë juriste, në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit.
2. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të administratës në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.
3. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të administratës në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.
4. Znj. Xh.F, me detyrë kryekujdestare në Shtëpinë e Fëmijës, Tiranë.

Në lidhje me këtë urdhër, konstatohet se:

(a) Nga Titullari i AK, Drejtori i komanduar zj. L.Ç., janë vendosur persona të njëjtë me konkretisht në komisionin me Urdhër nr. 2 prot.119 datë 11.04.2019 òPërgatitja e hartimit të fondit limitò me përbërje (zj. A.H, Xh.F), në Njësinë e Prokurimit me Urdhër nr.3 datë 11.04.2019 me përbërje (E.K zj. A.H, Xh.F) dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO) me Urdhër nr.4 datë 11.04.2019 me përbërje (E.K, A.H, Xh.F), kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, **neni 58** dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, ku citohet se:

“Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.

Për këtë mban përgjegjësi znj. L. Ç., në pozicionin e personit përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së këtij Institucioni.

(b) Procedura e prokurimit publik me objekt furnizimi me Ushqime për subjektin òZyber Hallulliò për vitin 2019, nuk është realizuar nga ABP, në detyrim të VKM-së, nr.82 datë 14.02.2018 òPër ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime ò i ndryshuar, pasi procedura është filluar nga Shërbimi Social Shtetëror, në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò neni 11 pika 2 i cili shprehet se

òAutoriteti kontraktor mund t'i kërkojë organit qendror blerës të kryejë një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së fituesit ose një sërë procedurash të tilla në emër të tij, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdishme për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregutò

dhe në bazë të VKM nr.914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 8 (kufijtë monetarë) pika 2 dhe neni 40 (procedura e prokurimit me vlerë të vogël pika 1, citohet se:

òAutoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/ mallra/shërbim, ku vlera e përlllogaritur është më e ulët se 800,000 (tetëqind mijë) lekë në vit.....ò

Gjithashtu, në bazë të Memos pa datë, hartuar nga anëtari i jashtëm (E.K) në cilësinë e anëtarit të Njësisë së prokurimit, i miratuar në bazë të Urdhër nr.621/3 prot datë 04.04.2019 òPër caktimin e juristit të njësisë së prokurimit për procedurën e prokurimit òBlerje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

ushqimeshë që do të zhvillohet nga institucionet e përkujdesit shoqëror në varësi të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH)ë, shprehet se *ö.kontrata nr.232 prot datë 10.07.2018 dhe kontrata datë 03.01.2019 me objekt “Blerje ushqimesh”, mbaron në prill të 2019. SHSSH në cilësinë e organit qendror blerës ka hedhur në sistemin elektronik më datë 31.01.2019 me REF-05715-01-30-2019 dhe është hapur më datë 11.03.2019. Pas procesit të vlerësimit të ofertave nga KVO, njëri prej OE ka paraqitur ankesë, ku SHSSH nuk e ka pranuar, kështu në referim të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim publik” i ndryshuar neni 63, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, i cili ka pezulluar procedurën. Sa më sipër, në kushtet në të cilat ndodhet Shtëpia e Fëmijëve Tiranë të ezaurimit edhe të ushqimeve të siguruara përmes kontratave të mësipërme, pra në kushtet e nevojës ekstreme, kështu jemi të detyruar të përdorim procedurën negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për një periudhë kohore prej 3 muaj, me kusht zgjidhës lidhjen e kontratës sipas procedurës së hapur të prokuruar në mënyrë të përqendruar nga SHSSH.ö*

Kështu, nga AK në këtë rast Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë në mbështetje të bazës ligjore dhe nënligjore, respektivisht, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *öPër prokurimin Publik* i ndryshuar neni 33/2/c dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 *öPër miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar, neni 36; Udhëzimit të APP-së nr.02, datë 08.01.2018, pika 10/c, ku citohet se:

Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike, pika c, ku citohet se:

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.

ka realizuar procedurën e prokurimit *öNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit*ö, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, pasi ka detyrimin primar ligjor:

Furnizimin e pandërprerë për gjatë gjithë vitit me produkte ushqimore për të gjithë fëmijët e grup moshave që janë rezidentë, pranë tij.

(c) Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, nga AK Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë *öZyber Hallulliö* u konstatua se:

(i) grupi për hartimin e fondit limit ngritur me Urdhër nr.2 datë 11.04.2019 *öPër ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt öBlerje ushqimeshë me përbërje (A.H, XH.F dhe E.D), nuk ka paraqitur procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 1,070,000 (një milion e shtatëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, vlerë e cila nuk është e llogaritur duke e ndarë specifikisht në këto elementë (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasi të e kalorive ditore që i duhet çdo fëmije sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 *öPër prokurimin Publik* i ndryshuar, neni 59:*

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës.

si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 *öPër miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar neni 59, VKM nr.518 datë 04.09.2018 *öPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarö* Kreu V si dhe me Udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 *öPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ö*

(ii) Nga auditimi u konstatua se, VKM nr.518 datë 04.09.2018 *öPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarö* Kreu V, si dhe me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, kanë përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror sipas grup moshës, por **nuk ka përcaktuar** sasi të e kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës, fakt që e rrit riskun mbi saktësinë e mënyrës së përcaktimit të vlerës ditore të shpenzimeve për secilin fëmijë dhe nuk jep garanci që kjo vlerë të jetë përlllogaritur saktë dhe në përputhje me nevojat e fëmijëve për ushqim.

(iii) Në bazë të VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò Kreu V, pika 71 citohet se:

*òNivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare **indeksohen çdo vit**, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolikeò.*

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se sipas Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò **niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar**, duke qëndruar të njëjtat kosto ditore sipas grup moshave të fëmijëve, prej vitit 2018 e në vazhdim, pra për një periudhë 3-vjeçare ku nisur dhe nga situata të jashtëzakonshme sikurse ishte pandemia COVID e ndodhur në vitin 2020, solli një inflacion të madh dhe një rritje çmimesh në produktet ushqimore bazë.

Nisur nga të dhënat e INSTAT, në lidhje me tabelën e paraqitur në faqen zyrtare **Ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit**, grupi òUshqime dhe pije alkoolikeò, nga grupi i auditimit u përlllogaritën se si duhet të ishin ndryshuar këto kuota çdo vit, për koston ditore për secilën grup moshë sipas Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò dhe konkretisht paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Kosto ditore e përlllogaritur sipas ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit

Grup moshë	Kosto ditore	Ndryshime mes i indeksit të çmimeve/2019	Vlera shtesë e indeksuar, 2019	Kosto ditore /2019, update	Ndryshimi mes i indeksit të çmimeve/ 2020	Vlera shtesë e indeksuar, 2020	Kosto ditore /2020	Indeksi /2021	Vlera shtesë e indeksuar, 2021	Kosto ditore /2021
6-12 vjeç	440	0.029	12.76	452.76	0.036	16.30	469.05	0.039	18.29	487.35
13-15 vjeç	480	0.029	13.92	493.92	0.036	17.78	511.70	0.039	19.96	531.66
16-18 vjeç	500	0.029	14.5	514.50	0.036	18.5	533.02	0.039	20.79	553.81
Totali	1420	0.087	41.18	1461.18	0.108	52.6	1513.78	0.117	59.037	1572.82

(Burimi INSTAT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së)

Pra sikurse konstatohet kosto ditore për fëmijë duhet të kishte ndryshuar përkatësisht për secilën grup moshë:

Nga 440 në 487,35 (fund të 2021) pra do të ishte rritur me 47 lekë në ditë

Nga 480 në 531,66, pra do të ishte rritur me 52 lekë në ditë

Nga 500 në 553,81, pra do të ishte rritur me 54 lekë në ditë.

E dhënë në vlerë vjetore paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela: Efekti i ndryshimit të koston ditore sipas grup moshave dhe ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit.

Grup moshë	Kosto ditore/ lekë	Kosto vjetore 2018/për fëmijë	Kosto vjetore 2019/për fëmijë	Kosto vjetore 2020/për fëmijë	Kosto vjetore 2021/për fëmijë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

6-12 vjeç	440	160,600	165,257	171,207	177,884
13-15 vjeç	480	175,200	180,281	186,771	194,055
16-18 vjeç	500	182,500	187,793	194,553	202,141
Totali	1420	518,300	533,331	552,531	574,079
Efekti			-15,031	-34,231	-55,779

Burimi INSTAT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Pra nga sa më sipër kjo ndikon drejtpërdrejt në llogaritjen e fondit limit, sasinë ditore ushqimore të planifikuar për fëmijë dhe si rrjedhim në mosplotësimin e nevojave ushqimore për çdo grup moshë, veprime në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò Kreu V, pika 71.

(iv) Nga auditimi u konstatua se, duke u bazuar në të dhënat e institucionit *Shtëpia e Fëmijëve Tiranë*, mbi numrin e fëmijëve për vitin 2019/muaji prill, e llogaritur me metodën e ponderimit (mesatarizimin për 30 ditë) **41 fëmijë** në total, rezultoi se:

Në mbështetje të vlerës së fondit limit prej 1,070,000 (një milion e shtatëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, shpenzimi mujor për 41 fëmijë ($1,070,000/3\text{muaj} = 356,667$ lekë/ në muaj)

Shpenzimi ditor për fëmijët ($356,667$ lekë/muaj/30 ditë= $11,889$ lekë/ditë për 41 fëmijë)

Në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, duke u nisur nga grup moshat 6-18 vjeç, shpenzimet ditore është në vlerën prej 473 lekë/ditë $\times 41$ fëmijë = $19,393$ lekë/në ditë.

Sa më sipër, në mbështetje të fondit limit kosto ditore për 41 fëmijë është $11,889$ lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej $19,393$ lekë, pra me një diferencë prej $7,504$ lekë/ditë për 41 fëmijë, ose e thënë ndryshe **183 lekë më pak për secilin fëmijë**, e përlllogaritur nga AK, në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ò

(d) **Nga auditimi pranë** sistemit të prokurimeve elektronike SPE, si dhe në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik òS.ò shpk, u konstatua se:

(1) Në DST nga njësia e prokurimit ngritur me Urdhër nr. 3 prot 119/1 datë 11.04.2019, me përbërje (E.K, A.H, dhe Xh.F) është kërkuar në pikën 2.3 (Kapacitet Teknike) nënpika 2-3 shprehimisht:

“Furrë buke minimumi 1 (një) në pronësi ose në përdorim, ku të përfshihen të gjitha ambientet e përshtatshme për ruajtjen, magazinimin dhe prodhimin e bukës. Leje higjeno-sanitare si dhe Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

-Njësi tregtare ushqimore vërtetuar me vërtetim pronësie ose kontratë qiraje shoqëruar me Lejen Higjeno-Sanitare përkatëse si dhe Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

OE ka paraqitur Kontratë Qiraje nr.1417 Rep, 409 Kol datë 01.02.2018 midis personit fizik F. Xh në cilësinë e qiradhënëses dhe shoqërisë òM.B...ò në cilësinë e qiramarrësit për pronën e një ndërtese në fshatin Libonik, Rruga Qendër, nr. pasurie 45/79, zona kadastrale 2445, për ta përdorur për prodhim e buke dhe magazinë për mbajtjen e produkteve.

Në bazë të Ekstraktit Historik të Regjistrisë Tregtare për të dhënat e subjektit òS.ò, (ndryshuar si emër në 27.03.2018.) Shoqëri me përgjegjësi të kufizuarò, datë 13.06.2022, përkatësisht në faqet 14, 15, 17, dhe në faqen 20, u konstatua se:

-Në datën 27.03.2018 me nr. çështjeje CN-Xx-03-18, u krye ndryshimi i administratorit Sh. S dhe u vendos L. S., emri i subjektit nga M.B..... u bë òS.ò shpk.

-Në datën 21.09.2018 me nr. çështjes CN-Xx-09-18, është mbyllur adresa dytësore e aktivitetit në Korçë, me adresë Libonik, Rruga Qendër, nr. pasurie 45/79, zona kadastrale 2445, pra objekti i marrë me qira nga subjekti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Rrjedhimisht në këtë adresë nuk është kryer më aktivitet, pavarësisht që Kontrata e Qirasë nr.1417 Rep, 409 Kol datë 01.02.2018, ka pasur afat zbatimi 5 vjet nga data e lidhjes.

-Në datën 27.03.2019 me nr. Çështjeje CN-Xx-03-19 është kryer hapja e po të njëjtës adresë dytësore në Libonik, Rruga Qendër, nr. pasurie 45/79, zona kadastrale 2445 dhe me të njëjtin përfaqësues të cituar më sipër.

Pra konstatojmë se për periudhën 21.09.2018 deri më 27.03.2019, pra për një periudhë 6 mujore shkepjtje, OE fitues 0S.ö shpk, nuk ka zhvilluar aktivitet në këtë adresë dhe për rrjedhojë aktet administrative për këtë objekt nuk kanë vlefshmëri juridike. Pra kontrata e qirasë nr.1417 Rep, 409 Kol, datë 01.02.2018, kanë ndryshuar, pasi duhej të rishikohej me ri-fillimin e aktivitetit të lidhej një kontratë e re, ku të pasqyrohej ndryshimi i administratorit dhe emrit të shoqërisë, veprime në kundërshtim me ligjin 9920 datë 29.05.2008 0Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, neni, 43/Përditësimi i të dhënave të regjistrimit.

(i) OE ka paraqitur licencë lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (Qendra Kombëtare e Licencave), të datës 07.08.2014, (Kodi) II.1.B (Kategoria) prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve me emër subjektit M.B....., afati i vlefshmërisë pa afat, Licencë lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (Qendra Kombëtare e Licencave) të datës 11.07.2017, (Kodi) II.1.C (Kategoria) prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve me emër subjekti M.B..... , afati i vlefshmërisë pa afat si dhe Leje nga Qendra Kombëtare e Biznesit të datës 19.04.2017, (Kodi) II.1.A (Kategoria) për ndikimin në mjedis me emër subjektit M.B....., afati i vlefshmërisë pa afat.

Sa më sipër, nuk është paraqitur Licencë e re/ Leje, ku të pasqyrohej ndryshimi i emrit të shoqërisë, veprime në kundërshtim me ligjin 9920 datë 29.05.2008 0Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar neni.43/ Përditësimi i të dhënave të regjistrimit, ku citohet se:

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

(ii) OE ka paraqitur Akt-Miratim-Higjieno-Sanitar nr.972 datë 09.02.2017, në emër të personit juridik M.B....., për furrën e bukës si dhe Akt-Miratim-Higjieno-Sanitar nr.1551 datë 01.06.2018, në emër të personit juridik S., për magazinën ushqimore frigoriferike në lagjen 0Xh.N.ö Lushnjë.

Sa më sipër, aktet administrative janë lëshuar jo në koherencë me realizimin e procedurës dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, duke cenuar kriterin e higjienës dhe sigurisë dhe sigurisë ushqimore.

Për sa më sipër, KVO e ngritur me Urdhër nr. 4, 119/2, prot, dt. 11.04.2019 me përbërje (E.K, A.H, dhe Xh.F), duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar dhe LPP, ku ndër të tjera citohet se:

..Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal. Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e njoftuar, por, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e dorëzimit të ofertave..

Në këto rast OE fitues nuk i ka plotësuar kriteret e mësipërme dhe shpallja fitues, është bërë në mënyrë të padrejtë në mospërputhshmëri me DST, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet buxhetore, për rrjedhojë **vlera prej 1,065, 355 lekë pa tvsh, është përdorur pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet nga SHFSH.**

Monitorimi i zbatimit të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Komisioni për marrjen në dorëzim të ushqimeve është ngritur sipas Urdhrit nr.6, dt. 03.01.2019 të Titullarit të SHF me përbërje:

- 1) K.L, ish-mjeke në Shtëpinë e Fëmijës (kryetare komisioni)
- 2) E.S, punonjës i mirëmbajtjes
- 3) Kuzhinieri i turnit, sipas grafikut

Midis Autoritetit Kontraktor dhe Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë dhe Kontraktuesit dhe shpk me NIPT XX, në bazë të procedurave të prokurimit me REF-17786-04-12-2019, është lidhur Kontrata e Furnizimit dhe Ushqimeshë nr. 119/9 prot, datë 24.04.2019. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, VKM nr.914, datë 29.1.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 23.04.2019, në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate është **1,065,355 leke (pa tvsh) dhe 1,278,426 leke** (me tvsh). Cilësia e mallit do të jetë sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit. Sigurimi i kontratës në vlerën 127,843 leke ose 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve dhe E.ö shme Formularin e sigurimit nr. Serial 070351810026801, datë 24.04.2019, me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës.

Kjo kontratë fillon efektet në momentin e nënshkrimit datë 24.04.2019, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re deri më 15.07.2019.

Grafiku i lëvrimit të mallit:

a- Për ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

b- Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë, etj., sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Malli do të merret në dorëzim, kundrejt faturës tatimore origjinale nga proces verbali i marrjes në dorëzim i mbajtur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Nga zbatimi kontratës rezultoi se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 3 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 1,145,380 leke ose 90% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzim	Fatura total artikuj	Totali i faturës (me tvsh)	F-hyrje	Targa e mjetit
Nr.60, dt. 10.05.2019	Nr.470, dt. 30.04.2019	342,790	Nr.8, dt. 30.04.2019	AA4xx
Nr.80, dt. 13.06.2019	Nr.474, dt. 30.05.2019	634,882	Nr.5, dt. 30.05.2019	AA4xx
Nr.90, dt. 02.07.2019	Nr.477, dt. 17.06.2019	167,708	Nr.12, dt. 17.06.2019	AA4xx
Paguar (90%)		1,145,380		

Malli është pranuar nga Komisioni i Pranimit të Mallit, i përbërë nga K.L (kryetare); E.S (anëtar) dhe kuzhinieri i turnit përkatës, ngritur sipas Urdhrit nr. 6, datë 03.01.2019, i cili do të funksionojë për të gjithë vitin. Komisioni i Pranimit ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazinë për çdo furnizim nga operatori ekonomik.

1. Por proces verbali i mbajtur për këtë qëllim, përmban listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pika 35 dhe 36, (sepse mungojnë datat e dokumentit, firma e personave që kanë marrë në dorëzim mallin, emri i personit që ka kryer furnizimin për të vërtetuar nëse ky individ është i deklaruar në listë pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të OE, etj., mjeti me të cilin është kryer furnizimi, nuk evidentohet analiza veterinarë për produktet ushqimore, dokumenti shoqëruar i mallit sipas kërkesave të DST të prokurimit publik.

Kontrata nr. 119/9, datë 24.04.2019 është ndërprerë në datë 10.06.2019, moment i lidhjes së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

kontratës së re me nr.178 prot, datë 10.06.2019, procedurë prokurimi e zhvilluar nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të autorizimit për lidhje kontrate me nr. 1031/3 prot, datë 06.06.2019).

-Nga auditimi u konstatua se, Urdhërshpenzimet kanë mangësi të dokumentacionit shoqërues administrativ nga Shtëpia e Fëmijës, TR, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar,Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35 dhe 36, me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik òi ndryshuar, neni 59, 60 (Kreu VI, Zbatimi i kontratës), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 77/Mbikëqyrja e Kontratës, pika 2, ku citohet se:

Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti Kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

-Mangësitë e konstatuara, si më poshtë:

a) Në faturat e shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues për çdo furnizim në rastin e kontratës së sipërcituar nuk është sjellë me automjetet tip të deklaruara nga OE në dokumentet standard dhe konkretisht ato janë transportuar me mjetin me targë AA XXRN, ndërkohë që targat e deklaruara përkatësisht nga OE, sipas mjeteve janë: AAXXTY dhe AAXXJR. (Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi).

b) Certifikatë Shëndetësore Veterinare, lëshuar nga institucionet përkatëse ose Raport analizat e kryera nga AKU, nuk figurojnë të jenë bashkëlidhur faturave tatimore sikurse është përcaktuar në DST duke cenuar sigurinë ushqimore, si dhe mallrat ushqimorë të ardhur janë transportuar nga persona fizik të paidentifikuar në proces verbalë, fakt që lë hapësira dyshimi për të vërtetuar nëse këta individë janë të deklaruar në listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, kontratat e punës, mungon fatura e blerjes së mallrave ushqimore nga OE për të verifikuar nëse transaksioni është kryer me subjektet me të cilët janë lidhur kontratat e qerasë nga kontraktori) (**Sipas DT, nuk është i lejuar nën kontraktimi**).

c) Në fillim të vitit buxhetor 2019, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” ka ngritur komisionet e marrjes në dorëzim të produkteve ushqimorë, ndonëse kontratat janë lidhur mbas muajve prill e në vazhdim të vitit 2019. Ky fakt ka bërë të mundur që komisioni i ngritur për të gjithë vitin nuk kanë shumë njohuri mbi OE fitues, nuk kanë informacion mbi specifikimet teknike (nuk u konstatua në asnjë proces verbal, p.sh. temperatura e mishit në momentin e hyrjes në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës, etj..).

d) Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas.

e) Në strukturën e Shtëpisë së Fëmijës, nuk është planifikuar apo aplikuar ekzistenca e strukturave monitoruese për kontratat, por është njaftuar vetëm me vendosjen e emrit të specialistit që do të ndjekë ecurinë e kontratës, që në rastin konkret është znj. A.H. Gjatë auditimit nuk u konstatua hartimi i raportit në përfundim të kontratës, ku sipas VKM nr. 914/2014, është parashikuar që personi përgjegjës për prokurimin pranë autoritetit Kontraktor merr informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton APP-së ose në rastin tonë Shërbimit Social Shtetëror, veprime në kundërshtim me nenin 77, pika 4 të VKM nr. 914/2014, ku citohet se:

Në përfundim të kontratës, autoriteti Kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

f) Nga auditimi, u konstatua se si pasojë e mos realizimit në kohë të këtyre procedurave nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), pranë Ministrisë së Brendshme, procedurat janë realizuar (për vitin 2019) dhe jo të monitoruara nga Shërbimi Social Shtetëror, ku u evidentua se, kanë mungesa të theksuara të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit dhe monitorimit, duke paraqitur konfuzitet mbi segmentet e caktuara të procesit të prokurimit, si rezultat i mos organizimit të trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.

Të gjitha elementët e sipër përmendur, kanë bërë që, ekzekutimi dhe monitorimi, paraqitet me tregues në shkellje të procedurave ligjore, në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, të cilat përbëjnë risk për shkellje dhe abuzime me fondet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

2. Auditimi i procedurës me objekt “Blerje ushqime- vezë, mishi dhe nënproduktet e tij” realizuar në gusht të vitit 2020, me fond limit në vlerën prej 799,600 lekë pa TVSH.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ÷Blerje artikuj ushqimor-vezë, mishi dhe nënproduktet e tij “realizuar në vitin 2020.		
1. Urdhër Prokurimi nr.153/2 prot datë 19.08.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT. 1. E.K 2. E.D 3. K.L	3.Urdhër nr.153 prot datë 19.08.2020 ÷Përgatitja e hartimit të kërkesave, për subjektet që do të kryejnë lëvrimin e këtyre produkteve ushqimore, specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit fondin limitë me komision : 1. A.H 2. E.L 3. F.A	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur në bazë të urdhër nr.153/1, datë 19.08.2020 1.A.H-kryetar 2. B.B-anëtar 3.XH.F -anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ÷Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimitë		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 799,600(shtatëqind e nëntëdhjetenëntë mijë e gjashtëqind) lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 792,400 (shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 7,200(shtatë mijë e dyqind) lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 27.04.2020, ora 09:00	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike 1. ÷E.Cö Shpk me NIPT LXXR
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ÷nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ÷nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontratë 153/5, datë 27.08.2020, me afat deri më 31.12.2020.	15.Komisioni i marrjes në dorëzim: Në bazë të kontratës nr. 153/5 prot datë 27.08.2020, është përcaktuar, përfaqësuesi i autorizuar për AK zj. S.L, si dhe në bazë të nenit 5, 6, kryerja e furnizimit ÷lëvrimi i mallit është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrit nr. 4, dt.. 06.01.2020, me përbërje: K.L (kryetare), B.Gj dhe Kuzhinieri i turnit , anëtarë).	

(a)Procedurat e prokurimit publik me objekt furnizimi me Ushqime për subjektin ÷Zyber Hallullië për vitin 2020, nuk janë realizuar në kohë nga ABP, në detyrim të VKM-së, nr.82 datë 14.02.2018 ÷Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogarit të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime ÷ i ndryshuar.

Me Urdhrin nr.153/2, datë 19.08.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. S.L ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit, negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në sistemin e prokurimit elektronik, me objekt ÷Blerje Artikuj Ushqimore-vezë, mish dhe nën produkte të tijë për nevoja të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor, Tiranë, me fond limit prej 799,600 lekë pa TVSH dhe ngritjen e njësisë së prokurimit me përbërje znj. E.K, znj. E.D dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

znj. K.L.

Po kështu, në formularin nr. 2 u përcaktua sipas kërkesës së magazinës edhe sasia e artikujve ushqimor të nevojshëm për tu prokuruar.

Me procesverbalin nr.1, protokolluar me nr. 153/4, datë 19.08.2020, Njësia e Prokurimit ka kërkuar t'ia dërgohet ftesa për ofertë 3 shoqërive me eksperiencë në tregun e ushqimeve konkretisht, operatorit ekonomik òE.Cò shpk, Nipt LXXR, operatorit ekonomik òM.C.ò shpk, me Nipt KXXJ dhe operatorit ekonomik òE.ò shpk, Nipt LXXI. Rezulton se Njësia e Prokurimit nuk e ka justifikuar përzgjedhjen e këtyre operatorëve, në shkelje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ~~Ë~~Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. Po kështu, në DST, nuk rezulton të jetë përcaktuar grafiku i lëvrimit, në shkeljet të përcaktimeve të nenit 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ~~Ë~~Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku parashikohet që:

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- *specifikimet teknike;*

- *grafikun e lëvrimit;*

- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

Gjithashtu, referuar përcaktimeve të pikës 6, paragrafi 2, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ‘Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike’, parashikohet që:

Argumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.

Po kështu, ftesa për ofertë i është dërguar te njëjtëve operatorë ekonomik, si në procedurën e prokurimit me të njëjtin objekt për vitin 2019, në mospërputhje me përcaktimet e pikës 6, paragrafit të 1 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ‘Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ku parashikohet që:

Zgjedhja e operatorëve ekonomik duhet të bëhet në mënyrë jo diskriminuese. Autoriteti kontraktor duhet ti ndërrojë sa më shpesh të jetë e mundur kandidatët që do të ftojë.

Ftesa për ofertë ju është dërguar operatorëve ekonomik, në datën 19.08.2020 ora 21.48, dhe referuar përcaktimeve të DST, Seksioni 4, pika 3 është përcaktuar që afati për dorëzimin e ofertave ka qenë data 20.08.2020 ora 16.00. Referuar pikës 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ‘Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, parashikohet që:

“Njësia e prokurimit në përcaktimin e afateve kohore për paraqitjen e ofertave duhet të mbajë në konsideratë një afat kohor minimal, i cili duhet të jetë i nevojshëm për ti dhënë mundësinë kandidatëve/ofertuesve të përgatisin ofertën.”

Referuar afatit kohor 16 orësh të përcaktuar në DST, konsiderohet si afat i shkurtër kohor për përgatitjen e ofertës, dhe mund të jetë i tillë, që dikton operatorët ekonomik në procesin e konkurrimit.

Në dosjen e prokurimit gjendet kërkesa e magazinierit z. A. D, me listën e produkteve dhe sasinë e nevojshme në lidhje me to. Kërkesa nuk rezulton të ketë asnjë nga elementët e aktit administrativ, si datë dhe subjektit të cilit i është drejtuar Po kështu nuk rezulton të jetë justifikuar sasia e nevojshme në raport me periudhën e kërkuar, në shkelje me përcaktimet e pikës 154 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, ku parashikohet që:

Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijëni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues.

Me shkresën nr. 282/1, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje znj. A. H, znj. A. Zh dhe M. I.

Me shkresën nr. 282/2, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerësimit të kontratës me përbërje znj. A. H, znj. E. L dhe znj. F. A.

Në kushtet kur ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm operatori ekonomik ÷E.Cö, është bërë vlerësimi në lidhje me dokumentacionin e paraqitur dhe është identifikuar si ofertë e suksesshme. Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në shkelje të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor .

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ÷Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që:

÷Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.

Në lidhje mbi furnizimin me vezë, mish dhe nënproduktet e tij, Kontrata nr. 338/5 prot, datë 31.12.2019, ka mbaruar më datë 06.06.2020. ABP ka njoftuar se Loti i vezëve është anuluar në bazë të shkresës me nr.1143 prot datë 18.06.2020 si dhe në bazë të Vendimit të KPP nr.299/2020 është anuluar dhe Loti i mishit dhe nënprodukteve të tij.

Nga AK ÷Zyber Hallulli është kërkuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik miratimi për të realizuar procedurën: ÷Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, Blerje Ushqime, të cilat janë të domosdoshme për mirërritjen e fëmijëve, pasi mungesa e këtyre artikujve ushqimorë përbën problem, pasi fëmijët e grup moshave janë rezidentë.

Kështu, në mbështetje të bazës ligjore dhe nënligjore, respektivisht, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin Publik ÷ i ndryshuar neni 33/2/c dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ÷ i ndryshuar, neni 36; udhëzimit të APP-së nr.02, datë 08.01.2018, pika 10/c, institucioni ÷Zyber Hallulli ka realizuar procedurën e prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, pasi ka detyrimin primar ligjor, furnizimin e pandërprerë për gjatë gjithë vitit me produkte ushqimore për të gjithë fëmijët e grup moshave që janë rezidentë, pranë tij.

(b) Nga Titullari i AK, janë vendosur persona të njëjtë në komision, më konkretisht zj. A.H, në komisionin e ngritur sipas Urdhrit të brendshëm nr.153 prot datë 19.08.2020 ÷Përgatitja e hartimit të kërkesave, për subjektet që do të kryejnë lëvrimitin e këtyre produkteve ushqimore, specifikimet teknike, grafikun e lëvrimitit fondin limit të dhe në komisionin e vlerësimit të ofertave (KVO) me Urdhër nr.153/1 datë 19.08.2020, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

datë 20.11.2006 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, neni 58 dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar.

(c) Sipas DST në rubrikën 1.3 Kriteret për kapacitetin teknik, është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, të plotësojë:

1.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë, kontratave të qirave ose nëpërmjet kontratave të furnizimit, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës Thertore / Njësi tregtimi të mishit / ambiente për magazinimin, shoqëruar me Leje Higjeno-Sanitare si dhe Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për artikullin e mishit.

1.3.2 Operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratave të qirave, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës 1 (një) Mjet transporti, të shoqëruar me leje qarkullimi, taksa vjetore e mjetit të vlefshme, policë të sigurimit, certifikatë e kontrollit teknik si dhe leja higjiene sanitare, për automjetin.

-Nga auditimi, pranë faqes zyrtare të app.gov.al me REF-69160-08-19-2020, u konstatua se, nga operatori i vetëm ekonomik pjesëmarrës dhe fitues òE.Aò Shpk me NIPT LXXR, është paraqitur Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.119 datë 27.01.2014, në lidhje mbi lejen higjiene-sanitare për mjetin e transportit me targë TRXT, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) Dega Rajonale Qarku Tiranë, në bazë të ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò i ndryshuar, neni 12.

- Ligji i mësipërm ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, konkretisht, ndryshimi i fundit i ligjit nr.54/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò, ka shfuqizuar pikërisht nenin 12, më datë 30.04.2020, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletore Zyrtare, d.m.th. mbas datës 15.05.2020, e për rrjedhojë, në këtë rast Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i ngritur në bazë të Urdhrit 153/1 datë 19.08.2020 me përbërje (A.H, B.B dhe Xh.F) i AK ka pranuar një Akt-miratimi administrativ të panevojshëm dhe të kundërligjshëm.

Në lidhje mbi vendosjen e këtij kriteri, nga njësia e prokurimit, duhej të përcaktohej qartë se, marrja e akti higjiene sanitar si për ambientin ku zhvillohet aktiviteti si dhe për mjetet e transportit (ATP), duhet të paraqitej me dokumentacionin përkatës nga AKU, autoritet shtetëror që kryen kontrollin paraprakë për përmbushjen e kërkesave tekniko-teknologjike, higjiene sanitare, fito sanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit të ushqimit.

Sa më sipër, nga auditimi në lidhje me ambientet ku ushtrohet aktiviteti për thertore/ dyqan mishi, u konstatua se, janë marrë AMHS si vijon:

- Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.32 datë 23.01.2015, për ambientin e marrë: dyqan mishi, është lëshuar në vitin 2015 nga Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë, d.m.th. 5 vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin si dhe duke humbur seriozitetin e kriterit të higjiens.
- Ky ambient si për thertore dhe dyqan mishi, është marrë me qira nga OE fitues në bazë të
- Kontratës së qirasë me nr.178 Rep nr.76 Kol datë 30.01.2018, për Thertore me sipërfaqe 180 m² si dhe dyqan Mishi me sipërfaqe 50 m², me adresë Kamzë, Tiranë, për periudhë 5 vjeçare.
- Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.542 datë 06.06.2007, për vënien në shfrytëzim të objektit: Kompleks prodhim vezë e rritje zogj, marrë nga Kompania òA.ò Shpk me afat vlefshmërie 1 vit nga data e dhënies së saj, është lëshuar në vitin 2007 nga ish-Inspektorati Sanitar Shtetëror Durrës, pra shumë vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin si dhe duke humbur seriozitetin e kriterit të higjiens.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- OE fitues me shoqërinë ðA.ð shpk, ka lidhur Kontratë Furnizimi nr.2600 Rep.Nr.792 Kol datë 12.11.2018, për furnizim me artikullin vezë.
- Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.119 datë 27.01.2014, për automjetin për transport lloji ATP me targa TR X T(mjeti nuk është në pronësi të OE, por është marrë në bazë të Kontratë-Qiraje nr.65 rep .Nr.28 Kol,) lëshuar në vitin 2014 nga ish-Inspektorati Sanitar Shtetëror Tiranë, është lëshuar në vitin 2014, pra 6 vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin si dhe duke humbur seriozitetin e kriterit të higjiens.
- Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.262 datë 11.03.2013, për automjetin për transport lloji ATV benz-frigorifer me targa AA XX FS (mjeti nuk është në pronësi të OE, por është marrë në bazë të Kontratë-Qiraje nr.1707 rep. Nr.491 Kol,) lëshuar në vitin 2013 nga ish-inspektorati Sanitar Shtetëror Tiranë, pra 7 vjet përpara, duke e humbur koherencën merealizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin si dhe duke humbur seriozitetin e kriterit të higjiens.

Për sa më sipër, KVO e ngritur me Urdhër nr. 153/1 datë 19.08.2020 me përbërje (A.H, B.B dhe Xh.F), duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet standarde të tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Në këtë rast OE fitues nuk i kanë plotësuar kriteret e mësipërme dhe shpallja fitues, është bërë në mënyrë të padrejtë në mospërputhshmëri me DST, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet buxhetore si dhe marrjen e produkteve ushqimorë (mish me nënproduktet e tij dhe vezë) për fëmijët e Shtëpisë së fëmijëve ðZyber Hallullio, për rrjedhoje **vlera prej 792,400 lekë pa TVSH, nga Buxheti i Shtetit. janë shpenzuar, pa ekonomikitet, eficencë dhe pa efektivitet.**

(d) Në bazë të dokumentet standarde të tenderit, nuk është paraqitur në mënyrë të qartë grafiku i lëvrimit të mallit (d.m.th. nuk është përcaktuar sa ditë/javë do të furnizohen me këto produkte), duke u paraqitur në këtë formë:

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Mish vici	Kg	200
2	Mish derri	Kg	200
3	Sallam	Kg	200
4	Krem vice	Kg	200
5	Kofsha Pule	Kg	600
6	Fileto Pule	Kg	400
7	Veze	Kokrra	4800

Afatet e lëvrimit:

Kohëzgjatja në muaj: 4 (katër) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës me të drejtë ndërprerje në momentin e lidhjes se një kontrate të re të përfutuar nga procedurat normale të prokurimit.

Midis Autoritetit Kontraktor ðShtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë dhe OE ðE.Cò Shpk me NIPT LXXR, në bazë të procedurave të prokurimit, është lidhur Kontrata e Furnizimit ðBlerje Ushqimesh ðme nr.153/5 prot, datë 27.08.2020, si dhe në bazë të nenit 5, 6, të saj do të kryhet furnizimi ðlëvrimi i mallit nga komisioni i ngritur nga përfaqësuesi i AK, zj. S.L sipas urdhrin nr. 4, dt. 06.01.2020, me përbërje:

K.L (kryetare), B.Gj dhe Kuzhinieri i turnit , anëtarë).

Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ðPër prokurimin publikö, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.1.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar, si dhe në procedurën e negocimit pa shpallje të njoftimit të kontratës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

meREF-69160-08-19-2020.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 21.08.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate është **792,400 leke (pa tvsh) ose 950,880 lekë (me tvsh)**. Sigurimi i kontratës është kryer në vlerën 95,100 leke ose 10% te çmimit të kontratës nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve òAXx shaö me Formularin e sigurimit nr. Serie 059705, datë 27.08.2020, me afat deri 31.12.2020.

Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit. Kjo kontratë fillon efektet në momentin e nënshkrimit dhe përfundon në datë 31.12.2020.

Paraqesim në vijim kontratat e qerasë të lidhura nga OE fitues me subjektet, si më poshtë:

Për mishin

1. Në bazë të Kontratës së Qirasë me nr.1707 rep. Nr.491 Kol, OE fitues ka marrë me qira mjetin e transportit lloji ATV targa AAXX FS, për transportin e artikullit mish dhe nënproduktet e tij.

2. Në bazë të Kontratës së-Qirasë me nr.65 rep. Nr.28 Kol, OE fitues ka marrë me qira mjetin e transportit lloji ATP targa TRXT, për transportin e artikull mish dhe nënproduktet e tij.

3. Në bazë të Kontratës së-Qirasë me nr.178 Rep nr.76 Kol datë 30.01.2018, OE ka marrë me qira ambiente për Thertore me sipërfaqe 180 m² si dhe dyqan Mishin me sipërfaqe 50 m², me adresë Kamzë, Tiranë, për një periudhë 5 vjeçare.

Konstatohet se nga subjekti qiradhënës nuk është paraqitur leja e ushtrimit të aktivitetit thertore, leje mjedisi, Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit OKL, kritere në DST. Për këtë mban përgjegjësi KVO.

4. Në bazë të Kontratës së furnizimit me nr.251 Rep; nr.132 Kol datë 19.01.2018, OE fitues ka lidhur kontratë furnizimi për artikullin mish viçi me shoqërinë òA. P.ö Shpk, për një periudhë pa afat.

5. Në bazë të kontratës së bashkëpunimit me Nr.258 rep. Nr.133 Kol datë 19.01.2018, OE fitues ka nënshkruar bashkëpunimin me shoqërinë òKö me objekt: Servirja, bagëti të gjalla(kryesisht gjedhë), për një periudhë pa afat.

6. OE fitues ka lidhur Kontratë furnizimi nr.2605 Rep nr.797 Kol datë 12.11.2018 me shoqërinë òA. ALBö për furnizimin me mish pule, për një periudhë pa afat.

Për vezë, zogj dhe pula

- OE fitues ka lidhur Kontratë Furnizimi me nr.2600 Rep.Nr.792 Kol datë 12.11.2018 me shoqërinë òA.ö Shpk për furnizim për artikullin vezë.

Për sa më sipër u verifikuan urdhër shpenzimet, hyrjet në magazinë, proces verbalet e mbajtura nga personat përkatës dhe rezultoi se:

Grafiku i lëvrimit të mallit:

- ✓ Ushqimet e prokuruar çdo ditë të hënë, sipas kërkesave të autoritetit Kontraktor.
- ✓ Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

OE ka faturuar mallrat e sjella me anë të 5 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 950,769 lekë ose 100% e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Tabela: Urdhër shpenzimet

Urdhër shpenzim	fatura total artikuj	Totali i faturës (me tvsh)	f-hyrje	Targa e mjetit pasqyruar në faturën tatimore
nr.141, dt.. 21.09.2020	nr.125, datë 31.08.2020	123,492	nr.14, dt.. 31.08.2020	AA xxB
nr.158, dt.. 14.10.2020	nr. 132, dt.. 30.09.2020	204,198	nr.17, dt.. 30.09.2020	mungon
nr.186, dt.. 16.11.2020	nr.145, dt.. 31.10.2020	186,444	nr.22, dt.. 31.10.2020	TRxxT
nr.211, dt.. 15.12.2020	nr.161, dt.. 30.11.2020	196,956	nr.27, dt.. 30.11.2020	AA XB

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

nr.220, dt.. 23.12.2020	nr.174, dt.. 22.12.2020	239,679	nr. 34, dt.. 22.02.2020	AA XB
Paguar (100%)		950,769		

(Punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së)

Realizimi ne cilësi i kontratës 153/5, datë 27.08.2020

Artikuj ushqimor	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi i prokuruar (me tvsh)	Vlerë e kontratës (me tvsh)	Vlera e realizuar (me tvsh)	Realizimi sipas	devijimi
Kofshe Pule	600	545	300	180,000	163,500	90.83%	-9.17%
Mish Vici	200	207	780	156,000	161,460	103.50%	3.50%
Sallam	200	217.4	540	108,000	117,396	108.70%	8.70%
Krem Vice	200	224	480	96,000	107,520	112.00%	12.00%
Bërxollë Derri	200	180	600	120,000	108,000	90.00%	-10.00%
Fileto Pule	400	374	540	216,000	201,960	93.50%	-6.50%
Veze	4800	5836	15.6	74,880	91,042	121.58%	21.58%
				950,880	950,878		

(Burimi, Shtëpia e Fëmijës, TR, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së)

1. Autoriteti Kontraktor ka pranuar mallin në sasi te ndryshme nga sasia e prokuruar, por pa efekte në vlere totale të kontratës, devijime te evidentuara ne tabelën e mësipërme. Sipas AK, ky devijim është i pashmangshëm për shkak të përshtatjes me menynë javore të ushqyerjes së fëmijëve në përputhje me ndryshimet e saj sipas numrit të fëmijëve, preferencave të ushqyerjes prej tyre.
2. Mos firmosja nga anëtarët e komisionit në te gjithë proces verbalet e pranimit të mallit në Magazinë.
3. Në proces verbalin e marrjes ne dorëzim shpesh herë nuk shënohet data e mbajtjes së tij, orari i furnizimit, verifikimi i cilësisë së mallit të pranuar sipas specifikimeve teknike të kërkuara ne DST (mungese e analizave veterinare për mishin, certifikatat e cilësisë etj..), si dhe në asnjë rast nuk është shënuar targa e mjetit me të cilin është kryer furnizimi nga OE.
4. Proces verbali i marrjes ne dorëzim nuk firmoset nga personi dorëzues i mallit i përcaktuar nga OE fitues në deklaratimet e kryera prej tij.
5. Në faturat e shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues për çdo furnizim në rastin e kontratës së sipërcituar nuk është sjellë me automjetet tip të deklaruara nga OE në dokumentet standard dhe konkretisht ato janë transportuar me mjetin me targë AA XXTB dhe vetëm në një furnizim për muajin nëntor është kryer me makinën e deklaruar nga OE me targë TR XT. (Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi).
6. Mungon Certifikata Shëndetësore Veterinare, lëshuar nga institucionet përkatëse ose Raport analizat e kryera nga AKU, të cilat duhet të jenë bashkëlidhur faturave tatimore sikurse është përcaktuar në DST duke cenuar sigurinë ushqimore, si dhe mallrat ushqimorë të ardhur janë transportuar nga persona fizik të paidentifikuar në proces verbalë, fakt që lë hapësira dyshimi për të vërtetuar nëse këta individë janë të deklaruar në listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, kontratat e punës, mungon fatura e blerjes së mallrave ushqimore nga OE për të verifikuar nëse transaksioni është kryer me subjektet me të cilët janë lidhur kontratat e qerasë nga kontraktori) **(Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi), veprime në kundërshtim me** Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pika 35 dhe 36, me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik òi ndryshuar, neni 59, 60 (Kreu VI, Zbatimi i kontratës), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 77/Mbikëqyrja e Kontratës, pika 2.

3. Auditimi i procedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit “Blerje e artikujve ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë” realizuar janar të vitit 2021.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë për Shtëpinë e fëmijëve Shkollorë Tiranë” realizuar në vitin 2021		
1. Urdhër Prokurimi nr.1 prot 282 datë 11.01.2021, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DST, me përbërje: 1. E.K 2. E.D 3. K.L	3.Urdhër nr.282/2 prot.282/2 datë 11.01.2021 òPër ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerësimit të kontratës për kryerjen e procedurës së prokurimitò 1. A.H Kryetar 2. S.H 3. F.A Fondi limit të përfshijë periudhën nga 11.01.2021 deri në datën 31.12.2021.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur në bazë të urdhër nr.282/1, prot, datë 11.01.2021, me përbërje: 1. A.H-Kryetar 2. A. Zh -anëtar 3. M.I-anëtar.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òMe negociim pa shpallje paraprake të njoftimitò		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 1,640,000 (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,625,087 (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 14,913 (katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë pse sa 99% e fondit limit.
8. Data e hapjes së tenderit Data 12.01.2021, ora 11:30	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1. òE.Cò Shpk me NIPT LXXR me vlerë oferte prej 1,625,087 lekë pa TVSH. 2. òEòshpk me NIPT LXXI, nuk ka paraqitur ofertë. 3.M.C.Shpk me NIPT KXXJ nuk ka paraqitur ofertë.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ònuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ònuk ka
b. Zbatimi i Kontratës së Prokurimit		
14. Lidhja e kontratës Kontratë nr. 281/3 prot datë 18.01.2021, fillon efektet në momentin e lidhjes së saj me afat 3 muaj, me të drejtë ndërprerje në momentin e lidhjes së një kontrate të re përfutur nga procedurat normale të prokurimit nga ABP.	15.Komisioni i marrjes në dorëzim: Në bazë të kontratës nr.281/3 prot datë .18.01.2021, është përcaktuar, të nënshkruar ndërmjet përfaqësuesi të AK znj. S.L dhe përfaqësuesit të OE, fitues, si dhe në bazë të nenit 5, 6 të kontratës të kryhet furnizimi olëvrimi i mallit., sipas komisionit të ngritur sipas Urdhrit nr. 5, datë 05.01.2021, me përbërje: K.L., (ish-mjeko në cilësinë e Kryetarit të grupit), A.Zh , (punonjëse sociale), dhe kuzhinieri i turnit, anëtarë.	

(a) Nga auditimi u konstatua se, përcaktimi i realizimit të procedurës òNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò me objekt òBlerje artikuj ushqimorëò është pasqyruar në Memo përgatitur nga njësia e prokurimit me përbërje (E.K, E.D dhe K.L), drejtuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, znj. S.L, duke u shprehur se:

- òKontrata aktuale është ndërprerë sipas njoftimit të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara nr.2366/1, datë 30.12.2020 me lëndë “Njoftim për zgjidhjen e marrëveshjeve kuadër të lidhura me operatorin ekonomik 4S Shpk.” Gjithashtu Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka njoftuar se aktualisht janë pezulluar dy marrëveshje kuadër përkatësisht Lotin bulmet dhe nënproduktet e tij, lotin e bukës dhe simite. Loti i mishit dhe nënprodukteve të tij si dhe Loti vezë akoma nuk është përfunduar. Sa më sipër kërkohet fillimin e procedurës me negociim të ushqimeve të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për mirërritjen e fëmijëve. Për këtë arsye do hedhim në sistemin e APP procedurën me objekt “Blerje artikuj ushqimor” (vezë, mish dhe nënprodukte të tij, buke dhe simite, bulmet dhe nënproduktet e tij) pasi jemi në kushtet e emergjencës dhe mosrealizimi shkakton problematika në mungesa të artikujve ushqimorë. Theksojmë se kontrata do të ndërpritet në momentin e lidhjes së marrëveshjes kuadër nga ana e ABP, pasi është iniciuar dhe është proceduar me hedhjen në sistem nga ABP por aktualisht rezulton në proces, pra nuk është finalizuar ende me lidhjen e kontratës.ò

-Gjithashtu në shkresën nr.2366/1 të datës 30.12.2020 që ABP i dërgon institucionit Shtëpisë së Fëmijës Shkollorë òZyber Hallulli- Tiranëò shkresën ku midis të tjerave shprehet se ò.Duke qenë se operatori ekonomik “4 S SHPK”, është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik me Vendim nr.77, datë 25.11.2020 të Agjencisë së Prokurimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Publik, për një periudhë 1,5 (një vit e gjysmë) vjet (duke filluar prej datës 25.11.2020-25.05.2022), marrëveshjet kuadër të sipër cituara të lidhura midis Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara në cilësinë e organit qendror blerës dhe operatorit ekonomik “4 S SHPK” konsiderohen të zgjidhura prej datës 25.11.2020, e për rrjedhim autoritetet kontraktore të përfshira në këto marrëveshje kuadër nuk mund të lidhin kontrata publike bazuar në këto marrëveshje kuadër. Në këto kushte, autoritetet tuaja kontraktore duhet të paraqesin sa më parë por jo më vonë se data 08.01.2021, kërkesën e plotë për prokurim nëpërmjet marrëveshjes kuadër me afat 24 muaj, pranë organit qendror blerës ABP, me qëllim publikimin dhe realizimin në kohë të procedurave të prokurimit për plotësimin e nevojave tuaja për artikuj ushqimorë.ö

-Kështu, në mbështetje të bazës ligjore dhe nënligjore, respektivisht, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ðPër prokurimin Publikø i ndryshuar neni 33/2/c dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikø i ndryshuar, neni 3, udhëzimit të APP-së nr.02, datë 08.01.2018, pika 10/c, institucioni ðZyber Hallulliø ka realizuar procedurën e tenderimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, pasi ka detyrimin primar ligjor, furnizimin e pandërprerë për gjatë gjithë vitit me produkte ushqimore për të gjithë fëmijët e grup moshave që janë rezidentë, pranë tij.

(b) Nga Titullari i AK, znj. S.L, në ndryshim nga vitet 2019 & 2020, nuk janë vendosur persona të njëjtë me konkretisht në Njësinë e Prokurimit me Urdhër nr.282 datë 11.01.2021 me përbërje (E.K, E.D dhe K.L) dhe në komisionin e vlerësimit të ofertave (KVO) me Urdhër nr.282/1 datë 11.01.2021 me përbërje (A.H, A. Zh dhe M.I), në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ðPër prokurimin Publikø i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikø i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, neni 58 dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ðPër menaxhimin financiar dhe kontrollinø i ndryshuar.

Me procesverbalin nr.1, protokolluar me nr. 282/0, datë 11.01.2021, Njësia e Prokurimit ka kërkuar t'ia dërgohet ftesa për ofertë 3 shoqërive me eksperiencë në tregun e ushqimeve konkretisht, operatorit ekonomik ðE.Cø shpk, Nipt LXxR, operatorit ekonomik ðM.C.ø shpk, Nipt KXxJ dhe operatorit ekonomik ðE.ø shpk, Nipt LXxI. Njësia e Prokurimit nuk rezulton të ketë justifikuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të cilëve u është dërguar ftesa, në shkelje të përcaktimeve të nenit 35, pika 4 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikø, i ndryshuar ku përcaktohet që:

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

Gjithashtu, referuar përcaktimeve të pikës 6, paragrafi 2, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 -Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeø, parashikohet që:

Argumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.

Referuar dokumenteve standard të tenderit (DST) shtojca 1 ðFormulari i ftesës për pjesëmarrjeø rezulton se në datën 11.01.2021 ora 15.54, u është dërguar ftesë operatorit ekonomik ðE.Cø shpk, Nipt LXxR, operatorit ekonomik ðM.C.ø shpk, Nipt KXxJ dhe operatorit ekonomik ðE.ø shpk, Nipt LXxI, ku janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, specifikimet teknike dhe sasia e artikujve ushqimorë.

Rezultoni se Njësia e Prokurimit nuk e ka justifikuar përzgjedhjen e këtyre operatorëve, në shkelje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikø, i ndryshuar. Po kështu, në DST, nuk rezulton të jetë përcaktuar grafiku i lëvritimit, në shkeljet të përcaktimeve të nenit 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikø, i ndryshuar ku parashikohet që:

Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

-specifikimet teknike;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- grafikun e lëvrimit:

- *Kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*

Po kështu, ftesa për ofertë i është dërguar te njëjtëve operatorë ekonomik, si në procedurën e prokurimit me të njëjtin objekt për vitin 2020, në mospërputhje me përcaktimet e pikës 6, paragrafit të 1 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, ku parashikohet që:

Zgjedhja e operatorëve ekonomik duhet të bëhet në mënyrë jo diskriminuuese. Autoriteti kontraktor duhet ti ndërrojë sa më shpesh të jetë e mundur kandidatët që do të ftojë.

Ftesa për ofertë është dërguar operatorëve ekonomik, në datën 11.01.2021 ora 15.54, dhe referuar përcaktimeve të DST, Seksioni 4, pika 3 është përcaktuar që afati për dorëzimin e ofertave ka qenë data 12.01.2021, ora 16.00. Referuar pikës 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, parashikohet që:

“Njësia e prokurimit në përcaktimin e afateve kohore për paraqitjen e ofertave duhet të mbajë në konsideratë një afat kohor minimal, i cili duhet të jetë i nevojshëm për ti dhënë mundësinë kandidatëve/ofertuesve të përgatisin ofertën.”

Referuar afatit kohor 1 ditore, të përcaktuar në DST, konsiderohet si afat i shkurtër kohor për përgatitjen e ofertës, dhe mund të jetë i tillë, që dikton operatorët ekonomik në procesin e konkurrimit.

Me shkresën nr. 282/1, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje znj. A.H, znj. A. Zh dhe M.I.

Me shkresën nr. 282/2, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerësimit të kontratës me përbërje znj. A.H, znj. E.L dhe znj. F.A.

Përcaktimi i znj. A.H, si anëtare e Njesisë së Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të nenit 56 të “Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”. Kjo pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST.

Rezulton se ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm operatori ekonomik òE.Cò, në vlerën 1,625,087 (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në kushtet kur ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm operatori ekonomik òE.Cò, është bërë vlerësimi në lidhje me dokumentacionin e paraqitur dhe është identifikuar si ofertë e suksesshme. Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në shkelje të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor .

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që:

òNë përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.

(c) Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, nga AK Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷ Zyber Hallullio u konstatua se:

(i) grupi për hartimin e fondit limit ngritur me Urdhër nr.282/2 datë 11.01.2021 ÷ Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt ÷ Blerje ushqimeshë me përbërje (E.K, E.D dhe K.L), në proces verbalin e datës 11.01.2021 kanë paraqitur listën e produkteve ushqimorë për 4 muaj, sasitë për secilin produkt ushqimor, si dhe listën e çmimeve të INSTAT për muajin nëntor 2020. Nga auditimi u konstatua se Njësia e prokurimit nuk ka paraqitur procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit në vlerën prej 1,640,000 (një milion e gjashtëqindëzjet mijë) lekë pa TVSH, vlerë e cila nuk është e kostuar duke e ndarë specifikisht në këto elementë (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasitë e kalorive ditore që i duhet çdo fëmijë sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ÷ Për prokurimin Publiko i ndryshuar neni 59, VKM nr.914 datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar neni 59, VKM nr.518 datë 04.09.2018 ÷ Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuaro Kreu V si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ÷ Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqëror.ö

(ii) Nga auditimi u konstatua se, sipas VKM nr.518 datë 04.09.2018 ÷ Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuaro Kreu V si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ÷ Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqëroro, kanë përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të për kujdesit shoqëror sipas grup moshës, por nuk ka përcaktuar sasitë e kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës, fakt që e rrit riskun mbi mënyrën e përcaktimit të vlerës ditore të shpenzimeve për secilin fëmijë.

(iii) Në bazë të VKM nr.518 datë 04.09.2018 ÷ Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuaro Kreu V, pika 71 shprehet se ÷ *Nivelet e kuotave të shpenzimeve të për kujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolikeö, nga auditimi u konstatua se në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ÷ Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqëroro niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar, duke qëndruar në të njëjtat vlera me nivelin e kuotave të vitit 2018.*

(iv) Nga auditimi u konstatua se, duke u bazuar në të dhënat e institucionit *Shtëpia e Fëmijëve Tiranë*, mbi numrin e fëmijëve për vitin 2021/muaji janar, rezultoi e llogaritur me metodën e ponderimit (mesataren për 31 ditë) **39 fëmijë** në total.

Në mbështetje të vlerës së fondit limit prej 1,640,005.27 (një milion e gjashtëqind e dyzetmijë e pesë. njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, shpenzimi mujor për 39 fëmijë (1,640,005.27 /6 muaj = 273,334 lekë/ në muaj)

Shpenzimi ditor për fëmijët (273,334 lekë/muaj/30 ditë= 9111 lekë/ditë për 39 fëmijë)

Në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ÷ Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqëroro, duke u nisur nga grup moshat 6-15 vjeç,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shpenzimet ditore janë në vlerën prej 460 lekë/ditë x 39 fëmijë = 17,940 lekë/në ditë.

Sa më sipër, në mbështetje të fondit limit kosto ditore për 39 fëmijë është 9,111 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 17,940 lekë/në ditë, pra me një diferencë prej 8,829 lekë/ditë për 39 fëmijë, ose e thënë ndryshe **226 lekë më pak për secilin fëmijë**, e përlllogaritur nga AK, në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqëror.ò Ri theksojmë që koha e përlllogaritjes në muaj është jo e njëjtë, nga AK, por grupi i auditimit është bazuar në numrin e urdhër shpenzimeve dhe faturave të deklaruara dhe likuiduara brenda gjashtëmujorit të parë të 2021, deri në lidhjen e kontratës së re nga ABP për òBlerje Ushqimeshò, me nr. 113, datë 21.06.2021.

(d)Nga auditimi u konstatua se, në bazë të proces-verbalit me shkresë nr.282 prot të datës 11.01.2021 nga anëtarët e njësisë së prokurimit me **Urdhër nr.282 datë 11.01.2021** me përbërje (E.K, E.D dhe K.L), shprehen se òObjekti i prokurimit elektronik është òBlerje artikuj Ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë, Tiranëò me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me fonde prej 1,640,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 3 (tre) muajnga data e nënshkrimit të kontratës me të drejtë ndërprerje në momentin e lidhjes së një kontrate të re të përfutur nga procedurat normale të prokurimit, ndërsasipas Urdhrit nr. prot.282/2 datë 11.01.2021 òPër ngritjen e komisionit për llogaritjen e vlerësimit të kontratës për kryerjen e procedurës së prokurimitò, shprehen se fondi limit të përfshijë periudhën nga 11.01.2021 deri në datën 31.12.2021. Po ashtu edhe në proces verbalin mbi përlllogaritjen e fondit limit përcaktohet një kohë prej 4 muaj. Pra njësia e prokurimit nuk është transparente në llogaritjen kohore të saktë, duke mos qenë e njëjtë në çdo dokument, pjesë përbërëse të dosjes.

Gjithashtu në bazë të kontratës nr.282/3 prot datë 18.01.2021 lidhur midis AK dhe OE fitues òE.Cò Shpk, në nenin 3 (Kohëzgjatja e kontratës) citohet se *òfillon efektet në momentin e lidhjes së saj me afat 3 muaj, me të drejtë ndërprerje në momentin e lidhjes së një kontrate të re përfutur nga procedurat normale të prokurimit nga ABP.ò*

Pra, kemi mos përputhshmëri për periudhën që do të përfshijë kontrata dhe për rrjedhojë nuk del e qartë se vlera limit prej 1,640,000 lekë pa TVSH do ti përkasë periudhës për 3 muaj apo periudhës nga 11.01.2021 deri 31.12.2021.

(e)Sipas DST në rubrikën 1.3 Kriteret për kapacitetin teknik, është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, të plotësojë:

1.3.2 Operatorët ekonomike duhet të këtë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë, kontratave të qirave ose nëpërmjet kontratave të furnizimit, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës Thertore / Njësi tregtimi të mishit / ambiente për magazinimin, shoqëruar me Leje Higjiene-Sanitare si dhe Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për artikullin e mishit.

1.3.3 Operatorët ekonomike duhet të këtë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratave të qirave, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës 1 (një) Mjet transporti, të shoqëruar me leje qarkullimi, taksa vjetore e mjetit të vlefshme, policë e sigurimit, certifikatë e kontrollit teknik si dhe leja higjiene sanitare, për automjetin.

-Nga auditimi në faqen zyrtare të app.gov.al me REF-83803-01-11-2021 dhe në dosjen fizike, u konstatua se, nga operatori ekonomik fitues òE.Aò Shpk me NIPT LXxR, në lidhje me kërkesat e sipër cituara ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- Kontratë Furnizimi nr.324 Rep, nr.127 Kol midis shoqërisë òF.ò Shpk dhe shoqërisë òE.ò Shpk me NIPT LXxR (në bazë të Ekstraktit Historik i regjistrimit, me numër çështje CN-XX-01-20 datë 20.01.2020 është ndryshuar emri tregtar në òE.Cò shpk), me objekt kontrate furnizimi me viça, gjedhë etj.. nga òF.ò, afati i furnizimit fillon nga viti 2018 e në vazhdim.

Në nenin 2 shprehet se ò...Detyrimet e “E” shpk, merr përsipër ti paraqesë shoqërisë “F” shpk një javë përpara kërkesës për furnizim në gjedhë, me qëllim që të bëhet planëzimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

furnizimit përkatës. Të bëjë likuidimin e faturave të furnizimit nëpërmjet bankës një herë në muaj nga data 1 deri në datë 5 të muajit pasardhës duke prerë faturën përkatëse në përputhje me legjislacionin fiskal tatimor ”

-Kontratë bashkëpunimi nr.258 Rep, Nr133Kol, datë 19.01.2018 midis OE òE.ò shpk dhe shoqërisë òK.ò Shpk, me objekt “personi i tatueshëm shoqëria “E.” shpk është pjesëmarrës në këtë bashkëpunim duke servitur bagëti të gjalla (kryesisht gjedhë) të ofruara prej tij, për ti therur në ambientet e punës të shoqërisë “K. 2013”, e cila do të angazhojë stafin dhe gjithë kapacitetin teknik të saj për të garantuar volumin e punës dhe cilësinë e nevojshme të shërbimit, me seriozitet, disiplinë, shpejtësi. Dhe kundrejt çmimeve të vetë të vendosur qartë dhe të deklaruara më parë prej tyre bazuar edhe në kriteret e vendosura nga MBZHR” dhe tregu aktual.

Shoqëria “K.” do të garantojë dhe aplikojë gjithashtu, pajisjet dhe teknologjinë bashkëkohore, komfort edhe kërkesave të Inspektoratit të Higjienës dhe Shëndetit, si edhe eksigjenzave të tregut sot si edhe cilësinë brenda standardevë për shërbimin që ofron.” Kontrata është pa afatë.

-Për kontratën nr.258 Rep, Nr133Kol, datë 19.01.2018, është paraqitur Akt-Miratimi-Higjiene-Sanitar nr.138 datë 15.03.2018, i lëshuar në vitin 2015 nga Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës, sipas ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò i ndryshuar, neni 12.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, Ligji i mësipërm ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, konkretisht, ndryshimi i fundit ligji nr.54/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò, ka shfuqizuar pikërisht neni 12, më datë 30.04.2020, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletore Zyrtare, d.m.th. mbas datës 15.05.2020, për rrjedhojë, në këtë rast Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i ngritur në bazë të Urdhrit 282/1 datë 11.01.2021 me përbërje (A.H, A.Zh dhe M.I) ka pranuar një Akt-miratimi administrativ të panevojshëm dhe të kundërligjshëm si dhe ky akt është lëshuar 3 vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës.

-Kontratë ó Qiraje me nr.17.07 Rep Nr.491 Kol datë 04.10.2019, midis shoqërisë òE.ò Shpk dhe shtetasit I. D, me objekt dhënien me qira të mjetit me targa AAX, lloji ATV.

Për kontratën nr.17.07 Rep Nr.491 Kol datë 04.10.2019, është paraqitur Akt-Miratimi-Higjiene-Sanitar nr.262 datë 11.03.2013, është lëshuar në vitin 2013 nga Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë, sipas ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò i ndryshuar, neni 12.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, Ligji i mësipërm ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, konkretisht, ndryshimi i fundit ligji nr.54/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò, ka shfuqizuar pikërisht nenin 12, më datë 30.04.2020, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletore Zyrtare, d.m.th. mbas datës 15.05.2020, për rrjedhojë, në këtë rast Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i ngritur në bazë të Urdhrit 282/1 datë 11.01.2021 me përbërje (A.H, A.Zh dhe M.I) ka pranuar një Akt-miratimi administrativ të panevojshëm dhe të kundërligjshëm si dhe ky akt është lëshuar 8 vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës.

-Akt Miratimi Higjiene Sanitar (AMHS) nr.542 datë 06.06.2007, për vënien në shfrytëzim të objektit: Kompleks prodhim vezë e rritje zogj, marrë nga Kompania òA.ò Shpk me afat vlefshmërie 1 vit nga data e dhënies së saj, të nxjerrë në vitin 2007 nga ish-Inspektorati Sanitar Shtetëror Durrës, pra rreth 14 vjet përpara, duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës.

OE fitues ka lidhur Kontratë Furnizimi nr.2600 Rep.Nr.792 Kol datë 12.11.2018, për furnizim me artikullin vezë me shoqërinë òA.ò Shpk.

Pra, në lidhje me vendosjen e këtij kriteri, nga njësia e prokurimit, duhej të përcaktohej qartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

se, marrja e akti higjienë sanitare si për ambientin ku zhvillohet aktiviteti ashtu edhe për mjetet e transportit (ATP ose ATV), duhet të kërkohej nga Njësia e prokurimit, të merrej dhe të paraqitej dokumentacioni përkatës nga AKU, në zbatim të ligjit nr. 9868, datë 28.01.2008, òPër Ushqiminò i ndryshuar, në VKM nr.1081, datë 21.10.2009 òPër organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar i Ushqimitò.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), është institucioni që kryen kontrole paraprake dhe inspektime të planifikuara/me ose pa kërkesë nga operatorët ekonomikë që kanë objekt të aktivitetit (prodhimin, magazinimin, tregtimin të artikujve ushqimorë me origjinë shtazore, bimore, industriale, fruta- perime e më gjerë, për njerëzit) për përmbushjen e kërkesave tekniko-teknologjike, higjienë sanitare, fito sanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit të ushqimit.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i ngritur në bazë të Urdhrit 282/1 datë 11.01.2021 me përbërje (A.H, A.Zh dhe M.I) duhej të konsideronte një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet standarde tenderit në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Në këto rast OE fitues nuk i kanë plotësuar kriteret e mësipërme dhe shpallja fitues, është bërë në mënyrë të padrejtë në mospërputhshmëri me DST, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet buxhetore si dhe marrjen e produktit ushqimor (mish me nënproduktet e tij dhe vezë) për fëmijët e Shtëpisë së fëmijëve òZyber Hallulliò, për rrjedhojë vlera prej 1,625,087 lekë pa TVSH, të financuara nga Buxheti i Shtetit, janë shpenzuar, pa ekonomikitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet.

Monitorimi.

Midis Autoritetit Kontraktor òShtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë dhe OE òE.Cò Shpk me NIPT LXXR, në bazë të procedurave të prokurimit, është lidhur Kontrata e Furnizimit òBlerje Ushqimeshò me nr.281/3 prot, datë 18.01.2021, si dhe në bazë të nenit 5, 6, të saj do të kryhet furnizimi òlëvrimi i mallit nga komisioni i ngritur nga përfaqësuesi i AK, znj. S.L sipas urdhrit nr. 5, datë 05.01.2021, me përbërje:

K.L, (ish-mjeke në cilësinë e Kryetarit të grupit), A.Zh, (punonjëse sociale), dhe kuzhinieri i turnit, anëtarë. Hartimi i kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.1.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, si dhe në procedurën e negocimit pa shpallje të njoftimit të kontratës meREF-83803-01-11-2021.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 12.01.2021 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate është **1,625,087 lekë (pa tvsh) ose 1,950,104 lekë (me tvsh)**. Sigurimi i kontratës është kryer në vlerën 195,011 leke ose 10% të çmimit të kontratës nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve òA.ò sha me Formularin e sigurimit nr. Serie 060822, datë 18.01.2021, me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës.

Cilësia e mallit do të jetë sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Urdhër shpenzim	fatura total artikuj	Totali i faturës (me tvsh)	f-hyrje	Targa e mjetit pasqyruar në faturën tatimore
nr.24, datë 17.02.2021	nr.1/2021, dt.. 29.01.2021	130,476	nr.3, dt.. 29.01.2021	
nr.39, datë 04.03.2021	nr.14/2021, dt.. 26.02.2021	291,792	nr.7, dt.. 26.02.2021	
nr. 62, dt.. 20.04.2021	nr. 27/2021, dt.. 31.03.2021	397,327	nr.10, dt.. 31.03.2021	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

nr.84, dt.. 20.05.2021	nr.39/2021, dt.. 30.04.2021	375,431	nr. 15, dt.. 30.04.2021	
nr.104, dt.. 0.05.2021	nr.45/2021, dt.. 31.05.2021	352,793	nr.19, dt.. 31.05.2021	
nr.126, dt.. 27.07.2021	nr.52/2021, dt.. 30.06.2021	292,866	nr.24, dt.. 30.06.2021	
Paguar (94 %)		1,840,685		

-Mangësitë e konstatuara në zbatimin e kontratës janë të njëjta me procedurat e sipër cituara, si më poshtë:

a) Në faturat e shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues për çdo furnizim në rastin e kontratës së sipërcituar nuk rezultojnë të jetë pasqyruar mjeti me të cilin është kryer transporti duke lënë shkas për dyshime në sigurinë dhe cilësinë e transportimit. (Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi).

b) Certifikatë Shëndetësore Veterinare, lëshuar nga institucionet përkatëse ose Raport analizat e kryera nga AKU, nuk figurojnë të jenë bashkëlidhur faturave tatimore sikurse është përcaktuar në DST duke cenuar sigurinë ushqimore, si dhe mallrat ushqimorë të ardhur janë transportuar nga persona fizik të pidentifikuar në proces verbalë, fakt që lë hapësira dyshimi për të vërtetuar nëse këta individë janë të deklaruar në listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, kontratat e punës, mungon fatura e blerjes së mallrave ushqimore nga OE për të verifikuar nëse transaksioni është kryer me subjektet me të cilët janë lidhur kontratat e qerasë nga kontraktori (**Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi**).

c) Në fillim të vitit buxhetor 2021, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të produkteve ushqimorë, (i njëjtë për çdo kontratë furnizimi) ndonëse kemi më shumë se një kontratë për Blerje Ushqimesh , të nënshkruar brenda një viti. Ky fakt ka bërë të mundur që komisioni i ngritur për të gjithë vitin nuk kanë njohuri mbi OE fitues, nuk kanë informacion mbi specifikimet teknike (nuk u konstatua në asnjë proces verbal, p.sh. temp e mishit në momentin e hyrjes në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës,).

d) Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas.

e) Në strukturën e Shtëpisë së Fëmijës, nuk është planifikuar apo aplikuar ekzistenca e strukturave monitoruese për kontratat, por është mjaftuar vetëm me vendosjen e emrit të specialistit që do të ndjekë ecurinë e kontratës, që në rastin konkret është znj. A.H. Gjatë auditimit nuk u konstatua hartimi i raportit në përfundim të kontratës, ku sipas VKM nr. 914/2014, është parashikuar që personi përgjegjës për prokurimin pranë autoritetit Kontraktor merr informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton APP-së ose në rastin tonë Shërbimit Social Shtetëror, veprime në kundërshtim me nenin 77, pika 4 të VKM nr. 914/2014, ku citohet se:

Në përfundim të kontratës, autoriteti Kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

f) Nga auditimi, u konstatua se si pasojë e mos realizimit në kohë të këtyre procedurave nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), pranë Ministrisë së Brendshme, procedurat e realizuara (për periudhën 2019-2020-2021) dhe jo të monitoruara nga Shërbimi Social Shtetëror, evidentuan se Shtëpia e Fëmijës ka mungesa të theksuara të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit dhe monitorimit, duke paraqitur konfuzitet mbi segmentet e caktuara të procesit të prokurimit, si rezultat i mos organizimit të trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.

Të gjitha elementët e sipër përmendur, kanë bërë që, ekzekutimi dhe monitorimi, paraqitet me tregues në shkelje të procedurave ligjore në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, të



cilat përbëjnë mundësi për shkelje dhe abuzime me fondet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Arrijmë në përfundimin që fondi prej 1,840,685 lekë është përdorur pa ekonomicitet, eficientë dhe ekonomicitet nga Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë.

Trajtimi i observacionit ardhur nga SHFSH mbi Akt Konstatimin nr.2, datë Nr. 196/1 Prot., datë 12/07/2022 si dhe shkresa me nr381/5, mbi PRA.

1-Në observacionin e znj. A.H në pozicionin e përgjegjëses së sektorit të administratës dhe nëpunësit zbatues ndër të tjera shprehet: *ShFSh “Zyber Hallulli” ka si mision të vetin mirërritjen, mirëqenien dhe sigurinë e fëmijëve rezident. I ndodhur në kushtet e emergjencës për sigurimin e ushqimeve ka zhvilluar procedurën “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” “Blerje artikuj ushqimor”. Në lidhje me konstatimin sqarojmë se bazuar në strukturën e institucionit, ndodhur në kushtet e emergjencës, bazuar në mungesën e fondeve për të marrë ekspertë të jashtëm si dhe ndjekur nga praktika e viteve të mëparshëm janë vendosur anëtarë të komisioneve persona që punojnë në ShFSh me arsim të lartë. Vendosja e të njëjtëve persona vjen si pasojë e mungesës së stafit si dhe përmëshjes së detyrimit të institucionit për sigurimin ushqimit të fëmijëve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Observacioni juaj nuk pranohet pasi nuk bazohet në argumente ligjorë të shpjeguar në material nga grupi i auditimit.

2- *Mbi këtë konstatim sqarojmë së grupi i punës në përlllogaritjen e tij ka paraqitur kërkesën e sasive orientuese për artikujt ushqimore të nevojshëm për këtë periudhë kohore. Sasitë janë orientuese e të bazuara në kërkesën e magazinës dhe kuzhinës në menutë javore, kërkesat e fëmijëve, gjendjes shëndetësore të tyre si dhe numrit rezidentë të fëmijëve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Observacioni juaj nuk pranohet pasi nuk bazohet në argumente ligjorë si dhe është kryer në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë Kreu V si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ö

3- *Mbi këtë akt-konstatim sqarojmë se përzgjedhja e OE është kryer gjendur në kushtet e emergjencës dhe bazuar në historikun e institucionit në lidhje me këtë operator i cili në momentin e fillimit të procedurës me institucionin tonë figuronte i regjistruar dhe me dokumentacionin e nevojshëm. Në lidhje me Akt Miratimin Higjieno Sanitar të paraqitur nga OE është i njëjtë pasi nuk ka ndryshuar objekti i ushtrimit të veprimtarisë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Observacioni juaj nuk pranohet pasi nuk bazohet në argumente ligjorë të shpjeguar në material nga grupi i auditimit.

Në lidhje me sa më sipër, SHFSH nuk ka sjellë observacion në lidhje me Projekt raportin. Për rrjedhim qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së, mbetet i pandryshueshëm.

4- *Në lidhje me këtë procedurë theksojmë se është kryer në situatë pandemie. Aktiviteti i institucioneve ishte i paralizuar. Është shpallur gjendja e jashtëzakonshme. Të gjithë janë të stresuar dhe në ankth për covid-19. Procedura është zhvilluar në kushte teknike të këqija, në shtëpi. Mungesa e komunikimit dhe punës në grupe në të njëjtin ambient ka qenë shumë e vështirë. Shmangia e gabimeve aritmetike të krijuara ka qenë e pamundur për shkak të situatës së ndodhur. Gjithsesi oferta e pranuar ka qenë brenda fondit limit, dhe shërbimi i sigurisë ka qenë shumë i nevojshëm për tu ofruar nisur nga rëndësia e veçantë që ka institucioni ynë.*

Sqarojmë se institucioni ynë për një periudhë të gjatë kohore ka qenë i mbyllur në karantinë dhe ndonëse në Institucionet e tjera puna vijoi normalisht ne, në varësi të dinamikës së institucionit e vijonim punën disi të paralizuar pasi herë pas here duhet të mbylleshim në karantinë nga rastet e paraqitura me covid herë pas here.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Observacioni juaj nuk pranohet pasi nuk bazohet në argumente ligjorë të shpjeguar në material nga grupi i auditimit. Në lidhje me sa më sipër, SHFSH nuk ka sjellë observacion në lidhje me Projekt raportin. Për rrjedhim qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së, mbetet i pandryshueshëm.

Trajtimi i observacionit ardhur nga SHFSH mbi Akt Konstatimin nr.2, datë Nr. 196/1 Prot., datë 12/07/2022, nga Znj. S.L, Drejtuese e SHFSH, Tiranë shprehet se:

Referuar òAkt-Konstatimitò Nr.2 (Dokumenti Nr.8), Nr.196/1Prot., datë 12.07.2022, informojmë dhe japim shpjegimet si më poshtë:

Lidhur me konstatimet e bëra në fq. nr. 7 të këtij òakt-konstatimiò mbi përlllogaritjen e vlerës dhe shpalljen e ofertës fituese gjatë një procedure prokurimi (shërbim roje civile), referuar përcaktimeve të bëra në rregullat e prokurimit publik, te drejtat e rezervuara dhe kompetencat për këtë rast janë nën tagrin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Lidhur me përbërjen e KVO, siç e sqaruam edhe më sipër *struktura e institucionit dhe tipologjia e saj është orientuar drejt emërtesave “edukator, kujdestar, punonjës social, psikolog, mjek....” e në mungesë të:*

specialistëve të fushës;

strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura;

fondeve financiare për te punësuar me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave;

me qëllimin kryesor për të përmbushur detyrimet për një ofrim shërbimi sa më cilësor gjithmonë në interesin më të lartë të fëmijëve në këto procedura prokurimi janë angazhuar persona pjesë e stafit të ShFSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Observacioni juaj nuk pranohet pasi nuk bazohet në argumente ligjorë të shpjeguar në material nga grupi i auditimit.

Në lidhje me sa më sipër, SHFSH nuk ka sjellë observacion në lidhje me Projekt raportin. Për rrjedhim qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së, mbetet i pandryshueshëm.

Titulli i gjetjes:	Hartimi i DST për 3 procedura prokurimi “Blerje ushqimesh për fëmijët në SHFSH”, për periudhën 2019-2020-2021.
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none">-Në 3 rastet e procedurave òBlerje Ushqime ò, të llojit òNegocim pa shpallje paraprake të njoftimitò, të kryera nga SHFSH përkatësisht për vitet 2019, 2020, 2021, nga Njësia e Prokurimit, rezulton se nuk është justifikuar përzgjedhja e të njëjtëve operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në shkelje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. Po kështu, në DST, nuk rezulton të jetë përcaktuar grafiku i lëvrimit, në kundërshtim me nenin 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.2- Në të 3 procedurat e prokurimit, nga NJP është lënë një afat shumë i shkurtër në sjelljen e ofertave nga OE të ftuar për pjesëmarrje në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ËMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò duke krijuar hapësira dhe dyshime për paracaktim të OE fitues dhe një proces konkurrimi jo transparent.3- Sipas DST në rubrikën 1.3 Kriteret për kapacitetin teknik, është



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHETËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, të plotësojë:</p> <p>1.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë, kontratave të qirave ose nëpërmjet kontratave të furnizimit, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës Thertore / Njësi tregtimi të mishit / ambiente për magazinimin, shoqëruar me Leje Higjeno-Sanitare si dhe Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për artikullin e mishit.</p> <p>1.3.2 Operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi ose në përdorim, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratave të qirave, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës 1 (një) Mjet transporti, të shoqëruar me leje qarkullimi, taksa vjetore e mjetit të vlefshme, policë të sigurimit, certifikatë e kontrollit tekniks dhe leja higjienë sanitare, për automjetin.</p> <p>Nga auditimi, pranë faqes zyrtare të app.gov.al me REF-69160-08-19-2020, u konstatua se, nga operatori i vetëm ekonomik pjesëmarrës dhe fitues òE.Aò Shpk me NIPT LXXR, është paraqitur Akt Miratimi Higjienë Sanitar (AMHS) nr.119 datë 27.01.2014, në lidhje mbi lejen higjienë-sanitare për mjetin e transportit me targë TRXT, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) Dega Rajonale Qarku Tiranë, në bazë të ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò i ndryshuar, neni 12.</p> <p>- Ligji i mësipërm ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, konkretisht, ndryshimi i fundit i ligjit nr.54/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 òPër inspektim sanitarò, <u>ka shfuqizuar pikërisht nenin 12, më datë 30.04.2020</u>, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletore Zyrtare, d.m.th. mbas datës 15.05.2020, e për rrjedhojë mbi vendosjen e këtij kriteri, nga njësia e prokurimit, duhej të përcaktohej qartë se, marrja e akti higjienë sanitar si për ambientin ku zhvillohet aktiviteti ashtu edhe për mjetet e transportit (ATP), <u>duhet të paraqitej me dokumentacionin përkatës nga AKU</u>, autoritet shtetëror që kryen kontrollet paraprake për përmbushjen e kërkesave tekniko-teknologjike, higjienë sanitare, fito sanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit të ushqimit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. neni 36, pika 4 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 òMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò.
Ndikimi/Efekt:	Kërkesa për kualifikim jo në përputhje me LPP
Shkaku:	Mos argumentimi i duhur nga strukturat përgjegjëse
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit në SHFSH në bashkëpunim me SHSSH të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim argumentimin e nevojave për prokurim në përputhje me kërkesat e bazës ligjore në fuqi.
Titulli i gjetjes:	Mungesa e Raportit Përmbledhës në 3 procedura prokurimi “Blerje ushqimesh për fëmijët në SHFSH”, për periudhën 2019-2020-2021.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHFESHË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Situata:	<p>Në 3 raste, Titullari i AK ka miratuar procedurat e prokurimit të Blere ushqimesh për fëmijët në SHFSHë pa pasur një raport përmbledhës të paraqitur dhe përpiluar nga anëtarët e KVO-së përkatëse, në shkelje të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që:</p> <p><i>“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor .</i></p> <p><i>Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.</i></p>
Kriteri:	neni 68 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim korrekt i kontratave, me rrjedhim përdorim pa efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mos respektim i Ligjit
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Titullari i AK të marrë masa që në të ardhmen që të mos miratojë procedura prokurimi pa praninë e Raportit Përmbledhës nga anëtarët e KVO, si dhe në çdo rast të sigurohet që ky dokument të përmbajë të gjithë elementët e duhur ligjorë.

Titulli i gjetjes:	Vendosje e personave të njëjtë si për NJP ashtu edhe në KVO, për 3 procedura prokurimi për blerje ushqimesh për fëmijët në SHFSHë, për periudhën 2019-2020-2021
Situata:	<p>1- Nga Titullari i AK, Drejtori i komanduar zj. L.Ç., janë vendosur persona të njëjtë me konkretisht në komisionin me Urdhër nr. 2 prot.119 datë 11.04.2019 për hartimin e fondit limit të me përbërje (zj. A.H, Xh.F), në Njësinë e Prokurimit me Urdhër nr.3 datë 11.04.2019 me përbërje (E.K, A.H, Xh.F) dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO) me Urdhër nr.4 datë 11.04.2019 me përbërje (E.K, A.H, Xh.F), veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 për prokurimin Publik i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, neni 58 dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar,</p> <p>2-Nga Titullari i AK, janë vendosur persona të njëjtë në komision, me konkretisht zj.A.H, në komisionin e ngritur sipas Urdhrit të brendshëm nr.153 prot datë 19.08.2020 për hartimin e kërkesave, për subjektet që do të kryejnë lëvrimin e këtyre produkteve ushqimore, specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin fondin limit dhe në komisionin e vlerësimit të ofertave (KVO) me Urdhër nr.153/1 datë 19.08.2020, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 për prokurimin Publik i ndryshuar</p> <p>3- Me shkresën nr. 282/1, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje znj. A.H, znj. A. Zhdhe M.I.</p> <p>Me shkresën nr. 282/2, datë 11.01.2021 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerësimit të kontratës me përbërje znj. A.H, znj. E.L dhe znj. F.A.</p> <p>Në 3 raste, Titullari i AK ka emëruar persona të njëjtë në NJP, dhe KVO në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin Publiko i ndryshuar dhe konkretisht përcaktimi i znj. A.H, si anëtare e Njesisë së Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të nenit 56 pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST.</p>
Kriteri:	ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin Publiko i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 56, neni 57, neni 58 dhe me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar,
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim korrekt i kontratave, me rrjedhim përdorim pa efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mos respektim i Ligjit
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Titullari i AK të marrë masa që në të ardhmen të mos vendosë persona të njëjtë në përbërje të Njesisë së prokurimit me atë të KVO dhe grupit për përllogaritjen e fondit limit, për kryerjen sa më korrekt të procedurave të prokurimit.

Titulli i gjetjes:	Përllogaritje e fondit limit në mospërputhshmëri me VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” për 3 procedura prokurimi “Blerje ushqimesh për fëmijët në SHFSH”, për periudhën 2019-2020-2021
Situata:	<p>Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, në të tre procedurat e prokurimit ÷Blerje Ushqimesh nga AK Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallullio u konstatua se: grupi për hartimin e fondit limit nuk ka paraqitur procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit ku të argumentojë vlerat përkatëse si dhe të pa detajuar duke e ndarë specifikisht në elementë si (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasi të kalorive ditore që i duhet çdo fëmijë sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin Publiko i ndryshuar, neni 59 ku</p> <p><i>Në përllogaritjen e vlerësimit të kontratës, autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerësimit të kontratës.</i></p> <p>si dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar neni 59, VKM nr.518 datë 04.09.2018 ÷Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar Kreu V si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 ÷Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime,</p>



në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ö

2- Gjithashtu u konstatua se sipas Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò **niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar**, duke qëndruar të njëjtat kosto ditore sipas grup moshave të fëmijëve, prej vitit 2018 e në vazhdim, pra për një periudhë 3-vjeçare ku nisur dhe nga situata të jashtëzakonshme sikurse ishte pandemia COVID e ndodhur në vitin 2020, solli një inflacion të madh dhe një rritje çmimesh në produktet ushqimore bazë. Nisur nga të dhënat e INSTAT, në lidhje me tabelën e paraqitur në faqen zyrtare òNdryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, grupi òUshqime dhe pije alkoolikeö, nga grupi i auditimit u përlllogaritën se si duhet të ishin ndryshuar këto kuota çdo vit, për koston ditore për secilën grup moshë sipas Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò dhe konkretisht kosto ditore për fëmijë duhet të kishte ndryshuar përkatësisht për secilën grup moshë në vijim:

Nga 440 në 487,35 (fund të 2021) pra do të ishte rritur me 47 lekë në ditë

Nga 480 në 531,66, pra do të ishte rritur me 52 lekë në ditë

Nga 500 në 553,81, pra do të ishte rritur me 54 lekë në ditë. Nga sa më sipër kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në llogaritjen e fondit limit, sasinë ditore ushqimore të planifikuar për fëmijë dhe si rrjedhim në mosplotësimin e nevojave ushqimore për çdo grup moshë,

1-Nga auditimi i procedurës Blerje Ushqimesh, miratuar sipas **Urdhër Prokurimi** nr.3 prot 119/1 datë 11.04.2019, nga titullari i AK u konstatua se, duke u bazuar në të dhënat e institucionit *Shtëpia e Fëmijëve Tiranë*, mbi numrin e fëmijëve për vitin 2019/muaji prill, e llogaritur me metodën e ponderimit (mesatarizimin për 30 ditë) **41 fëmijë** në total, rezultoi se:

Në mbështetje të vlerës së fondit limit prej 1,070,000 (një milion e shtatëdhjetëmijë) lekë pa TVSH, shpenzimi mujor për 41 fëmijë ($1,070,000/3\text{muaj} = 356,667$ lekë/ në muaj)

Shpenzimi ditor për fëmijët ($356,667$ lekë/muaj/30 ditë= $11,889$ lekë/ditë për 41 fëmijë)

Në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, duke u nisur nga grup moshat 6-18 vjeç, shpenzimet ditore është në vlerën prej 473 lekë/ditë x41 fëmijë = $19,393$ lekë/në ditë.

Sa më sipër, në mbështetje të fondit limit kosto ditore për 41 fëmijë është $11,889$ lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej $19,393$ lekë, pra me një diferencë prej $7,504$ lekë/ditë për 41 fëmijë, ose e thënë ndryshe **183 lekë më pak për secilin fëmijë**, e përlllogaritur nga AK, në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe



Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ò

2- **Nga auditimi i procedurës “Blerje artikuj ushqimorë për Shtëpinë e fëmijëve Shkollorë Tiranë” sipas Urdhër Prokurimi nr.1 prot 282 datë 11.01.2021**, në përlllogaritjen e fondit limit nga grupi i punës me përbërje A.H Kryetar, dhe S.H e F.A anëtarë, në proces verbalin e datës 11.01.2021 kanë paraqitur listën e produkteve ushqimorë për 4 muaj, sasitë për secilin produkt ushqimor, si dhe listën e çmimeve të INSTAT për muajin nëntor 2020, por në proces verbal nuk kanë argumentuar vlerën prej 1,640,000 (një milion e gjashtëqindëzjet mijë) lekë pa TVSH, vlerë e cila nuk është e kostuar duke e ndarë specifikisht në këto elementë (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasitë e kalorive ditore që i duhet çdo fëmije sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar neni 59, VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò Kreu V. Gjithashtu u konstatuan gabime në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit dhe konkretisht duke u bazuar në të dhënat e institucionit *Shtëpia e Fëmijëve Tiranë*, mbi numrin e fëmijëve për vitin 2021/muaji janar, e llogaritur me metodën e ponderimit (mesataren për 31 ditë) **39 fëmijë** në total, rezultoi se:

Në mbështetje të vlerës së fondit limit prej 1,640,005.27 (një milion e gjashtëqind e dyzetmijë e pesë. njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, shpenzimi mujor për 39 fëmijë ($1,640,005.27 / 6 \text{ muaj} = 273,334 \text{ lekë/në muaj}$)

Shpenzimi ditor për fëmijët ($273,334 \text{ lekë/muaj}/30 \text{ ditë} = 9111 \text{ lekë/ditë}$ për 39 fëmijë)

Në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, duke u nisur nga grup moshat 6-15 vjeç, shpenzimet ditore janë në vlerën prej 460 lekë/ditë x 39 fëmijë =17,940 lekë/në ditë.

Sa më sipër, në mbështetje të fondit limit kosto ditore për 39 fëmijë është 9,111 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 17,940 lekë/në ditë, pra me një diferencë prej 8,829 lekë/ditë për 39 fëmijë, ose e thënë ndryshe 226 lekë më pak për secilin fëmijë, e përlllogaritur nga AK, në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror.ò Ritheksojmë që koha e përlllogaritjes në muaj është jo e njëjtë, nga AK, por grupi i auditimit është bazuar në numrin e urdhër shpenzimeve dhe faturave të deklaruar dhe likuiduara brenda gjashtëmujorit të parë të 2021, deri në lidhjen e kontratës së re nga ABP për òBlerje Ushqimeshò, me nr. 113, datë 21.06.2021.

U konstatuan mos përputhshmëri për periudhën që do të përfshijë kontrata dhe për rrjedhojë nuk del e qartë se vlera limit prej 1,640,000

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	lekë pa TVSH do ti përkasë periudhës për 3 muaj apoperiudhës nga 11.01.2021 deri 31.12.2021.
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar neni 59,VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të për kujdesit shoqërorò, VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò Kreu V.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim pa efencë, economicitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën totale për 3 procedura 3,936,834 lekë .
Shkaku:	Përllogaritje gabim të fondit limit në kundërshtim me bazën ligjore nga grupi i punës të SHFSH
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të ngrihet një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësisë, në lidhje me mangësitë e konstatuara në për llogaritjen e fondit limit për produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, economicitet dhe efencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Titulli i gjetjes:	Vlerësimi i ofertave për 3 procedura prokurimi “Blerje ushqimesh për fëmijët në SHFSH”, për periudhën 2019-2020-2021
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës, konstatohet se në procedurat e prokurimit me objekt:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Procedura me objekt òBlerje ushqimesh për institucionin òShtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranëò realizuar në prill të vitit 2019, lidhur Kontrata nr. 119/9, datë 24.04.2019, me fond limit 1,070,000 lekë2. Procedura me objekt òBlerje ushqimor- vezë, mishi dhe nënproduktet e tijò realizuar në gusht të vitit 2020, me fond limit 799,600 lekë3.Procedura me objekt òBlerje e artikujve ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorëò realizuar janar të vitit 2021, fond limit 1,640,000 lekë. <p>U konstatuan se OE fitues kanë paraqitur dokumente të cilat nuk provojnë vërtetësinë për të cilën janë dhënë dhe konkretisht leje higjono sanitare të lëshuara 3-4 vjet përpara duke e humbur koherencën me realizimin e procedurës së prokurimit dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, si dhe në rritjen e riskut për kriterin e higjenes.</p> <p>Gjithashtu në procedurën e prokurimit òBlerje Ushqimeò realizuar sipas Urdhër Prokurimit nr.153/2 prot datë 19.08.2020, nga operatori i vetëm ekonomik pjesëmarrës dhe fitues òE.Aò Shpk me NIPT LXxR, sipas kriterëve të DST janë paraqitur leje higjono sanitare të nënkontraktorëve të tij shumë të hershme të cilat humbin seriozitetin dhe rrisin riskun në kriterin bazë për ushqimin që është Higjena.</p> <p>Kualifikimi i ofertave të OE pjesëmarrës është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	neni 55, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 66, pika 3. Për pasojë, AK duhej të sòkualifikonte ofertat e OE pjesëmarrës, e të vazhdonte me anulimin e procedurave të prokurimit në zbatim të nenit 24, të LPP.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Kualifikim dhe shpallje fituese e OE të papërshtatshëm
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Për rritjen e efijencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Titulli i gjetjes:	i In efijencë në zbatimin e kontratave të lidhura për 3 procedurat e prokurimit për 3 procedura prokurimi òBlerje ushqimesh për fëmijët në SHFSHò, për periudhën 2019-2020-2021.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratave për 3 procedurat e prokurimit òBlerje ushqimesh për fëmijët shkollorë në SHFSH Zyber Hallulli, Tiranë, përkatësisht për vitet 2019-2020-2021, u konstatuan këto mangësi: a) Në faturat e shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues dhe të verifikuara nga grupi i auditimit u konstatua se ato nuk transportoheshin me mjetet tip dhe të deklaruara nga OE fitues duke sjellë risk në sigurinë ushqimore si dhe duke mos respektuar kriteret e përcaktuar në DST dhe në kontratën e nënshkruar. (Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi). b)Mos firmosja nga anëtarët e komisionit në te gjithë proces verbalet e pranimit të mallit në Magazinë. c)Në proces verbalin e marrjes ne dorëzim shpesh herë nuk shënohet data e mbajtjes së tij, orari i furnizimit, verifikimi i cilësisë së mallit të pranuar sipas specifikimeve teknike të kërkuara ne DST (mungese e analizave veterinare për mishin, certifikatat e cilësisë etj.), si dhe në asnjë rast nuk është shënuar targa e mjetit me të cilin është kryer furnizimi nga OE. d)Certifikatë Shëndetësore Veterinare, lëshuar nga institucionet përkatëse ose Raport analizat e kryera nga AKU, nuk figurojnë të jenë bashkëlidhur faturave tatimore sikurse është përcaktuar në DST duke cenuar sigurinë ushqimore, si dhe mallrat ushqimorë të ardhur janë transportuar nga persona fizik të pidentifikuar në proces verbalë, fakt që lë hapësira dyshimi për të vërtetuar nëse këta individë janë të deklaruar në listë pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, kontratat e punës, mungon fatura e blerjes së mallrave ushqimore nga OE për të verifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>nëse transaksioni është kryer me subjektet me të cilët janë lidhur kontratat e qerasë nga kontraktori) (Sipas DT. nuk është i lejuar nën kontraktimi).</p> <p>e) Në fillim të çdo viti buxhetor, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të produkteve ushqimore, (i njëjtë për çdo kontratë furnizimi) ndonëse kemi më shumë se një kontratë për Blerje Ushqimesh, të nënshkruar brenda një viti. Ky fakt ka sjellë që komisioni i ngritur për të gjithë vitin nuk kanë njohuri mbi OE fitues, nuk kanë informacion mbi specifikimet teknike (nuk u konstatua në asnjë proces verbal, p.sh. temp e mishit në momentin e hyrjes në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës).</p> <p>f) Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas.</p> <p>e) Në strukturën e Shtëpisë së Fëmijës, nuk është planifikuar apo aplikuar ekzistenca e strukturave monitoruese për kontratat, por është mjaftuar vetëm me vendosjen e emrit të specialistit që do të ndjekë ecurinë e kontratës, që në rastin konkret është znj.A.H. Gjatë auditimit nuk u konstatua hartimi i raportit në përfundim të kontratës, ku sipas VKM nr. 914/2014, është parashikuar që personi përgjegjës për prokurimin pranë autoritetit Kontraktor merr informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton APP-së ose në rastin tonë Shërbimit Social Shtetëror, veprime në kundërshtim me nenin 77, pika 4 të VKM nr. 914/2014, ku citohet se:</p> <p><i>Në përfundim të kontratës, autoriteti Kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.</i></p> <p>g) Nga auditimi, u konstatua se si pasojë e mos realizimit në kohë të këtyre procedurave nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP), pranë Ministrisë së Brendshme, procedurat e realizuara (për periudhën 2019-2020-2021) dhe jo të monitoruara nga Shërbimi Social Shtetëror, evidentuan se Shtëpia e Fëmijës ka mungesa të theksuara të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit dhe monitorimit, duke paraqitur konfuzitet mbi segmentet e caktuara të procesit të prokurimit, si rezultat i mos organizimit të trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.</p>
Kriteri:	Sa më sipër në kundërshtim me kontratat e furnizimit me nr. 119/9 prot, datë 24.04.2019 midis S. dhe SHFSH, kontrata me nr. 153/5, datë 27.08.2020, të lidhur midis E.Cö Shpk me NIPT LXxR dhe SHFSH si dhe kontrata me nr281/3 prot, datë 18.01.2021 të lidhur midis E.Cö Shpk me NIPT LXxR dhe SHFSH
Ndikimi:	Cenim i sigurisë ushqimore dhe përdorim pa efience, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mos zbatim i bazës ligjore nga strukturat përkatëse
Rëndësia:	<i>E lartë</i>
Rekomandimi	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Nga grupi i auditimit, u audituan tre procedura prokurimi të realizuara në vitin 2020, òShërbim roje civileò. Përpara se të trajtojmë hollësisht këto tre prokurime, japim një historik se si është trajtuar ky lloj shërbimi në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë (SHFSH) Tiranë, pasi për një periudhë kohore ajo nuk e ka pasur këtë shërbim dhe ka kryer vetë-ruajtjen e objektit por edhe të fëmijëve të këtij Institucioni, duke sjellë risk në këtë proces kaq të rëndësishëm.

I)Më datë 17.03.2020, është miratuar Kontrata shtesë nr. 52, me objekt òShërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, për vazhdimin për plotësimin e nevojave me OE N.ö NXx Services, me afat kohor deri më datë 31.03.2020.

II)Detyrimin për realizimin e procedurës për përzgjedhjen e operatorin ekonomik për këtë shërbim, e ka òI.Gò SHA në bazë të VKM Nr. 177, datë 04.04.2019 pika 10òPër krijimin e shoqërisë òI.Gò SHA dhe për përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërieò në të cilin përcaktohet se: *“Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen, me kërkesë, kësaj shoqërie, për të përfutuar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”*, por për shkak të situatës së krijuar nga Covid sipas VKM nr.243 datë 24.03.2020 òPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyroreò më datën **31.03.2020**, AK është njoftuar, nga I.G se për shkak të vështirësive teknike e kanë të pa mundur ofrimin e shërbimit për institucionin.

Si pasojë e kësaj situate, për periudhën në vazhdim nga 01.04.2020 deri 31.12.2020, do të mbetë i pa òmbuluar òshërbimi i ruajtjes duke përbërë një rrezik për ruajtjen e objekteve, pronës dhe sigurisë së personelit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor Tiranë.

Nisur nga rrethanat e krijuara, AK ka propozuar të zhvillojë procedurën òKërkesë për Propozimòme objekt: "Shërbim me Roje Civile" me afat 7 muaj me kusht zgjidhjen e kontratës në momentin e paraqitjes së shoqërisë òI.Gò sha për ofrimin e shërbimit.

III) Më datë 06.04.2020 nga titullari i AK është miratuar urdhri nr. 97 prot, datë 06.04.2020 òPër caktimin e juristit të njësisë së prokurimit për procedurat e prokurimitò si dhe në të njëjtën datë është miratuar njësia e prokurimit me Urdhër nr.54 prot, i përbërë nga (E.K kryetare, A.H dhe E.D anëtare).

Në datë 06.04.2020 u ngrit Urdhri për komisionin e vlerësimit të ofertave me nr.55 prot, i përbërë nga (B.Gj kryetare, K.L dhe XH.F anëtare).

Gjithashtu në datë 06.04.2020 u ngrit komisioni për llogaritjen e vlerësimit të kontratës më Urdhër nr.53 prot, i përbërë nga (A.H, B.B dhe F.A). Në bazë të proces-verbalit të datës 09.04.2020, grupi është shprehur mbi bazën ligjore në të cilin është mbështetur, për llogaritjen e fondit limit në vlerën prej 1,090,437.6 lekë pa TVSH si dhe kushtet dhe dokumentacionet e nevojshme për kryerjen e procedurës së prokurimit òKërkesë për PropozimòMarrëveshje kuadërò me një operator ekonomik, me afat 7 muaj, me kusht zgjidhjen e kontratës në momentin e paraqitjes së shoqërisë òI.Gò sha për ofrimin e shërbimit.

IV) Më datë 04.05.2020, KVO ka hartuar procesverbalin nr. 3 òPër hapjen dhe vlerësimin e ofertaveò, duke rezultuar se, janë sòkualifikuar 17 OE, për shkak të gabimeve në llogaritje të ofertave të tyre ekonomike si dhe OE e skualifikuar nuk kanë marrë parasysh njoftimit e (APP) nr.233 prot datë 14.02.2019, mbi mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ofertës për kontratën e shërbim roje civile, si vijon:

- 1.A. sha pa ofertë ekonomike
- 2.E. pa ofertë ekonomike
- 3.M.1,089,746.21 lekë pa tvsh
- 4.N. 1,077,513.75 lekë pa tvsh
- 5.N.shpk 1,090,437.59 lekë pa tvsh
- 6.S. 1,091,227.69 lekë pa tvsh
- 7.T.pa ofertë ekonomike
- 9.T. 1,088,747.52 lekë pa tvsh



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- 10.A. 1,090,437.6 lekë pa tvsh
- 11.S. 1,091,297.28 lekë pa tvsh
- 12.F.1,086,197.76 lekë pa tvsh
- 13.G. 1,091,130.23 lekë pa tvsh
- 14.R. 1,090,437.6 lekë pa tvsh
- 15.S. 1,090,437.6 lekë pa tvsh
- 16.K. 1,096, 675.61 lekë pa tvsh
- 17.D. 1,090,437.59 lekë pa tvsh

Nga KVO, ofertat të cilat plotësojnë të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST janë si vijon:

1. S. shpk me ofertë 1,091, 227.69 lekë pa tvsh,
2. M.-2K shpk me ofertë 1,087, 993.47 lekë pa tvsh.

Ky klasifikim për KVO ka përcaktuar si fitues OE M.

V) Në vijim të s -kualifikimeve të bëra nga KVO, në institucion janë paraqitur ankesa të cilat njëkohësisht janë paraqitur dhe në Komisionin e Prokurimit Publik ku janë marrë vendime përkatësisht :

-Vendim nr. 434/1 prot, datë 20.05.2020 ku KPP pas shqyrtimit të ankesave si dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre, ka vendosur :

1. Të kalojë për shqyrtim ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë òA.ò shpk, òS.ò shpk dhe òS.ò shpk, në procedurën e prokurimit ``Kërkesë për Propozim`` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt ``Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë``, me fond limit 1.090.437,6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

2.Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga AK deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

-Vendim nr.452/1 prot, datë26.05.2020 KPP pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre, ka vendosur:

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik òT.ò shpk, në procedurën e prokurimit ``Kërkesë për Propozim`` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt : ``Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë``, me fond limit 1.090.437,6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

2. AK të dërgojë menjëherë pranë KPP informacion të hollësishëm me argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik òT.ò shpk.

-Vendim nr.669/1 prot, datë 29.06.2020 KPP pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre, ka vendosur :

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatorët ekonomikë òA.ò shpk dhe òS.òshpk, në procedurën e prokurimit ``Kërkesë për Propozim`` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt ``Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë``, me fond limit 1,090,437.6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

2. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga AK deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

-Vendim nr.685/1 prot, datë 01.07.2020 KPP pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre, ka vendosur :

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik òK.ò shpk, në procedurën e prokurimit ``Kërkesë për Propozim`` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë` me fond limit 1, 090,437.6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

2. AK të dërgojë menjëherë pranë KPP informacion të hollësishëm me argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik òK.ò shpk.

-Vendim nr.694/1 prot, datë03.07.2020 KPP pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur tyre, ka vendosur :

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik òM.ò shpk, në procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë` me fond limit 1, 090,437.6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

-Në datë 30.07.2020 Komisioni i Prokurimit Publik dërgon vendimin me nr. 286/1 prot për dijëni dhe Agjencisë së Prokurimit Publik Tiranë. Në këtë vendim është vendosur :

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë A. shpk, S. shpk, K. shpk, M. shpk, për procedurën e prokurimit `Kërkesë për Propozim` me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë` me fond limit 1,090,437,6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

2. Autoriteti Kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

-Në datë 17.08.2020 KPP dërgon vendimin 286/3/2020 në të cilin është vendosur

1. Të heqë pezullimin për procedurën e prokurimit me objekt Kërkesë për Propozim me Nr.REF-56051-04-10-2020, me objekt Shërbim me Roje Civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë`, me fond limit 1, 090,437.6 pa tvsh, zhvilluar më datë 04.05.2020 nga Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, Tiranë.

Sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se, në referim të situatës së krijuar për mos përfundimin në kohë të shpalljes së OE për shërbimin e rojeve, si nga shoqëria òL.Gò sh.a si dhe për shkak të ankesave të paraqitura në KPP, nga OE të skualifikuar, ka sjellë që për periudhën **01.06.2020-09.10.2020**, pra për një periudhë 4- mujore, ky shërbim është siguruar nga personeli i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor Tiranë òZyber Hallulliò, kjo në referim të Urdhrit të brendshëm nr.36 prot datë 01.06.2020, të titullarit të institucionit znj. S. L, e cila ka urdhëruar që shërbim i rojeve të mbulohet nga punonjësit e institucionit z. E. S (me detyrë mirëmbajtës), z. A. D (me detyrë magazinier) dhe z. Z. C (me detyrë roje). Ky shërbim do të zhvillohej me rotacion të turneve (i pari, i dyti, i treti).

4)Nga auditimi i realizimit të procedurës me objekt “Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020”, u konstatua se, për rrethanat e krijuara SHFSH-Tiranë Zyber Halluli, për shkak të afatit të kohës si dhe përballë situatës së vështirë nga pandemia e virusit Covid-19, është aplikuar në bazë të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar neni 33 pika 2, germa c, procedura "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës".

Të dhënat e tenderit:

“Shërbim Roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.5, nr. 61.prot, datë 09.04.2020	3.Njësia e prokurimit: E.K A.H E.D 3/1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit, specififikimet teknike, kohëzgjatja e kontratës, etj., janë realizuar nga njësité :	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur sipas Urdhrit nr. 24, prot. Nr.60, datë 09.04.2020, me përbërje: 1-B.Gj (Kryetar) 2- K.L 3- Xh.F
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit	Me Urdhrit nr. 23, prot nr.58, datë 09.04.2020,është ngritur Grupi i Punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, me përbërje	

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

"Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës"	1. A.H 2. B.B 3. F.A	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 310,825.6 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese (pa tvsh) 308,583.57 lekë pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)
8. Data e lidhjes së kontratës Datë 23.04.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	2,242.43 lekë më pak ose sa 93 % e fondit limit
11. Ankimime Nga disa OE ka pasur ankesa pranë KPP, për s kualifikim e tyre nga KVO	12. Përgjigje Ankesës nga KPP Vendim nr. 434/1 prot, datë 20.05.2020 ; Vendim nr.452/1 prot, datë 26.05.2020 ; Vendim nr.669/1 prot, datë 29.06.2020 ; Vendim nr.685/1 prot, datë 01.07.2020 ; Vendim nr.694/1 prot, datë 03.07.2020 ; Vendim nr 286/1/3 datë 17.08.2020.	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës me nr. 65, datë 23.04.2020. është lidhur kontratë me ðN.ð, me NiptLXxH	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 199,333.16 lekë	16. Likuiduar sipas urdhër shpenzimeve
17. Afati i kontratës nga 23.04.2020-01.06.2020 Parashikuar 40 ditë	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbalet mujore dhe grafik ditor.	

VII) Nga auditimi në lidhje mbi dokumentacionin administrativ për realizimin e procedurës së prokurimit, u konstatuan disa mangësi si vijon:

-Referuar DST shtojcës 1 (Formulari i ftesës për pjesëmarrje), njësia e prokurimit i ka dërguar ftesë për ofertë 3 operatorëve ekonomik, konkretisht, N. NIPT JXxH, D. shpk NIPT KXxJ dhe S. shpk NIPT KXxR.

Njësia e prokurimit nuk rezulton të ketë justifikuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të cilëve u është dërguar ftesa, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 35, pika 4, ku përcaktohet që *ðNë çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë. “si dhe referuar përcaktimeve, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018* -Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike pika 6 paragrafi 2, parashikohet që *ðArgumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.”*

-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit, u konstatua se, nga anëtarët e NjP dhe KVO, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

- Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që, *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.*

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 oPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që, *“Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.*

- Në lidhje me të gjithë urdhrat e miratuara nga titullari i AK, është konstatuar se, secili prej tyre ka një numër të ndryshëm protokoll, specifikisht, urdhri për ngritjen e KVO, Grupit për llogaritjen e fondit limit, si dhe urdhri i prokurimit, nuk mban të njëjtin numër protokoll në seri, në kundërshtim me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, e cila përcakton se *“Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e jo shtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.”*

VIII) Nga auditimi në lidhje mbi përllogaritjen e fondit limit dhe mbi mënyrën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, u konstatua si vijon:

Në përllogaritjen e fondi limit, Grupi i punës i është referuar zbatimit të bazës ligjore se ai është përgatitur sipas proces verbalit të datës 09.04.2020, (pa nr. prot) dhe mbështetur në Ligjin 75/2014 Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, Ligjit nr. 74/2014 oPër armët, Udhëzimit nr. 157, dt. 01.04.2016 të Ministrit të Punëve të Brendshme oPër shërbimin privat të sigurisë fizike si dhe VKM nr. 809, dt. 26.12.2018 oPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, VKM nr.77, datë 28.01.2015 oPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor. Nisur nga koeficientët bazë të përllogaritjes vlera është si më poshtë:

Paga minimale 39,000	Paga orare $39,000/174=224.13$ lekë/orë
Numri i vendrojeve 1	Turni II: $30.5 \text{ ditë} * 3 * 224.13 * 20\% =$
Numri i Turneve 2 (16 orë)	1235.41 lekë
Numri i rojeve në ditë 3,32 roje	$39,000 + 1235.41 = 40,235.41$ lekë
Orë pune /1 roje në muaj 174 orë	$40,235.41 + 16,7\% * 40,235.41 = 46,954.72$

46,954.72 lekë, kosto mujore/30.5 ditë=1,539.49 lekë kosto ditore

Prej nga fondi limit për 61 ditë (prill+maj 2020) është:

$1539.49 * 61 * 3,32 = 311,777.51$ lekë (ndërsa grupi i punës e nxjerr vlerën 310,825.6 lekë ose 951,91 lekë më pak). Pra grupi i punës ka përllogaritur gabim vlerën e fondit limit me 951,91 lekë më pak.

Ndërsa OE fitues oN.ö, ka paraqitur këtë ofertë ekonomike:

Analiza e detajuar e koston (1 roje / ditë).

1. Paga bazë llogaritet mbi VKM nr. 809 dt..26.12.2018 oPër përcaktimin e pagës bazë në shkallë vendi, që është 26 000 leke në muaj, dhe
2. Shtesa 50% mbi pagën baze = 39 000 leke/muaj/roje sipas nenit 18, shkronja (g) të ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", dhe prej këtej del në kosto ditore të një roje duke kryer veprimin: $39,000 * 12/366 = 1278,68$ lekë/roje/ditë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

3. Shtesa mbi pagë për vështirësi për turnin e II otë , llogaritet në bazë të nenit 81 të ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 i cili shprehet se *“Çdo orë pune e kryer nga ora 19-00 deri në 22-00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 %”*
4. $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II të.
5. Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68** + 27 lekë/roje/ditë, turni i II të = **1,305.68** lekë/roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.
6. Paga ditore = 1,305.68 + 218,04 = **1523.72** lekë/roje/ditë, *3,32 = **5,058.75** lekë për një vendroje/ditë.
7. Kosto për 61 ditë $5,058.75 \times 61 = 308,583.75$ + 20% tvsh = **370,300.50** lekë.

Nga auditimi u konstatua se, KVO, ka pranuar këtë ofertë duke mos konstatuar gabime, që grupi i auditimit i konstatoi, në mënyrën e përlllogaritjes dhe konkretisht:

-OE fitues, në llogaritjen e ofertës, kur ka llogaritur shtesën e vështirësisë për turnin e II nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por e ka pjesëtuar me një koeficient më të lartë të gabuar me 4,98 roje, pra me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të koston së vështirësisë duke e ulur atë, duke e paraqitur në këtë formë:

1. OE $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II të.

Grupi i auditimit:

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 3,32 = 40,5$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-ë.

2.OE Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68** + 27 lekë / roje / ditë, turni i I-të = 1,305.68 lekë/roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Grupi i auditimit:

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68** + 40,5 lekë / roje / ditë, turni i II-të = 1,319.18 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 220,30 lekë/roje/ ditë.

3.OE Paga ditore = 1,305.68 + 218,04 = 1523.72 lekë/roje/ditë, *3,32 = 5,058.75 lekë për një vendroje/ditë.

Grupi i auditimit:

Paga ditore = 1,319.18 + 220,30 = 1539,48 lekë/roje/ditë, *3,32 = 5,111.07/lekë për një vendroje/ditë.

4. OE/Kosto 61 ditë $5,058.75 \times 61 = 308,583.77$ + 20% tvsh = 370,300.50 lekë.

Grupi i auditimit:

$5,111.07 \times 61 = 311,775.49 + 20\% \times 311,775.49 = 311,775.49 + 62,355.09 = 374,130.58$ lekë pra 3830,08 lekë më pak llogaritur nga OE.

Kjo nuk është eficientë sepse jo çdo vlerë më e ulët do të thotë menaxhim me eficientë, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit sepse subjekti paguan më pak sigurime shoqërore e shëndetësore në muaj në kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë si dhe në shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 për procedurat Tatimore në RSHö, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d, ku citohet se *“Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh / transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku: d) evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore. Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/ transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.”*

Në lidhje mbi këtë, mban përgjegjësi Titullari i institucionit në cilësinë e titullarit të AK dhe anëtarët e KVO-së.

1.S.L, në cilësinë e titullarit të AK

2. B.Gj (Kryetar e KVO), me pozicion punonjëse sociale, me arsim të lartë, profile juridik (ndërrerë marrëdhëniet e punës në datë 15.07.2020.)



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

3. K.L, (anëtare e KVO, ish-mjeke, (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 01.12.2021)

4.Xh.F,(anëtare e KVO, me pozicion kryekujdestare me arsim të lartë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 10.11.2020)

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 58, i cili ndër të tjera përcakton se òKomisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës”.

Sa më sipër, KVO e krijuar me anëtarë të cilët nuk janë specialistë të fushës ka çuar në një vendim jo të drejtë sepse në parim është pranuar një ofertë ekonomike (e vetmja e paraqitur) pa u analizuar por thjesht pse është me e ulët se fondi limit, ndërkohë nisur nga tipologjia dhe standardi i miratuar mbi mënyrën e përlogaritjes së vlerës së kontratës, për procedurat e prokurimit me objekt òShërbim roje civile ò, koeficientët e marrë për bazë llogaritje janë të mirë përcaktuar dhe rrjedhimisht oferta ekonomike nuk ka sens të jetë shumë me e vogël se fondi limit. Pikërisht nisur nga ky fakt, duhet që KVO-ja të kontrollonte, përlogaritjen e ofertës fituese si dhe të arsyetonte, pse OE paraqitet shumë ulët në vlerë krahasuar me fondin limit.

Këto risqe shtohen edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura, i cili nga auditimi rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mos njohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 55, pika 3, e cila ndër të tjera përcakton se òAutoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

IX) Mbi auditimin e zbatimit të kontratës datë 23.04.2020 me operatorin ekonomik fitues N. dhe Titullarit të AK.

Në datë 23.04.2020 është nënshkruar kontrata: òShërbimi me roje civileò, me nr 65 Prot, ndërmjet AK Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë dhe N. me Nipt: JXx. Kjo kontratë fillon efektet e saj nga momenti i nënshkrimit datë 23.04.2020 deri në datë 01.06.2020.

Vlera e kontratës është: 199,333.16 lekë pa tvsh ose 239,199.8 lekë me tvsh.

Nga auditimi në referim të tabelës së mëposhtme, u konstatua se:

Nr. Urdhër Shpenzim /datë	Nr. fature /datë	Vlera në lekë	Nr. proces verbal /datë
Nr. 67 datë 08.05.2020	Nr. 51, datë 30.04.2020	48,564	Nr. 21/datë 30.04.2020 P.K, H.T, N.B
Nr. 86 datë 08.06.2020	Nr. 86, datë 31.05.2020	188,185	Nr. 80, prot, datë, H.T, N.B, P.K
Totali		236,749	
Vlera e kontratës		239,199.8	
Pjesa e mbetur		2,450.8	
% e realizuar		98,90%	

Likuidimi i kontratës, është kryer nëpërmjet 2 urdhër shpenzimeve, pra në fund të çdo muaji respektiv dhe kështu në referim të datës së lidhjes së kontratës 23.04.2022, grupi i auditimit konstatoi se:

USH (1) është paguar 8 ditë mbas lidhjes së kontratës

USH (2) është paguar për 31 ditë në maj që në total është një afat prej 39 ditësh, nuk konstatohet kjo e mirë përcaktuar në kontratë pasi në bazë të numrit të ditëve do të përlogaritet edhe kosto e saktë për likuidim dhe nisur nga sa më sipër si dhe nga kosto ditore e ofertuar dhe e pranuar nga KVO, shuma është:

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Kosto për 8 ditë: $5,058.75 \cdot 8 + 20\% \cdot 5058,75 = 40,470 + 8,094 = 48,564$ lekë

Kosto për 31 ditë: $5058.75 \cdot 31 + 20\% \cdot 156,821,25 = 156,821.25 + 31,364.25 = 188,185.5$, lekë

Nga auditimi, i dokumentacionit shoqërues të Urdhër-shpenzimeve, u konstatua se, në asnjë nga faturat e sjella nga subjekti nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat ai ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura pranohen përgjegjësi i sektorit të administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 12, pika 3/dh dhe e, ku citohet se:

Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:

dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi.

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve prill dhe maj të vitit 2020, pasi subjekti fitues ka dorëzuar vetëm listëpagesat janar-mars 2020.

Grupi i auditimit, vlerëson se, ky dokument administrativ, duhet të ishte pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbimi për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet, veprimet e Ak janë në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku citohet se 3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali.

4. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.”

5) Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt shërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Zyber Hallulli, Tiranë, 30 shtator 2020.

Të dhëna të përgjithshme të tenderit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë për periudhën 21.09.2020 deri në lidhjen e marrëveshjes kuadër.”		
1. Urdhër Prokurimi nr.17, datë 30.09.2020	3.Njësia e prokurimit: 1.E.K 2.E.D 3.M.I 3/1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit, specififikimet teknike, kohëzgjatja e kontratës, etj., janë realizuar nga njësitë :	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur sipas Urdhrit nr. 209/2, datë 30.09.2020, me përbërje : 1-A.H (Kryetar) 2- A.Zh 3- K.L
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit.	Me shkresën nr. 209/1, datë 30.09.2020, është ngritur Grupi i Punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, me përbërje	
"Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës"	4. A.H 5. S.H 6. F.A	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 306,666,4 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese (pa tvsh) 306,664.20 lekë pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
8. Data e lidhjes së kontratës ndërmjet N. me nipt JXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr, prot 217, datë 09.10.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	0.20 lekë më pak ose sa 99.99 % e fondit limit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

11. Ankimime	12. Përgjigje Ankesës nga AK	
Nuk ka	Nuk ka	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës është lidhur kontratë me ðN.ð, me NiptJXX	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 367,977,04 lekë	16. Likuiduar sipas urdhër shpenzimit;
17. Afati i kontratës në muaj	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali i datës Nr.234 datë 31.10.2020 Procesverbali i datës Nr.285 datë 30.11.2020	
Parashikuar 2 muaj		

-Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Memos e administruar, në dosjen e prokurimit, protokolluar me nr. 209/10, datë 30.09.2020 njësia e prokurimit, e përbërë nga (E.K, E.D dhe M.I), referuar njoftimit të I.G, për pamundësi të ofrimit të shërbimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë më datë 31.03.2020, dhe në kushtet kur procedura e prokurimit ðKërkesë për propozimë me afat 01.06.2020 deri më 31.12.2020 është anuluar me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 286/3/2020, datë 19.08.2020 dhe është ri-publikuar ne sistemin e APP me datë të hapjes së ofertave 05.10.2020, ka kërkuar nisjen e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës me objekt ðShërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë për periudhën 21.09.2020 e deri në lidhjen e marrëveshjes kuadër.

Kështu, për rrethanat e krijuara SHF-Tiranë Zyber Halluli, për shkak të afatit të zgjatur prej vendim marrjes së KPP si dhe përballë situatës së vështirë nga pandemia e virusit Covid-19, është aplikuar në bazë të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ðPër prokurimin publikë i ndryshuar neni 33 pika 2, germa c dhe e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, neni 55 pika 1, germa (c).

Sa më sipër, në mbështetje të Urdhrit të titullarit të AK nr.17, 209/9, prot, datë 30.09.2020 S.L, është miratuar nisja e procesit të realizimit të procedurës së prokurimit negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt ðShërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë, me fond limit prej 306.666,4 lekë pa TVSH.

-Nga auditimi në lidhje mbi dokumentacionin administrativ për realizimin e procedurës së prokurimit, u konstatuan disa mangësi si vijon:

-Referuar DST shtojcës 1 (Formulari i ftesës për pjesëmarrje), njësia e prokurimit i ka dërguar ftesë për ofertë 3 operatorëve ekonomik, konkretisht, N. NIPT JXX, D. shpk me NIPT KXX dhe S. shpk NIPT KXX.

Njësia e prokurimit ngritur me Urdhër nr.209 datë 30.09.2020 me përbërje (E.K, E.D dhe M.I) nuk rezulton të ketë justifikuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të cilëve u është dërguar ftesa, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar neni 35, pika 4, ku përcaktohet që ðNë çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë. “si dhe referuar përcaktimeve, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 -Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike pika 6 paragrafi 2, parashikohet që ðArgumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.”

- Me urdhrin nr. 209/1, datë 30.09.2020 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës me përbërje znj. A.H, znj. S.H dhe znj. F.A.

Me urdhrin nr. 209/2, datë 30.09.2020 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e KVO, me përbërje znj. A.H, znj. K.L, dhe znj. F.A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Përcaktimi i znj. A. H e F. A, si anëtare e Njesisë se Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të neni 56 “Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.

Kjo pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST.

- Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të neni 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që, “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018. Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që, “Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.

- Nga auditimi mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit nga grupi i punës, është e njëjta procedurë e ndjekur me të njëjtët koeficiente të përcaktuar për një vëndroje dhe pagës bazë plus shtesën e vështirësisë, me vlerë 306,666.4 lekë dhe kosto ditore 1,539.49 lekë.

Monitorimi i zbatimit të kontratës.

-Mbi auditimin e zbatimit dhe monitorimit të Kontratës nr. 217 prot, datë 09.10.2020 lidhur midis operatorit ekonomik òN.ò dhe SHFSH Tiranë u konstatua se kontrata i mbaroi efektet e saj më datë **16.11.2020** me lidhjen e kontratës së re me òS.ò. Kjo kontratë ka afat 2 muaj nga momenti i nënshkrimit të saj me kusht ndërprerjen në momentin e lidhjes së kontratës sipas procedurës bazë òKërkesë për Propozimò.

Vlera e kontratës është: 306.664,2 lekë pa tvsh ose 367.977,04 lekë me tvsh.

Nga auditimi në referim të tabelës së mëposhtme, u konstatua se:

Nr. Urdhër Shpenzim /datë	Nr. fature /datë	Vlera në lekë	Nr. proces verbal /datë
Nr.179 datë 09.11.2020 (Nr. 234 datë 31.10.2020	138,745	Nr. 65 datë 31.10.2020 H.T, P.K, A.K
Nr.202 datë 14.12.2020	Nr. 285 datë 30.11.2020	96,518	Nr. 66 datë 17.11.2020 H.T, P.K, Gj.B
Totali		235,263	
Vlera e kontratës		367,977.04	
Pjesa e mbetur		132,714.04	
% e realizuar		63.98%	

- Në asnjë nga faturat e sjella nga subjekti nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat OE fitues, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhën si dhe këto fatura janë pranuar nga përgjegjësi i sektorit të administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015. Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 12, pika3/dh dhe e, ku citohet se òNëpunësit zbatues të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”.

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve tetor-nëntor të vitit 2020, pasi subjekti fitues ka dorëzuar vetëm listëpagesat janar ómars 2020.

Grupi i auditimit, vlerëson se, ky dokument administrativ, duhet të ishte pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbim për të siguruar zbatimin e kontratës me eficencë, veprimet e AK janë në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku citohet se 03. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali.

4. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.”

***Si përfundim në mënyrë të përmbledhur për dy procedurat e mësipërme të tipit 0Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, të kryera nga SHFSH përkatësisht sipas Urdhrit të prokurimit nr.5, 61/prot, datë 09.04.2020 dhe Urdhrit të prokurimit nr.17, datë 30.09.2020, për Shërbim roje civile në SHFSH u konstatua se:

1-Njësia e prokurimit nuk rezulton të ketë justifikuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të cilëve u është dërguar ftesa, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 35, pika 4, si dhe referuar përcaktimeve, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018. Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 6 paragrafi 2, parashikohet që 0Argumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.”

2-Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit, u konstatua se, nga anëtarët e NjP dhe KVO, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

3- Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar,

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018. Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që, 0Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.

4- Në lidhje me të gjithë urdhrat e miratuara nga titullari i AK, është konstatuar se, secili prej tyre ka një numër të ndryshëm protokoll, specifikisht, urdhri për ngritjen e KVO, Grupit për llogaritjen e fondit limit, si dhe urdhri i prokurimit, nuk mban të njëjtin numër protokoll në seri, në kundërshtim me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.

5-Grupi i punës për hartimin e fondit limit në procedurën e prokurimit sipas Urdhrit nr. 5, 61/prot, datë 09.04.2020 i ngritur në bazë të Urdhër nr.53 datë 06.04.2020, i përbërë nga (A.H, B.B dhe F.A), i është referuar bazës ligjore, ligjit 75/2014 Për ofrimin e shërbimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

privat të sigurisë fizike, ligjit nr. 74/2014 për armët, Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.157, datë 01.04.2016 për shërbimin privat të sigurisë fizike, VKM nr. 809, datë 26.12.2018 për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe VKM nr.77, datë 28.01.2015 për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor. Nisur nga koeficientët bazë të përlogaritjes vlera është si më poshtë:

46,954.72 lekë, kosto mujore/30.5 ditë=1,539.49 lekë kosto ditore

Prej nga fondi limit për 61 ditë (prill+maj 2020) është:

$1539.49 * 61 * 3,32 = 311,777.51$ lekë (ndërsa grupi i punës e nxjerr vlerën 310,825.6 lekë ose **951,91 lekë më pak**). Pra grupi i punës ka përlogaritur gabim vlerën e fondit limit me **951,91 lekë më pak**.

Ndërsa OE fitues ðN.ö, ka paraqitur këtë ofertë ekonomike:

Analiza e detajuar e koston (1 roje / ditë).

Shtesa mbi pagë për vështirësi për turnin e II otë , llogaritet në bazë të nenit 81 të ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 i cili shprehet se *“Çdo orë pune e kryer nga ora 19-00 deri në 22-00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 %”*

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+27 lekë/roje/ditë, turni i II-të=**1,305.68** lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Paga ditore = 1,305.68 +218,04= **1523.72 lekë/roje/ditë**, *3,32= **5,058.75** lekë për një vendroje/ditë.

Kosto mujore $5,058.75 * 61 = 308,583.75 + 20\%$ tvsh= **370,300.50** lekë.

Nga auditimi u konstatua se, KVO, e ka pranuar këtë ofertë duke mos konstatuar gabime, që grupi i auditimit i konstatoi, në mënyrën e përlogaritjes dhe konkretisht:

-OE fitues, në llogaritjen e ofertës, kur ka llogaritur shtesën e vështirësisë për turnin e II nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por e ka pjesëtuar me një koeficient më të lartë të gabuar me 4,98 roje, pra me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të koston së vështirësisë duke e ulur atë, duke e paraqitur në këtë formë:

1. OE $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

Grupi i auditimit:

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 3,32 = 40, 5$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

2.OE Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+27 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,305.68 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Grupi i auditimit:

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+40,5 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,319.18 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 220,30 lekë/roje/ ditë.

3.OE Paga ditore = 1,305.68 +218,04= 1523.72 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,058.75 lekë për një vendroje/ditë.

Grupi i auditimit:

Paga ditore = 1,319.18 +220,30= 1539,48 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,111.07/lekë për një vendroje/ditë.

4. OE/Kosto 61 ditë $5,058.75 * 61 = 308,583.77 + 20\%$ tvsh= 370,300.50 lekë.

Grupi i auditimit:

$5,111.07 * 61 = 311,775.49 + 20\%$ *311,775.49 =311,775.49 +62,355.09= **374,130.58** lekë pra **3830,08** lekë më pak llogaritur nga OE.

Kjo nuk është eficient sepse jo çdo vlerë më e ulët do të thotë menaxhim me eficientë, ekonomictet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit sepse me këtë diferencë, subjekti paguan më pak sigurime shoqërore e shëndetësore në muaj,në kundërshtim me ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë si dhe në shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 ÷Për procedurat Tatimore në RSH, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.

Sa më sipër, KVO e krijuar me anëtarë të cilët nuk janë specialistë të fushës ka çuar në një vendim jo të drejtë sepse në parim është pranuar një ofertë ekonomike (e vetmja e paraqitur) pa u analizuar por thjesht pse është me e ulët se fondi limit, ndërkohë nisur nga tipologjia dhe standardi i miratuar mbi mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, për procedurat e prokurimit me objekt ÷Shërbim roje civile ÷, koeficientët e marrë për bazë llogaritje janë të mirëpërcaktuar dhe rrjedhimisht oferta ekonomike nuk ka sens të jetë shumë me e vogël se fondi limit. Pikërisht nisur nga ky fakt, duhet që KVO-ja të kontrollonte, përlllogaritjen e ofertës fituese si dhe të arsyetonte, pse OE paraqitet shumë ulët në vlerë krahasuar me fondin limit.

Këto risqe shtohen edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura, i cili nga auditimi rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mos njohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 55, pika 3.

Në lidhje mbi këtë, mban përgjegjësi Titullari i institucionit në cilësinë e titullarit të AK dhe anëtarët e KVO-së.

1.S.L, në cilësinë e titullarit të AK

2.B.Gj (Kryetar e KVO), me pozicion punonjëse sociale, me arsim të lartë, profile juridik (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 15.07.2020.)

3.K.L, (anëtare e KVO, ish-mjeke, (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 01.12.2021)

4.Xh.F, (anëtare e KVO, me pozicion kryekujdestare me arsim të lartë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 10.11.2020)

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 58.

Në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e dy kontratave respektivisht të lidhura u konstatua se:
1-Në asnjë nga faturat e sjella nga subjekti nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat OE fitues, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura janë pranuar nga përgjegjësi i sektorit të administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 12, pika3/dh dhe e.

2-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve tetor-nëntor të vitit 2020, pasi subjekti fitues ka dorëzuar vetëm listëpagesat janar ómars 2020.

Grupi i auditimit, vlerëson se, ky dokument administrativ, duhet të ishte pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbim për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet, veprimet e AK janë në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku citohet se ÷3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali.

3- Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Si përfundim, vlera prej 239,199.8 lekë për shërbim me roje civile për SHFSH dhe 367,977.04 lekë është përdorur pa ekonomikitet, efencë dhe ekonomikitet nga Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë.

6) Auditimi i procedurës me objekt “Shërbim Roje”, për nevoja të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor, Tiranë” për vitin 2020/ shtator.

Të dhënat e përgjithshme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Auditimi i procedurës me objekt: “Shërbim me Roje civile, për nevoja të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollor, Tiranë” për vitin 2020, 18 shtator.		
1. Urdhër Prokurimi nr.16, 189/3 datë 18.09.2020	3. Njësia e prokurimit E.K(juriste në Q. Kombëtare të viktimave të trafikimit) E.D M.I 3/1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit, specififikimet teknike, kohëzgjatja e kontratës, etj., janë realizuar nga njësitë :	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur sipas Urdhrit nr. 189/1, datë 18.09.2020, me përbërje: 1-A.H (Kryetar) 2-K.L 3- A.Zh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit	Me shkresën nr. 189/2, datë 18.09.2020, është ngritur Grupi i Punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, me përbërje	
"Marrëveshje kuadër" me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj .	7. A.H 8. S.H 9. F.A	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,870,910.13 lekë pa TVSH (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e dhjetë lekë)	6. Oferta fituese (pa tvsh) , më datë 19.11.2020. 1,870,087.20 lekë (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e e tetëdhjetë e shtatë) pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit 823 lekë (pa TVSh) , më pak ose sa 99.99 % e fondit limit.
8/1. Data e lidhjes së kontratës Nr. Prot 247, datë 16.11.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	
8/2. Data e lidhjes së kontratës II , me nr. 278/prot, dt. 31.12.2020 me kohëzgjatje 01.01.2021-16.11.2021		
8.3. Amendim Kontrate , datë 01.02.2021, si rezultat i ndryshimit të pagës minimale me VKM nr. .1025, dt. 16.12.2020.		
11. Ankimime S., dt. 22.10.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK Po ka. dt. 26.10.2020	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Me S. me Nipt KXX	15. Vlera e kontratës I (me TVSh) 276,731.22 lekë me tvsh. Vlera e kontratës së II (me tvsh) 1.967.373.42 lekë. Vlera e kontratës së III/ e amenduar (me tvsh) 2,271,122,23 lekë.	16. Likuiduar sipas urdhër shpenzimit;
17/1 Afati i kontratës I në muaj, fillon efektet nga dt. 17.11.2020-31.12.2020, pra 44 ditë kalendarike. 17/2. Afati i kontratës II fillon efektet nga dt. 01.01.2021-16.11.2021. 17/3. Amendimi I kontratës me nr.38/ prot, dt. 31.03.2021,	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali respektive për co muaj shërbimi	19. Fletë Hyrja dorëzimi i grafikut tip sipas kontratës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së shërbimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

nga SHFSH.		

-Nga auditimi i përzgjedhjes së llojit të prokurimit të procedurës, AK, i është referuar Memo nr.189. prot, dt. 18.09.2020, të SHSSH ku midis të tjerave propozon, që SHFSH Zyber Hallulli, Tiranë *“të zhvillojë procedurën “Kërkesë për Propozim - Marrëveshje kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj “për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë me objekt: “Shërbim me Roje Civile” me kusht zgjidhjen e kontratës në momentin e paraqitjes së shoqërisë òl.Gö sha për ofrimin e shërbimito pasi shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për periudhën në vazhdim mbetet i pa mbuluar dhe përbën një rrezik për ruajtjen e objekteve .*

Në lidhje me përzgjedhjen e kësaj procedure KLSH, konstaton se, nga SHSSH dhe AK është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 òPër prokurimin publiko i ndryshuar, me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar, dhe me VKM nr. 177, datë 04.04.2019, òPër krijimin e shoqërisë òl.Gö, pasi SHSSH dhe AK i referohen njoftimit të datës 31.03.2020 të Shoqërisë òl.Gö, e cila në atë kohë, për shkak të vështirësive teknike, e kishte të pamundur ofrimin e shërbimit për SHFSH Zyber Hallulli, TR me shërbim roje civile. **Pra në këtë rast nuk jemi në kushte të emergjencës, që procedura të realizohej nga AK SHF Zyber Hallulli, Tiranë, pasi jemi në muajin shtator 2020.**

-Në dosjen e audituar nuk rezultoi asnjë korrespondencë zyrtare me Shoqërinë òl.Gö në muajin shtator 2020, e cila të shprehej mbi pamundësinë e saj për zbatimin e detyrimit ligjor për shërbimin e rojeve civile në mbështetje tëVKM nr. 177, datë 04.04.2019, òPër krijimin e shoqërisë òl.Gö.

Kësaj shtate i shtohen risqe edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura nga SHSSH dhe SHF Zyber Hallulli-Tiranë, i cili nga auditimi më specifiku për shërbim roje civile, rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mosnjohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike.

-Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, nuk janë realizuar trajnime për stafin e punonjësve që do të përfshihen në realizimin e prokurimeve publike me njësitë e tjera të varësisë (SHFSH Zyber Hallulli, TR). Gjithashtu në mungesë të kapaciteteve të burimeve njerëzore, **SHSSH duhet të realizonte këto procedura, në mënyrë që të kishim menaxhim me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet, të fondeve publike, për të siguruar shërbimin e kërkuar pranë SHF Zyber Hallulli, TR.**

Për këtë mban përgjegjësi Titullari i Institucionit dhe njësia e Prokurimit me anëtarë: E.K, M.I(me pozicion psikologe në SHF) dhe E.D (përgj/sectorit social në SHF)

-Nga auditimi i përcaktimit të punonjësve pjesëmarrës në strukturat prokuruese, u konstatua se, me shkresën nr. 189/2, datë 18.09.2020, Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e fondit limit, me përbërje (A.H, S.H dhe F.A) si dhe me shkresën nr. 189/1, datë 18.09.2020, Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje (A.H-kryetar, K.L dhe A.Zh).

Përcaktimi i znj. A.H, si anëtare (Kryetare) e Njësisë së Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të nenit 56 të, të LPP, 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku citohet se: **“Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.** Kjo pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Veprim që ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK zj. S.L.

-Nga auditimi në mbështetje edhe të dosjes elektronike pranë app.gov.al me nr. Reference REF-72495-09-21-2020, u konstatua se:

Rezulton se kanë paraqitur ofertë ekonomike 13 operatorë ekonomik SHRSF dhe fitues është shpallur SH.R.S. F "S." me Nipt: KXx. ÷ Sipas njoftimit afati për dorëzimin e ofertave ka qenë **data 05.10.2020.**

Vlera e ofertës ekonomike ditore (kosto ditore për një roje + kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore), prej 46,939.94 (Dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë nëntë dhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe vlera totale e ofertës prej 1.870.087.20 (Një milion tetëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëdhjetë-e shtatë pikë njëzet) lekë pa tvsh është identifikuar si **oferta e fituese**, më datë **19.11.2020**, si çmimi më i ulët.

- Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku parashikohet që, *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.*

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

Po kështu, referuar pikës 10, shkronja (a) të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ÷ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ku parashikohet që, ÷ *Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni i vlerësimi të ofertave përgatit një raport përmbledhës, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha hapat e ndjekura nga ky komision për përzgjedhjen e ofertës fituese dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor”.*

-Nga auditimi i përcaktimit të kriterëve, në Seksionin **2.** (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit) nga njësia e prokurimit, u konstatua se:

2.2/Kapacitetet teknike, pika 4, është kërkuar nga OE që ÷4. *Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën **Janar-Mars 2020** shoqëruar me **listëpagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara në formë elektronike (Rekomandim i APP-së nr.8197 prot., datë 03.09.2019, fq.5) për jo me pak se 10 punonjës të siguruar. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.**”*

Grupi i auditimit, vlerëson se në vendosjen e këtij kriteri është konceptuar jo në shërbim të plotësisht të kontratës dhe dhënies së garancisë nga OE për një zbatim sa më korrekt të saj, pasi procedura e tenderimit është kryer në shtator 2020, njoftimi i fituesit është shpallur në tetor 2020 dhe listëpagesat për subjektin janë kërkuar për muajt janar-mars 2020, ku nuk japin garanci për numrin e punonjësve të siguruar në vazhdimësi si dhe për emrat e të siguarve, pasi subjekti mund të kryejë lëvizje të vazhdueshme të fuqisë punëtore dhe në rastin konkret nisur nga lloji i aktivitetit ÷ Shërbim ruajtjeo punonjësit duhet të kenë një Certifikatë tip për punonjësit e shërbimit për ushtrimin e profesionit konform Ligjit Nr.75/2014" Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizikeo të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 ÷ Për Prokurimin Publiko, të ndryshuar, pika 1, 2, ku citohet se ÷ *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” si dhe me VKM nr.914 neni 28 pika 2, ku citohet se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Sa më sipër, ky kriter hartuar jo në përputhshmëri ligjore ka sjellë risqe në mos zbatimin korrekt të kontratës dhe hapësira për abuzim nga OE, pasi u konstatua nga monitorimi i zbatimit të kontratës dhe në proces verbalet mujorë të mbajtur ndërmjet OE fitues dhe AK si dhe grafikut bashkëlidhur, se punonjësit e cituar nuk figuronin në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të sjella nga vetë tatimpaguesi për muajt janar-shkurt-mars/2020, dhe AK, nuk kishte dijeni nëse këta punonjës që kryenin shërbimin e ruajtjes ishin të siguruar dhe deklaruar në vijimësi.

-Gjithashtu njësia e prokurimit vendos një kriter pa bazë dhe të pa argumentuar ku përcakton se *“Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.”*

Ndërkohë OE fitues, mund të ketë edhe më shumë se 10 punonjës dhe kjo nuk i jep garanci AK se ky numër është i mjaftueshëm pasi shoqëritë e ruajtjes kryejnë shërbimin e ruajtjes në disa objekte njëkohësisht dhe konkretisht, OE fitues òS.ò me shkresën e sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me nr.1824/49. Prot, datë 23.07.2020, konfirmon se deri në korrik 2020, ka në ruajtje:

- ✓ Objekte shtetërore-3
- ✓ Objekte private- 3
- ✓ Objekte në ruajtje private me verifikim sinjali-3.

Numri i punonjësve në dispozicion sipas kontratave të lidhura për këto objekte është **29**.

Ndërkohë në bazë të auditimit, sipas vërtetimit tip mbi numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar ógusht 2020, numri mesatar i punonjësve të siguruar është **28**. Pra subjekti rezulton të mos ketë mjaftueshëm numër fuqie punëtoresh për të kryer zbatimin e kontratave të lidhura me subjekte të ndryshëm. Sipas përlllogaritjeve të mësipërme subjekti duhet të ketë *jo më pak se 29+ 3.32 (3,32 punonjës të detyrueshëm për shtëpinë e fëmijëve Tr) =33 punonjës gjithsej.*

Pra kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit është i pa studiuar dhe nuk garanton në asnjë moment zbatimin korrekt të kontratës nga OE, veprime në kundërshtim me nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar neni 28/ Kontratat e shërbimit, pika 2, si dhe nenin 46 të LPP nr. ku citohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në lidhje mbi vendosje të këtij kriteri nëse i referohemi dhe vendimeve të KPP ndaj ankimeve të kryera nga SHRSF, shprehet se:

òPër AK e rëndësishme është të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi, për sa kohë vërtetohet se ato janë të punësuar pranë OE në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës në RSH, si dhe të figurojnë në listë pagesa në përputhje me legjislacionin tatimor, dhe jo kohëzgjatja e disponimit në periudhat e mëparshme.ò



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Nisur sa më sipër, nga KVO nuk janë kërkuar dokumente shtesë ku të vërtetojnë kapacitetin aktual të punonjësve të siguruar në shoqërinë òS.ò, të cilat do të jepnin garanci për zbatimin e kontratës.

Kështu nga AK/KVO, pasi shqyrtoi dokumentet e sjella nga OE dhe konstatoi që numri mesatar i punonjësve ishte 28, kur ndërkohë sipas përlllogaritjeve të mësipërme të grupit të auditimit, subjekti duhet te ketë jo më pak se 29+ **3.32**(3,32 punonjës të detyrueshëm për shtëpinë e fëmijëve Tr) =**33 punonjës gjithsej**, për vazhdimësinë e të gjitha kontratave të lidhura prej tij.

Pra KVO ka shpallur fitues operatorin ekonomik, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, ku citohet se *òPas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.*”, dukemos ikushtuar vëmendje plotësimi apo jo të kriterëve duke u bazuar në DST standarde pa kryer argumentimin përkatës për të dhënë siguri në lidhjen dhe zbatimin e kontratës së lidhur me këtë OE.

-Grupi i punës për hartimin e fondit limit i ngritur në bazë të Urdhër me shkresë nr189/1 datë 18.09.2020, me përbërë nga (A.H, S.H dhe F.A), i është referuar bazës ligjore, ligjit 75/2014ò Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizikeò, ligjit nr. 74/2014 òPër armëtò, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.157, datë 01.04.2016 òPër shërbimin privat të sigurisë fizikeò, VKM nr. 809, datë 26.12.2018 òPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendiò dhe VKM nr.77, datë 28.01.2015 òPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësorò. Nisur nga koeficientët bazë të përlllogaritjes vlera është si më poshtë:

Përlllogaritja sipas bazës ligjore të mësipërme ka nxjerrë një kosto mujore prej 46,950.46 lekë për 30.41 ditë, dhe në rrjedhim për 365 ditë dhe për 3.32 roje, vlera totale rezulton 1,870,910.13 lekë (fond limit).

Në lidhje me paraqitjen e ofertave nga OE, bazuar edhe në dosjen elektronike u konstatuan se nga 13 OE, 12 prej tyre kanë dalë në të njëjtin përfundim për koston mujore të një roje dhe konkretisht në vijim:

- I. Analiza e çmimit për 3.32 roje/vendroje paga bazë = 26 000 lekë ne muaj (pa tvsh).
- II. Shtesa 50% mbi pagën bazë = 39 000 leke/muaj/roje sipas neni 18, shkronja g) të ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike"
- III. Shtesa Turni II = Paga orare 224.13 lekë/orë x 30.41 ditë në muaj x 3 orë Turni II-të (ora 19.00-22.00 sipas Neni 81 te Kodit te Punës) x 20% (shtesa sipas neni 81 të Kodit të Punës) = 4,089.47 lekë 3.32 roje/vendroje = 1 231.76 leke/muaj/roje
- IV. Total paga + Shtesat = 39,000+ 1,231.76= 4,0,231. 76 lekë/muaj/roje
- V. Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore: 40, 231.76 lekë x 16.7% =6,718.7 lekë/muaj/roje.
- VI. (Në bazë të ligjit nr.10070 datë 05.02.2009 òPër sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16. 7 %).
- VII. Total bazë + shtesa turni II + Sigurime (16.7%)= 4,0231.76+ 6,718.7= 46,950.46 lekë
- VIII. Totali për 12 muaj dhe 3.32 roje është: 46,950.46*12*3.32=1,870,506.32 lekë

Në këtë vlerë kanë paraqitur ofertën 12 ofertuesit e mëposhtëm e cila është **403, 81 lekë më pak** se fondi limit prej **1,870,910,13 lekë**.

Ajo që konstatohet është se në ofertë mujore si AK dhe OE janë njësoj pra në vlerën 46,950.46 lekë/roje/muaj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Kur nxjerrin koston vjetore, AK operon duke nxjerrë në fillim koston ditore e cila është sipas tij $46,950.46/30,41 \text{ ditë} = 1,543.91 \text{ lekë} * 365 \text{ ditë} = \underline{1,810,910.13 \text{ lekë}}$.

Në të njëjtën mënyrë llogaritje vepron edhe OE SH.R.S.F "S.", i cili nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje pasi diferenca për të cilën ai është shpallur fitues është vetëm 10,52 lekë më pak në kosto mujore dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes saktë, të cilën e shpjegojmë në vijim:

Analiza e detajuar e kostos (1 roje / ditë)

1.Paga bazë llogaritet mbi VKM nr. 809 datë 26.12.2018 òPër përcaktimin e pagës bazë në shkallë vendi, që është 26 000 lekë në muaj

2.Shtesa 50% mbi pagën bazë = 39 000 leke/muaj/roje sipas nenit 18, shkronja g të ligjit nr 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", dhe prej këtej del në kosto ditore të një roje duke kryer veprimin: $39,000 * 12/365 = 1282,19 \text{ lekë/roje/ditë}$.

3.Shtesa mbi pagë për vështirësi për turnin e II òtë , llogaritet në bazë të nenit 81 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 òÇdo orë pune e kryer nga ora 19-00 deri në 22-00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 %:

4. $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% : 3.32 = 40.50 \text{ lekë/roje/ditë}$ shtesë për turnin e II të.

5.Paga bazë lekë /roje/ditë 1,282.19 +40.50 lekë / roje / ditë, turni i II të= $1,322,69 \text{ lekë} / \text{roje/ditë} \times 16.7 \% \text{ sig. shoqërore dhe shëndetësore} = 220,88 \text{ lekë/roje/ ditë}$.

6.Paga ditore = $1322,69 + 220.88 = 1543,57 \text{ lekë/roje/ditë}$.

7. Koston mujore e llogarit OE: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96 \text{ lekë}$, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që do të ishte:

$1543.57 * 365/12 = 46,950,25 \text{ lekë}$, pra subjekti ka kryer gabim veprimin pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rrumbullakosur numrin 12/365 ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rrumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht kjo për llogaritje sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29 \text{ lekë}$ më pak, $155,840.60 \text{ lekë/vendroje/muaj}$.

Nga tabela e Ofertuesve që kanë paraqitur ofertë ekonomike e dhënë në mënyrë të përmbledhur:

Nr.	operatori ekonomik	Vlera e ofruar
1	Sh.P.S.F "S"	46939.94
2	N	46950.46
3	M	46950.46
4	K	46950.46
5	A	46950.46
6	D	46950.46
7	M	46950.46
8	Ç	46950.46
9	S	46950.46
10	S	46950.46
11	F	46950.46
12	N	46950.46
13	T	46950.46

Pra AK (KVO), ka vepruar në mënyrë të padrejtë duke përzgjedhur fitues OE òS." si çmimi më i ulët, me formularin e njoftimit të fituesit të datës 05.11.2020, se normalisht sqaruar më sipër edhe ky OE ka pasur të njëjtën vlerë oferte por ka për llogaritur gabim numrin e ditëve mujor/vjetorë duke e shprehur në njërin rast 30,41 ditë dhe në llogaritjen tjetër 12/365 duke krijuar një kosto mujore jo reale për vetëm 10.29 lekë më pak. Gjithashtu, nisur edhe nga ankesa e kryer nga OE S., me shkresën nr. 228/prot, datë 22.10.2020, ku sqaron se bazuar në Udhëzimin e APP nr. 15, datë 26.11.2018 òPër një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 òPër përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 1, paragrafi i fundit citon se òVlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

së ofertës së dhënë për 1 (një), vendroje në muaj, nga ku AK ka bërë vlerësim për operatorët pjesëmarrës për çmimin mujor për 1 roje dhe jo vlerën e ofertës për një vendroje në muaj. Duke ecur në të njëjtën logjikë citon se oferta e “S” është jo ligjore pasi nuk ka zbatuar bazën ligjore të sipërcituar duke nxjerre një kosto mujore për një roje prej 46,939.94 lekë duke paguar më pak sigurime shoqërore në shkelje të ligjit.ö

-Në datën 22.10.2020 nga OE òS.ö është bërë ankesë pranë AK, kështu brenda të njëjtës ditë, titullari i AK, znj. S.L ka nxjerrë urdhrin nr. 66, datë 22.10.2020 dhe ka krijuar Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së OE S., dhe urdhrin nr.67, datë 22.10.2020, òPër pezullimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendim përfundimtar, i përbërë nga:

1. E.L, kryetare- me pozicion: Edukatore dhe arsim i lartë/profil merceologji e përgjithshme
2. D.N, anëtar, me pozicion: Kujdestare me arsim të lartë/ histori ófilologji.
3. L.A, anëtar, me pozicion: Kujdestare me arsim të lartë/ psikologji.

Në bazë të VKM, nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 78, pika 6, germa a, citohet se òTitullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës⁷ për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përyjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe⁸. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.”

Nga auditimi, u konstatua se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, nga ku rezultoi se edhe në kthimin e përgjigjes ndaj ankimit të kryer, (pa datë dhe nr. prot), nuk ka asnjë arsyetim për problematikën e ngritura nga OE S., por thjesht citohet mënyra e përlllogaritjes së OE òS.ö duke mos dhënë asnjë argument bindës dhe ligjor për pranimin e kësaj oferte.

Për raste të tilla, sikurse jemi shprehur në materialin kronologjik, dhe ankesave të shumta të kryera nga OE drejtuar KPP-së, si dhe Vendimit të KPP/së, nr. 286/1, datë 30.07.2020, citohet se òKur autoriteti kontraktor konstaton gabime aritmetike në llogaritjen e ofertave duhet të zbatojë procedurën e parashikuar në nenin 66, pika 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014,”

Për miratimin e prokurimit publik”, i ndryshuar, citon se:

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: - Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.”

Nisur nga sa më sipër KVO, duhet të kishte marrë në shqyrtim ofertën ekonomike të fituesit, pasi siç rezultoi ka një standard për mënyrën e llogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit për òShërbim Rojëö dhe duke parë diferencën prej 10 lekë më pak të fituesit e cila në logjikën aritmetike nuk ka kuptim, pasi koeficientet mbi të cilët kryhet llogaritja janë të njëjtë dhe paga minimale është e njëjtë për të gjithë në vlerën 39,000 lekë. Në këtë mënyrë AK dhe grupi i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të ankesave vlerëson të saktë, koston mujore për një roje/muaj të sjellë nga OE S. duke òmohuar vetenö, pra duke pranuar që fondi limit nuk është në vlerën e duhur ose ka gabime në përlllogaritje, kjo në

⁷ Shtuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 òPËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, òPËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIKÖ, TË NDRYSHUAR.

⁸ Shtuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 òPËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, òPËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIKÖ, TË NDRYSHUAR.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3, ku citohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”*

Kështu, grupi i auditimit arriti në konstatim se, OE òS.ò nuk ka sjellë ofertë me çmim më të ulët, sikurse është shprehur KVO, por ka kryer veprime aritmetikore jo me të njëjtin standard dhe konkretisht në kryerjen e rrumbullakimit pas presjes dhjetore të cilën e ricitojmë:

Veprimi aritmetik i kryer nga OE:

-Kosto mujore e llogaritur nga OE: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96$ lekë, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore ($39,000 * 12/365 = 1282,19$ lekë/roje/ditë).

- Kosto mujore e llogaritur nga grupi i auditimit, që është:

$1543.57 * 365/12 = 46,950,25$ lekë, pra subjekti ka kryer gabim veprimin pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rrumbullakosur numrin 12/365 ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rrumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht kjo përlllogaritje sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29$ lekë më pak, 155,840.60 lekë/vendroje/muaj.

Monitorimi

-Në datën 16.11.2020 është nënshkruar kontrata: òShërbimi me roje civileò me nr. 247 Prot, ndërmjet AK, Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë dhe S. shpfs me Nipt: KXx.

Kjo kontratë fillon efektet e saj nga momenti i nënshkrimit (datë 16.11.2020) deri në datë 31.12.2020.

Vlera e kontratës është: 230609.35 lekë pa tvsh ose 276,731.22 lekë me tvsh.

Nr. Urdhër Shpenzim /datë	Nr. faturë /datë	Vlera në lekë	Nr. proces verbal /datë
Nr.205 datë 14.12.2020	Nr.30 datë 30.11.2020	86,094	Nr. 8 datë 30.11.2020 P.K, S.H, K.M
Nr.218 datë 23.12.2020	Nr.44 datë 22.12.2020	190,637	Nr. 9 datë 31.12.2020 P.K,A,N,I,L
Totali		276,731	
Vlera e kontratës		276,731.22	
Pjesa e mbetur		0.22	
% e realizuar		100.00%	

-Nga auditimi u konstatua se, në datë 31.12.2020 Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë nënshkruan kontratën me nr. 278 prot me òS.ò shpsf me objekt òShërbim roje civileò në vazhdim të kontratës së I-rë sipas Urdhër Prokurimit nr.16, 189/3 datë 18.09.2020. Kjo kontratë fillon efektet e saj nga data 01.01.2021 deri në datë 16.11.2021. Vlera e kontratës është :1.967.373.42 lekë me tvsh.

-Në datë 31.03.2021 nënshkruhet amendamenti nr. 38 prot i cili ndryshon vlerën e kontratës në 2.271.122,23 lekë me tvsh, pasi ka hyrë në fuqi VKM. Nr. 1025, datë 16.02.2020 òPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, hyrë në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare me nr. 222, datë 21.12.2020. Paga minimale bazë mujore të jetë 30,000 lekë. Pra paga minimale është rritur me 4,000 lekë dhe si rrjedhim përlllogaritja e koston ditore dhe mujore për një vend roje në ditë ndryshon vlerë në rritje

Nr. Urdhër Shpenzim /datë	Nr. faturë /datë	Vlera në lekë	Proces verbal /datë
Nr.18 datë 09.02.2021	Nr. 1/2021 datë 30.01.2021	190,638	Datë 31.01.2021 P.K, K.Q,T.K

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHETPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Nr.40 datë 04.03.2021	Nr.14/2021 datë 28.02.2021	190,637	Datë 28.02.2021 P.K, A.N,T.K
Nr.58 datë 13.04.2021	Nr.7/2021 datë 02.04.2021	252,201	Datë 31.03.2021 P.K, A.N, I.L
Nr.88 datë 25.05.2021	Nr.14/2021 datë 05.05.2021	215,828	Datë 30.04.2021 Z.Z, A.N,S.H
Nr.112 datë 22.06.2021	Nr.19/2021 datë 03.06.2021	179,857	Datë 31.05.2021 Z.Z, A.N, S.H
Nr.127 datë 26.07.2021	Nr.27/2021 datë 04.07.2021	291,798	Datë 30.06.2021 A.N, Z.Z, S.H
Nr.146 datë 30.08.2021	Nr.33/2021 datë 04.08.2021	215,828	Datë 31.07.2021 P.M, A.N,S.H
Nr.177 datë 22.09.2021	Nr.39/2021 datë 03.09.2021	215,828	Datë 31.08.2021 P.M, A.N, S.H
Nr.197 datë 11.10.2021	Nr.47/2021 datë 04.10.2021	215,828	Datë 30.09.2021 A.N, I.K,S.H
Nr.226 datë 11.11.2021	Nr.54/2021 datë 08.11.2021	215,828	Datë 31.10.2021 I.K,A.N, S.H
Nr.248 datë 15.12.2021	Nr.63/2021 datë 07.12.2021	86,851	Datë 16.11.2021 S.H, I.D, P.M
Totali		2,271,122	
Vlera e kontratës		2,271,122.23	
Pjesa e mbetur		0.23	
% e realizuar		100.00%	

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës dhe pagesat që janë realizuar nga AK, u konstatua se, në asnjë nga faturat e sjella nga subjekti nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat ai ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura pranohen nga përgjegjësi i sektorit të administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 12, pika 3/dh dhe e, ku citohet se *“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; e) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.”*

-Gjithashtu, u konstatua se, proces verbalet janë mujorë dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët nuk mund të verifikojmë nëse janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve nëntor- dhjetor 2020, pasi subjekti ka dorëzuar vetëm listëpagesat janar- maj të vitit 2020.

Grupi i auditimit, vlerëson se ky dokument duhet të ishte pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbim për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet si dhe në kundërshtim me nenin 77 mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku citohet se *“3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali.”*

4. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.”

Në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:

1-Në lidhje me përzgjedhjen e kësaj procedure të Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muajë. KLSH, konstaton se,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

nga SHSSH dhe AK është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 ðPër prokurimin publikë i ndryshuar, me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, dhe me VKM nr. 177, datë 04.04.2019, ðPër krijimin e shoqërisë ðl.Gö, pasi SHSSH dhe AK i referohen njoftimit të datës 31.03.2020 të Shoqërisë ðl.Gö, e cila në atë kohë, për shkak të vështirësive teknike, e kishte të pamundur ofrimin e shërbimit për SHFSH Zyber Hallulli, TR me shërbim roje civile. **Pra në këtë rast nuk jemi në kushte të emergjencës, që procedura të realizohej nga AK SHF Zyber Hallulli, Tiranë, pasi jemi në muajin shtator 2020.**

-Në dosjen e audituar nuk rezultoi asnjë korrespondencë zyrtare me Shoqërinë ðl.Gö në muajin shtator 2020, e cila të shprehej mbi pamundësinë e saj për zbatimin e detyrimit ligjor për shërbimin e rojeve civile në mbështetje të VKM nr. 177, datë 04.04.2019, ðPër krijimin e shoqërisë ðl.Gö.

Kësaj shtate i shtohen risqe edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura nga SHSSH dhe SHF Zyber Hallulli-Tiranë, i cili nga auditimi më specifikisht për shërbim roje civile, rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mosnjohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike. ***Për këtë mban përgjegjësi Titullari i Institucionit dhe njësia e Prokurimit me anëtarë: E.K, M.I(me pozicion psikologe në SHF) dhe E.D (përgj /sektorit social në SHF).***

2-Nga auditimi i përcaktimit të punonjësve pjesëmarrës në strukturat prokuruese, se përcaktimi i znj. A.H, si anëtare (Kryetare) e Njesisë se Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të nenit 56 të, të LPP, 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku citohet se: “Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”. Kjo pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST, Veprim që ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK zj. S.L.

3- Nga dosja e administruar nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar.

4-Nga auditimi i përcaktimit të kriterëve, në Seksionin 2. (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit)nga njësia e prokurimit, u konstatua se në lidhje me 2.2/Kapacitetet teknike, pika 4, është kërkuar nga OE që ð4. Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Mars 2020 shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara në formë elektronike (Rekomandim i APP-së nr.8197 prot., datë 03.09.2019, fq.5) për jo me pak se 10 punonjës të siguruar.

Grupi i auditimit, vlerëson se në vendosjen e këtij kriteri është konceptuar jo në shërbim të plotësisht të kontratës dhe dhënies së garancisë nga OE për një zbatim sa më korrekt të saj, pasi procedura e tenderimit është kryer në shtator 2020, njoftimi i fituesit është shpallur në tetor 2020 dhe listëpagesat për subjektin janë kërkuar për muajt janar-mars 2020, ku nuk japin garanci për numrin e punonjësve të siguruar në vazhdimësi si dhe për emrat e të siguarve, pasi subjekti mund të kryejë lëvizje të vazhdueshme të fuqisë punëtore dhe në rastin konkret nisur nga lloji i aktivitetit ðShërbim ruajtjeë punonjësit duhet të kenë një Certifikatë tip për punonjësit e shërbimit për ushtrimin e profesionit konform Ligjit Nr.75/2014" Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizikeë të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës, veprime në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 ðPër Prokurimin Publikë, të ndryshuar, pika 1, 2, si dhe me VKM nr.914 neni 28 pika 2.

Sa më sipër, ky kriter hartuar gabim ka sjellë risqe në mos zbatimin korrekt të kontratës dhe hapësira për abuzim nga OE, pasi u konstatua nga monitorimi i zbatimit të kontratës dhe në proces verbalët mujorë të mbajtur ndërmjet OE fitues dhe AK si dhe grafikut bashkëlidhur, se punonjësit e cituar nuk figuronin në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

sjella nga vetë tatimpaguesi për muajt janar-shkurt-mars/2020, dhe AK, nuk kishte dijeni nëse këta punonjës që kryenin shërbimin e ruajtjes ishin të siguruar dhe deklaruar në vijimësi.

-Gjithashtu njësia e prokurimit vendos një kriter pa bazë dhe të pa argumentuar ku përcakton se *“Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.”*

Ndërkohë OE fitues, mund të ketë edhe më shumë se 10 punonjës dhe kjo nuk i jep garanci AK se ky numër është i mjaftueshëm pasi shoqëritë e ruajtjes kryejnë shërbimin e ruajtjes në disa objekte njëkohësisht dhe konkretisht, OE fitues òS.ò me shkresën e sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me nr.1824/49. Prot, datë 23.07.2020, konfirmon se deri në korrik 2020 se: **Numri i punonjësve në dispozicion sipas kontratave të lidhura për këto objekte është 29.** Në bazë të auditimit, sipas vërtetimit tip mbi numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar ógusht 2020, numri mesatar i punonjësve të siguruar është **28.** Subjekti rezulton të mos ketë mjaftueshëm numër fuqie punëtoresh për të kryer zbatimin e kontratave të lidhura me subjekte të ndryshëm. Sipas përlllogaritjeve të mësipërme subjekti duhet të ketë *jo më pak se 29+ 3.32 (3,32 punonjës të detyrueshëm për shtëpinë e fëmijëve Tr) =33 punonjës gjithsej.* Kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit është i pa studiuar dhe nuk garanton në asnjë moment zbatimin korrekt të kontratës nga OE, veprime në kundërshtim me nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar neni 28/ Kontratat e shërbimit, pika 2, si dhe nenin 46 të LPP.

Pra KVO ka shpallur fitues operatorin ekonomik, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, dukemos ikushtuar vëmendje plotësisht apo jo të kriterëve duke u bazuar në DST standarde pa kryer argumentimin përkatës për të dhënë siguri në lidhjen dhe zbatimin e kontratës së lidhur me këtë OE.

5-Grupi i punës për hartimin e fondit limit i ngritur në bazë të Urdhër me shkresë nr189/1 datë 18.09.2020, me përbërë nga (A.H, S.H dhe F.A), i është referuar bazës ligjore, ligjit 75/2014ò Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizikeò, ligjit nr. 74/2014 òPër armëtò, Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.157, datë 01.04.2016 òPër shërbimin privat të sigurisë fizikeò, VKM nr. 809, datë 26.12.2018 òPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendiò dhe VKM nr.77, datë 28.01.2015 òPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësorò. Nisur nga koeficientët bazë të përlllogaritjes vlera është si më poshtë:

Përlllogaritja sipas bazës ligjore të mësipërme ka nxjerrë një kosto mujore prej 46,950.46 lekë për 30.41 ditë, dhe në rrjedhim për 365 ditë dhe për 3.32 roje, vlera totale rezulton 1,870,910.13 lekë (fond limit).

Në lidhje me paraqitjen e ofertave nga OE, bazuar edhe në dosjen elektronike u konstatuan se nga 13 OE, 12 prej tyre kanë dalë në të njëjtin përfundim për koston mujore të një roje dhe konkretisht në vijim:

- I. Total bazë + shtesa turni II + Sigurime (16.7%)= 4,0231.76+ 6,718.7= 46,950.46 lekë
- II. Totali për 12 muaj dhe 3.32 roje është:
- III. 46,950.46*12*3.32=1,870,506.32 lekë

Ajo që konstatohet është se në ofertë mujore si AK dhe OE janë njësoj pra në vlerën 46,950.46 lekë/roje/muaj.

Kur nxjerrin koston vjetore, AK operon duke nxjerrë në fillim koston ditore e cila është sipas tij $46,950.46/30,41 \text{ ditë}=1,543.91 \text{ lekë} * 365 \text{ ditë} = \underline{1,810.910,13 \text{ lekë}}$.

Në të njëjtin mënyrë llogaritje vepron edhe OE SH.R.S. F "S.", por nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje dhe sjell një ofertë me një diferencë prej 11.06 lekë më pak në kosto mujore për të cilën ai është shpallur dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes saktë, të cilën e shpjegojmë në vijim:

Veprimi aritmetik i kryer nga OE:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

-Kosto mujore e llogaritur nga OE: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96$ lekë, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore ($39,000 * 12/365 = 1282,19$ lekë/roje/ditë).

- **Kosto mujore e llogaritur nga grupi i auditimit, që është:**

$1543.57 * 365/12 = 46,950,25$ lekë, pra subjekti ka kryer gabim veprimin pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rrumbullakosur numrin 12/365 ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rrumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht kjo përlllogaritje sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29$ lekë më pak, **155,840.60 lekë/vendroje/muaj.**

Grupi i auditimit të KLSH-së vlerëson se AK (KVO), ka vepruar në mënyrë të padrejtë duke përzgjedhur fitues OE òS.ò si çmimi më i ulët, me formularin e njoftimit të fituesit të datës 05.11.2020, se normalisht sqaruar më sipër edhe ky OE ka pasur të njëjtën vlerë oferte por ka përlllogaritur gabim numrin e ditëve mujor/vjetorë duke e shprehur në njërin rast 30,41 ditë dhe në llogaritjen tjetër 12/365 duke krijuar një kosto mujore jo reale për vetëm 10.29 lekë më pak.

Gjithashtu, nisur edhe nga ankesa e kryer nga OE S., me shkresën nr. 228/prot, datë 22.10.2020, ku sqaron se bazuar në Udhëzimin e APP nr. 15, datë 26.11.2018 Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 òPër përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 1, paragrafi i fundit citon se òVlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë për 1 (një), vendroje në muaj, nga ku AK ka bërë vlerësim për operatorët pjesëmarrës për çmimin mujor për 1 roje dhe jo vlerën e ofertës për një vendroje në muaj. Duke ecur në të njëjtën logjikë citon se oferta e S. është jo ligjore pasi nuk ka zbatuar bazën ligjore të sipërcituar duke nxjerre një kosto mujore për një roje prej 46,939.94 lekë duke paguar më pak sigurime shoqërore në shkelje të ligjit.ò

Brenda të njëjtës ditë, titullari i AK, znj. S.L ka nxjerrë urdhrin nr. 66, datë 22.10.2020 dhe ka krijuar Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së OE S., dhe urdhrin nr.67, datë 22.10.2020, òPër pezullimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendim përfundimtar, ku u konstatua se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me VKM, nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 78, pika 6, germa a, dhe në kthimin e përgjigjes ndaj ankimit të kryer, (pa datë dhe nr. prot), nuk ka asnjë arsyetim për problematikat e ngritura nga OE S., por thjesht citohet mënyra e përlllogaritjes së OE òS.ò duke mos dhënë asnjë argument bindës dhe ligjor për pranimin e kësaj oferte. Për raste të tilla, sikurse jemi shprehur në materialin kronologjik, dhe ankesave të shumta të kryera nga OE drejtuar KPP-së, si dhe Vendimit të KPP/së, nr. 286/1, datë 30.07.2020, citohet se òKur autoriteti kontraktor konstaton gabime aritmetike në llogaritjen e ofertave duhet të zbatojë procedurën e parashikuar në nenin 66, pika 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër KVO, duhet të kishte marrë në shqyrtim ofertën ekonomike të fituesit, pasi siç rezulton ka një standard për mënyrën e llogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit për òShërbim Rojeò dhe duke parë diferencën prej 10 lekë më pak të fituesit e cila në logjikën aritmetike nuk ka kuptim, pasi koeficientët mbi të cilët kryhet llogaritja janë të njëjtë dhe paga minimale është e njëjtë për të gjithë në vlerën 39,000 lekë. Në këtë mënyrë AK dhe grupi i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të ankesave vlerëson të saktë, koston mujore për një roje/muaj të sjellë nga OE S. duke òmohuar vetenò, pra duke pranuar që fondi limit nuk është në vlerën e duhur ose ka gabime në përlllogaritje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3,

Kështu, grupi i auditimit arriti në konstatim se, OE òS.ò nuk ka sjellë ofertë me çmim më të ulët, sikurse është shprehur KVO, por ka kryer veprime aritmetikore jo me të njëjtin standard dhe konkretisht në kryerjen e rrumbullakimit pas presjes dhjetore të cilën e recitojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, me AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1/ pika 2/d, Objekti dhe qëllimi, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar, ku citohet se:

Qëllimi i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; duke mos dhënë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që fondi prej 2,271,122 + 276,731.21= 2,547,853.21 lekë është përdorur pa ekonomikitet, efikasitet dhe ekonomikitet nga Shtëpia e Fëmijëve Zyber Hallulli, Tiranë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me sa më sipër, SHFSH nuk ka sjellë observacion në lidhje me Projekt Raportin. Për rrjedhim qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së, mbetet i pandryshueshëm.

Titulli i gjetjes:	Hartimi i DST për 3 procedura prokurimi -Shërbim Roje Civile, për vitin 2020.
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin dhe Dokumentet Standarde të Tenderit, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në lidhje me procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. nr.5, nr. 61.prot, datë 09.04.2020, u konstatua se të gjithë urdhrat e miratuara nga titullari i AK, kanë një numër të ndryshëm protokoll, specifikisht, urdhri për ngritjen e KVO, Grupit për llogaritjen e fondit limit, si dhe urdhri i prokurimit, nuk mban të njëjtin numër protokoll në seri, në kundërshtim me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.- Në lidhje me procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. nr.5, nr. 61.prot, datë 09.04.2020 dhe procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, sipas Urdhër Prokurimi nr.17, datë 30.09.2020 me fond limit prej 306.666,4 lekë pa TVSH u konstatua se, nga anëtarët e NjP dhe KVO, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. <p>Referuar DST shtojcës 1 (Formulari i ftesës për pjesëmarrje), njësia e prokurimit i ka dërguar ftesë për ofertë 3 operatorëve ekonomik, konkretisht, N. me Nipt JXX; D. shpk me Nipt KXX dhe S. Shpk me Nipt KXX dhe nuk rezulton të ketë justifikuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të cilëve u është dërguar ftesa, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 -Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar neni 35, pika 4, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 -Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 6 paragrafi 2, ku parashikohet që ÷Argumentimet për përzgjedhjen e operatorëve të ftuar duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim.”</p> <ul style="list-style-type: none">- Në procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, sipas Urdhër Prokurimi nr.17, datë 30.09.2020 me fond limit prej 306.666,4 lekë pa TVSH, si dhe në procedurën ÷Shërbim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, me urdhrin nr. 209/1, datë 30.09.2020 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës me përbërje znj. A.H, znj. S.H dhe znj. F.A.</p> <p>Me urdhrin nr. 209/2, datë 30.09.2020 Titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e KVO, me përbërje znj. A.H, znj. K.L, dhe znj. F.A.</p> <p>Përcaktimi i znj. A.H e F.A, si anëtare e Njësisë së Llogaritjes së Fondit Limit dhe njëkohësisht si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në shkelje të përcaktimeve të neni 56 “Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.</p> <p>Kjo pasi njësia e llogaritjes së fondit limit është pjesë e strukturës përgjegjëse për hartimin e DST.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 68, neni 35, pika 4, normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.</p> <p>Pika 6 e Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ÷Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në punë e kryer nga NJP dhe titullari i AK në procedurat e prokurimit.
Shkaku:	Mos argumentimi i duhur nga strukturat përgjegjëse
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Titullari i AK, Njësia e prokurimit në SHFSH, në bashkëpunim me SHSSH të marrin masat e duhura, për përzgjedhjen e anëtarëve të ndryshëm në KVO me grupin e ngritur për përllogaritjen e fondit limit.</p> <p>NJP në SHFSH të marrë masa për kryerjen e procedurave në përputhje me dispozitat ligjore me qëllim argumentimin dhe dokumentimin në përzgjedhjen e operatorëve të ftuar dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.</p>

Titulli i gjetjes:	<p>Përllogaritje e fondit limit në mospërputhshmëri me Ligjin 75/2014” Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, VKM nr. 809, dt. 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor për 2 procedura prokurimi ‘Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, për vitin 2020 dhe vlerësim i gabuar i KVO-së.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit, të procedurës me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr.5, 61/prot, datë 09.04.2020, rezultoi se: grupi për hartimin e fondit limit nuk ka kryer saktë llogaritjen e tij në një vlerë prej 951,91 lekë më pak, fakt ky që nuk është konstatuar nga KVO e ngritur sipas Urdhrit nr. 24, prot. Nr.60, datë 09.04.2020, me përbërje:</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

B.Gj (Kryetar), K.L e Xh.F. Grupi i punës ka përllogaritur vlerën e fondit limit 310,825.6 lekë ndërkohë që kjo vlerë duhet të ishte 311,777.51 lekë, fakt ky që shoqërohet edhe me një ofertë ekonomike e paraqitur më e vogël nga OE N. e cila ka ardhur po si pasojë e përllogaritjes gabim të kostos ditore/roje dhe konkretisht në llogaritjen e shtesës së vështirësisë së pagës për roje për turnin e II, të cilën nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por e ka pjesëtuar me një koeficient më të lartë me 4,98 roje, ose me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të kostos së vështirësisë duke e ulur atë, duke e paraqitur në këtë formë

1. **OE** $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II të.

Grupi i auditimit:

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 3.32 = 40,5$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II të.

2. **OE** Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+27 lekë / roje / ditë, turni i II të= $1,305.68$ lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Grupi i auditimit:

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+40,5 lekë / roje / ditë, turni i II të= $1,319.18$ lekë/ roje/ditë x 16.7 % sig. shoqërore dhe shëndetësore = 220,30 lekë/roje/ ditë.

3. **OE** Paga ditore = $1,305.68 + 218,04 = 1523.72$ lekë/roje/ditë, *3,32= 5,058.75 lekë për një vendroje/ditë.

Grupi i auditimit:

Paga ditore = $1,319.18 + 220,30 = 1539,48$ lekë/roje/ditë, *3,32= 5,111.07/lekë për një vendroje/ditë.

4. **OE/Kosto** 61 ditë $5,058.75 \times 61 = 308,583.77 + 20\%$ tvsh= 370,300.50 lekë.

Grupi i auditimit:

$5,111.07 \times 61 = 311,775.49 + 20\%$ *311,775.49 = 311,775.49 + 62,355.09= **374,130.58 lekë** pra 3830,08 lekë më pak llogaritur nga OE.

Kjo nuk është eficient sepse jo çdo vlerë më e ulët do të thotë menaxhim me eficientë, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit sepse subjekti paguan më pak sigurime shoqërore e shëndetësore në muaj, në kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë si dhe në shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 për procedurat Tatimore në RSHö, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.

Ky gabim nuk është konstatuar në vijimësi nga KVO pasi në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 58, duke kualifikuar në mënyrë të padrejtë një ofertë të llogaritur gabim me kosto në pagesa të gabuara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo individ të deklaruar në listë pagese.

Kriteri:

Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 për prokurimin Publikë i ndryshuar, neni 55, pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar;
Ligjin 75/2014 për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, VKM



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	nr. 809, dt. 26.12.2018 òPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendiò, VKM nr.77, datë 28.01.2015 òPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësorò, Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 òPër procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.
Ndikimi/Efekti:	Shmangie të detyrimeve fiskale në dëm të kontributeve të individëve që kryejnë shërbimin, duke sjellë risk në ofrimin e ruajtjes së objektit dhe fëmijëve.
Shkaku:	Përlllogaritje gabim të fondit limit në kundërshtim me bazën ligjore nga grupi i punës i SHFSH dhe nga OE si dhe vlerësim jo i saktë i KVO, në mospërputhshmëri me dispozitat ligjore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të ngrihet një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësisë, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përlllogaritjen e fondit limit për shërbim roje civile , me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Titulli i gjetjes:	Hartimi i DST për procedurën e prokurimit ‘Shërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve “Zyber Hallulli”, sipas Urdhër Prokurimit nr.16, 189/3 datë 18.09.2020
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, në procedurën e prokurimit -Shërbim me roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve òZyber Hallulliò, sipas Urdhër Prokurimit nr.16, 189/3 datë 18.09.2020, u konstatua se:</p> <p>- Nga auditimi i përcaktimit të kriterëve, në Seksionin 2. (KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT)nga njësia e prokurimit, u konstatua se:</p> <p>2.2/Kapacitetet teknike, pika 4, është kërkuar nga OE që ò4. <i>Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Mars 2020 shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara në formë elektronike (Rekomandim i APP-së nr.8197 prot., datë 03.09.2019, fq.5) për jo me pak se 10 punonjës të siguruar. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.</i></p> <p>Grupi i auditimit, vlerëson se vendosja e këtij kriteri nuk jep garanci nga OE për një zbatim sa më korrekt të kontratës, pasi procedura e tenderimit është kryer në shtator 2020, njoftimi i fituesit është shpallur në tetor 2020 dhe listëpagesat për subjektin janë kërkuar për muajt janar-mars 2020, ku nuk japin asnjë siguri dhe vërtetësi për numrin e punonjësve të siguruar në vazhdimësi si dhe për emrat e të siguarve, pasi subjekti mund të kryejë lëvizje të vazhdueshme të fuqisë punëtore dhe në rastin konkret nisur nga lloji i aktivitetit òShërbim ruajtjeò punonjësit duhet të kenë një Certifikatë tip për punonjësit e shërbimit për ushtrimin e profesionit konform Ligjit Nr.75/2014" Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizikeò të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës, veprime në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar, pika 1, 2, ku përcakton shprehimisht se òSpecifikimet teknike, që përcaktojnë</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p><i>karakteristikat e shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si dhe me VKM nr.914 neni 28 pika 2.</i></p> <p><u>Sa më sipër</u>, ky kriter hartuar jo në përputhshmëri ligjore ka sjellë risqe në mos zbatimin korrekt të kontratës dhe hapësira për abuzim nga OE, pasi nga monitorimi i zbatimit të kontratës dhe në proces verbalet mujorë të mbajtur ndërmjet OE fitues dhe AK si dhe grafikut bashkëlidhur, rezultoi se punonjësit e cituar nuk figuronin në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të sjella nga vetë tatimpaguesi për muajt janar-shkurt-mars/2020, dhe AK nuk kishte dijeni nëse këta punonjës që kryenin shërbimin e ruajtjes ishin të siguruar dhe deklaruar në vijimësi.</p> <p>-Gjithashtu njësia e prokurimit vendos një kriter pa bazë dhe të pa argumentuar ku përcakton se <i>“Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.”</i> Ndërkohë OE fitues, mund të ketë edhe më shumë se 10 punonjës dhe kjo nuk i jep garanci AK se ky numër është i mjaftueshëm pasi shoqëritë e ruajtjes kryejnë shërbimin e ruajtjes në disa objekte njëkohësisht dhe konkretisht, OE fitues <i>“S.ö me shkresën e sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me nr.1824/49. Prot, datë 23.07.2020, konfirmon se deri në korrik 2020, ka në ruajtje:</i></p> <ul style="list-style-type: none">✓ Objekte shtetërore-3✓ Objekte private- 3✓ Objekte në ruajtje private me verifikim sinjali-3. <p>Numri i punonjësve në dispozicion sipas kontratave të lidhura për këto objekte është 29.</p> <p>Ndërkohë në bazë të auditimit, sipas vërtetimit tip mbi numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar ógusht 2020, numri mesatar i punonjësve të siguruar është 28. Pra subjekti rezulton të mos ketë mjaftueshëm numër fuqie punëtore për të kryer zbatimin e kontratave të lidhura me subjekte të ndryshëm. Sipas përlllogaritjeve të mësipërme subjekti duhet te ketë <i>jo më pak se 29+ 3.32 (3,32 punonjës të detyrueshëm për shtëpinë e fëmijëve Tr) =33 punonjës gjithsej.</i></p> <p>Pra kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit është i pa studiuar dhe nuk garanton në asnjë moment zbatimin korrekt të kontratës nga OE, veprime në kundërshtim me nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, <i>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar neni 28/ Kontratat e shërbimit, pika 2, si dhe nenin 46 të LPP .</i></p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 <i>“Për prokurimin publikë, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar.</i>
Ndikimi/Efekti:	Kërkesa për kualifikim jo në përputhje me LPP
Shkaku:	Mos argumentimi i duhur nga strukturat përgjegjëse
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit në SHFSH të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim argumentimin e kriterëve në DST, të cilat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ö
--	--

Titulli i gjetjes:	Raporti Përmbledhës
Situata:	Në 6 raste, Titullari i AK, ka miratuar procedurat e prokurimit pa paraqitjen dhe përpilimin Raportit Përmbledhës nga KVO drejtuar Titullarit të AK, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar.
Kriteri:	neni 68 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Procedura me mangësi dhe me pasojë përdorim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Titullari i AK të marrë masa që në të ardhmen të mos miratojë procedura prokurimi pa praninë e Raportit Përmbledhës nga anëtarët e KVO, si dhe në çdo rast të sigurohet që ky dokument të përmbajë të gjithë elementët e duhur ligjorë.

Titulli i gjetjes:	Përlllogaritje e fondit limit në mospërputhshmëri me Ligjin 75/2014ö Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizikeö,VKM nr. 809, dt. 26.12.2018 öPër përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendiö, VKM nr.77, datë 28.01.2015 öPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor për procedura prokurimi öShërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranëö, sipas Urdhrit të Prokurimi nr. 189/3 datë 18.09.2020, me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH dhe vlerësim i padrejtë nga KVO.
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit të llojit öMarrëveshje kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me një afat 12 muajö, öShërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranëö, sipas Urdhrit të Prokurimi nr. 189/3 datë 18.09.2020, me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, grupi i punës i ngritur për përlllogaritjen e fondi limit ka përcaktuar vlerën prej 1,870,910.13 lekë pa TVSH dhe një vlerë prej 46,950.46 lekë/roje/muaj. Në këtë procedurë kanë paraqitur ofertë 13 ofertues ku 12 prej tyre kanë dhënë të njëjtën ofertë mujore prej një vëndroje në muaj në vlerën 46,950.46 lekë/roje/muaj dhe vetëm OE S. ka dhënë vlerën prej 46,939.94 lekë/roje/muaj ose 10,52 lekë më pak dhe si rrjedhim është shpallur fitues për vlerën më të ulët. Por KVO nuk ka vlerësuar saktë këtë ofertë pasi në të njëjtën mënyrë llogaritje vepron edhe OE SH.R.S. F "S.", por ai nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje pasi diferenca për të cilën ai është shpallur fitues është vetëm 10,52 lekë më pak në kosto mujore dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes me të njëjtin standard matematikor, dhe konkretisht: OE, Koston mujore e llogarit: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96 \text{ lekë}$, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që do të ishte:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHETËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

$1543.57 \cdot 365 / 12 = 46,950,25$ lekë, pra subjekti ka kryer gabim veprimin me dashje pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rrumbullakosur numrin 12/365 ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rrumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht ky rrumbullakim i numrit sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29$ lekë më pak, për vendroje/muaj duke e shpallur fitues.

Pra AK (KVO), ka vepruar në mospërputhshmëri ligjore duke përzgjedhur fitues OE S. si çmimi më i ulët, me formularin e njoftimit të fituesit të datës 05.11.2020, se normalisht sqaruar më sipër edhe ky OE ka pasur të njëjtën vlerë oferte por ka përlllogaritur gabim numrin e ditëve mujor/vjetorë duke e shprehur në njërin rast 30,41 ditë dhe në llogaritjen tjetër 12/365 duke krijuar një kosto mujore jo reale për vetëm 10.29 lekë më pak.

Gjithashtu, nisur edhe nga Udhëzimi i APP nr. 15, datë 26.11.2018 Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 1, paragrafi i fundit citon se vlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë për 1 (një), vendroje në muaj, nga ku AK ka bërë vlerësim për operatorët pjesëmarrës për çmimin mujor për 1 roje dhe jo vlerën e ofertës për një vendroje në muaj. Duke ecur në të njëjtën logjikë citon se oferta e S. është jo ligjore pasi nuk ka zbatuar bazën ligjore të sipërcituar duke nxjerre një kosto mujore për një roje prej 46,939.94 lekë duke paguar më pak sigurime shoqërore në shkelje të ligjit. **Nisur nga sa më sipër KVO**, duhet të kishte marrë në shqyrtim ofertën ekonomike të fituesit, pasi siç rezulton ka një standard për mënyrën e llogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit për Shërbim Roje dhe duke parë diferencën prej afër 10 lekë më pak të fituesit e cila në logjikën aritmetike nuk ka kuptim, pasi koeficientët mbi të cilët kryhet llogaritja janë të njëjtë dhe paga minimale është e njëjtë për të gjithë në vlerën 39,000 lekë. Në këtë mënyrë AK, grupi i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të ankesave vlerëson të saktë, koston mujore për një roje/muaj të sjellë nga OE S. duke omohuar vetenë, pra duke pranuar që fondi limit nuk është në vlerën e duhur ose ka gabime në përlllogaritje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3.

Kualifikimi i OE S. fitues është bërë në kundërshtim Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 55, pika 3. Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që fondi prej **2,547,853 lekë** është përdorur pa ekonomicitet, efikasitet dhe ekonomicitet nga Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë.

Kriteri:

Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 55, pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar;
Ligjin 75/2014 Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, VKM nr. 809, dt. 26.12.2018 Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, VKM nr.77, datë 28.01.2015 Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 Për procedurat Tatimore në RSH, i ndryshuar, neni 71/2, pika /d.

Ndikimi/Efekti:

Shmangie të detyrimeve fiskale në dëm të kontributeve të individëve që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	kryejnë shërbimin, duke sjellë risk në ofrimin e ruajtjes së objektit dhe fëmijëve.
Shkaku:	Përllogaritje gabim të fondit limit në kundërshtim me bazën ligjore nga grupi i punës i SHFSH dhe nga OE si dhe vlerësim jo i saktë i KVO, në mospërputhshmëri me dispozitat ligjore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa në ngritjen e një grupi pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme dhe të pakushtëzuara, për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Titulli gjetjes:	i In efikasitet në zbatimin e kontratave të lidhura për 3 procedurat e prokurimit për 3 procedura prokurimi të shërbimit roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, për periudhën 2020.
Situata:	<p>Nga auditimi i tre procedurave të shërbimit roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, për periudhën 2020, përkatësisht</p> <p>1-me fond limit në vlerën 310,825.6 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata me nr. 65, datë 23.04.2020, ndërmjet SHFSH me ÕN.õ, me Nipt JXX.</p> <p>2-me fond limit 306,666,4 lekë pa TVSH është lidhur kontrata ndërmjet ÕN.õ me nipt JXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 217, datë 09.10.2020.</p> <p>3- me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata ndërmjet S. shpsf me Nipt: KXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 247, datë 16.11.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatua se:</p> <p>1-Në asnjë nga faturat e sjella nga OE fitues nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat subjekti, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura janë pranuar nga përgjegjësi i sektorit të administratës, znj. A.H, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, nenin 12, pika 3/dh dhe e.</p> <p>2- U konstatua se, proces verbalët janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve përkatës sipas procedurave për vitin 2020, <u>pasi subjekti fitues ka dorëzuar vetëm listëpagesat janar-mars 2020.</u></p> <p>Grupi i auditimit, vlerëson se, ky dokument administrativ, duhet të ishte pjesë e proces verbalëve për çdo muaj shërbimi për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet, veprime këto në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku citohet se Õ3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në</p>

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

	<i>kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit. Në rast se kontraktori nuk është i pranishëm, autoriteti kontraktor ia komunikon me shkrim përmbajtjen e këtij procesverbali. 3- Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.</i>
Kriteri:	Sa më sipër në kundërshtim me kontratat e shërbimit me nr. 65, datë 23.04.2020.ndërmjet SHFSH me òN.ò, me Nipt JXX; kontrata ndërmjet òN.ò me nipt JXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr.,prot 217, datë 09.10.2020. dhe kontrata lidhur ndërmjet S. shpsf me Nipt: KXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 247, datë 16.11.2020.
Ndikimi:	Cenim i sigurisë së ruajtjes së fëmijëve dhe objektit Shtëpia e Fëmijëve shkollorë Tiranë dhe përdorim pa eficence, ekonomikitet dhe efektivitet i fondeve të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mos zbatim i bazës ligjore nga strukturat përkatëse
Rëndësia:	<i>E lartë</i>
Rekomandimi	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt òShërbim roje civileò, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

a) Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Grupi i audituesve të KLSH-se, për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021, për të realizuar objektin e auditimit, u fokusua në **procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes** së kontratave të lidhura nga AK **për blerje ushqimesh**, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër prokurimin publikò; Ligji nr. 162/2020 òPër prokurimin publikò; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021, si dhe çdo akti ligjor ne fuqi lidhur me procedurën e prokurimit me fonde buxhetore.

Për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021, AK ka lidhur kontrata për blerje ushqimesh, si më poshtë vijon:

Kontratat e lidhura nga AK për 2019-2021 për blerje ushqimesh

Furnitor	Kontrata	Fondi prokuruar (me TVSH)	Totali Faturës (Me Tvsh)	Realizimi
S	nr.2, datë 03.01.2019	901,440	901,440	100.00%
S	nr.119/9, datë 24.04.2019	1,278,426	1,145,380	89.59%
E. Shpk	nr.178, dt. 10.06.2019	4,130,052	4,130,045	100.00%
	Total 2019	6,309,918	6,176,865	97.89%
E. Shpk	nr.338, dt. 31.12.2019	3,302,131	3,302,130	100.00%
E.	nr.153/5, datë 27.08.2020	950,880	950,769	99.99%
	Total 2020	4,253,011	4,252,899	100.00%
E.	nr.281/3, dt. 18.01.2021	1,950,104	1,840,685	94.39%

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

M.	nr.113, datë 21.06.2021	830,640	830,591	99.99%
	Total 2021	2,780,744	2,671,276	96.06%

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Nga auditimi procedurave për zbatimin e kontratave të lidhura nga AK dhe dokumentacionit të dosjes se prokurimit rezultoi si më poshtë vijon:

Viti 2019

➤ **Autoriteti Kontraktor** është Fëmijëve Shkollor Tiraneë dhe **Kontraktuesi S** dhe AB G.shpk në baze të procedurave të prokurimit për blerje ushqimesh, ka lidhur **Kontratë Furnizimi Nr.2 prot, datë 03.01.2019**. Hartimi kontratës është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, VKM nr.924, datë 29.1.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, si dhe në referencë të shkresës nr. 489/13 prot, datë 03.07.2019 *“Autorizim për lidhje kontrate”* të zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror. Furnizimi i institucionit me Ushqime do bëhet sipas listës së ushqimeve të prokuruar bashkëlidhur kësaj kontrate dhe cilësisë sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jetë **751.200 leke (pa TVSH) ose 901,440 leke (me TVSH)**.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit të saj, dhe përfundon në datën e marrjes në dorëzim të gjithë mallit. Grafiku i lëvrimit të mallit do të jetë: -Për ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; -Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë, etj. sipas kërkesave të autoritetit kontrakt. Malli do të merret në dorëzim, kundrejt faturës tatimore origjinale, me proces verbal marrje në dorëzim i mbajtur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat me **4 fatura tatimore**, të cilat janë likuiduar nga AK në muajin pasardhës, nëpërmjet Degës së Thesarit, sipas dokument kontabël Urdhër-Shpenzimeve, duke paguar në total shumën **901,440 leke ose 100%** e vlerës së prokuruar sipas Kontratës nr. 2, datë 03.01.2019. Transaksionet për pagesat e kryera janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Urdhër 0shpenzim për kontratën nr. 2, datë 03.01.2019

Urdhër Shpenzim	Fatura Total	Totali Faturës (Me TVSH)	Flete-hyrje magazine
nr.21, dt. 22.02.2019	nr.91, dt. 31.01.2019	316,691	nr.2, dt. 31.01.2019
nr.31, dt. 18.03.2019	nr.453, dt. 28.02.2019	308,831	nr.3, dt. 28.02.2019
nr.44, dt. 04.04.2019	nr.456, dt. 29.03.2019	189,284	nr.4, dt. 29.03.2019
nr.52, dt. 18.04.2019	nr.466, dt. 16.04.2019	86,634	nr.7, dt. 16.04.2019
Paguar (100%)		901,440	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, rezulton se NA me **Urdhër nr. 6, datë 03.01.2019** të NA, ka ngritur Komisionin e Pranimit të Mallit, përberë nga K.L (kryetare) me detyrë funksionale ish-mjeke institucionit; E.S (anëtar) me detyrë funksionale punonjës mirëmbajtje dhe kuzhinieri turnit (anëtar). Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punës me përgjegjësi materiale.

Në Proces Verbal/et, nuk ka pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (*shtojca 9*) **lidhur me:**

-Produktet koloniale (sheqer, oriz, etj...) për treguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

jetë jo me pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nëse furnizimi është në përputhje me standardin shtetëror të përcaktuar në DST.

- Pranimin e perimeve dhe zarzavateve (*patate, qepe, domate, etj.*), pranimin e frutave (*mollë, portokalle, mandarina, dardha, pjeshkë dhe kajsi*) nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësore sipas standardit shtetëror të miratuar.

- Pranimin e **bulmetrave** (*qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët*) për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit.

- Për furnizimin me **veze** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

- Për furnizimin me **buke gruri** nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 oPër materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Për furnizimin me **mish viçi** nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinarë me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, rezulton se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të **nuk është** respektuar pranimi mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 oRregullat e Prokurimit Publiko, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni 4.

Kontrata e furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019

Neni 4: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3:

Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 oRregullat e Prokurimit Publiko, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

Lidhur me zbatimin e kontratës, grupi i auditimit përzgjodhi për auditim verifikimin e sasisë dhe çmimit të prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij, sipas kritereve të përcaktuara në prokurim.

Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar. Ndërsa lidhur me sasinë e furnizuar për mish dhe nënprodukte të tij, sasia e prokuruar (sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur) është 570 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 891 kg ose **më shumë për 321 kg** kundrejt sasisë së prokuruar, në kundërshtim me Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni 2.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit òMish dhe nënprodukte të tij, krahasuar me sasinë e prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës, pasi këto diferenca në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar të cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero.⁹ Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevojat për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e NZ si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e furnizimit nr. 2 prot, datë 03.01.2019, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publiko, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publiko, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019

Nenin 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës se shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 10.04.2018 në faqen zyrtare të APP. Në çmim janë të përfshira të gjithë detyrimet fiskale në fuqi sipas listës bashkëlidhur kontratës.

Veprimet e mospërputhjes në sasi për blerje ushqimesh, janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Realizimi kontratës nr.2 datë 03.01.2019, për mishin dhe nënproduktet e tij.

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlera e produkteve sipas kontratës (me TVSH)	Devijimi nga sasia e prokuruar (numër)	Realizimi sipas kontratës (%)	Devijimi nga prokurimi (%)
Kofshe pule	Kg	80	243	300	24,000	163	303.75%	203.75%
Mish vici	Kg	100	172	600	60,000	72	172.00%	72.00%
Mish i grire	Kg	60	49	600	36,000	-11	81.67%	-18.33%
Sallam	Kg	50	63	480	24,000	13	126.00%	26.00%
Krem vice	Kg	30	26	420	12,600	-4	86.67%	-13.33%
Bërxolla derri	Kg	80	70	600	48,000	-10	87.50%	-12.50%
Fileto pule	Kg	80	196	300	24,000	116	245.00%	145.00%
Qofte	Pako	50	50	240	12,000	-	100.00%	0.00%
Proshute	Kg	40	22	600	24,000	-18	55.00%	-45.00%
		570	891		264,600	321		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimin e institucionit me Ushqime, ta kryej sipas listës së nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1).

⁹ **Grupi i auditimit shprehet lidhur me konstatimin se diferenca (+/-) lidhur me sasinë e furnizuar të mallrave të prokuruar nuk jep efekt financiar në vlerën totale të prokuruar, bazuar në dokumentin “Fature tatimore” të lëshuar nga Kontraktori, bashkëlidhur se cilës për çdo rast është lista e mallrave të furnizuara, sasia, çmimi dhe vlera përkatëse. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flet-Hyrje mbështetur në dokumentin “fature tatimore dhe lista bashkëlidhur e mallrave të furnizuara”. Ky konstatim shërben për të gjitha rastet në vijim.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Për furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor), ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore (mujore) të lëshuar nga OE. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, ne disa raste mungon firmosja nga ndonjë anëtar i komisionit. **Nga auditimi konstatohet** se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal me Kontraktorin për sasinë e mallit të pranuar, furnizuar pjesë-pjesë, dhe dokumentacion të përkohshëm, nuk ka evidentuar dokumentacionin e përkohshëm për pranimin e mallit, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paragrafi 39. VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivatë dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave

➤ **Autoriteti Kontraktor** òShtëpia e Fëmijëve Shkollor Tirane dhe Kontraktuesi òS.ö shpk me NIPT xx, në baze të procedurave të prokurimit me REF-17786-04-12-2019, ka lidhur Kontratë Furnizimit òBlerje Ushqimeshë me **nr.119/9 prot, datë 24.04.2019**. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, VKM nr.924, datë 29.1.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar. Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 23.04.2019 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete **1,065,355 leke (pa TVSH) dhe 1,278,426 leke** (me TVSH). Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit. **Sigurimi i kontratës** në vlerën 127,843 leke ose 10% të çmimit të kontratës është bere nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve òE.ösha me Formularin e Sigurimit nr. Serial 070351810026801, datë 24.04.2019, me afat deri zbatimin e plote të kontratës..

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit datë 24.04.2019, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re për vitin 2019. Grafiku i lëvrimit të mallit: a-Për ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; b-Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë, etj. sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Malli do të merret në dorëzim, kundrejt faturës tatimore origjinale nga proces verbali i marrjes në dorëzim i mbajtur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 3 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve **ne shume 1,145,380 leke ose 90% e vlerës së kontratës** si më poshtë vijon:

Urdhër-Shpenzimeve për realizmin e kontratës nr.119/9 prot, datë 24.04.2019

Urdhër shpenzim	Fatura total artikuj	Totali Faturës (me TVSH)	Flete Hyrje
Nr.60, dt. 10.05.2019	Nr.470, dt. 30.04.2019	342,790	Nr.8, dt. 30.04.2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Nr.80, dt. 13.06.2019	Nr.474, dt. 30.05.2019	634,882	Nr.5, dt. 30.05.2019
Nr.90, dt. 02.07.2019	Nr.477, dt. 17.06.2019	167,708	Nr.12, dt. 17.06.2019
Paguar (90%)		1,145,380	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimi të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); E.S (anëtar) dhe kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 6, datë 03.01.2019, i cili do të funksionojë për periudhën 03.01.2019 deri 31.12.2019, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Kontrata nr. 119/9, datë 24.04.2019 është ndërprerë në datë 10.06.2019, moment i lidhjes së kontratës së re me nr.178 prot, datë 10.06.2019, procedure prokurimi e zhvilluar nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të Autorizimit për lidhje kontrate me nr. 1031/3 prot, datë 06.06.2019).

Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimi të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.*

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Por proces verbali/et i mbajtur për këtë qellim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje. Proces verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) **lidhur me:**

-**Produktet koloniale** për treguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të jetë jo më pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nesë furnizimi është në përputhje me standardin shtetëror të përcaktuar në DST.

- **Pranimin e perimeve dhe zarzavateve, pranimin e frutave** nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësor sipas standardit shtetëror të miratuar dhe kërkuar nga DST.

- Pranimin e **bulmetrave** (*qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët*) për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit,

- Për furnizimin me **veze** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

- Për furnizimin me **buke gruri** nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 *“Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”* të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Për furnizimin me **mish viçi** nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Kontrata e furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019

Neni 4: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi

Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 *Ërregullat e Prokurimit Publik*, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t’i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at

Lidhur me zbatimin e kontratës, grupi i auditimit përzgjedhi për auditim zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Por nga verifikimi i sasisë së mallrave të prokuruar dhe sasisë së mallrave të furnizuara rezultoi se sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 1,048 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 826 kg ose me pak për 222 kg nga sasia e prokuruar, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së Furnizimit nr. 119/9 prot, datë 24.04.2019.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit “Mish dhe nënprodukte të tij”, krahasuar me sasi të prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës, pasi këto diferencat në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar të cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero. Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e furnizimit nr. 119/2 prot, datë 24.04.2019, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Rregullat e Prokurimit Publik*, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 *Ër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit nr. 119/2 prot, datë 24.04.2019

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës së shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 23.04.2019 në faqen zyrtare të APP.

Veprimet e mospërputhjes janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Realizimi kontratës nr.119/9, datë 24.04.2019 për mishin dhe nënproduktet e tij.

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlera e produkteve (me TVSH)	Devijimi nga sasia e prokuruar (sasi)	Realizimi sipas kontratës	Devijimi (%)
Kofshe pule	Kg	220	219	360	79,200	(1)	99.55%	-0.45%
Mish vici	Kg	88	80	720	63,360	(8)	90.91%	-9.09%
Qofte	Pako	300	178	240	72,000	(122)	59.33%	-40.67%
Sallam	Kg	80	75	480	38,400	(5)	93.75%	-6.25%
Krem vice	Kg	60	26	480	28,800	(34)	43.33%	-56.67%
Bërxolla derri	Kg	80	60	600	48,000	(20)	75.00%	-25.00%



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Fileto pule	Kg	180	165	480	86,400	(15)	91.67%	-8.33%
Proshute	Kg	40	23	600	24,000	(17)	57.50%	-42.50%
		1048	826		368,160	(222)		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimin e institucionit me Ushqime, ta kryej sipas listës së nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1).

Për furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor), ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore (mujore) të lëshuar nga OE. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, ne disa raste mungon firmosja nga ndonjë anëtar i komisionit. **Nga auditimi konstatohet** se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal me Kontraktorin për sasinë e mallit të pranuar, furnizuar pjesë-pjesë, dhe dokumentacion të përkohshëm, nuk ka evidentuar dokumentacionin e përkohshëm për pranimin e mallit, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paragrafi 39.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivatë dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave.

➤ Midis Autoritet Kontraktor të Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tirane dhe Kontraktuesi O.E. shpk me NIPT LXr është lidhur Kontrata e Furnizimit “Blerje Ushqimeshë nr.178 prot, datë 10.06.2019. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, VKM nr.924, datë 29.1.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik dhe në , i ndryshuar dhe procedure së përqendruar të prokurimit të zhvilluar nga Shërbimi Social Shtetëror sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 1031/3, datë 06.06.2019 me afat 12-muaj dhe Autorizimit SHSSH për lidhje kontrate me nr. 1031/11 prot, datë 07.06.2019.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 11.03.2019 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete **3,441,710 leke (pa TVSH) dhe 4,130,052 leke (me TVSH)**. Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit datë 24.04.2019, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re për vitin 2019. Grafiku i lëvrimit të mallit: -Për ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes së kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; -Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë ,etj. dy here në jave sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; - Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit

Nga zbatimi kontratës rezulton se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 7 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve **ne shumën 4,130,045 leke ose 100%** e vlerës së kontratës si më poshtë vijon:

Urdhri ó Shpenzim për Kontratën nr.178 prot, datë 10.06.2019

Urdhër Shpenzim	Numri faturës	Totali Faturës (me TVSH)	Fletë-Hyrje
nr.96, dt. 05.07.2019	nr. 25, dt. 30.06.2019	273,217	nr. 13, dt. 30.06.2019
nr.114, datë 08.08.2019	nr.56, datë 31.07.2019	642,151	nr.14, dt. 31.07.2019
nr.131, dt. 10.09.2019	nr.71, dt. 31.08.2019	386,900	nr.15, dt. 31.08.2019
nr.151, dt. 09.10.2019	nr.98, dt. 30.09.2019	425,492	nr.16, dt. 30.09.2019
nr.170, dt. 12.11.2019	nr.66, dt. 31.10.2019	592,576	nr.18, dt. 31.10.2019
nr.188, dt. 05.12.2019	nr.89, dt. 30.11.2019	516,057	nr. 19, dt. 30.11.2019
nr.194, dt. 12.12.2019	nr. 113, dt. 10.12.2019	1,293,652	nr.20, dt. 10.12.2019
Paguar (100%)		4,130,045	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); E.S (anëtar) dhe kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 6, datë 03.01.2019, i cili do të funksionojë për periudhën 03.01.2019 deri 31.12.2019. Komisioni ka mbajtur proces verbal/e për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punësuar me përgjegjësi materiale.

Proces verbali/et i mbajtur për këtë qëllim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje. Proces Verbali/et nuk kanë pasqyruar të dhëna mbi treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

-Produktet koloniale për treguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të jetë jo më pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nëse furnizimi është në përputhje me standardin shtetëror të përcaktuar në DST.

- Pranimin e perimeve, zarzavateve dhe fruta, nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësor sipas standardit shtetëror të miratuar.

- Pranimin e bulmetrave, për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit,

- Për furnizimin me veze nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 òPër materialet dhe artikujt në kontakt me ushqiminò të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Për furnizimin me mish nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3 dhe Kontrata e furnizimit nr. 178, datë 10.06.2019.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkëlqes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Kontrata e furnizimit nr. 178, datë 10.06.2019

Neni 4: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi

Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar. Sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 3,950 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 3,203.5 kg ose me pak për 747 kg nga sasia e prokuruar, veprime ne kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit “Mish dhe nënprodukte të tij”, krahasuar me sasi të prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës, pasi këto diferencat në sasi për këto kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar të cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero. Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e Furnizimit nr. 178, datë 10.06.2019, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit ne nenin 2 përcakton se sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i i mallit sipas ofertës së shpallur fituese në prokurimin.

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Realizimi kontratës nr.178, datë 10.06.2019 për mishin dhe nënproduktet e tij.

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlera e produkteve të mishit sipas kontratës (me TVSH)	Devijimi nga sasia e prokuruar (ne sasi)	Realizimi sipas kontratës (%)	Devijimi (%)
Kofshe pule	Kg	900	880	216	194,400	-20	97.78%	-2.22%
Mish vici	Kg	280	378	510	142,800	98	135.00%	35.00%
Mish vici grire	Kg	300	40	360	108,000	-260	84.10%	-15.90%
Qofte	Pako	500	514	108	54,000	14	102.80%	2.80%
Sallam	Kg	300	252.3	360	108,000	-48	84.10%	-15.90%
Krem vice	Kg	500	221.2	360	180,000	-279	44.24%	-55.76%
Bërxolla derri	Kg	320	170	456	145,920	-150	53.13%	-46.88%
Fileto pule	Kg	700	664	444	310,800	-36	94.86%	-5.14%
Proshute	Kg	150	84	396	59,400	-66	56.00%	-44.00%
		3950	3203.5		1,303,320	-747		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimi institucionit me Ushqime, bëhet sipas listës së nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1). Për furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor) nga OE, ka mbajtur Proces Verbalet Pranimit, sipas verifikimit fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, ne disa raste mungon firmosja nga ndonjë anëtar i komisionit. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore të lëshuar.

Nga auditimi konstatohet se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal në prezencë të Kontraktorit, për sasinë e mallit pranuar, të furnizuar pjese-pjese dhe dokumentacion të përkohshëm, për të cilin është lëshuar fatura tatimore dhe kryer pagesa nga AK, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi .

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivatë dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave

Zbatimi kontratave për vitin 2020

➤ Midis Autoritet Kontraktor të Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tirane dhe Kontraktuesi të E.Ö shpk me NIPT LXr, është lidhur Kontrata e Furnizimit të Blerje Ushqimeshë **nr.338 prot, datë 31.12.2019**. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.924, datë 29.1.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar dhe procedurës së përqendruar të prokurimit të zhvilluar nga Shërbimi Social Shtetëror sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 1031/3, datë 06.06.2019 (vazhdim i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Kontratës nr.178 prot, datë 10.06.2019, me afat 12-muaj) dhe Autorizimit SHSSH për lidhje kontrate me nr. 1031/11 prot, datë 07.06.2019.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 11.03.2019 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jete **2,751,776 leke (pa TVSH) dhe 3,302,131 leke (me tvsh)**. Sigurimi i kontratës në vlerën 10% të çmimit të kontratës është bere në òA.ò. Cilësia e mallit do të jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit. Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit datë 24.04.2019, dhe përfundon me lidhjen e kontratës së re për vitin 2019. Grafiku i lëvrimit të mallit:- Për ushqimet 30% ditën e nesërme të lidhjes se kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; - Për ushqimet që prishen si qumësht, djathë, dy here ne jave sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; - Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 7 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve ne shumen 3,302,130 leke ose 100% e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzime për likuidimin e kontratës nr.338 prot, datë 31.12.2019

Urdhër shpenzim	Numri faturës	Totali Faturës (me TVSH)	Flete-Hyrje
nr.23, dt. 12.02.2020	nr.12, dt. 31.01.2020	202,926	nr.1, dt. 31.01.2020
nr.38,dt. 06.03.2020	nr.26, dt. 28.02.2020	344,977	nr.2, dt. 28.02.2020
nr.53, dt. 14.04.2020	nr.49, dt. 31.03.2020	502,118	nr.3, dt. 31.03.2020
nr.68, dt. 14.05.2020	nr. 61, dt. 30.04.2020	519,027	nr.4, dt. 30.04.2020
nr. 87, dt. 08.06.2020	nr.85, dt. 31.05.2020	779,196	nr.5, dt. 31.05.2020
nr.101, dt. 02.07.2020	nr. 106, dt. 06.06.2020	953,886	nr.6, dt. 06.06.2020
Paguar (100%)		3,302,130	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimi të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); B.Gj (anëtar) dhe kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2020, i cili do të funksionojë për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qellim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimi të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Por Proces Verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

-Produktet koloniale për treguesit fiziko-kimik, ambalazhimin e mallit të pranuar, të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto (neto), afatin e skadencës i cili duhet të jetë jo me pak se një vit nga data e furnizimit në institucion, kushtet e transportimit dhe nëse furnizimi është në përputhje me standardin shtetëror të përcaktuar ne DST.

- Pranimin e perimeve dhe zarzavateve , pranimin e frutave, nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësor sipas standardit shtetëror të miratuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

- Pranimin e bulmetrave për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë te freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit.

- Për furnizimin me veze nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 oPër materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Për furnizimin me mish dhe nënprodukte të tij nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Sa më sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Kontrata e furnizimit kontratës nr.338 prot, datë 31.12.2019

Neni 5: Cilësia e Mallit

Cilësia e mallrave do të jetë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat do të dorëzohen në magazinën e AK dhe transporti i tyre do të përballohet nga vetë Kontraktuesi

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 oRregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 2,650 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 2,707 kg ose me shumë për 57 kg nga sasia e prokuruar, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së Furnizimit nr. 338, datë 31.12.2019.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit oMish dhe nënprodukte të tij, krahasuar me sasinë e prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës, pasi këto diferenca në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikujt të tjerë të prokuruar



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHETËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

te cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero. Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e furnizimit nr. 338 prot, datë 31.12.2019, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39. Kontrata e furnizimit kontratës nr.338 prot, datë 31.12.2019

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës se shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 11.03.2019

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Realizimi ne cilësi i kontratës nr.338 prot, datë 31.12.2019

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlere e produkteve te mishit sipas kontratës (me TVSH)	Devijimi (sasi)	Realizmi sipas kontratës	Devijimi (në %)
Kofshe Pule	Kg	300	600	216	64,800	300	200.00%	100.00%
Mish Vici	Kg	20	353	510	10,200	333	1765.00%	1665.00%
Mish Vici Grire	Kg	200	16	360	72,000	(184)	8.00%	-92.00%
Qofte	Pako	300	431	108	32,400	131	143.67%	43.67%
Sallam	Kg	500	356	360	180,000	(144)	71.20%	-28.80%
Krem Vice	Kg	400	238	360	144,000	(162)	59.50%	-40.50%
Bërxolla Derri	Kg	180	150	456	82,080	(30)	83.33%	-16.67%
Fileto Pule	Kg	500	563	444	222,000	63	112.60%	12.60%
Proshute	Kg	250	0	396	99,000	(250)	0.00%	-100.00%
		2650	2707	3210	906,480	57		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimi institucionit me Ushqime, bëhet sipas listës se nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1). Komisioni i Pranimit të Mallit për furnizimet e kryera, për çdo dorëzim malli (pjesor), ka mbajtur Proces Verbalet Pranimi, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, ne disa raste mungon firmosja nga ndonjë anëtar i komisionit. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore të lëshuar.

Nga auditimi konstatohet se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal me Kontraktorit, për sasinë e mallit pranuar, furnizuar pjese-pjese dhe dokumentacion të përkohshëm, për të cilin është lëshuar fatura tatimore dhe kryer pagesa nga AK, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave

➤ **Autoriteti Kontraktor** është e Fëmijëve Shkollor Tirane dhe Kontraktuesi është E.C. shpk me NIPT LXxr, në baze të procedurave të prokurimit, kanë lidhur Kontratë e Furnizimit të Ushqimshëm **nr.153/5 prot, datë 27.08.2020**. Hartimi i kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, VKM nr.924, datë 29.1.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik dhe në procedurën e negociimit pa shpallje të njoftimit të kontratës me REF-69160-08-19-2020.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 21.08.2020 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jetë **792,400 leke (pa TVSH) dhe 950,880 leke (me TVSH)**. Sigurimi i kontratës në vlerën 95,100 leke ose 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve A.ö sha me Formularin e sigurimit nr. Serial 059705, datë 27.08.2020, me afat deri 31.12.2020.

Cilësia e mallit do të jetë sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e nënshkrimit dhe përfundon 31.12.2020

Grafiku i lëvrimit të mallit:

- ✓ Ushqimet e prokuruar çdo ditë të hënë, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- ✓ Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi i kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 5 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën 950,769 leke ose 100% e vlerës së kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër Shpenzim	Fatura	Totali Faturës (Me TVSH)	Fletë-Hyrje
nr.141, dt. 21.09.2020	nr.125, dt. 31.08.2020	123,492	nr.14, dt. 31.08.2020
nr.158, dt. 14.10.2020	nr. 132, dt. 30.09.2020	204,198	nr.17, dt. 30.09.2020
nr.186, dt. 16.11.2020	nr.145, dt. 31.10.2020	186,444	nr.22, dt. 31.10.2020
nr.211, dt. 15.12.2020	nr.161, dt. 30.11.2020	196,956	nr.27, dt. 30.11.2020
nr.220, dt. 23.12.2020	nr.174, dt. 22.12.2020	239,679	nr. 34, dt. 22.02.2020
Paguar (100%)		950,769	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); B.Gj (anëtar) dhe kuzhinieri turni (anëtar), ngritur me Urdhër nr. 4, datë 06.01.2020, i cili do të funksionojë për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020. Komisioni Pranimit ka mbajtur proces verbal për dorëzimin (pjesor) të mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbal/et i mbajtur për këtë qëllim, përmban listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Por Proces Verbalet nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) **lidhur me:**

- për furnizimin me **veze** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregimit për vezët.

- për furnizimin me **mish dhe nënprodukte të tij** nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinarë me të cilën vërtetohet se mishin nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik, neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Neni 77, pika 3: Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 *Ërregullat e Prokurimit Publik*, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Lidhur me furnizimin në sasi, konstatohet se sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 3,950 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 3,203.5 kg ose me pak për 747 kg nga sasia e prokuruar, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019.

Kontrata e furnizimit nr. 153/5, datë 27.08.2020

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës se paraqitur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 21.08.2020 në faqen zyrtare të APP.

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 1,800 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 1,747 kg ose me pak për 53 kg nga sasia e prokuruar. Sasia e prokuruar për furnizimin me vezë është 4,800 kokrra, ndërsa sasia e furnizuar është 5,836 kokrra ose me shume për 1,036 kokrra, veprime në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së Furnizimit nr.153/5 prot, datë 27.08.2020

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit òMish dhe nënprodukte të tijò, krahasuar me sasinë e prokuruar, **nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës**, pasi këto diferenca në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar te cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero.

Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me *Kontratën e furnizimit nr. 153/5 prot, datë 27.08.2020*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit Publik*”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011ò*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit nr.153/5 prot, datë 27.08.2020

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës së shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 21.08.2020.

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Realizimi në cilësi i kontratës 153/5, datë 27.08.2020

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlere e kontratës (me TVSH)	Vlera e realizuar (me TVSH)	Devijimi (në sasi)	Realizmi sipas	Devijimi (%)
Kofshe Pule	Kg	600	545	300	180,000	163,500	-55	90.83%	-9.17%
Mish Vici	Kg	200	207	780	156,000	161,460	7	103.50%	3.50%
Sallam	Kg	200	217	540	108,000	117,396	17	108.70%	8.70%
Krem Vice	Kg	200	224	480	96,000	107,520	24	112.00%	12.00%
Bërxa Derri	Kg	200	180	600	120,000	108,000	-20	90.00%	-10.00%
Fileto Pule	Kg	400	374	540	216,000	201,960	-26	93.50%	-6.50%
Sasia		1,800	1747				-53		
Veze	Kokrra	4,800	5,836	15.6	74,880	91,042	1,036	121.58%	21.58%
Sasia		4,800	5,836				1,036		

(Burimi : SHFSHPunoi : KLSH)

Kontraktuesi ka detyrim kontraktual që furnizimi institucionit me Ushqime, bëhet sipas listës së nevojave për prokurim të ushqimeve bashkëlidhur kontratës (Aneksi nr.1). Për furnizimet e kryera, Komisioni i Pranimit të mallit, për çdo dorëzim malli (pjesor) nga OE, ka mbajtur Proces Verbalet Pranimit, sipas verifikim fizik dhe dokumentet e përkohshëm të lëshuar nga furnitori për furnizimet pjesore. Në Proces Verbalet e Pranimit, për pranimin e mallit dhe hyrjen e tij në magazine, në disa raste mungon firmosja nga ndonjë anëtar i komisionit. Hyrja e mallit në magazine bëhet me Flete-Hyrje, referuar faturës tatimore të lëshuar nga OE.

Nga auditimi konstatohet se Komisioni i Pranimit të Mallit, nuk ka mbajtur një Proces Verbal në prezencë të Kontraktorit, për pranimin gjithë sasisë së furnizuar pjese-pjese me dokumentacion të përkohshëm, sipas të cilës është lëshuar fatura tatimore. Në pranimin e mallit nuk ka firmosur magazinieri i institucionit, proces verbali nuk i drejtohet NZ, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, paragrafi 39; 42; 43 dhe 44.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik,

3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar.

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

50. Procesverbali i drejtohet nëpunësit zbatues të njësisë për informacion dhe për ndjekje sipas dispozitave në fuqi në rastet e nevojshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave.

Zbatimi kontratave për vitin 2021

Midis Autoritet Kontraktor të Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tirane dhe Kontraktuesi të E.C. shpk me NIPT LXxr, në baze të procedurave të prokurimit me REF-83803-01-11-2021 është lidhur Kontrata e Furnizimit të Blerje Ushqimeshë **nr.281/3 prot, datë 18.01.2021**. Hartimi kësaj kontrate është mbështetur në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, VKM nr.914, datë 29.1.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Sigurimi i kontratës në vlerën 195,011 leke ose 10% të çmimit të kontratës është bërë nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve të A.ö sha me Formularin e sigurimit nr. Serial 060822, datë 18.01.2021, me afat deri zbatimin e plote të kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 12.01.2021 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do të jetë 1,625,087 leke (pa TVSH) ose 1,950,104 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do të jetë sipas specifikimeve të kërkuara nga AK në dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet në momentin e lidhjes së saj, me afat 3 muaj, me të drejtë ndërprerje në momentin e lidhjes së një kontrate të re, përfituar nga procedurat normale të prokurimit nga ABP. Grafiku i lëvrimit të mallit:- Ushqimet e prokuruar çdo ditë të martë, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor; - Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nga zbatimi kontratës rezulton se Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 6 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve në shumën **1,840,685 leke ose **94.38%** e vlerës së kontratës si më poshtë vijon**

Urdhër-Shpenzimeve për pagesën e Kontratës nr. 281/3 prot, datë 18.01.2021

Urdhër Shpenzim	Fatura	Totali Faturës (Me TVSH)	F-Hyrje
nr. 24, dt. 17.02.2021	nr. 1/2021, dt. 29.01.2021	130,476	nr.3, dt. 29.01.2021
nr. 39, dt. 04.03.2021	nr. 14/2021, dt. 26.02.2021	291,792	nr.7, dt. 26.02.2021
nr. 62, dt. 20.04.2021	nr. 27/2021, dt. 31.03.2021	397,327	nr.10, dt. 31.03.2021
nr. 84, dt. 20.05.2021	nr. 39/2021, dt. 30.04.2021	375,431	nr. 15, dt. 30.04.2021
nr. 104, dt. 0.05.2021	nr. 45/2021, dt. 31.05.2021	352,793	nr.19, dt. 31.05.2021
nr. 126, dt. 27.07.2021	nr. 52/2021, dt. 30.06.2021	292,866	nr.24, dt. 30.06.2021
Paguar (100%)		1,840,685	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); A.Zh (anëtar) dhe kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 5, datë 09.01.2021, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2021 deri 31.12.2021, ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbal/et i mbajtur për këtë qellim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Nga auditimit rezulton se Proces Verbalet nuk përmbajnë të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

- Pranimin e bulmetrave, Proces verbal/et që pranon furnizimin me djathë nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë te freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit te produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit,

- Për furnizimin me veze nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

- Për furnizimin me buke gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, te vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 oPër materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

- Për furnizimin me mish nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, ne kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 3: Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Nga dokumentacioni dosjes se prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit te saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 oRregullat e Prokurimit Publikö, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit te furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 1,749 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 1,880 kg ose me shumë për 131 kg nga sasia e prokuruar. veprime ne kundërshtim Kontratën e Furnizimit nr.281/3 prot, datë 18.04.2021,nenin 2.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit “Mish dhe nënprodukte të tij”, krahasuar me sasi të e prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së kontratës, pasi këto diferenca në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar te cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero. Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e furnizimit nr. 281/3 prot, datë 18.04.2021, VKM nr. 914, datë

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit nr.281/3 prot, datë 18.04.2021

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës se shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 12.01.2021.

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon.

Realizimi ne sasi i kontratës nr.281/3 datë 18.01.2021

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlere e produkteve te mishit sipas kontratës (me TVSH)	Devijimi (ne sasi)	Realizmi (%)	Devijimi (ne %)
Kofshe pule	Kg	620	289	420	260,400	-331	46.61%	-53.39%
Mish vici	Kg	180	208	720	129,600	28	115.56%	15.56%
Qofte	Kg	160	372	120	19,200	212	232.50%	132.50%
Sallam	Kg	180	190	480	86,400	10	105.56%	5.56%
Krem vice	Kg	180	255	480	86,400	75	141.67%	41.67%
Mish derri	Kg	144	140	540	77,760	-4	97.22%	-2.78%
Fileto pule	Kg	285	426	480	136,800	141	149.47%	49.47%
		1749	1880	3240	796,560	131		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 òPër Arkivatò dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave .

➤ **Autoriteti Kontraktor** òShtëpia e Fëmijëve Shkollorò Tirane dhe Kontraktuesi òMC Kateringò shpk me NIPT KXxJ, kalidhur Kontratë Furnizimi òBlerje Ushqimeshò **nr.113 prot, datë 21.06.2021**.Hartimi kësaj kontrate është mbështetur ne Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, VKM nr.914, datë 29.1.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò dhe në procedure e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, sipas **Marrëveshjes Kuadër nr. 44/4 prot, datë 27.05.2021** me afat 24-muaj) dhe **Njoftimit për lidhje kontrate** me nr. 44/6 prot, datë 28.05.2021.Sigurimi i kontratës në vlerën 83,064 leke ose 10% te çmimit te kontratës është bere nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve òA.ò sha me Formularin e sigurimit nr. serial 061919, datë 16.06.2021, me afat deri zbatimin e plote te kontratës.

Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas oferte së shpallur fituese, në prokurimin e zhvilluar më datë 05.05.2021 në faqen zyrtare të APP. Vlera totale e mallit objekt i kësaj kontrate do te jete 692,200 leke (pa TVSH) dhe 830,640 leke (me TVSH). Cilësia e mallit do te jete sipas specifikimeve të kërkuara nga AK ne dokumentet e tenderit.

Kjo kontrate fillon efektet ne momentin e nënshkrimit, dhe për vitin buxhetor përfundon ne 31.12.2021. Grafiku i lëvrimin të mallit:-Mish dhe nënprodukte te tij një herë në javë, sipas kërkesave te autoritetit kontraktor; -Malli do të lëvrohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, sipas Marrëveshjes Kuadër nr.44/5 prot. Datë 27.05.2021

Nga zbatimi kontratës rezulton se:

Kontraktuesi ka faturuar mallrat e sjella me anë të 6 faturave tatimore, të cilat janë likuiduar me anë të Urdhër-Shpenzimeve ne shume 830,591 leke ose **99.99%** e vlerës se kontratës si më poshtë vijon:

Urdhër-Shpenzimeve për Kontratën nr. 113 prot, datë 21.06.2021

Urdhër shpenzim	Fatura tatimore	Totali Faturës (me TVSH)	Fletë-Hyrje
nr. 150, dt. 30.08.2021	nr. 534/2021, dt. 30.07.2021	20,571	nr. 29, dt. 30.07.2021
nr. 172, dt. 14.09.2021	nr. 620/2021, dt. 31.08.2021	118,664	nr. 38, dt. 31.08.2021
nr. 191, dt. 06.10.2021	nr. 673/2021, dt. 30.09.2021	135,834	nr.44, dt. 30.09.2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

nr. 220, dt. 09.11.2021	nr. 793/2021, dt. 29.10.2021	122,304	nr. 46, dt. 29.10.2021
nr. 254, dt. 15.12.2021	nr. 893/2021, dt. 30.11.2021	148,278	nr. 54, dt. 30.11.2021
nr. 260, dt. 29.12.2021	nr. 984/2021, dt. 28.12.2021	284,940	nr. 61, dt. 28.12.2021
Paguar (100%)		830,591	

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Malli është pranuar nga Komisioni Pranimit të Mallit, i përberë nga K.L (kryetare); A. Zh(anëtar) dhe kuzhinieri turni, ngritur me Urdhër nr. 5, datë 09.01.2021, i cili do të funksionojë për periudhën 05.01.2021 deri 31.12.2021.

Urdhri NA për ngritjen e Komisionit të Pranimit të Mallit, nuk ka përcaktuar magazinierin e institucionit si pjesë e komisionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, neni 43.

UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Komisioni pranimit ka mbajtur proces verbal për pranimin e mallit në magazine për çdo furnizim nga operatori ekonomik. Proces verbali/et i mbajtur për këtë qellim, përmbajnë listën e përgjithshme të produkteve duke shënuar në të vetëm sasinë e artikullit të furnizuar për këtë hyrje.

Proces Verbali/et e pranimit të mallit nga OE nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtojca 9) lidhur me:

-furnizimin me mish dhe nuk evidentohet nëse furnizimi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se mishi nuk është prekur nga sëmundje, furnizimi është i sigurt dhe lejohet të tregtohet për konsum, sipas DST.

Sa me sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka monitoruar zbatimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik , neni 77 pika 3.

Neni 77, pika 3: Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 òRregullat e Prokurimit Publikò, e ndryshuar, neni 77 pika 4.

VKM nr. 914/2016 Rregullat e Prokurimit Publik

Neni 77, pika 4: “Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t’i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at.

Grupi i auditimit lidhur me zbatimin e kontratës përzgjedhi për auditimit zbatimin e kontratës lidhur me sasinë dhe çmimin e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij. Nga krahasimi çmimeve të mallit të furnizuar nuk konstatohen mospërputhje me çmimet e prokuruar.

Sasia e prokuruar për mish dhe nënprodukte të tij sipas kontratës dhe listës bashkëlidhur është 2,020 kg, ndërsa sasia e furnizuar është 1,936 kg ose me pak për 84 kg nga sasia e prokuruar. veprime në kundërshtim Kontratën e Furnizimit nr.113 prot, datë 21.06.2021, neni 2.

Diferencat në sasi për furnizimet për llojin e ushqimit “Mish dhe nënprodukte të tij”, krahasuar me sasinë e prokuruar, nuk japin efekt financiar në realizimin e vlerës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

kontratës, pasi këto diferenca në sasi për këtë kategori janë kompensuar me artikuj të tjerë të prokuruar te cilat dhe në total për gjithë artikujt ndryshimi në sasi është zero. Këto veprime kanë ardhur si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe të argumentuar për nevoja për konsum ushqimor për fëmijët në momentin e prokurimit, përgjegjësi kjo e grupit të hartimit të fondit limit si në rastin kur këto procedura janë kryer nga SHSSH ashtu edhe nga SHFSH, konstatime të argumentuara nga grupi i auditimit në procedurat e prokurimeve, veprime në kundërshtim me Kontratën e furnizimit nr. 113 prot, datë 21.06.2021, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paragrafi 39.

Kontrata e furnizimit nr.113 prot, datë 21.06.2021

Neni 2: Sasia e mallit do të jetë sipas listës bashkëlidhur kontratës dhe çmimi i mallit sipas ofertës se shpallur fituese në prokurimin e zhvilluar në datë 12.01.2021.

Veprimet e mospërputhjes për sasinë e prokuruar për mishin dhe nënproduktet e tij janë pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Realizimi ne cilësi i kontratës nr.113, datë 21.06.2021

Artikuj ushqimor	Njësia	Sasia e prokuruar	Sasia e pranuar	Çmimi prokuruar (me TVSH)	Vlere e kontratës (me TVSH)	Devijimi (kg)	Realizimi sipas artikujve	Devijimi
Kofshe pule	Kg	900	456	372	334,800	-444	50.67%	-49.33%
Mish vici	Kg	270	370	612	165,240	100	137.04%	37.04%
Salla	Kg	240	422	372	89,280	182	175.83%	75.83%
Krem vice	Kg	240	360	372	89,280	120	150.00%	50.00%
Bërxolla derri	Kg	120	180	492	59,040	60	150.00%	50.00%
Mish vici grie	Kg	250	148	372	93,000	-102	59.20%	-40.80%
		2020	1936		830,640	-84		

(Burimi: SHFSH Punoi: KLSH)

Dosja e prokurimit nuk rezulton të jetë numëruar dhe arkivuar në arkivin e institucionit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivatë dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e përgjithshme e Arkivave.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

- 1) Znj. S.L për periudhën 15.07.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NA të institucionit.*
- 2) Znj. A.H për periudhën 01.01.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NZ të institucionit.*
- 3) Znj.K.L me detyrë ish. Ish-mjeke institucioni për periudhën 01.01.2019 deri në 01.12.2021, në cilësinë e kryetare Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA për vitet 2019-2021.*
- 4) Z.E.S me detyrë punonjës mirëmbajtje, në cilësinë e anëtares se Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA për vitin 2019.*
- 5) Znj.B.Gj me detyrë punonjëse sociale, në cilësinë e anëtares se Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA për vitin 2020.*
- 6) Znj.A.Zh me detyrë punonjëse sociale për periudhën ne cilësinë e anëtares se Komisionit/ve të Pranimit të Mallit të ngritur me Urdhër të NA për vitin 2021.*

Në lidhje Projekt Raport Auditimin ka bërë komente dhe shpjegime znj. S.L, në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A. H ne cilësinë e përgjegjës se Administratës me shkresën nr. 239 prot, date 26.08.2022, protokolluar në KLSH me nr. 381/5 prot, date 30.08.2022 si më poshtë vijon:

Ne lidhje me rekomandimin nr.18.1: ne institucion funksionon zyra e protokoll arkivës, ku ne çdo fillim viti me urdhër të Drejtorit caktohet punonjësi i protokoll arkivues (sepse mungon ne organike). Ne vijimësi do te vijohet me arkivimin e dosjeve te procedurave te përfunduara. Ne lidhje me rekomandimin nr.20.1: ne lidhje me kërkesën për medikamente për fëmijët ju sqarojmë se mjeku i institucionit është personi kompetent për te identifikuar nevojat si dhe për te ndjekur ecurinë e gjendjes shëndetësore, në varësi të të cilave hartohet dhe kërkesa për medikamente. Sqarojmë se ne kërkesat tona nuk përfshihen ilaçet e rimbursura. Ne vijim ne



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

proces verbalin e marrjes në dorëzim të medikamenteve do të pasqyrohet edhe data e kadencës për çdo medikament, ndonëse është zbatuar afati më shumë së një vit nga marrja në dorëzim e ilaçeve.

Ne respektim të rregullores së institucionit menjëherë posi të merren medikamentet nga Komisioni, magazinohen me pas i kalojnë krye kujdestares, e cila kryen shpërndarjen në apartamentet përkatëse, ku është identifikuar nevoja në lidhje me gjendjen shëndetësore të fëmijëve, ku merret në dorëzim nga kujdestari në turn, i cili vendos në një ambient të sigurt, larg aksesit nga fëmijët apo personat e pa autorizuar si dhe ruhen në kushte optimale

Në lidhje Projekt Raport Auditimit ka bërë komente dhe shpjegime znj. S.L, në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A.H në cilësinë e përgjegjës së Administratës me shkresën nr. 239 prot, date 26.08.2022, protokolluar në KLSH me nr. 381/5 prot, date 30.08.2022 si më poshtë vijon:

Observacione nga Znj. A.H

Ne lidhje me rekomandimin nr.19.1: SHFSH ne vijim do të mbajë proces verbal përmbledhës për të gjithë sasinë e mallit të prokuruar, mbi të cilën është pranuar fatura tatimore. Gjithashtu do të kërkojë bashkëpunim me ABP për tu njohur me kriteret e veçanta dhe specifikimet e produkteve të dosjeve të prokurimeve të bëra prej tyre, në mënyrë që të zbatojë me përpikmeri rekomandimin tuaj

Ne lidhje me rekomandimin nr.19.2: ne vijmësi dokumentacioni i pranimit të mallit të prokuruar do të behet pjese e dosjes së prokurimit në zbatim të rekomandimit tuaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së} :

Ne lidhje me sa është pretenduar, subjekti audituar pranon rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit

Në lidhje Projekt Raport Auditimit ka bërë komente dhe shpjegime znj. S.L, në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A.H në cilësinë e përgjegjës së Administratës me shkresën nr. 239 prot, date 26.08.2022, protokolluar në KLSH me nr. 381/5 prot, date 30.08.2022 si më poshtë vijon:

Ne lidhje me rekomandimin nr.3.1:SHFSH do të vijojë të zbatojë me përpikmëri procedurën e parashikuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Ne lidhje me rekomandimin nr. 3.2 :Nga SHFSH do të merren masa të menjëhershme për krijimin e regjistrimit të aktiveve të SHSSH

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së} :

Ne lidhje me sa është pretenduar, subjekti audituar nuk shpreh dakordësinë me qëndrimin e grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në procedurën e mbajtjes së dokumentacionit lidhur me zbatimin e kontratave
Situata	Grupi i audituesve të KLSH-se, për periudhën 01.01.2019 deri në periudhën 31.12.2021, për të realizuar objektin e auditimit lidhur me procedurën e prokurimit me fonde buxhetore, u fokusua në procesin e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së kontratave të lidhura nga AK për “blerje ushqimesh” . Lidhur me zbatimin e kontratave për blerje ushqimesh, referuar kontratës nr. 2, datë 03.01.2019; kontratës nr.119/9, datë 24.04.2019, kontratës nr. nr.178, dt. 10.06.2019; kontratës nr.338, dt. 31.12.2019; kontratës nr.153/5, datë 27.08.2020; kontratës nr.281/3, dt. 18.01.2021 dhe kontratës nr.nr.113, datë 21.06.2021 nga auditimi dokumentacionit në dosjes/ve të prokurimit rezultoi se rezultoi se: - Komisionin e Pranimit të Mallit ngritur me të posaçëm të NA, nuk ka përcaktuar si pjesë e komisionit magazinierin e institucionit, veprim në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 oPër Menaxhimin



e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë, neni 43.

- Komisioni i Pranimit të Mallit, ka mbajtur proces verbal për çdo hyrje pjesore malli në magazine, furnizim i kryer pjese-pjese, dhe me dokumentacion të përkohshëm. Komisioni nuk ka mbajtur një Proces Verbal (përmbledhës) me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi të cilën është pranuar fatura tatimore, nuk ka evidentuar dokumentacionin e përkohshëm për pranimin e mallit, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publikë, neni 77 pika 3 dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 ÷ Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë, paragrafi 39.

- Proces Verbal/et, e pranimit të mallit **perimeve dhe zarzavateve** (patate, qepe, domate, etj.), pranimin e frutave (mollë, portokall, mandarina, dardha, pjeshkë dhe kajsi), nuk kanë evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nuk kanë fletë analizë në rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar. Proces Verbal/et, pranimit të produktit **mish/ të përpunuar i mishit** (sallam, proshuta, etj.) nuk përmban të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatë veterinarë, e cila do të vërtetonte sigurinë e produktit dhe vërteton se produkti është i sigurt dhe lejohet për konsum publik, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të DST.

- Proces Verbal/et, pranimit të **bulmetrave** (*qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët*) për furnizimin me djathë Proces verbali nuk ka evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht nuk ka evidentuar certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit, etiketa e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit;

- Për furnizimin me **veze** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregimit për vezët;

- Për furnizimin me **buke gruri** nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 ÷ Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

Sa më sipër, nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, rezultojnë se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të **nuk është** respektuar pranimi mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 ÷ Rregullat e Prokurimit Publikë, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni

Nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, nuk rezultojnë të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 ÷ Rregullat e Prokurimit Publikë, e ndryshuar, neni 77 pika 4.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTRËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>Nga auditimi u konstatua se në SHFSH dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.</p>
Kriteri:	<p>Kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër prokurimin publikò; Ligji nr. 162/2020 òPër prokurimin publikò; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, si dhe çdo akti ligjor ne fuqi.</p>
Ndikimi/Efekt:	<p>Gjatë zbatimit të kontratës, proces verbali i pranimit të mallit, nuk është shprehur mbi respektimin e pranimi mallit sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 òRregullat e Prokurimit Publikò, e ndryshuar, neni 77 pika 3 dhe Kontratën e Furnizimit nr. 2, datë 03.01.2019, neni 4.</p>
Shkaku:	<p>Komisioni i pranimit të mallit nuk ka njohuri/ kualifikim të mjaftueshme lidhur me zbatimin e kriterëve të përgjithshme/ specifike të prokurimit.</p>
Rëndësia:	<p>E Lartë</p>
Rekomandime:	<p>-Autoriteti Kontraktor, duhet të mbajë një Proces Verbal (përmbledhës) me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi të cilën është pranuar fatura tatimore. Gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatë/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, bazuar në përputhje me standardet shtetërore të të cilësisë dhe kriterëve të kualifikimit të OE.</p> <p>-Këto dokumente duhet të evidentohen në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Proces verbali të hartohet në tre kopje , njëra prej të cilave të behet pjesë e dosjes së prokurimit.</p> <p>-Autoriteti Kontraktor për kontratat e përfunduara të hartojë Raportin përmbledhës në të cilin të evidentojë cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të saj në rast se ka, masat e marra për zgjidhjen e tyre.</p> <p>-Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e SHFSH, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.</p>

Drejtimi 6: Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

menaxhimit financiar dhe kontrollit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga SHFSH, përcillet tek Shërbimi Social Shtetëror dhe ndjek ecurinë për miratimin përfundimtar për tu vënë në dispozicion fondet buxhetore. Monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni është si më poshtë vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 31.12.2021 rezultoi se:

Në Shqipëri funksionon një rrjet institucionesh të përkujdesit shoqëror (IPSH), të cilat ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ofron shërbim rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. SHFSH funksionon në bazë të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, Ligjit nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Strategjia e institucionit në arritjen e objektivave bazohet në:

- Respektimin dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve shoqërore
- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve nëpërmjet kualifikimit të stafit, menaxhimit efektiv, fuqizimit të burimeve materiale dhe financiare
- Dhënien e shërbimeve të personalizuar, duke vlerësuar nevojat e veçanta sociale, shëndetësore, emocionale, kulturore dhe materiale të përfituesve
- Bashkëpunimin me sektorin joqeveritar, donatorët, biznesin, pushtetin vendor, etj..

Me synim verifikimin e implementimit të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe akteve të tjera rregullatore janë kërkuar nga SHFSH shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, raportimet periodike në lidhje me buxhetin, etj..

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm, por auditohet nga struktura e institucionit epror SHSSH. Respektimi i kërkesave ligjore në shërbimet e kujdesit shoqëror kontrollohet edhe nga Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, sipas nenit 34 të Ligjit nr. 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, Inspektorati kontrollon standardet e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Gjatë periudhës objekt auditimi, grupi konstatoi se nuk është kryer asnjë inspektim i tillë në SHFSH, edhe pse ligji ka disa vite që ka hyrë në fuqi.

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ka caktuar si Nëpunës Autorizues znj. S.L (Drejtoreshë e institucionit) me anë të shkresës nr. 13766/1 prot., datë 23.07.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe si Nëpunës Zbatues znj. A.H (Përgjegjëse e Sektorit të Administratës) me anë të shkresës nr. 2027 prot., datë 14.11.2018 të Shërbimit Social Shtetëror. Sa më sipër, sipas pikës 23 të nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, Nëpunës autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

Nga auditimi u konstatua se Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ka dërguar çdo vit Programin Buxhetor Afatmesëm në Shërbimin Social Shtetëror. Përkatësisht, PBA 2019 ó 2021 është dërguar me anë të shkresës nr. 207 prot, datë 19.06.2018, PBA 2020 ó 2022 është dërguar me anë të shkresës nr. 195 prot, datë 27.06.2019 dhe PBA 2021 ó 2023 është dërguar me anë të shkresës nr. 110 prot, datë 29.06.2020 dhe elektronikisht në datë 30.06.2020. Me qëllim përgatitjen e programeve buxhetore afatmesme, SHFSH ka ngritur komisione të posatshëm me urdhër të titullarit. Përkatësisht, për hartimin e PBA 2020 ó 2022 është ngritur komisioni me Urdhër nr. 28 prot, datë 09.07.2019 dhe për hartimin e PBA 2021 - 2023 është ngritur komisioni me Urdhër nr. 46 prot, datë 25.06.2020. Komisionet përbëheshin nga 3 anëtarë, të cilët kanë qenë pjesë e strukturës së SHFSH dhe në përfundim të punës së tyre



përgatisin një relacion mbi Programin Buxhetor Afatmesëm.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 òPër rregullat e etikës në administratën publike, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni nuk ka një kod etike të mirëfilltë dhe të miratuar. SHFSH përdor një format standard në formë deklarate, i cili titullohet “Kodi i Etikës” dhe nënshkruhet nga punonjësit. Në këtë dokument përcaktohen shprehimisht zotimet etike të punonjësit të institucionit.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 88, datë 25.10.2011, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetërorò, i ndryshuar. Akti i mësipërm përcakton edhe strukturën e institucioneve në varësi të SHSSH. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 2712 prot, datë 31.12.2015, ku janë përcaktuar: struktura organizative e SHFSH, funksionet dhe detyrat e drejtimit dhe strukturave të tjera në institucion, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit, etj..

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në Përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 15 òRregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave, si dhe Kapitulli III òDelegimi i detyrave, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se ka rregullore të brendshme të miratuar nga institucioni epror (Shërbimi Social Shtetëror), ku janë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre. Gjithashtu, në VKM nr. 659, datë 17.10.2005 òPër standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidencialeò përcaktohet se institucionet rezidenciale për fëmijët duhet të veprojnë në përputhje me një set standardesh të miratuara. Për shembull, ato duhet të kenë të publikuar dhe afishuar dokumentin “Deklarata e qëllimit” i cili përfshin një përkufizim të qartë të misionit dhe qëllimit, ku parashtrohen shërbimet që institucioni ofron dhe të jetë lehtësisht i dukshëm për të gjithë. Gjithashtu, kërkohet që për çdo fëmijë të hartohet plani i përkujdesit personal, formulari për informacionin e domosdoshëm, plani i mbështetjes për të përgatitur largimin nga kujdesi rezidencial, plani i nevojave shëndetësore dhe arsimore për çdo fëmijë, etj.. SHFSH ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 659, datë 17.10.2005.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë, burimet njerëzore menaxhohen nga institucioni epror Shërbimi Social Shtetëror, sipas VKM nr. 135, datë 07.03.2018 òPër miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetërorò. Një kopje e praktikave dhe dosjeve personale të punonjësve mbahet edhe nga Sektori i Administratës në SHFSH. Të gjithë punonjësit janë të rekrutuar me anë të kontratave



individuale të punës, referuar dispozitave të Kodit të Punës së R.SH.

Në bazë të dokumentit të Rregullores së Brendshme, pika 11 e detyrave të Drejtorit përcakton se Drejtori vlerëson në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, performancën e të gjithë punonjësve, duke vënë në dijeni çdo punonjës dhe depoziton vlerësimin në dosjen personale të punonjësit. Nga auditimi i dosjeve personale të stafit konstatohet se gjatë periudhës së audituar, nuk janë përfshirë vlerësime periodike të punonjësve të institucionit. Ato mbahen në mënyrë të veçantë nga Sektori i Administratës në SHSSH.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se ky institucion nuk ka pasur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për periudhën 2019 - 2021 referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 ÷ Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët ÷ Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore dhe ÷ Profesionalizmi i stafit. Institucioni nuk bën një identifikim periodik të nevojave të stafit për trajnim në përputhje me kërkesat e VKM nr. 659, datë 17.10.2005 ÷ Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale.

Megjithatë, nga auditimi i dosjeve të personelit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SHFSH, rezulton se punonjësit kanë realizuar trajnime, për të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pjesëmarrjeje si më poshtë:

Viti 2019:

- datë 28.01.2019 trajnimi me temë ÷ Shërbimi i kujdestarisë për fëmijët pa kujdes prindërorë organizuar nga B. me pjesëmarrjen e 2 personave, punonjës social e psikolog; datë 25.10.2019 pjesëmarrës në konferencën e organizuar nga Spitali Psikiatrik me temë ÷ Integrimi i kërkimit dhe praktikës klinike në shëndetin mendor me pjesëmarrjen e psikologut e mjekut; datë 30.04.2019 ÷ Ekstremizmi i dhunshëm MShMS, ShSSH me pjesëmarrjen e psikologut, 1 person.

Viti 2020:

- datë 28.05.2020 deri 16.08.2020 trajnimi me temë ÷ Shëndeti mendor dhe mbështetja psiko-sociale në emergjencat UNICEF me pjesëmarrës punonjës social e psikolog (2 persona); Java e dytë e nëntorit 2020 me temë ÷ Trauma tek fëmijët e të rinjtë e sistemuar në përkujdesje rezidenciale e teknika praktike për profesionistët e kujdestarët për të menaxhuar traumat e fëmijëve B.; datë 15-16.02.2020 me temë ÷ Ndihma psikologjike në situatë emergjente me pjesëmarrjen e një psikologu.

Viti 2021:

- datë 28-29.09.2021 trajnimi me temë ÷ Të shëruarit nëpërmjet artit organizuar nga S. the Ch. me pjesëmarrjen e 6 personave Drejtor, Përgj. Sek. Social, Punonjës Social e 3 edukatorë; datë 24.11.2020 B. me temë ÷ Teknika praktike për të punuar me fëmijë e të rinj në kujdes alternativ që shfaqin problematika në sjellje me pjesëmarrjen e të gjithë stafit; datë 12.01.2021 trajnimi me temë ÷ Vlerësimi i situatës së jetimëve dhe fëmijëve të cenusur në Shqipëri; datë 08.09.2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me organizatën A., në partneritet dhe mbështetur nga UNICEF Shqipëri, organizuan seminarin me temë ÷ Ribashkimi i fëmijës me familjen, progresi dhe mundësitë për zhvillim dhe parandalimi i ndarjes me pjesëmarrjen e një personi Drejtori; Trajnimi i datës 18-19.11.2021 organizuar nga N. me temë ÷ Procesi i de institucionalizimit në Shqipëri, arritjet, sfidat dhe vizioni për të ardhmenë.

Ligji nr. 121/2016 ÷ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë ka parashikuar disa dispozita lidhur me edukimin e vazhdueshëm në institucionet e kujdesit shoqëror. Neni 42, pika 2 e ligjit parashikon që ÷ *profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve.* ÷ Më tej, pika 3 e nenit përcakton se punësimi ose kontratat në institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, pezullohen nëse profesionisti i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shërbimeve të kujdesit shoqëror nuk merr asnjë kredit të edukimit të vazhdueshëm. Rifitimi i së drejtës për punësim ose lidhja e kontratave të punës me institucionet bëhet pasi profesionisti t'ia jetë nënshtruar provimit të certifikimit. Megjithatë, sistemi i trajnimit të vazhdueshëm është një proces që iniciohet dhe rregullohet në nivel ministror. Në zbatim të ligjit nr. 121/2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 624, datë 29.7.2020 për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sipas këtij vendimi, certifikimi i profesionistëve bëhet në cikle 5-vjeçare, por trajnime duhet të ofrohen dhe zhvillohen çdo vit. Nga dokumentacioni i disponuar nga auditimi, nuk rezultojnë të ketë zhvillime mbi zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me trajnimin e vazhduar dhe certifikimin.

Institucionet publike dhe jopublike të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre. VKM nr. 135, datë 07.03.2018 për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror ngarkon pikërisht SHSSH si institucion epror për vlerësimin periodik të kapaciteteve dhe të nevojave për trajnim dhe i propozon bordit të edukimit të vazhdueshëm objektin e trajnimeve të profesionistëve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror (Paragrafi 3.3, pika ç).

Titulli i gjetjes	Mungesa e programeve specifike për trajnimin e punonjësve
Situata:	<p>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka pasur programe specifike për trajnimin e punonjësve për periudhën 2019 - 2021 referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 6Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)6, paragrafët 6Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore6 dhe 6Profesionalizmi i stafit6. Institucioni nuk bën identifikim periodik të nevojave të stafit për trajnim.</p> <p>Neni 42, pika 2 e ligjit 121/2016 parashikon që profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar t'ia nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve. Nga dokumentacioni i disponuar nga auditimi, nuk rezultojnë të ketë zhvillime mbi zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me trajnimin e vazhduar dhe certifikimin.</p> <p>Në frymën e ndryshimeve të ligjit 121/2016, VKM nr. 135, datë 07.03.2018 për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror ngarkon SHSSH si institucion epror për vlerësimin periodik të kapaciteteve dhe të nevojave për trajnim dhe i propozon bordit të edukimit të vazhdueshëm objektin e trajnimeve të profesionistëve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror.</p>
Kriteri:	<p>Ligji 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë6 VKM nr. 135, datë 07.03.2018 për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror6 Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mangësi në trajnimin dhe përmirësimin e aftësive të stafit, gjë e cila ka rëndësi thelbësore në institucione të kësaj natyre.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë dhe Shërbimi Social Shtetëror të bëjnë vlerësim periodik të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim të stafit të SHSSH, në mënyrë që procesi i edukimit të vazhdueshëm të jetë i shënjestruar në formën e duhur.</p>

Titulli i gjetjes - Mungesa e një dokumenti të miratuar të Etikës;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	- Mungesa e vlerësimeve periodike në dosjet individuale të punonjësve
Situata:	<p>- Nga auditimi u konstatua se, institucioni nuk ka një kod etike të mirëfilltë dhe të miratuar. SHFSH përdor një format standard në formë deklarate, i cili titullohet -Kodi i Etikës dhe nënshkruhet nga punonjësit. Në këtë dokument përcaktohen shprehimisht zotimet etike të punonjësit të institucionit.</p> <p>- Në bazë të dokumentit të Rregullores së Brendshme, pika 11 e detyrave të Drejtorit përcakton se Drejtori vlerëson në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, performancën e të gjithë punonjësve, duke vënë në dijeni çdo punonjës dhe depoziton vlerësimin në dosjen personale të punonjësit. Nga auditimi i dosjeve personale të stafit konstatohet se gjatë periudhës së audituar, nuk janë përfshirë vlerësime periodike të punonjësve të institucionit. Ato mbahen në mënyrë të veçantë nga Sektori i Administratës në SHSSH.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të institucionit
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në zbatimin e dispozitave të ligjit për MFK.
Rëndësia:	E mesme / E ulët
Rekomandimi:	<p>- Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë të miratojnë një dokument të Kodit Etik për veprimtarinë e SHFSH.</p> <p>- Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të bëjnë pjesë të dosjeve përkatëse të personelit, vlerësimet periodike që kryhen për punonjësit e SHFSH.</p>

2. Menaxhimi i riskut

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen. Sipas Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016, Nëpunësi Zbatues, në bazë të madhësisë së njësisë publike, përcakton situatat riskmbajtëse të renditura paraprakisht në mënyrë hierarkike. Kjo mundëson pasqyrimin e këtyre situatave në regjistrin e riskut. Gjithashtu në regjistrin e riskut duhet të përfshihen aktivitetet e institucionit, si edhe proceset më me rrezik për të.

Nga auditimi u konstatua se SHFSH ka hartuar çdo fillim viti planin vjetor ku paraqitet një matricë risku institucionale, e cila identifikon dhe vlerëson ngjarjet e mundshme apo situatat që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave.

3. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit kryhen nga ana e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë. Titullari ka ngritur komisione për inspektimin dhe verifikimin e mallrave të marra në dorëzim, nëpërmjet urdhrave përkatës. Ndarja e detyrave institucionale bëhet sipas përcaktimeve të Rregullores së Brendshme, por cenohet nga mungesa e qëndrueshmërisë së stafit.

Sistemi i dy firmave është përdorur në dokumentet dhe shkresat institucionale. Nga auditimi është konstatuar se Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka hartë të proceseve të punës të miratuar (Aneksi nr. 3 i Manualit të MFK).



4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisive. Titullari është informuar nga punonjësit me anë të mbledhjeve dhe nëpërmjet relacioneve. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera (veçanërisht SHSSH) pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka faqen e saj zyrtare në internet, por përmendet tek faqja zyrtare e Shërbimit Social Shtetëror si IPSH. Informacioni është i kufizuar për të interesuarit rreth veprimtarisë së institucionit.

5. Monitorimi

Pika 23/1 e nenit 4 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin përcakton se: *òNëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe/ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...ò. Për periudhën objekt auditimi nuk janë konstatuar raporte monitorimi 4-mujore të buxhetit të SHFSH. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit konsistojnë në rakordimet mujore bazuar në evidenca dhe situacione, të cilat i dërgohen Shërbimit Social Shtetëror.*

Raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese asistojnë në monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuar dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe marrjen e masave korigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, sipas pikës 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreò.

7. PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT.

A. Nivelit të kuotave për shpenzimet ditore të ushqimeve

Të drejtat e fëmijëve shqiptarë janë të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

Legjislacioni shqiptar, **Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”,** ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Në kuptim të ligjit ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, duhet të bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale (*ligji 121/2016, neni 27 pika 3*). Ligji për t \grave{a} bërë i zbatueshëm, kërkon nxjerrjen e akteve të reja dhe deri në daljen e tyre, do të vazhdojnë të mbeten në fuqi aktet nënligjore që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me këtë ligj. (*ligji 121/2016, neni 52 pika 3*).

Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”.

Neni 24 pika 6: Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.

Neni 26 pika 2. Në çdo rast, metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre do të bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave

Neni 27 pika 3. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Neni 53 pika 3 : Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Neni 52: Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.

2. Dispozitat apo pjesët e dispozitave të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, shfuqizohen.

3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Por MSHMS, lidhur me zbatimin e standardeve të shërbimeve sociale shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelin e përcaktimit të tarifave nuk ka nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Në zbatim të këtij ligji mbeten në fuqi dhe për tu zbatuar akte nënligjore më të hershme dhe të dala në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, *“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”,* i shfuqizuar. Të tilla akte nënligjore janë VKM nr.659, datë 17.10.2005, *“Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”,* në të cilën përcaktohen standardet për shërbimet rezidenciale për fëmijët; VKM Nr. 195, datë 11.4.2007 *“Për Miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, në Qendrat Rezidenciale, për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi”,* që miraton standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Lidhur me ushqyerjen nga institucioni rezidencial Standardi IV kërkon :

Standardi IV

“Fëmijëve u sigurohen dhe ofrohen Ushqime dhe lëngje të shëndetshëm, të sigurtë, të shumëllojshëm e në sasi të mjaftueshme për moshën si dhe që plotësojnë dëshirat e tyre.”

Zbatimi e standardeve të miratuara, aktualisht rregullohet nga Udhëzimi MSHMS nr. 830, datë 14.04.2008 *“Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike”,* i cili synon që fëmijët marrin Ushqime dhe lëngje të shëndetshme me vlera ushqyese që plotësojnë nevojat e tyre dietike në përputhje me grup-moshën dhe fëmijëve me nevoja të veçanta ushqimore t’u sigurohet një dietë e veçantë sipas rekomandimeve të specialistit.

Masa e shumës për shpenzime personale dhe nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime për përfituesit e shërbimit rezidencial e komunitar, janë përcaktuar VKM nr.518, datë 04.09.2018 *“Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitimin e tyre, dhe masën e shumës për shpenzime personale”,* kreu V.

Për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, përcakton nivelin kuotave për shpenzimet ditore të ushqimeve (*paragrafin 68 germa “c” dhe germa “ç”*) dhe kërkon indeksimin e tij çdo vit sipas paragrafit 71 të VKM nr.518/2018

VKM nr.518, datë 04.09.2018

Paragrafi 68: Subjekteve përfituese të shërbimit rezidencial publik, sipas përcaktimit të këtij vendimi, u jepet, për shpenzime personale, një shumë parash, si më poshtë vijon:

-germa “c”: fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 000 (një mijë) lekë në muaj;

-germa “ç”: fëmijëve të moshës 16-18 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

paragrafi 69: Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave që u jepet kategorive të përcaktuara në pikën 67 të këtij vendimi, për shpenzime personale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

Paragrafi 70: Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

*Paragrafi 71: Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare **indeksohen çdo vit** sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.*

MSHMS, ne zbatim të Ligjit 121/2016, neni 23, të VKM nr. 518/2018 neni 71, ka miratuar **Udhëzimin nr.689, datë 02.10.2018** “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, për nivelin e miratuar i kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve, sipas grup moshës së tyre.

Udhëzimi MSHMS 689/2018

Pika 1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për klientët që përfitojnë

shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, është:

- Për fëmijët e grup-moshës 6–12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 440 lekë.

- Për fëmijët e grup-moshës 13–15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 480 lekë.

- Për fëmijët e grup-moshës 16–18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në 500 lekë.

- Niveli i kuotës financiare për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

Nga auditimi dokumentacionit të institucionit, ushqyerja e fëmijëve, llogaritja e shpenzimeve për zbatimin e kuotës ushqimore, bazohet në dokumentacionin si më poshtë vijon:

✓ Ushqyerja e fëmijëve bazohet në menu-javore, hartuar nga mjekja e institucionit, financierja, përgjegjësjë e sektorit social, një kuzhinier, dhe miratohet nga titullari institucionit.

✓ Raportimi ditor i forcës për përgatitjen e menisë, firmosur nga K/Kujdestare dhe Përgjegjës i Sektorit Social.

✓ Kuzhinierja e turnit harton òKërkesë për Furnizimò ne sasi dhe artikull ushqimor, sipas forcës ditore të raportuar, duke përcaktuar artikujt ushqimore te nevojshëm për përgatitje e vakteve të ushqyerjes.

✓ òKërkesë për Furnizimò shërben si dokument bazë për miratimin e listës përfundimtare për artikuj ushqimore për konsum. Lista e miratuar evidentohet në òUrdhër Dorëzimiò për përlllogaritje e vlerës ditore për konsum dhe firmoset nga Përgjegjëse e Sektorit të Administratës, Magazinieri, miratuar nga drejtori institucionit.

✓ Artikujt ushqimore bëhen dalje nga magazina, shoqëruar me flete òdalje firmosur nga magazinieri dhe marrësi ne dorëzim (kuzhinieri).

✓ Çdo ditë ushqimi gatuar konsumohet ne apartamentet e fëmijëve sipas menisë-ditore të miratuar. Kuzhina harton òKartele ditore shoqërimiò ditore për asortimentet e gatuar dhe dorëzon ushqimin te kujdestari i fëmijëve sipas apartamenteve te banimit. òKartela ditore e shoqërimiò firmoset nga dorëzuesi (kuzhinier) dhe pranuesi (kujdestari i apartamentit).

✚ Për zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesjes shoqërore, **u**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

përzgjedhën për auditim praktikat dokumentare të hartimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit si më poshtë vijon¹⁰:

Për vitin 2019, për auditim u përzgjedhën me zgjedhje, hartimi menysë, flet-daljet e magazinës për muajin shkurt dhe mars dhe rezultoi si me poshtë:

Shkurt 2019	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	654	440	287,760		
13-15 vjeç	345	480	165,600		
16-18 vjeç	140	500	70,000		
Kuzhina (60%)	11	284	3,124		
Dalje nga magazina				464,361	
Donatore				44,220	
Totali	1,150	1,704	526,484	508,581	-17,903

Mars 2019	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	711	440	312,840		
13-15 vjeç	390	480	187,200		
16-18 vjeç	146	500	73,000		
Kuzhina (60%)	61	284	17,324		
Dalje nga magazina				440,277	
Donatore				20,256	
Totali	1,308	1,704	590,364	460,533	-129,831

Nga auditimi rezultoi se për muajt e përzgjedhur Shkurt, Mars të vitit 2019, bazuar në përmbledhësen mujore të konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor përkatësisht për muajin Shkurt 2019 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 61,832 lekë deri +9,413 lekë ose mospërputhja mujore -5,161 lekë, për muajin Mars 2019 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -3,968 lekë deri +4523 lekë ose mospërputhja mujore -129,831 lekë. Ne muajin mars 2019 ka një mospërputhje të konsiderueshme midis nevojës për konsum ushqimor dhe konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve.

Për vitin 2020, për auditim u përzgjedh me zgjedhje raportimi ditor i fëmijëve, hartimi menysë, flet-daljet e magazinës u përzgjedhën muajt shtator, tetor, nëntor dhe rezultoi si me poshtë:

Shtator 2020	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	974	440	428,560		
13-15 vjeç	261	480	125,280		
16-18 vjeç	31	500	15,500		
Kuzhina (60%)	60	284	17,040		
Dalje nga magazina				553,687	
Donatore				15,189	
Totali	1,326	1,704	586,380	568,876	-17,504

Tetor 2020	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	992	440	436,480		
13-15 vjeç	302	480	144,960		

¹⁰Ne kuotën ushqimore janë përfshirë ushqime të blera me fonde buxhetore dhe të dhuruara nga donator.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

16-18 vjeç	69	500	34,500		
Kuzhina (60%)	62	284	17,608		
Dalje nga magazina				600,638	
Donatore				2,254	
Totali	1,425	1,704	633,548	602,892	-30,656

Nëntor 2020	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	960	440	422,400		
13-15 vjeç	270	480	129,600		
16-18 vjeç	60	500	30,000		
Kuzhina (60%)	60	284	17,040		
Dalje nga magazina				589,888	
Donatore				15,596	
Totali	1,350	1,704	599,040	605,484	-6,444

Muaji Dhjetor	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	992	440	436,480		
13-15 vjeç	279	480	133,920		
16-18 vjeç	62	500	31,000		
Kuzhina (60%)	62	284	17,608		
Dalje nga magazina				679,917	
Donatore				210	
Totali	1,395	1,704	619,008	680.127	+61,119

Nga auditimi rezultoi se për muajt e përzgjedhur për auditim Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor të vitit 2020, ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor. Bazuar në përmbledhësen mujore të konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, se për muajin Shtator 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 64,614 lekë deri +6,870 lekë, mospërputhja mujore -17,504 lekë; për muajin Tetor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 63,747 lekë deri +6,080 lekë, mospërputhja mujore -30,656 lekë, për muajin Nëntor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 66,681 lekë deri +3,616 lekë, mospërputhja mujore -6,444 lekë. Për muajin Dhjetor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 67,276 lekë deri +5,928 lekë. Në datën 31.12.2020 **mospërputhja mujore +61,119 lekë**, pasi me rastin e festes së vitit të ri, fëmijët kanë konsumuar më tepër se kuota ushqimore. Konsumi ushqimor i datës 31.12.2020 është tejkaluar në shumë të konsiderueshme, dhe nuk justifikohet me një menu të veçantë që justifikon ushqimin e konsumuar nga fëmijët.

Për vitin 2021, me zgjedhje u përzgjedhën për auditim hartimi menysë, flet-daljet e magazinës u përzgjedh muaji janar, qershor, korrik dhe gusht dhe rezultoi si me poshtë:

Janar 2021	Përfituesit totale	Kuota E miratuar	Nevojat për Konsumi mujor	Konsum I faktik ushqimor	Diferenca Mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	900	440	396,000		
13-15 vjeç	255	480	122,400		
16-18 vjeç	38	500	19,000		
Kuzhina (60%)	62	284	17,608		
Dalje nga magazina				549,560	
Donatore				5,630	
Totali	1,255	1,704	555,008	555,190	-182

Qershor 2021	Përfituesit Total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
--------------	-------------------	------------------	---------------------------	-------------------------	------------------

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	868	440	381,920		
13-15 vjeç	150	480	72,000		
16-18 vjeç	19	500	9,500		
Kuzhina (60%)	60	284	17,040		
Dalje nga magazina				469,741	
Donatore				12,350	
Totali	1,097	1,704	480,460	482,091	-1,631

Korrik 2021	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	685	440	301,400		
13-15 vjeç	188	480	90,240		
16-18 vjeç	27	500	13,500		
Kuzhina (60%)	62	284	17,608		
Dalje nga magazina				421,205	
Donatore				1,280	
Totali	962	1,704	422,748	422,485	-263

Gusht 2021	Përfituesit total	Kuota e miratuar	Nevojat për konsumi mujor	Konsumi faktik ushqimor	Diferenca mujore
Grup-moshe	Numër	Lek/Person	Leke	Leke	Leke
6-12 vjeç	794	440	349,360		
13-15 vjeç	203	480	97,440		
16-18 vjeç	51	500	25,500		
Kuzhina (60%)	54	284	15,336		
Dalje nga magazina				471,496	
Donatore				12,000	
Totali	1,102	1,704	487,636	483,496	- 4,140

Për vitin 2021, nga auditimi i ushqyerjes së fëmijëve sipas menisë së ushqyerjes, bazuar në përmbledhësen mujore të konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, rezultoi mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor, për muajin janar mospërputhjet janë çdo ditë të muajit dhe variojnë nga -3,968 lekë deri +4523 lekë ose mospërputhje mujore -182 lekë, për muajin qershor mospërputhjet janë çdo ditë të muajit dhe variojnë nga -4,941 lekë deri +5498 lekë ose mospërputhja mujore -1,631 lekë; për muajin korrik mospërputhjet janë çdo ditë të muajit dhe variojnë nga -1,982 lekë deri +3006 lekë ose mospërputhja mujore -263 lekë, për muajin gusht mospërputhjet janë çdo ditë të muajit dhe variojnë nga -3,928 lekë deri +3980 lekë ose mospërputhja mujore -4,140 lekë.

Nga auditimi rezulton se:

1. Për fëmijët që përfitojnë shërbime publike në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, për muajt e përzgjedhur për auditim, ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve. Kjo mospërputhje tregon se nga njësitë shpenzuese, SHFSH Tiranë, nuk është zbatuar niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, veprim në mospërputhje me **kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit nr. 689**, datë 02.10.2018 *“Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”*.

2. **Ligji 121/2016 në nenin 24 pika 6 përcakton se Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.** Porlidhur me standardet e shërbimeve sociale shtetërore dhe *metodologjinë dhe nivelin e përcaktimit të tarifave*, **MSHMS nuk ka nxjerrë akte të reja nënligjore** në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Lidhur me zbatimin e standardeve të kërkuara, për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme, personeli shëndetësor duhet të udhëhiqet nga **Manuali “Bazat e ushqyerjes, ushqyerja e gruas**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

shtatzënisë, ushqyerja e fëmijës modul i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë ne vitin 2011, në bashkëpunim me rekomandimet e UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët), OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe FAO, (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë).

Aktualisht, ushqyerja e fëmijëve shkollorë në SHFSH, Tiranë bazohet në menu të ushqyerjes se fëmijëve, e cila hartohet çdo javë nga grupi i hartimit të menisë e llogaritur në vlerë, bazuar në numrin e fëmijëve (force ditore) dhe kuotën miratuar sipas grup moshës. Lidhur me nevojat dietore të fëmijëve për lëndë ushqyese dhe kalori, menuja ushqimore përgatitet për të gjithë fëmijët e institucionit pa dallim grup- moshe, gjinie ose gjendjeve të veçanta. **Personeli SHFSH**, që merret për përgatitjen e menisë së ushqyerjes së fëmijëve, nuk ka njohuri me standardet e ushqyerjes të përcaktuara të nxjerra nga MSHMS. Në faqen zyrtare të MSHMS është publikuar **Manual mbi bazat e Ushqyerjes**, i cili nuk është zbatuar nga personeli përkatës që trajton mbi ushqyerjen e fëmijëve nga mosha 6-18 vjeç. Në pikën 7.3 nga MSHMS janë dhënë rekomandime mbi ushqyerjen e fëmijëve të moshës parashkollorë mbi sasinë e të drithërave sipas moshës, gjinisë, sasinë për drithëra, zarzavate, fruta, bulmet, bishtajore, yndyrna. Manuali ka përcaktuar ndarjen kalorike që përcakton sasinë e proteinave, lipideve dhe karbohidrateve që duhet të marre fëmija. Ndarja kalorike është përcaktuar jo vetëm ditore, por edhe sipas vakteve të ushqyerjes. Manuali ka përcaktuar si programohen pjatat ushqimore, porcionet e ushqimeve sipas grup moshës, racionet e këshilluara për një vakt sipas moshës së fëmijës.

Grupi i hartimit të menisë në ushqyerjen ditore të fëmijëve në SHFSH, Tiranë, nuk udhëhiqet nga standardet në fuqi të ushqyerjes, referuar grup moshës së fëmijëve, llojit të produktit ushqimor për konsum, normës ditore, vlerës në k/kalori, dhe në fund vlerësimi në vlerë duke respektuar kuotën ditore të miratuar nga MSHMS. Mos diferencimi i menisë ushqimore sipas grup-moshës së fëmijëve, pavarësisht se nuk ndikon në vlerë, ndikon në cilësinë e të ushqyerit, dhe nuk përputhet rekomandimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP dhe udhërrëfyesit e OBSH. Raporti i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) mbi kërkesat për energji përcakton se:

Kërkesa për energji e një individi është ajo sasi energjie që merret nga ushqimet, e cila mbulon shpenzimet energjetike tek një individ me madhësi trupore dhe aktivitet fizik që përshtatet me një jetë të shëndetshme dhe që ndihmon në mbajtjen e një aktiviteti fizik të dëshirueshëm nga ana sociale dhe ekonomike.

Në zbatim **Udhëzimit Nr. 830, datë 14.04.2008** për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale, titullari i institucionit ka ngritur **Grupi Multidisiplinor**:

✓ Për periudhën kohore **Janar-Dhjetor 2019** të përberë nga 5 anëtarë, përkatësisht nga znj. L.Ç., përgjegjëse e sektorit social; znj. B.Gj punonjëse sociale, Znj. E.D psikologe, Znj. K.L ish-mjeke dhe edukatori përkatës sipas problematikës që diskutohet.

✓ Për periudhën kohore **Janar-Dhjetor 2020** të përberë nga 6 anëtarë, përkatësisht nga znj. L.Ç., Përgjegjëse e Sektorit Social; znj. B.Gj Punonjëse Sociale, Znj. E.D Psikologe, Znj. K. Gj Psikologe, Znj. K.L ish-mjeke dhe Edukatori përkatës sipas problematikës që diskutohet.

✓ Për periudhën kohore **Janar-Dhjetor 2021** të përberë nga 5 anëtarë, përkatësisht nga znj. E.D përgjegjëse e sektorit social; znj. A.Zh punonjëse sociale, Znj. M.I psikologe, Znj. K.L ish-mjeke dhe Edukatori përkatës sipas problematikës që diskutohet.

Rregullorja e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës **“Zyber Hallulli**, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, në pikën nr.4 **odetyrat funksionale të mjekut**, përcakton se Mjeku **harton së bashku me ekipin** multidisiplinar menutë ushqimore të fëmijëve.

Rregullorja e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës

Detyrat funksionale të Mjekut:

Pika 4: Mjeku harton së bashku me ekipin multidisiplinar menutë ushqimore të fëmijëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Nga auditimi rezulton se menutë ushqimore hartohen nga mjeku, përgjegjësja e sektorit social, financiarja, dhe kuzhinierja dhe miratohet nga titullari i institucionit. Në hartimin e menisë nuk merr pjesë ekipi multidisiplinar, veprim në mospërputhje me kërkesat Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës ë Zyber Hallullio, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, neni 0detyrat funksionale te mjekut0, pika 4.

✚ Udhëzimi MSHMS Nr. 689, datë 2.10.2018, 0Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore0 ka përcaktuar kuotat e ushqimit ditor në vlerë lekë, për fëmijët e grup-moshës 6 0 12 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në vlerë 440 lekë; për fëmijët e grup-moshës 13 0 15 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në vlerë 480 lekë dhe për fëmijët e grup-moshës 16 0 18 vjeç të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në vlerë 500 lekë.

VKM nr.518 datë 04.09.2018 0Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar0, në paragrafin 71, përcakton se niveli kuotave në institucionet publike rezidenciale duhet te indeksohen çdo vit, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi 0Ushqime dhe pije joalkoolike0

VKM 518/2018, paragrafi 71

Nivelet e kuotave në institucionet publike rezidenciale duhet te indeksohen çdo vit, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike0.

Sipas INSTAT indeksi i çmimeve konsumit ka pësuar ndryshim në rritje, për nëngrupin 0Ushqime dhe pije joalkoolike0 për vitin 2019, 2020 dhe 2021, rritje e pa reflektuar ne nivelet e kuotave për fëmijë në institucionet publike rezidenciale. Mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për fëmijë është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që kanë marrin fëmijët përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, duke marre në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, vlera në lekë e përcaktuara për kuotën ditore për fëmijët nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore si në vitin 2018 edhe në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021.

Ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit¹¹

(Në/In %)		2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
COIC OP											
000000	Gjithsej	2.0	1.9	1.6	1.9	1.3	2.0	2.0	1.4	1.6	2.0
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	2.4	4.2	2.2	4.3	3.3	3.9	2.7	2.9	3.6	3.9
01.1.	Ushqime	2.3	4.3	2.4	4.5	3.5	4.1	2.8	3.1	3.9	4.2
01.1.1.	Bukë dhe drithëra	0.9	1.0	-1.2	-0.1	-0.9	0.1	-0.2	0.0	1.8	3.2
01.1.2.	Mish	2.2	1.0	0.1	0.1	-1.0	0.6	0.9	0.4	1.5	1.6
01.1.3.	Peshk	1.3	1.4	0.0	1.1	1.8	4.5	2.3	2.2	3.4	1.8
01.1.4.	Qumësht, djathë dhe vezë	4.8	0.9	0.6	-1.5	0.9	3.3	0.9	2.6	2.0	2.9
01.1.5.	Vajra dhe yndyra	0.6	-0.2	-5.8	-1.1	0.4	-2.3	1.8	-0.2	4.0	6.7
01.1.6.	Fruta	11.7	11.7	10.9	15.0	17.4	11.3	5.6	5.2	15.2	5.2
01.1.7.	Zaravate përfshirë patatet	-2.6	21.3	12.4	17.0	11.0	11.5	12.9	11.3	5.3	6.5
01.1.8.	Sheqer, reçel, mjaltë, çokollata, dhe ëmbëlsira.	-0.2	-4.5	-3.7	0.8	3.0	2.5	-0.9	0.7	3.2	2.6
01.1.9.	Ushqime të tjera	1.2	0.1	-1.2	2.6	1.0	1.4	1.5	0.0	1.2	2.7
01.2.	Pije joalkoolike	2.6	2.5	-1.8	0.0	-0.3	0.4	-0.1	-0.4	0.1	1.0
01.2.1.	Kafe, çaj dhe kakao	4.7	7.2	-2.5	-1.4	0.1	1.2	-1.2	-0.6	0.3	1.1
01.2.2.	Ujë mineral, pije të buta dhe lëngje	1.6	-0.1	-1.4	0.9	-0.5	-0.1	0.7	-0.3	0.3	0.8

(Burimi: INSTAT)

Nga auditimi konstatohet se **Indeksi i Çmimeve të Konsumit** të publikuar nga INSTAT, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike0 ka pësuar rritje te indeksit mesatar për vitin 2019 ne masën 2.9%, në vitin 2020 rritje në masën 3.6% dhe në vitin 2021 rritje në masën 3.9% . Kjo

¹¹<http://www.instat.gov.al/al/temat/%C3%A7mimet/indeksi-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit/#tab2>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTEPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

rritje nuk është reflektuar në koston ditore të ushqyerjes së fëmijëve, efektet financiare të së cilës ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së fëmijëve rezident në SHFSH, Tiranë.

Grupi auditimit përlloritari koston ditore të ushqyerjes së fëmijëve për person, bazuar në ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT.

Ne bazë të përlloraritjeve për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 453 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 12.76 lekë. Për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 494lekë / ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 13.92 lekë. Për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 515lekë / ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 14.50 lekë.

Ne bazë të përlloraritjeve për vitin 2020krahasuar me vitin 2019 rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6 -12 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 469 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 16.30 lekë. Për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjesbëhet 512 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 17,78 lekë, për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 533 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 18.52 lekë.

Ne bazë të përlloraritjeve për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 487 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 18.29 lekë, për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 532 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 19.96 lekë, për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes bëhet 554 lekë/ ditë dhe për pasojë është llogaritur më pak për 20.79 lekë.

Te dhënat mbi efektet e mos indeksimit të kuotës ditore të ushqyerjes së fëmijëve, janë pasqyruar në tabelat si më poshtë vijon.

Indeksimi i kuotës ditore te ushqimit te fëmijëve

Grup moshë	Kosto ditore	Indeksi /2019	Ndikimi indeksit viti 2019	Kosto ditore /2019	Indeksi /2020	Ndikimi indeksit viti 2020	Kosto ditore /2020	Indeksi /2021	Ndikimi indeksit viti 2021	Kosto ditore /2021
	lekë/person	%	lekë/person	lekë/person	%	lekë/person	lekë/person	%	lekë/person	lekë/person
6-12 vjeç	440	0.029	12.76	453	0.036	16.30	469	0.039	18.29	487
13-15 vjeç	480	0.029	13.92	494	0.036	17.78	512	0.039	19.96	532
16-18 vjeç	500	0.029	14.50	515	0.036	18.52	533	0.039	20.79	554

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Kosto ditore e indeksuar sipas grupit te auditimit:

Grup moshë	Kosto ditore e ushqyerjes	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2019	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2020	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2021
	lekë/person	lekë/person	lekë/person	lekë/person
6-12 vjeç	440	453	469	487
13-15 vjeç	480	494	512	532
16-18 vjeç	500	515	533	554

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Grupi auditimit llogariti efektet e mos indeksimit të koston së ushqyerjes së fëmijëve dhe ne bazë të përlloraritjeve rezultoi se:

❖ **Kosto vjetore për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018** rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç kosto vjetore për person është llogaritur më pak për 4,657 lekë, për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 5,081 lekë, për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 5,293 lekë. Për të tre grup moshat e fëmijëve kosto vjetore e **vitit 2019 krahasuar me vitin 2018** është llogaritur më pak ne **shumen 15,031 lekë/ person**.

❖ **Kosto vjetore për vitin 2020 krahasuar me vitin 2018** rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç kosto vjetore për person është llogaritur më pak për 10,607 lekë, për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 11,571 lekë, për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 12,053 lekë. Për gjithë grup moshat kosto vjetore e **vitit 2020 krahasuar me vitin 2018** është llogaritur më pak ne **shumen 34,231 lekë/për person**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

❖ **Kosto vjetore për vitin 2021 krahasuar me vitin 2018** rezulton se për fëmijët e grup-moshës 6-12 vjeç kosto vjetore për person është llogaritur më pak për 17,284 lekë, për fëmijët e grup-moshës 13-15 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 18,855 lekë, për fëmijët e grup-moshës 16-18 vjeç kosto ditore e ushqyerjes është llogaritur më pak për 19,641 lekë. Për gjithë grup moshat kosto vjetore e **vitit 2021 krahasuar me vitin 2018** është llogaritur më pak ne **shumen 55,779 lekë**.

Te dhënat mbi efektet vjetore të mos indeksimit të kuotës ditore të ushqyerjes se fëmijëve, janë pasqyruar në tabelat si më poshtë vijon.

Kosto vjetore e ushqyerjes për fëmijë sipas grup moshës

Grup moshë	Kosto mujore/person	Viti 2018	Viti 2019	Ndryshimi 2019/2018	Viti 2020	Ndryshimi 2020/2018	Viti 2021	Ndryshimi 2021/2018
6-12 vjeç	440	160,600	165,257	- 4,657	171,207	-10,607	177,884	-17,284
13-15 vjeç	480	175,200	180,281	- 5,081	186,771	-11,571	194,055	-18,855
16-18 vjeç	500	182,500	187,793	- 5,293	194,553	- 12,053	202,141	-19,641
Totali		518,300	533,331	- 15,031	552,531	- 34,231	574,079	- 55,779

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Konkluzion:

Duke marre në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi kuotës ditore për ushqim për fëmijë është në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që kanë marrin fëmijët përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion, Vlera në lekë e përcaktuara për kuotën ditore për fëmijët nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore që duhet të konsumojnë fëmijët, për shkak të mos respektimit të vlerës së kuotës ushqimore nga institucioni, dhe mos indeksimit të kuotës ushqimore sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT. Për pasojë vlera e kuotës së ushqyerjes se fëmijë në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021, për muajt e përzgjedhur ka qenë në vlera me të ulëta se kuota e miratuar, përgjegjësi kjo e SHFSH Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e MSHMS.

Organizimi të ushqyerit të fëmijëve mbështetet vetëm në miratimin e kuotës ushqimore sipas grup moshës së fëmijëve. Hartimi i menisë së ushqyerjes së fëmijëve nuk ka përcaktuar një normë ushqyerje sipas grup moshës së fëmijës, nuk ka të përcaktuar kaloritë dhura që duhet të marrë secili prej tyre, në kundërshtim me kërkesat e Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 *ËPër shërbimet e kujdesit shoqëror në RSHö, neni 27 pika 3 dhe VKM nr.659, datë 17.10.2005, ËPër standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidencialeö, standardit IV.*

Nga auditimi rezulton se menutë ushqimore hartohen nga mjeku, përgjegjësja e sektorit social, financierja, dhe kuzhinierja dhe miratohet nga titullari i institucionit. Në hartimin e menisë nuk merr pjese ekipi multidisiplinar, veprim në mospërputhje me kërkesat Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës *ËZyber Hallulliö, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, neni òdetyrat funksionale te mjekutö, pika 4..*

Personeli SHFSH, që merret për përgatitjen e menisë së ushqyerjes së fëmijëve, nuk ka njohuri me standardet e ushqyerjes të përcaktuara të nxjerra nga MSHMS.

B. Shpenzime personale nga përfituesit e shërbimit rezidencial.

Fëmijëve rezident në qendrat rezidenciale për fëmijë u jepet për shpenzime personale një shumë monetare (në lekë), referuar **Nenit 23 i Ligjit nr. 121/2016, ËPër ndihmën dhe shërbimet shoqëroreö, i ndryshuar, përcakton se përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar. Zbatimi kësaj dispozite ka gjetur zbatim në VKM nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarö, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” (Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga data 1.10.2018.)

Sipas përcaktimit të VKM 518/2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò, Kreut V, paragrafi 68, subjekteve përfituese të shërbimit rezidencial publik, u jepet, **përshpenzime personale, një shumë parash**, si më poshtë vijon:

Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare janë miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, me **VKM 518/2018, paragrafi 70**. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare duhet të indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi òUshqime dhe pije joalkoolikeò. (VKM 518/2018, paragrafi 71)

VKM 518/2018

*Paragrafi 68: Fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, **1 000 (një mijë) lekë në muaj**; (VKM 518/2018, kreu V, paragrafi 68, germa “c”) dhe fëmijëve të moshës 16-18 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, **1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj**(VKM 518/2018, kreu V, paragrafi 68, germa “ç”)*

Paragrafi 69: Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave që u jepet kategorive të përcaktuara në pikën 67 të këtij vendimi, për shpenzime personale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

Paragrafi 71. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.

Paragrafi 72: Ngarkohen strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe qarqeve dhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje dhe me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre.

Paragrafi 74: Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave që ju jepet kategorive përfituese për shpenzime personale janë përcaktuar në **Udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018** òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqëroreò të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për periudhën objekt auditimi, njësia shpenzuese me fonde të buxhetit ka kryer shpenzime personale për fëmijëve të moshës 6-15 vjeç me kuotë **1,000 (një mijë) lekë në muaj** dhe për fëmijëve të moshës 16-18 vjeç me kuotë **1,500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj**. Sipas dokumentacionit të Bankës dhe Arkës për vitet 2019-2021, shpenzimet e kryera në institucionin rezidencial SHFSH Tiranë, për fëmijët rezident janë si më poshtë vijon:

Shpenzime personale për fëmijëve paguar me arkë.

Muaji	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2021		
	6-15 vjeç	15-18 vjeç	Shpenzime Mujore	6-15 vjeç	15-18 vjeç	Shpenzime Mujore	6-15 vjeç	15-18 vjeç	Shpenzime Mujore
	numër	numër		nr. Fëmijëve	nr. Fëmijëve		nr. Fëmijëve	nr. Fëmijëve	
Janar	37	2	40,000.00	37	2	40,000.00	41	2	44,000.00
Shkurt	37	2	40,000.00	36	2	39,000.00	40	2	43,000.00
Mars	37	2	40,000.00	36	2	39,000.00	40	2	43,000.00
Prill	39	3	43,500.00	38	2	41,000.00	40	2	43,000.00
Maj	36	3	40,500.00	38	2	41,000.00	40	2	43,000.00
Qershor	36	2	39,000.00	38	2	41,000.00	39	3	43,500.00
Korrik	36	2	39,000.00	38	2	41,000.00	39	4	45,000.00
Gusht	34	2	37,000.00	38	2	41,000.00	39	4	45,000.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Shtator	34	2	37,000.00	42	1	43,500.00	39	4	45,000.00
Tetor	34	1	35,500.00	42	1	43,500.00	38	3	42,500.00
Nëntor	36	1	37,500.00	42	1	43,500.00	38	2	41,000.00
Dhjetor	37	2	40,000.00	41	2	44,000.00	37	1	38,500.00
Paguar Nga Arka			469,000.00			497,500.00			516,500.00

(Burimi: SHFSH; Punoi: KLSH)

Nga auditimi rezulton se fëmijët sipas grup-moshës së tyre, kanë përfituar si shpenzime personale, një shumë parash, që varion nga **1,000 deri 1,500 lekë për person**. Shpenzimet e kryera nga njësia shpenzuese për vitin 2019 janë **469,000 lekë**, për vitin 2020 janë **497,500 lekë** dhe për vitin 2021 janë **516,500 lekë**.

Nga auditimi rezulton se në SHFSH, Tiranë nuk ka gjetur zbatim indeksimi shpenzimeve personale që kanë përfituar fëmijët rezident në SHFSH, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 71, të VKM 518/2018 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarë*. Kjo dispozitë kërkon që niveli i kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare të indeksohet çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi Ushqime dhe pije joalkoolike dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, në cilësinë e autoriteti përgjegjës për shërbimet sociale nuk kanë marrë masa për zbatimin e kësaj dispozite.

Grupi auditimit përllogarit indeksimin e shpenzimeve mujore personale për person, bazuar në ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT.

Indeksimin e shpenzimeve mujore personale për person

Grup moshë	Shpenzime personale	indeksi çmimeve 2019	Ndikimi indeksit viti 2019	Indeksimi shpenzimeve personale viti 2019	Indeksi çmimeve 2020	Ndikimi indeksit viti 2020	Indeksimi shpenzimeve personale vitin 2020	Indeksi çmimeve 2021	Ndikimi indeksit viti 2021	Indeksimi shpenzimeve personale viti 2021
6-15 vjeç	1,000	0.03	29.00	1,029	0.04	37.04	1,066	0.04	41.58	1,108
15-18 vjeç	1,500	0.03	43.50	1,544	0.04	55.57	1,599	0.04	62.36	1,661

(Punoi: KLSH)

Efektet vjetore të indeksimin e shpenzimeve personale për person

Grup moshë	Shpenzime personale	Vjetor 2018	Vjetore 2019	Ndryshimi 2019/2018	Vjetor 2020	Ndryshimi 2020/2018	Vjetor 2021	Ndryshimi 2021/2018
6-15 vjeç	1,000	12,000	12,348	-348	12,793	-793	13,291	-1,291
15-18 vjeç	1,500	18,000	18,522	-522	19,189	-1,189	19,937	-1,937
		30,000	30,870	-870	31,981	-1,981	33,229	-3,229

(Punoi: KLSH)

Ne bazë të përllogaritjeve të grupit të auditimit, efektet vjetore nga **mos indeksimi shpenzimeve personale për person** rezultoi si më poshtë vijon:

❖ Për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen **1,029 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale për **348 leke/person**, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen **1,544 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale janë llogaritur më pak për **522 lekë/person**.

❖ Për vitin 2020 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen **1,066 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale për **793 leke/person**, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen **1,599 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale **1,189 leke/person**.

❖ Për vitin 2021 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen **1,108 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale **1,291 leke/person**, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person j pas indeksimit

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

duhet të bëhen **1,661 leke/person**, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale **1,937leke/person**.

Efektet vjetore të mos indeksimit të shpenzimeve personale për gjithë fëmijët rezident janë si më poshtë vijon:

Efektet vjetore të mos indeksimit të shpenzimeve personale

Kosto e indeksuar	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2021		
	1029 lekë për person	1544 lekë për person	Shpenzime 2019	1066 lekë për person	1599 lekë për person	Shpenzime 2020	1108 lekë për person	1661 lekë për person	Shpenzime 2021
	Grup moshë 6-15 vjeç	15-18 vjeç		6-15 vjeç	15-18 vjeç		6-15 vjeç	15-18 vjeç	
Periudha	Nr. Fëmijëve	Nr. Fëmijëve		Nr. Fëmijëve	Nr. Fëmijëve		Nr. Fëmijëve	Nr. Fëmijëve	
Janar	37	2	41,161	37	2	42,640	41	2	48,750
Shkurt	37	2	41,161	36	2	41,574	40	2	47,642
Mars	37	2	41,161	36	2	41,574	40	2	47,642
Prill	39	3	44,763	38	2	43,706	40	2	47,642
Maj	36	3	41,676	38	2	43,706	40	2	47,642
Qershor	36	2	40,132	38	2	43,706	39	3	48,195
Korrik	36	2	40,132	38	2	43,706	39	4	49,856
Gusht	34	2	38,074	38	2	43,706	39	4	49,856
Shtator	34	2	38,074	42	1	46,371	39	4	49,856
Tetor	34	1	36,530	42	1	46,371	38	3	47,087
Nëntor	36	1	38,588	42	1	46,371	38	2	45,426
Dhjetor	37	2	41,161	41	2	46,904	37	1	42,657
			482,613			530,335			572,251
Efektet vjetore të mos indeksimit			-13,613			-61,335			-103,251

(Burimi SHFSH Punoi: KLSH)

Nga auditimit rezulton se:

❖ Kosto vjetore për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 për fëmijët e grup-moshës 6-18 vjeç kosto vjetore/person për shpenzime personale është llogaritur më pak për **13,613 lekë**.

❖ Kosto vjetore për vitin 2020 krahasuar me vitin 2018 për fëmijët e grup-moshës 6-18 vjeç kosto vjetore/ person për shpenzime personale është llogaritur më pak për **61,335 lekë**.

❖ Kosto vjetore për vitin 2021 krahasuar me vitin 2018 për fëmijët e grup-moshës 6-18 vjeç kosto vjetore/ person për shpenzime personale është llogaritur më pak për **103,251 lekë**.

Konkluzion: Nga sa më sipër rezulton se mosveprimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur mos indeksimit të kostos ditore të ushqyerjes së fëmijëve, dhe shpenzimeve personale mujore sipas çmimeve të konsumit të publikuara nga INSTAT, ka cenuar drejtpërdrejt ushqyerjen ditore të fëmijëve rezident në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 71 të VKM nr.518 datë 04.09.2018 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar* ö.

Veprimet e mësipërme janë në kompetencë të:

1. Znj. S.L për periudhën 15.07.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NA të institucionit.
2. Znj. A.H për periudhën 01.01.2019 e ne vazhdim në cilësinë e NZ të institucionit
3. K.L me detyrë ish-mjeke institucioni për periudhën 01.01.2019 deri në 01.12.2021, në cilësinë mjekut të institucionit, pjese e grupit multifunksional dhe personi ngarkuar me përgjegjësi për e përcaktimit të menuesë së ushqyerjes së fëmijëve sipas Rregullorja e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli”, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, ne pikën nr.4 “detyrat funksionale të mjekut”.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 10, datë 12.07.2022

Në lidhje Akt Konstatimin Nr.10, datë 12.07.2022 ka bërë komente dhe shpjegime shpjegime znj. S.L, dhe në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A.H ne cilësinë e Përgjegjës së Sektorit të Administratës, si më poshtë:

Ne lidhje me hartimin dhe hartimin e menuesë së fëmijëve ju informojmë se mjeku i institucionit është person kompetent dhe ekspert i fushës në përcaktimin e cilësisë së ushqimit që duhet të konsumohet për çdo fëmijë në përputhje me moshën , gjendjen shëndetësore, dëshirat e fëmijëve dhe në zbatim të rregullores së brendshme të institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

<i>Titulli i Gjetjes:</i>	<i>Mos respektimi dhe mos indeksimi vjetor i kuotës ushqimore</i>
<i>Situata</i>	<p>Për fëmijët që përfitojnë shërbime publike në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, për muajt e përzgjedhur për auditim, ka mospërputhje në vlerë ditore dhe mujore në zbatimin e nivelit e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve. Kjo mospërputhje tregon se nga stafi SHFSH Tiranë, nuk është zbatuar niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, veprim në mospërputhje me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit nr. 689, datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore.</p> <p>➤ Ligji 121/2016 në nenin 24 pika 6 përcakton se Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve. Por lidhur me standardet e shërbimeve sociale shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelit e përcaktimit të tarifave, MSHMS nuk ka nxjerrë akte të reja nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.</p> <p>Ushqyerja e fëmijëve shkollorë bazohet në menu të ushqyerjes së fëmijëve, e cila hartohet çdo javë nga grupi i hartimit të menusë e llogaritur në vlerë, bazuar në numrin e fëmijëve (force ditore) dhe kuotën miratuar sipas grup moshës. Lidhur me nevojat dietore të fëmijëve për lëndë ushqyese dhe kalori, menuja ushqimore përgatitet për të gjithë fëmijët e institucionit pa dallim grup- moshe, gjinie ose gjendjeve të veçanta. Nga auditimi rezulton se menutë ushqimore hartohen nga mjeku, përgjegjësja e sektorit social, financierja, dhe kuzhinierja dhe miratohet nga titullari i institucionit. Në hartimin e menusë nuk merr pjesë ekipi multidisiplinar, veprim në mospërputhje me kërkesat Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës òZyber Hallulliò, me nr. 2712 Prot, datë 31.12.2015, neni òdetyrat funksionale te mjekutò, pika 4.</p> <p>Vlera në lekë e përcaktuara për kuotën ditore për fëmijët nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore që duhet të konsumojnë fëmijët, për shkak të mos respektimit të saj nga institucioni, dhe mos indeksimit të kuotës ushqimore sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT. Për pasojë vlerat e kuotës së ushqyerjes në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021, për muajt e përzgjedhur për auditim, kanë qenë më të ulëta se kuota e miratuar, kjo e fundit përgjegjësi drejtpërdrejt e SHFSH Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e MSHMS. Mosveprimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur mos indeksimine kosmos ditore te ushqyerjes se fëmijëve, dhe shpenzimeve personale mujore sipas çmimeve të konsumit të publikuara nga INSTAT, ka cenuar drejtpërdrejt ushqyerjen ditore te fëmijëve rezident në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 71 të VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.</p> <p>Personeli SHFSH, që merret për përgatitjen e menusë së ushqyerjes së fëmijëve, nuk ka njohuri me standardet e ushqyerjes të përcaktuara të nxjerra nga MSHMS.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Kriteri:	<p>Ligji nr. 121/2016, datë 21.11.2016 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror në RSHö.</p> <p>VKM nr.659, datë 17.10.2005, òPër standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale</p> <p>VKM Nr. 195, datë 11.4.2007 òPër Miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, në Qendrat Rezidenciale, për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimiö</p> <p>Udhëzimi MSHMS nr. 830, datë 14.04.2008 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike ö</p> <p>VKM nr.518, datë 04.09.2018 òPër Shërbimet e Kujdesit Shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitimin e tyre, dhe masën e shumës për shpenzime personaleö, kreu V</p> <p>Udhëzimi MSHMS nr.689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, për nivelin e miratuar i kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve, sipas grup moshës së tyre.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>➤ Nga auditimi rezultoi se për muajt e përzgjedhur Shkurt, Mars të vitit 2019, bazuar në përmbledhësen mujore te konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor përkatësisht për muajin Shkurt 2019 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 61,832 lekë deri +9,413 lekë ose mospërputhja mujore -5,161 lekë, për muajin Mars 2019 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -3,968 lekë deri +4523 lekë ose mospërputhja mujore -129,831 lekë. Ne muajin mars 2019 ka një mospërputhje te konsiderueshme midis nevojës për konsum ushqimor dhe konsumit faktit te ushqyerjes se fëmijëve.</p> <p>Për muajt e përzgjedhur për auditim Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor të vitit 2020, ka mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor. Bazuar në përmbledhësen mujore te konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, se për muajin Shator 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 64,614 lekë deri +6,870 lekë, mospërputhja mujore -17,504 lekë; për muajin Tetor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 63,747 lekë deri +6,080 lekë, mospërputhja mujore -30,656 lekë, për muajin Nëntor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 66,681 lekë deri +3,616 lekë, mospërputhja mujore -6,444 lekë. Për muajin Dhjetor 2020 mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga 67,276 lekë deri +5,928 lekë. Në datën 31.12.2020 mospërputhja mujore +61,119 lekë, pasi me rastin e festes se vitit te ri, fëmijët kanë konsumuar më tepër se kuota ushqimore. Konsumi ushqimor i datës 31.12.2020 është tejkaluar në shumë të konsiderueshme, dhe nuk justifikohet me një menu te veçantë që justifikon ushqimin e konsumuar nga fëmijët.</p> <p>Për vitin 2021, nga auditimi i ushqyerjes se fëmijëve sipas menisë së ushqyerjes, bazuar në përmbledhësen mujore te konsumit faktik të ushqyerjes së fëmijëve, rezultoi mospërputhje midis nevojës për konsum dhe konsum faktik ushqimor, për muajin janar mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -3,968 lekë deri +4523 lekë ose mospërputhje mujore -182 lekë, për muajin qershor mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -4,941 lekë deri +5498 lekë ose mospërputhja mujore -1,631lekë; për muajin korrik mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -1,982 lekë deri +3006 lekë ose mospërputhja</p>

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

mujore -263 lekë, për muajin gusht mospërputhjet janë çdo dite të muajit dhe variojnë nga -3,928 lekë deri +3980 lekë ose mospërputhja mujore - 4,140 lekë.

➤ **Efektet vjetore te mos indeksimit te kuotës ushqimore.**

Për të tre grup moshat e fëmijëve kosto vjetore e vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 është llogaritur më pak ne shumen **15,031 lekë/ person**.

Për gjithë grup moshat kosto vjetore e vitit 2020 krahasuar me vitin 2018 është llogaritur më pak ne shumen **34,231 lekë/për person**.

Për gjithë grup moshat kosto vjetore e vitit 2021 krahasuar me vitin 2018 është llogaritur më pak ne shumen **55,779 lekë**.

Kosto ditore e indeksuar sipas grupit te auditimit:

Grup moshë	Kosto ditore e ushqyerjes	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2019	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2020	Kosto ditore e ushqyerjes indeksuar /2021
	lekë/person	lekë/person	lekë/person	lekë/person
6-12 vjeç	440	453	469	487
13-15 vjeç	480	494	512	532
16-18 vjeç	500	515	533	554

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Kosto vjetore e ushqyerjes për fëmijë sipas grup moshës

Grup moshë	Kosto mujore/person	Ndryshimi 2019/2018	Ndryshimi 2020/2018	Ndryshimi 2021/2018
6-12 vjeç	440	- 4,657	-10,607	-17,284
13-15 vjeç	480	- 5,081	-11,571	-18,855
16-18 vjeç	500	- 5,293	- 12,053	-19,641
Totali		- 15,031	- 34,231	- 55,779

(Burimi INSTAT: Punoi KLSH)

Shkaku:

1. Mos respektimi SHFSH i kuotës se miratuar nga **Udhëzimi MSHMS Nr. 689, datë 2.10.2018, òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore.**

2. Mos indeksimi kuotës se ushqyerjes sipas kriterëve të **VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò, në paragrafin 71**

Rëndësia:

Mosrespektimi kuotës ditore për ushqim për fëmijë dhe mos indeksimi saj janë në dëm të sasisë dhe cilësisë së ushqimit që kanë marrin fëmijët përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion.

Rekomandime:

➤ Hartimi menusë të kryhet nga ekipi multidisiplinar, dhe të udhëhiqet nga standardet në fuqi të ushqyerjes, referuar grup moshës së fëmijëve, llojit të produktit ushqimor për konsum, normës ditore, vlerës në k/kalori, dhe në fund vlerësimi në vlerë duke respektuar kuotën ditore të miratuar nga MSHMS.

➤ Lidhur me zbatimin e standardeve të kërkuara për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve, deri në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe indeksimin e kuotave të ushqyerjes nga MSHMS, ekipi multidisiplinar i SHFSH, duhet të udhëhiqet nga Manuali òBazat e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p><i>ushqyerjes, ushqyerja e gruas shtatzënisë, ushqyerja e fëmijës</i> modul i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë ne vitin 2011, në bashkëpunim me rekomandimet e UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët), OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe FAO, (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë).</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Deri ne nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ekipi multidisiplinar i SHFSH të kërkojë të trajnohet nga SHSSH mbi njohjen dhe zbatimin e Manualit mbi bazat e Ushqyerjes. ➤ SHFSH në bashkëpunim me SHSSH, të njoftojnë MSHMS mbi efektet e mos indeksimit të kuotës ushqimore, me qëllim neni paragrafit 71, të VKM 518/2018 të gjejë zbatim në praktikë, duke ndikuar në mirëqenien e fëmijëve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.
--	--

Në lidhje Projekt Raport Auditimit ka bërë komente dhe shpjegime znj. S.L, në cilësinë e titullarit të institucionit, dhe znj. A.H ne cilësinë e përgjegjës se Administratës me shkresën nr. 239 prot, date 26.08.2022, protokolluar në KLSH me nr. 381/5 prot, date 30.08.2022 si më poshtë vijon:

Ne lidhje me rekomandimin nr.13.1: Nisur nga afati kohor i lidhjes se kontratave (2 vjeçar) janë plotësuar nevojat e fëmijëve duke mos cenuar mirëqenien e tyre. Patjetër që marrja e masave nga institucioni do te jete e menjëhershme në rast nevoje, konform rregullave në fuqi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së} :

Ne observacionin e paraqitur shprehet vullneti i drejtueses se institucionit për përmirësimin e punës ne të ardhmen, konform rregullave ne fuqi dhe rekomandimeve te grupit te auditimit.

Titulli i Gjetjes:	Mos respektimi dhe mos indeksimi vjetor të shpenzimeve personale për fëmijë
Situata	Për periudhën objekt auditimi, në SHFSH, Tiranë nuk ka gjetur zbatim indeksimi shpenzimeve personale që kanë përfituar fëmijët rezident në SHFSH, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 71, të VKM 518/2018 <i>“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar</i> ”, pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoriteti përgjegjës për shërbimet sociale nuk kanë marrë masa për zbatimin e kësaj dispozite.
Kriteri:	Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave qe ju jepet kategorive përfituese për shpenzime personale janë përcaktuar në Udhëzimin e nr. 689, datë 02.10.2018 <i>“Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</i>
Ndikimi/Efekti:	Ne bazë të përlllogaritjeve të grupit të auditimit, efektet vjetore nga mos indeksimi shpenzimeve personale për person rezultoi si më poshtë vijon: Për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen 1,029 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale për 348 leke/person, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen 1,544 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale janë llogaritur më pak për 522 lekë/person. Për vitin 2020 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen 1,066 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

	<p>shpenzime personale për 793 leke/person, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen 1,599 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale 1,189 leke/person.</p> <p>Për vitin 2021 krahasuar me vitin 2018 rezulton për fëmijët e grup-moshës 6-15 shpenzimeve personale vjetore për person pas indeksimit duhet të bëhen 1,108 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale 1,291 leke/person, për fëmijët e grup-moshës 15-18 shpenzimeve personale vjetore për person j pas indeksimit duhet të bëhen 1,661 leke/person, për pasojë SHFSH për një vit ka llogaritur më pak shpenzime personale 1,937 leke/person.</p> <p>Indeksi i shpenzimeve mujore personale për person</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Grup moshë</th> <th>Shpenzime personale</th> <th>Indeksi shpenzimeve personale viti 2019</th> <th>Indeksi shpenzimeve personale vitin 2020</th> <th>Indeksi shpenzimeve personale viti 2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>6-15 vjeç</td> <td>1,000</td> <td>1,029</td> <td>1,066</td> <td>1,108</td> </tr> <tr> <td>15-18 vjeç</td> <td>1,500</td> <td>1,544</td> <td>1,599</td> <td>1,661</td> </tr> </tbody> </table> <p>(Burimi : INSTAT Punoi: KLSH)</p> <p>Efektet vjetore të indeksimit e shpenzimeve personale për person</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Grup moshë</th> <th>Shpenzime personale</th> <th>Ndryshimi 2019/2018</th> <th>Ndryshimi 2020/2018</th> <th>Ndryshimi 2021/2018</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>6-15 vjeç</td> <td>1,000</td> <td>-348</td> <td>-793</td> <td>-1,291</td> </tr> <tr> <td>15-18 vjeç</td> <td>1,500</td> <td>-522</td> <td>-1,189</td> <td>-1,937</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>-870</td> <td>-1,981</td> <td>-3,229</td> </tr> </tbody> </table> <p>(Punoi: KLSH)</p>	Grup moshë	Shpenzime personale	Indeksi shpenzimeve personale viti 2019	Indeksi shpenzimeve personale vitin 2020	Indeksi shpenzimeve personale viti 2021	6-15 vjeç	1,000	1,029	1,066	1,108	15-18 vjeç	1,500	1,544	1,599	1,661	Grup moshë	Shpenzime personale	Ndryshimi 2019/2018	Ndryshimi 2020/2018	Ndryshimi 2021/2018	6-15 vjeç	1,000	-348	-793	-1,291	15-18 vjeç	1,500	-522	-1,189	-1,937			-870	-1,981	-3,229
Grup moshë	Shpenzime personale	Indeksi shpenzimeve personale viti 2019	Indeksi shpenzimeve personale vitin 2020	Indeksi shpenzimeve personale viti 2021																																
6-15 vjeç	1,000	1,029	1,066	1,108																																
15-18 vjeç	1,500	1,544	1,599	1,661																																
Grup moshë	Shpenzime personale	Ndryshimi 2019/2018	Ndryshimi 2020/2018	Ndryshimi 2021/2018																																
6-15 vjeç	1,000	-348	-793	-1,291																																
15-18 vjeç	1,500	-522	-1,189	-1,937																																
		-870	-1,981	-3,229																																
Shkaku:	Mos indeksimi shpenzimeve personale për fëmijët sipas kriterëve të VKM nr.518 datë 04.09.2018 <i>“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitare rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, në paragrafin 71.</i>																																			
Rëndësia:	Duke marrë në konsideratë rritjen e çmimeve për artikujt ushqimor, sipas publikimit të INSTAT, mos indeksimi shpenzimeve personale për fëmijë është cilësisë së jetës që marrin fëmijët përgjatë kohës që ata janë rezident në institucion.																																			
Rekomandime:	MSHMS të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e indeksimit të çmimeve në bashkëpunim me SHSSH me pasojë në shpenzimet personale mujore për fëmijë, në zbatim të neni 71, të VKM 518/2018 veprim që ndikon direkt në mirëqenien e fëmijëve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.																																			

Në përfundim të auditimit rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, në hartimin e fondit limit për procedurat e prokurimit me objekt “Blerje mallra ushqimorë të realizuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021, me vlerë totale të fondit limit 3,504,935 lekë pa TVSH nuk ka paraqitur procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit, në të cilën duhet të përfshiheshin elementët (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasitë e kalorive ditore që i duhet çdo fëmije sipas grup moshave). Gjithashtu, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

bazë të auditimit u konstatua se, VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò Kreu V si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, kanë përcaktuar nivelin e kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për fëmijët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror sipas grup moshës, por nuk kanë përcaktuar sasi të kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 92-117, të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë e varësisë në Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa, për përmirësimin e VKM nr.518 datë 04.09.2018 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuarò, duke përcaktuar sasi të kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës si dhe në bashkëpunim me INSTAT të bëjë përditësimin e ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit nëpërmjet Udhëzimit të Ministrisë të MSHMS, me qëllimsaktësimin e mënyrës së përcaktimit të vlerës ditore të shpenzimeve për secilin fëmijë në përputhje me nevojat për ushqim.

Brenda vitit 2022

B. MASAT ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga stafi i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, nuk është zbatuar niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të Udhëzimit nr. 689, datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqëroreò.

Ligji 121/2016 në nenin 24 pika 6 përcakton se Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve. Por lidhur me standardet e shërbimeve sociale shtetërore dhe metodologjinë dhe nivelin e përcaktimit të tarifave, MSHMS nuk ka nxjerrë akte të reja nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Lidhur me nevojat ditore të fëmijëve për lëndë ushqyese dhe kalori, menyuja ushqimore përgatitet për të gjithë fëmijët e institucionit pa dallim grup-moshe, gjinie ose gjendjeve të veçanta. Në hartimin e menysë nuk merr pjesë ekipi multidisiplinar, në mospërputhje me kërkesat Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shtëpisë së Fëmijës òZyber Hallullio. Vlera në lekë e përcaktuar për kuotën ditore për fëmijët nuk i përgjigjet të njëjtës sasi ushqimore që duhet të konsumojnë fëmijët, për shkak të mos respektimit të saj nga institucioni, si dhe mos indeksimit të kuotës ushqimore sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT.

Për pasojë vlerat e kuotës së ushqyerjes në vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021, për muajt e përzgjedhur për auditim, kanë qenë më të ulëta se kuota e miratuar, kjo e fundit përgjegjësi drejtpërdrejt e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, dhe akoma me e ulët për shkak të mos indeksimit të çmimeve, përgjegjësi kjo e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Niveli i kuotave financiare të shpenzimeve për Ushqime, nuk është i përditësuar, duke qëndruar në vlera të njëjta të kostos ditore për çdo grup moshe të fëmijëve, prej vitit 2018, ndonëse përgjatë këtyre viteve ka inflacion të madh dhe rritje çmimesh në produktet ushqimore bazë, si pasojë e situatës së Covid-19 dhe situatave globale.

Kështu, nisur nga të dhënat e INSTAT në faqen zyrtare, në lidhje me ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, për grupin òUshqime dhe pije alkoolikeò, nga grupi i auditimit u përllogaritën se sa duhet të ishin ndryshuar këto kuota çdo vit, për koston ditore për secilin grup moshë, duke konstatuar se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Për grup moshën 6-12 vjeç, nga 440 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 487,35 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 47 lekë/ditë.

Për grup moshën 13-15 vjeç, nga 480 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 531,66 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 52 lekë/ditë.

Për grup moshën 16-18 vjeç, nga 500 lekë/ditë në vitin 2018, në fund të vitit 2021 duhej të bëhej në 553,81 lekë/ditë, pra do të ishte rritur me 54 lekë në ditë.

Sa më sipër, mos përditësimi i ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit nga institucioni i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, ka ndikuar drejtpërdrejtë në llogaritjen e fondit limit, vlerë e cilanuk jep garanci të jetë përlllogaritur saktë dhe në përputhje me nevojat ditore fëmijëve për ushqim duke shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore për secilin grup moshe për fëmijë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 faqet 92-117 dhe pikën 7 faqet 190-208, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë të marrë masa të menjëhershme që hartimi i menysë ditore të fëmijëve të kryhet nga ekipi multidisiplinar dhe të udhëhiqet nga standardet në fuqi të ushqyerjes, referuar grup moshës së fëmijëve, llojit të produktit ushqimor për konsum, normës ditore, vlerës në k/kalori, dhe në fund vlerësimi në vlerë duke respektuar kuotën ditore të miratuar nga MSHMS.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.2: Lidhur me zbatimin e standardeve të kërkuara për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve, deri në përmirësimin e kuadrit rregullator nga MSHMS, ekipi multidisiplinar i Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, duhet të udhëhiqet nga Manuali *ëBazat e ushqyerjes, ushqyerja e gruas shtatzënë, ushqyerja e fëmijës* modul i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2011, në bashkëpunim me rekomandimet e UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët), OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe FAO, (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë).

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 1.3: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për trajnimin e stafit të Shtëpisë së Fëmijëve Zyber Hallulli Tiranë (ekipit multidisiplinar), mbi njohjen dhe zbatimin e Manualit mbi bazat e Ushqyerjes deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, në Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë nuk ka gjetur zbatim indeksimi i shpenzimeve personale që kanë përfituar fëmijët rezident, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 71, të VKM 518/2018 *ëPër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar, pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoriteti përgjegjës për shërbimet sociale nuk kanë marrë masa për zbatimin e kësaj dispozite. (Trajtuar më hollësisht pikën 7 në faqet 190-208, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 2.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, ti drejtohen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masat e duhura për indeksimin e shpenzimeve personale mujore për fëmijë, në funksion të rritjes së mirëqenies e fëmijëve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tirane ka paraqitur kërkesë për shpenzime për investime për shumën 2,419 mijë lekë në PBA 2019-2021, PBA 2020-2022, PBA 2021-2023, të cilat nuk u miratuan në buxhetin vjetor të shpenzimeve. Mos miratimi i fondeve për investime në qendrën rezidenciale për ndërtimin e shkallëve të emergjencës mund të çojë në rrezikimin e jetës së fëmijëve në rastet e rënies së zjarrit, ndërsa mos përmirësimi i mobilimit në apartamentet e fëmijëve ndikon në uljen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

cilësisë së kushteve të jetesës për fëmijët rezident. *(Trajtuar më hollësisht pikën 1 në faqet 28-39, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 3.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetërorë, përpara miratimit të buxhetit vjetor për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin ekërkesës për zërin òInvestimeò në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenien e fëmijëve rezident në institucion.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, të cilat dërgohen në Shërbimin Social Shtetëror. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve të masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. *(Trajtuar më hollësisht pikën 1 në faqet 28-39, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 4.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, të marrë masa, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8-mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Njësia shpenzuese përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2019, 2020 dhe 2021, nuk ka kryer procesin e inventarizimit për aktivet gjendje në magazine, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Për vitin 2019, Nëpunësi Autorizues nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit dhe nuk ka përcaktuar një afat të përfundimit të procesit të inventarizimit. Komisioni nuk ka bërë relacion përmblendës për NA, lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë ose në përdorim. Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur proces verbal, pa prezencën e personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale që ka në ngarkim ose përdorim aktivin, pa përcaktuar nëse këto aktive duhet të dalin jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material apo asgjësimit përfundimtar. Proces Verbal nuk është hartuar në tre kopje, nuk është protokolluar në arkiv. NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve. Komisioni i Inventarizimit, nuk ka nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit për anëtarët tij. Në përbërje të Komisionit të Inventarizimit rezultojnë të njëjtët anëtarë me ata të vitit paraardhës. Komisioni i Asgjësimit ka mbajtur Proces Verbal për aktivet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimi, por pa përcaktuar metodën e asgjësimit (nëpërmjet groposjes ose djegies), veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30, 84, 100, 104 germa òcò, 105, 109, 110. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3 në faqet 47-67, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 5.1: Titullari i institucionit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë në bashkëpunim me Përgjegjësen e Sektorit të Administratës (financiare), të marrë masat e duhura që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të përmirësojë të metat dhe mangësitë e konstatuara lidhur me zbatimin me përpikëri procedurës për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, duke eliminuar mungesën e urdhrit për ngritje komisioni, mungesën e deklaratës së shmangies se konfliktit të interesit, mungesën e mbajtjes së proces verbalit në formën e duhur, duke shmangur vendosjen e të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite të njëpasnjëshëm, mungesën e firmosjes nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesën e relacionit për titullarin, etj.



Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 5.2:Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Regjistrimit të Aktiveve të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit të përzgjedhura për auditim u konstatuan mangësi të dokumentacionit, sinë 1 nga dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit;në 6 nga dosjet mungojnë certifikatat personale të punonjësve dhe në 2 nga dosjet mungon librezat e punës. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2 në faqet 39-47, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 6.1:Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i administruar në auditim, stafi përkatës i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë nuk ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete nga ofrues të akredituar sipas ligjit, pasi nuk është ofruar asnjë i tillë, në kundërshtim me VKM nr. 624, datë 29.07.2020 për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqërorë. Pika 3 e këtij vendimi përfshin si subjekte të certifikimit punonjësit socialë dhe psikologët e ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Megjithatë procesi i certifikimit ndahet në cikle 5-vjeçare, profesionistët e shërbimeve shoqërore duhet të marrin një numër minimal kreditesh çdo vit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 1 në faqet 22-30, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 7.1:Shërbimi Social Shtetëror të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, të cilët janë subjekt i VKM nr. 624, datë 29.07.2020.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:Nga analiza e pasqyrës të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto konstatohet se Llogaria 214 të Inventar ekonomik, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) duhet të ishte pasqyruar vlera bruto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, paragrafi 3.6 të Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4 në faqet 68-77, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 8.1:Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi:Nga analiza e pasqyrës të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto) konstatohet se subjekti ka përdorur normën 5% për përlogaritjen e amortizimit vjetor të Mjeteve të Transportit, dhe jo normën 20%, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 36. (Trajtuar më hollësisht në pikën 4 në faqet 68-77 të Raport Auditimit).

Rekomandimi 9.1. Të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor të òMjeteve të transportitò me normën 20% në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi Nga analiza e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj netoò konstatohet se Llogaria 218 òInventar ekonomikò, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 425,000 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò duhet të ishte pasqyruar vlera buto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. Gjithashtu për një pjesë të aktiveve të regjistruara në këtë llogari është përlllogaritur amortizimi vjetor në vlerën prej 5% dhe jo në vlerën 20% nëse nuk janë pajisje elektronike, e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit Financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò paragrafi 36 òRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet netoò. (Trajtuar më hollësisht në pikën 4 në faqet 68-77, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 10.1: Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj netoò dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Rekomandimi 10.2: Të bëhet sistemimi dhe përlllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 òInventar ekonomikò në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2021 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur.

Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve òpajisje elektronikeò janë regjistruar në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe jo në llogarinë në llogarinë 218600 òpajisjeve elektronikeò pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është llogaritur me normën 25 % dhe jo 20%.

Një pjesë e pajisje òzyre orendiò janë regjistruar në llogarinë 214 òInstalime Teknike makineri, pajisjeò dhe jo në llogarinë në llogarinë 218 òInventarë ekonomikò, por pa ndikim material në pasqyrat financiare. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 òPër disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik ò. (Trajtuar më hollësisht në pikën 4 në faqet 68-77, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 11.1: Të bëhet një klasifikim i saktë në llogaritë përkatëse për çdo aktiv që në momentin e hyrjes në magazine si dhe të bëhet një sistemim në llogaritë përkatëse për të gjitha aktivet e institucionit.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të procedurave tenderuese u konstatua se, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò në cilësinë e autoritetit kontraktor, ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

mungesë të njohurive ligjore/ nënligjore nga ana e personelit të angazhuar në prokurime publike si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP mbi prokurimet publike, për pasojë janë evidentuar mangësi dhe problematika, si vijon:

Nga Titullari i AK janë vendosur persona të njëjtë në komisionet e hartimit të fondit limit, në njësinë e prokurimit, në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe në vendosjen e emrit të njëjtë të personit, për ndjekjen e ecurisë së kontratës. Autoriteti Kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallulli, për tre vitet në auditim 2019, 2020 dhe 2021, ka realizuar tre procedura ÷Blerje Ushqimesh për fëmijët në Shtëpinë e fëmijëve shkollorë, Tiranë ÷negocim pa shpallje me vlerë të fondit limit 3,504,935 lekë pa TVSH ose në vlerë kontrate 3,936,834 lekë me TVSH, për shkak të mos realizimit në kohë nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) si dhe 3 procedura për vitin 2020 ÷Shërbim roje civile në Shtëpinë e fëmijëve shkollorë, Tiranë me vlerë të fondit limit 2,488,402,13 lekë pa TVSH, për shkak të mos realizimit në kohë nga ÷I.Gö SH.A. Kështu realizimi i tyre, rezultoi me mangësi të cilësisë së hartimit të Dokumenteve Standarde (DST), të cilësisë për llogaritjen e fondit limit, të cilësisë për hartimin e kontratave, deri në përzgjedhjen e operatorit fitues.

Nga auditimi i procedurave ÷negocim pa shpallje referuar DST shtojcës 1 (Formulari i ftesës për pjesëmarrje), nga njësia e prokurimit i është dërguar ftesë për ofertë 3 operatorëve ekonomik, por nuk rezulton arsyetimi mbi përzgjedhjen e tyre.

Në lidhje me procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. 61.prot, datë 09.04.2020, u konstatua se të gjithë urdhrat e miratuara nga titullari i AK, kanë një numër të ndryshëm protokoll, specifikisht, urdhri për ngritjen e KVO, Grupit për llogaritjen e fondit limit, si dhe urdhri i prokurimit, nuk mban të njëjtin numër protokoll në seri, në kundërshtim me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1.

Në lidhje me procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, prill për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr. nr. 61.prot, datë 09.04.2020 dhe procedurën me objekt ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, sipas Urdhër Prokurimi nr.17, datë 30.09.2020 me fond limit prej 306.666,4 lekë pa TVSH u konstatua se, nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Nga auditimi i procedurave tenderuese për periudhën 2019-2021, Titullari i AK ka miratuar procedurat e prokurimit pa paraqitjen dhe përpilimin e Raportit Përmbledhës nga KVO.

Mungon gjurma e auditimit, që lidhet me përgatitjen e informacionit në mënyrë të vazhdueshme, mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe si pasojë nuk është hartuar raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, si dhe nuk janë referuar problemet e hasura gjatë zbatimit me qëllim marrjen e masave për zgjidhjen e tyre. Në përfundim të kontratës nuk është mundur as dërgimi i një kopje të këtij raporti APP-së, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin Publik ÷ i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ÷ i ndryshuar, Kreu VII (Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave) neni 35, pika 4, neni 56, 57, 58, 68, neni 77, pika 3 dhe 4; Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ÷Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike ÷ pika 6 paragrafi 2, si dhe Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ÷ i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 79-185, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 12.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallulli, në cilësinë e institucioneve të varësisë, të marrë masa për personat të cilët do të angazhohen në realizimin, monitorimin e procedurave të prokurimeve publike, për trajnimin e tyre të vazhdueshëm pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për të marrë përgjegjësinë dhe



detyrat, për realizimin e hartimit të kërkesave dhe kritereve në përzgjedhjen e operatorit fitues konform kuadrit ligjor dhe rregullator të procedurave tenderuese, për ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke synuar forcimin e kontrollit të brendshëm, për të mirë menaxhuar fondet buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për prokurim me objekt òblerje Ushqimeshò për periudhën 2019-2021, u konstatua se, nga AK Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò, sipas procesverbaleve të paraqitura për përllogaritjen e fondit limit nga grupet për hartimin e fondit limit, nuk kanë paraqitur argumentimin e vlerave përkatëse si dhe nuk e kanë detajuar, duke e ndarë specifikisht në elementë si (numri i fëmijëve përfitues të ndarë sipas grup moshave, sasi të e kalorive ditore që i duhet çdo fëmijë sipas grup moshave), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 28, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar neni 59:

(a)Nga auditimi i procedurës së prokurimit òblerje Ushqimesh për fëmijëtò me Urdhër Prokurimi nr.3 prot 119/1 datë 11.04.2019, me fond limit në vlerën prej 1,070,000 lekë pa TVSH u konstatua se, numri i fëmijëve rezultoi 41 fëmijë (llogaritur me metodën e mesatarizimit për 30 ditë), ku shpenzimi mujor për 41 fëmijë është (1,070,000/3muaj = 356,667 lekë/ në muaj) si dhe shpenzimi ditor për fëmijët (356,667 lekë/muaj/30 ditë= 11,889 lekë/ditë për 41 fëmijë).

Ndërsa, në bazë të Udhëzimit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, duke u nisur nga grup moshat 6-18 vjeç, shpenzimet ditore janë në vlerën prej 473 lekë/ditë x41 fëmijë =19,393 lekë/në ditë.

Sa më sipër, përllogaritja e fondit limit kosto ditore për 41 fëmijë është 11,889 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 19,393 lekë, pra me një diferencë prej 7,504 lekë/ditë për 41 fëmijë, ose e thënë ndryshe **183 lekë më pak për secilin fëmijëò, përgjegjësi e grupit të hartimit të fondit limit.**

(b)Nga auditimi i procedurës òblerje artikuj ushqimorë për fëmijëtò me Urdhër Prokurimi nr.1 prot 282 datë 11.01.2021, me fond limit në vlerën prej 1,640,000 lekë pa TVSH, u konstatua se, numri i fëmijëve rezultoi 39 fëmijë (llogaritur me metodën e mesatarizimit për 31 ditë), ku shpenzimi mujor për 39 fëmijë është (1,640,000/6 muaj = 273,334 lekë/ në muaj) si dhe shpenzimi ditor për fëmijët (273,334 lekë/muaj/30 ditë= 9111 lekë/ditë për 39 fëmijë), kjo sipas proces verbalit të datës 11.01.2021.

Ndërsa, në bazë të Udhëzimit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò, duke u nisur nga grup moshat 6-15 vjeç, shpenzimet ditore janë në vlerën prej 460 lekë/ditë x 39 fëmijë =17,940 lekë/në ditë.

Sa më sipër, përllogaritja e fondit limit kosto ditore për 39 fëmijë është 9,111 lekë ndërsa sipas Udhëzimit kjo kosto është në vlerën prej 17,940 lekë/në ditë, pra me një diferencë prej 8,829 lekë/ditë për 39 fëmijë, ose e thënë ndryshe **226 lekë më pak për secilin fëmijëò, kjo në kundërshtim me nivelin e kuotave financiare për shpenzime ditore të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 òPër nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorò.**

Sa më sipër, për vitin buxhetor 2019 dhe vitin 2021,mënyra e përllogaritjes së fondit limit nga AK nuk është e saktë dhe si rrjedhim, janë shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore ose e thënë ndryshe **409 lekë më pak të vlerës ditore për secilin fëmijëò, duke cenuar detyrimin bazë të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, mbi përkujdesjen, respektin dhe përkushtimin ndaj fëmijëve, në kundërshtim me VKM nr. 518 datë 04.09.2018. (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 92-117, të Raport Auditimit).**



Rekomandimi 13.1: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa për ngritjen një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në për llogaritjen e fondit limit për produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, në plotësimin e nevojave ushqimore për fëmijët sipas standardeve kohore.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në hartimin e kontratave të prokurimeve, nga AK¹², nuk janë parashikuar si detyrime kontraktore për OE-të, disa elemente të rëndësishëm që i shërbejnë forcimit të kontrolleve, konkretisht:

-Identifikimi qartësisht i llojit të mjeteve ATV me targat respektive si dhe paraqitja e akteve administrative në lidhje me cilësinë ushqimore, në emër të operatorit ekonomik fitues, mungesa e të cilave, ka mundësuar ekzekutimin e kontratës nga palë të treta (dhe jo nga OE fitues), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar, neni 75 pika 1, pasi në DT nuk është parashikuar nënkontraktimi si opsion.

-Gjithashtu, rezultoi se, certifikatat shëndetësore veterinarë, lëshuar nga institucionet përkatëse, ose raport analizat e kryera nga AKU, janë paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të ndryshëm nga ata që kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese. Personat fizikë nuk figurojnë në listë pagesat e OE-së fituese, duke krijuar një situatë të paqartë se mbi çfarë bazë Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷ Zyber Hallulli ka lejuar përfshirjen në zbatimin e kontratës (pra ofrimin e ushqimeve) të disa personave që pa përfshirë më parë në asnjë prej procedurave të ndjekura për prokurimin e mallit në fjalë (Ushqime). Për më tepër që, sipas DST opsioni i nënkontraktimit nuk është i lejuar. Gjithë sa më sipër vë në diskutim cilësinë e ekzekutimit të kontratës. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 92-117, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 14.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷ Zyber Hallulli, në cilësinë e autoritetit kontraktor, të marrë masa që strukturat përgjegjëse tenderuese, të caktojnë kriteret e veçanta, për hartimin e kontratave me objekt furnizimin me produkte ushqimore, në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, për të siguruar forcimin e kontrolleve në të gjitha hallkat, me qëllim shmangien e risqeve për abuzime në sigurinë ushqimore dhe përfitimin e mallrave sipas cilësisë së kërkuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendosjes të kriterëve dhe kërkesave në DST, nga njësia e prokurimit me objekt ÷ Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë me Urdhër Prokurimit nr.189/3 datë 18.09.2020, u konstatua se:

- Në Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2, Kapacitetet teknike, pika 4, është kërkuar ÷ *Vërtetim për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Mars 2020 shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara në formë elektronike (Rekomandim i APP-së nr.8197 prot., datë 03.09.2019, fq.5) për jo me pak se 10 punonjës të siguruar. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit.* Grupi i auditimit konstaton se, vendosja e këtij kriteri nuk jep garanci nga OE për një zbatim sa më korrekt të kontratës, pasi procedura e tenderimit është kryer në shtator të vitit 2020 dhe njoftimi i fituesit është shpallur në tetor të vitit 2020, ndërsa listëpagesat për OE, nga AK janë

¹²1. Procedura me objekt “Blerje ushqimesh për institucionin “Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë” realizuar në prill të vitit 2019, lidhur Kontrata nr. 119/9, date 24.04.2019.

2.Procedura me objekt “Blerje ushqimor- vezë, mishi dhe nënproduktet e tij” realizuar në gusht të vitit 2020

3.Procedura me objekt “Blerje e artikujve ushqimorë, për nevojat e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë” realizuar janar të vitit 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

kërkuar për muajin janar-mars të vitit 2020. Gjithashtu nga auditimi i zbatimit dhe monitorimit të kontratës, duke u mbështetur në proces verbalet mujorë të mbajtur ndërmjet OE fitues dhe AK si dhe grafikut bashkëlidhur, rezultoi se punonjësit e cituar nuk figuronin në listë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të OE fitues, për muajt janar-shkurt-mars/2020, si dhe AK nuk kishte dijeni nëse këta punonjës që kryenin shërbimin e ruajtjes ishin të siguruar dhe deklaruar nga subjekti fitues në vijimësi.

Kriteri i përzgjedhur nga OE, bie në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 për Prokurimin Publik, të ndryshuar, pika 1, 2, dhe VKM nr.914 neni 28 pika 2.

Nga njësia e prokurimit të AK, vendosja e kriterit që Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj, 8 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga shpallja e njoftimit, o, nuk është i argumentuar në mënyrë të plotë, pasi OE fitues është me shkresën e sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me nr. 1824/49. Prot, datë 23.07.2020, konfirmon se deri në korrik 2020, ka në ruajtje objekte shtetërore-3 roje, objekte private- 3 roje dhe objekte në ruajtje private me verifikim sinjali-3 roje.

Numri i punonjësve në dispozicion sipas kontratave të lidhura për këto objekte është 29 punonjës. Në bazë të auditimit, sipas vërtetimit tip mbi numrin e punonjësve të siguruar për periudhën janar-gusht 2020, numri mesatar i punonjësve të siguruar është 28. Pra subjekti nuk ka numër të mjaftueshëm punonjësish për të kryer zbatimin e kontratave të lidhura me subjekte të ndryshëm. Sipas përlogaritjeve të mësipërme subjekti duhet të ketë jo më pak se 33 punonjës gjithsej. Kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit është i pa studiuar dhe nuk garanton në asnjë moment zbatimin korrekt të kontratës nga OE, veprime në kundërshtim me nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 138-152, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 15.1: Njësia e prokurimit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim argumentimin e kriterëve në DST, të cilat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ö

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë Zyber Hallulliö, dosjet e prokurimeve për të cilat kanë përfunduar procedurat përkatëse, nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 për arkivatë si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 79-185, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 16.1: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë Zyber Hallulliö, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Lidhur me zbatimin e kontratave për blerje ushqimesh, referuar kontratës nr. 2, datë 03.01.2019; kontratës nr.119/9, datë 24.04.2019, kontratës nr. 178, dt. 10.06.2019; kontratës nr.338, dt. 31.12.2019; kontratës nr.153/5, datë 27.08.2020; kontratës nr.281/3, dt. 18.01.2021 dhe kontratës nr.113, datë 21.06.2021 nga auditimi i dokumentacionit të dosjes/ve të prokurimit rezultoi se:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Në Komisionin e Pranimit të Mallit ngritur me urdhër të posaçëm të NA, nuk ka përcaktuar si pjesë të komisionit magazinierin e institucionit. Komisioni i Pranimit të Mallit, ka mbajtur proces verbal për çdo hyrje pjesore malli në magazinë, furnizim i kryer pjesë-pjesë, dhe me dokumentacion të përkohshëm. Komisioni nuk ka mbajtur një Proces Verbal Përmbledhës me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi të cilën është pranuar fatura tatimore, nuk ka evidentuar dokumentacionin e përkohshëm për pranimin e mallit. Proces Verbal/et, e pranimit të mallit (perime dhe zarzavate), pranimin e frutave, nuk kanë evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së pare, nuk kanë fletë analizë në rastin kur mallrat janë të freskëta, nuk kanë evidentuar nëse ambalazhimi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nuk kanë pasqyruar të dhëna treguesish cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, nëse furnizimi është në përputhje sipas standardit shtetëror të miratuar. Proces Verbal/et, pranimit të produktit **mish/ të përpunuar i mishit** (sallam, proshuta, etj.) nuk përmban të dhëna mbi vulën e kontrollit veterinar, të dhëna mbi certifikatën veterinare, e cila do të vërtetonte sigurinë e produktit, veprim në kundërshtim me kërkesat specifike të DST.

Proces Verbal/et, e pranimit të **bulmetrave** (*qumësht për konsum, djathë i bardhë dhe gjalpë i freskët*), nuk ka të evidentuar certifikatën e cilësisë për çdo furnizim parti prodhimi, për furnizimin me qumësht, certifikatën e analizës, për furnizimin me gjalpë të freskët, nuk ka evidentuar ambalazhin e paketimit të produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, masën bruto/ neto, dhe origjinën e prodhimit;

Për furnizimin me **vezë** nuk është përcaktuar nëse furnizimi është në përputhje me rregullat e Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët;

Për furnizimin **me bukë** gruri nuk evidentohet nëse furnizimi plotëson kërkesat e standardit shtetëror Nr. 1411, të vitit 1987, përcaktuar në specifikime teknike; nuk përcaktohet nëse ambalazhimi i bukës është sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

Sa më sipër, nga dokumentacioni dosjes së prokurimit, rezulton se për korrektësinë e cilësinë e zbatimit të kontratës, gjatë zbatimit të kontratës në pranimin e mallit nuk janë respektuar specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit lidhur me standardet shtetërore të kërkuar në DST.

Nga dokumentacioni i dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jenë hartuar Raport Përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj (kur ka) dhe një kopje i dërgohet dhe APP, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914/2016 *“Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 77 pika 3, 4; UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, neni 39 dhe 43 si dhe kontratat e furnizimit të lidhura me Kontraktuesit. (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 160-185, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 17.1: Autoriteti Kontraktor, duhet të mbajë një Proces Verbal (përmbledhës) me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi të cilën është pranuar fatura tatimore. Gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatë/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, bazuar në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kriterëve të kualifikimit të OE.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandimi 17.2: Dokumentacioni i pranimit të mallit të prokuruar duhet të evidentohet në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Proces verbalin të hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave të behet pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi



Rekomandimi 17.3: Autoriteti Kontraktor për kontratat e përfunduara të hartojë Raport Përmbledhës në të cilin të evidentojë cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të saj në rast se ka, masat e marra për zgjidhjen e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, kërkesat e ish-mjekes së institucionit për blerje të medikamenteve, nuk kanë arsyetuar domosdoshmërinë e blerjes së menjëhershme të medikamenteve, nuk kanë përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blerë sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist, përveç atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejtë. Komisioni/et për marrjen në dorëzim të mallit, ngritur nga NA përveç ish-mjekes së institucionit, në përbërje të tij nuk ka punonjës me njohuri mbi medikamentet si dhe nuk ka të përfshirë punonjës të përgjegjës të materiale. Medikamentet janë mallra të ambalazhuara, dhe në secilin prej tyre është vendosur pulla fiskale që tregon çmimin e blerjes, dhe datën e skadencës së tij. Në proces verbal mungon evidentimi çmimi i mallit, data e skadencës së tij. Proces Verballi mbajtur për blerje medikamentesh, nuk pasqyron numrin e kopjeve që janë mbajtur, nuk përcakton destinacionin e tij.

Për vitin 2019 dhe vitin 2020, medikamentet janë bërë hyrje në total, me dokument flet-hyrje e cila referon në listën e barnave që shoqërojnë faturën tatimore. Për vitin 2021 kemi përmirësim në regjistrim, pasi hyrjet janë bërë me artikuj. Regjistrimi i hyrjeve jo sipas artikujve të faturës, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 15. Po në të njëjtën datë ato bëhen dalje, me dokument flete- dalje, në ngarkim të ish-mjekes së institucionit, e cila për vitet 2019-2020, i përdor ato sipas rastit, duke lëshuar recete mjekësore dhe nënshkruhet nga edukatorja dhe kujdestarja. Marrja në ngarkim e medikamenteve nga mjekja e institucionit, bie ndesh me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, paragrafi 15; paragrafit 44 germa 6, paragrafit 50; si dhe me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Fëmijëve Shkollorë Zyber Hallullio, paragrafi 4, pika 2 dhe 6, si dhe paragrafi 18, (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 160-185, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 18.1: Nga ana e Autoriteti Kontraktor, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi me vlerë nën 100 mijë lekë, Komisioni i Blerjeve të Vogla duhet të dokumentojë me anë të një procesverballi domosdoshmërinë e blerjes së medikamenteve duke përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blerë sipas rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist sipas nevojës imediate për medikament, përveç të rasteve të sëmundjeve kronike ose atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte. Për çdo blerje medikamenti duhet të verifikohet dhe evidentohet afati i skadencës së medikamentit, sipas i cili minimalisht duhet të jetë mbi një vit nga data e blerjes së tij. Të ndërpritet përfundimisht mbajtja e medikamenteve nga mjeku i institucionit dhe mbajtja e tij të bëhet sipas rregullave të Udhëzimit nr.30/2011.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nuk ka pasur programe specifike për trajnimin e punonjësve për periudhën 2019 - 2021 referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 6Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ö, paragrafët 6Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreö dhe 6Profesionalizmi i stafitö. Institucioni nuk bën identifikim periodik të nevojave të stafit për trajnim në kundërshtim me nenin 42, pika 2 e ligjit 121/2016.Shërbim Social Shtetëror, si institucion epror për vlerësimin periodik të kapaciteteve dhe të nevojave për trajnim nuk e ka kryer këtë detyrë dhe nuk i ka propozuar bordit të edukimit të vazhdueshëm objektin e trajnimeve të profesionistëve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, në kundërshtim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

ligjin 121/2016, VKM nr. 135, datë 07.03.2018 òPër miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 185-190, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 19.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë dhe Shërbimi Social Shtetëror të bëjnë vlerësimin periodik të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim të stafit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në mënyrë që procesi i edukimit të vazhdueshëm të jetë në formën e duhur.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, institucioni nuk ka një kod etike të mirëfilltë dhe të miratuar. Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë përdor një format standard në formë deklarate, i cili titullohet “Kodi i Etikës” dhe nënshkruhet nga punonjësit. Në këtë dokument përcaktohen shprehimisht zotimet etike të punonjësit të institucionit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 185-190, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 20.1: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë të miratojnë një dokument të Kodit Etik për veprimtarinë e Shtëpisë së fëmijëve.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve personale të stafit konstatohet se për periudhën në auditim, nuk janë përfshirë në dosjet e punonjësve, vlerësimet periodike të tyre, detyrë e Drejtorit të Institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 11 të Rregullores së Brendshme. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 185-190, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 21.1: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të bëjnë pjesë të dosjeve përkatëse të personelit, vlerësimet periodike që kryhen për punonjësit e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë.

Në vazhdimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, me objekt furnizimin me produkte ushqimore, u konstatua, si më poshtë vijon:

1.1 Në faturat e thjeshta të shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues, për çdo furnizim me produkte ushqimore të freskëta, kanë munguar kritere që lidhen me specifikimin e llojit të makinave apo targat e tyre, të cilat janë të ndryshëm nga kriteret e veçanta të kualifikimit në DT.., Këto veprime kanë sjellë që komisionet e pritjes së mallit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò, kanë pranuar dërgesat e produkteve ushqimore nga palë të treta, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 75 pika 1, pasi në DT. nuk është i lejuar nënkontraktimi.

1.2 Certifikatat shëndetësore veterinarë dhe/ose raport analizat e kryera nga AKU, nuk janë paraqitur në emër të operatorit ekonomik fitues, sikundër përcaktohen në kriteret e veçanta të kualifikimit në DT., të plotësuar nga fituesi në tender, por janë të paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese.

1.3 Për rastet e konstatuara, nuk është paraqitur fatura tatimore e blerjes së mallrave për të verifikuar nëse produkti është blerë nga të tretët.

1.4 Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas. Sa më sipër, në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë òZyber Hallulliò rezultuan: (i) kontrole të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave; (ii) mosparashikimi si detyrime kontraktore për OE-të, të elementeve, llojin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

automjeteve me targa, certifikatat ushqimore, kushtet e transportit me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore; (iii) komisionet në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallulliö të miratuara në fillim viti buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallranga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrrur);

Pra në total nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ÷Zyber Hallulliö, **vlera 3,936,834 lekë** është paguar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö i ndryshuar, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö pika 35 dhe 36, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik ö, i ndryshuar, neni 59, 60, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö i ndryshuar, neni 75 pika 1 dhe neni 77, me Kontratë pika V (Afati i zbatimit) pika 5. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 92-117, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje me monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, konstatohet se në 3 rastet e procedurave të llojit ÷Negocim pa shpallje paraprake të njoftimitö për ÷Blerje Ushqimeshë, të kryera nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë për periudhën 2019-2021, janë lidhur Kontratat e Furnizimit me nr. 119/9, datë 24.04.2019; Kontrata e Furnizimit ÷Blerje Ushqimeshë me nr. 153/5 prot, datë 27.08.2020; si dhe Kontrata me nr. 281/3 prot, datë 18.01.2021. Nga Njësia e Prokurimit nuk është justifikuar përzgjedhja e të njëjtëve operatorë ekonomikë pjesëmarrës, është lënë një afat shumë i shkurtër në sjelljen e ofertave nga OE të ftuar për pjesëmarrje, dhe në DST nuk është përcaktuar grafiku i lëvrimit në shkelje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 si dhe nenit 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 ÷Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö duke krijuar një proces konkurrimi jo transparent.

Në DST, në rubrikën ÷Kriteret e veçanta të kualifikimitö nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për çdo mjet motorik (ATV) dhe ambientin që e përdor për kryerjen e aktivitetit, duhet të paraqesë akt miratimin higjiëno ósanitar (AMHS) të lëshuar nga institucioni shtetëror, referuar ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 ÷Për inspektimin sanitarö i ndryshuar, **neni 12.** Operatorët Ekonomikë kanë paraqitur aktet higjiëno sanitare të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, kohë përpara dhe pa afat vlefshmërie, veprime jo në koherencë me realizimin e procedurës dhe në pa pajtueshmëri me ndryshimet ligjoretë përcaktuara në ligjin nr.54/2020 datë 30.04.2020 ÷Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 ÷Për inspektim sanitarö, i cili ka shfuqizuar nenin 12. Për rrjedhojë, mbas datës 30.04.2020, KVO nuk duhet të pranonte aktet higjiëno-sanitare, pasi ato kanë humbur efektin juridik për shkak të shfuqizimit të dispozitës ligjore. Sa më sipër përzgjedhja e OE fitues është bërë në mospërputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö i ndryshuar neni 66. **Vlera prej 3,936,834 lekë** përbën shpenzim pa ekonomikitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5 në faqet 92-117, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 2.1: Ministria e Shëndetësisë si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, në cilësinë e institucionit të varësisë, të marrin masa, për ngritjen



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në kontratat me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Rekomandimi 2.2: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në të gjitha procedurat hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit, të procedurës me objekt ÷ Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr.61/prot, datë 09.04.2020, rezultoi se: grupi për hartimin e fondit limit nuk ka kryer saktë llogaritjen e tij në një vlerë prej 951,91 lekë më pak, fakt ky që nuk është konstatuar nga KVO e ngritur sipas Urdhrit nr. 24, prot. nr. 60, datë 09.04.2020. Grupi i punës ka përlllogaritur vlerën e fondit limit 310,825.60 lekë ndërkohë që kjo vlerë duhet të ishte 311,777.51 lekë, fakt ky që shoqërohet edhe me një ofertë ekonomike e paraqitur më e vogël nga OE N. e cila ka ardhur po si pasojë e përlllogaritjes gabim të kostos ditore/roje dhe konkretisht në llogaritjen e shtesës së vështirësisë së pagës për roje për turnin e II, të cilën nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por me një koeficient më të lartë me 4,98 roje, ose me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të kostos së vështirësisë duke e ulur atë, e paraqitur në vijim:

1. OE $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\%$: **4.98**=27 lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

Grupi i auditimit:

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\%$: **3,32**= 40, 5 lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

2. OE Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+27 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,305.68 lekë/roje/ditë x 16.7 % sigurime shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Grupi i auditimit:

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+40,5 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,319.18 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sigurime shoqërore dhe shëndetësore = 220,30 lekë/roje/ ditë.

3. OE Paga ditore = 1,305.68 +218,04= 1523.72 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,058.75 lekë për një vendroje/ditë.

Grupi i auditimit:

Paga ditore = 1,319.18 +220,30= 1539,48 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,111.07 lekë për një vendroje/ditë.

4. OE/Kosto 61 ditë $5,058.75 \times 61 = 308,583.77 + 20\%$ tvsh= 370,300.50 lekë.

Grupi i auditimit:

$5,111.07 \times 61 = 311,775.49 + 20\%$ *311,775.49 =311,775.49 +62,355.09= **374,130.58 lekë** pra 3830,08 lekë më pak llogaritur nga OE.

Ky gabim në llogaritjen e fondit limit nuk është konstatuar nga KVO pasi në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 58, duke kualifikuar në mënyrë të padrejtë një ofertë të llogaritur gabim të cilat sjellin kosto në pagesa të gabuara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo individ të deklaruar në liste pagesënë kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar ÷ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

Shqipërisë si dhe në shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 për procedurat Tatimore në RSHÖ, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.

Sa më sipër, KVO ka pranuar një ofertë ekonomike (e vetmja e paraqitur) pa e analizuar saktë, duke arsyetuar thjesht si oferta më e ulët se fondi limit. Ndërkohë që nisur nga tipologjia dhe standardi i miratuar mbi mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, për procedurat e prokurimit me objekt ÷Shërbim roje civile ÷, koeficientet e marrë për bazë llogaritje janë të mirëpërcaktuar. Nisur nga ky fakt, duhet që KVO-ja të kontrollontepërlllogaritjen e ofertës fituese si dhe të arsyetonte, pse OE paraqitet në vlerë shumë ulët krahasuar me fondin limit.

Këto risqe shtohen edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura, i cili nga auditimi rezultoi konfuz mbi faza të caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mos njohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike, veprime që sjellin një përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **310,825.6 lekë**. (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 125-138, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 3.1: Nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të ngrihet një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësisë, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përlllogaritjen e fondit limit për shërbim roje civile, si dhe për mos konstatim të KVO të një oferte jo të saktë të paraqitur nga OE fitues, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të llojit ÷Marrëveshje kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me një afat 12 muajë, ÷Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë, sipas Urdhrit të Prokurimi nr. 189/3 datë 18.09.2020, me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, grupi i punës i ngritur për përlllogaritjen e fondi limit ka përcaktuar vlerën prej 1,870,910.13 lekë pa TVSH dhe një vlerë prej 46,950.46 lekë/roje/muaj. Në këtë procedurë kanë paraqitur ofertë 13 ofertues ku 12 prej tyre kanë dhënë të njëjtën ofertë mujore prej një vëndroje në muaj në vlerën **46,950.46 lekë/roje/muaj** dhe vetëm OE ÷S.ö ka dhënë vlerën prej 46,939.94 lekë/roje/muaj ose 10,52 lekë më pak dhe si rrjedhim është shpallur fitues për vlerën më të ulët. Por KVO nuk ka vlerësuar saktë këtë ofertë pasi në të njëjtën mënyrë llogaritje vepron edhe OE "S.", por ai nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje pasi diferenca për të cilën ai është shpallur fitues është vetëm 10,52 lekë më pak në kosto mujore dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes me të njëjtin standard matematikor, dhe konkretisht:

OE, Koston mujore e llogarit: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96 \text{ lekë}$, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që do të ishte:

$1543.57 * 365 / 12 = 46,950,25 \text{ lekë}$, pra subjekti ka kryer gabim veprimin me dashje pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rumbullakosur numrin 12/365, ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht rumbullakimi i numrit sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29 \text{ lekë}$ më pak, për vëndroje/muaj duke e shpallur fitues OE.

Pra AK (KVO), ka vepruar në mospërputhje ligjore duke përzgjedhur fitues OE ÷Sö si çmimi më i ulët, pasi ky OE ka pasur të njëjtën vlerë oferte, por ka përlllogaritur gabim numrin e ditëve mujor/vjetorë duke e shprehur në njërin rast 30,41 ditë dhe në llogaritjen tjetër 12/365 duke llogaritur një kosto mujore/ditore për një vënd/roje për vetëm 10.29 lekë më pak, vlerë e pasaktë.

Nisur edhe nga Udhëzimi i APP nr. 15, datë 26.11.2018ö Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 öPër përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, pika 1, paragrafi i fundit citon se *÷Vlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës*



KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

së ofertës së dhënë për 1 (një), vendroje në muaj, nga ku AK ka bërë vlerësim për operatorët pjesëmarrës për çmimin mujor për 1 roje dhe jo vlerën e ofertës për një vendroje në muaj. Duke ecur në të njëjtën logjikë citon se oferta e S. është jo ligjore pasi nuk ka zbatuar bazën ligjore të sipërcituar duke nxjerre një kosto mujore për një roje prej 46,939.94 lekë duke paguar më pak sigurime shoqërore në shkellje të ligjit.ö.

Nisur nga sa më sipër KVO, duhet të kishte analizuar diferencën për 10 lekë më pak të ofertës se paraqitur, cila shpalli fitues OE, pasi standardi mbi mënyrën e llogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit për Shërbim Rojeë përcakton të njëjtët koeficientë të vështirësisë të kostos ditore/vendroje dhe të njëjtën pagë minimale në vlerën 39,000 lekë. Në këtë mënyrë AK, grupi i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të ankesave vlerëson të saktë, koston mujore për një roje/muaj të sjellë nga OE Sh.ö duke omohuar vetenö, pra duke pranuar që fondi limit nuk është në vlerën e duhur ose ka gabime në përlllogaritje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3. Kualifikimi i OE S. fitues është bërë në kundërshtim Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 Për prokurimin publikö, i ndryshuar, neni 55, pika 3.

Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që fondi prej **2,547,853 lekë** është përdorur pa ekonomicitet, eficencë dhe ekonomicitet nga Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë. (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 138-152, të Raport Auditimit).

Rekomandimi 4.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa në ngritjen e një grupi pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme dhe të pakushtëzuara, për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë vitit 2020 për tre procedurat Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, përkatësisht:

1-Me fond limit në vlerën 310,825.6 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata me nr. 65, datë 23.04. 2020, ndërmjet Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë me Sh.ö, me Nipt JXX.

2-Me fond limit 306,666,4 lekë pa TVSH është lidhur kontrata ndërmjet Sh.ö me Nipt JXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 217, datë 09.10.2020.

3-Me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata ndërmjet Sh.ö me Nipt: KXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 247, datë 16.11.2020, u konstatua se:

1-Në asnjë nga faturat e sjella nga OE fitues nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat subjekti, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura janë pranuar nga përgjegjësi i sektorit të administratës, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 Për menaxhimin financiar dhe kontrollinö, i ndryshuar, neni 12, pika3, gërma ödhö dhe öeö.

2- U konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruar në listëpagesat përkatëse të muajve përkatës punonjësit që kryenin shërbimin e rojës, pasi nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga OE fitues, për muajt janar ömars 2020, kishte mospërputhshmëri në emrat e deklaruar krahasuar me proces verbalet, duke rrisur zbatimin korrekt të kontratës.

Grupi i auditimit, vlerëson se, listëpagesat e muajve koherente për të cilët kryhet shërbimi i rojës duhet të ishin pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbimi për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet, veprime këto në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

3- Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që vlera prej **3,154,550.22 lekë** për Shërbim roje civile në Shtëpinë e Fëmijëve shkollorë Tiranë, është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficencë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 6 në faqet 125-152, të Raport Auditimit).*

Rekomandimi 5.1: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt òShërbim roje civile, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH-ës nëni 15 pika (b) dhe (c), ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, ***rekomandojmë Drejtorit të Shërbimit Social Shtetëror***, që referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkeljet dhe të vendosë marrjen e masave disiplinore òVërejte” deri në ***Largim nga puna***, për personat si vijon, lidhur me konstatimet:

(i) mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore, të mungesës së urdhrave për ngritje komisioni të inventarizimit, të shmangies së të njëjtëve anëtarë komisioni për dy vite të njëpasnjëshëm, mungesës së firmosjes nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale në proces verbalët përkatëse, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik;

(ii) në fushën e prokurimeve, për procedurat me objekt òBlerje ushqimesh për fëmijë duke miratuar, jo në mënyrë të saktë përlllogaritjen e fondit limit dhe si rrjedhim, janë shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore ose e ose e thënë ndryshe **409 lekë më pak të vlerës ditore për secilin fëmijë**, duke cenuar detyrimin bazë të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, mbi përkujdesjen, respektin dhe përkushtimin ndaj fëmijëve, në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar dhe Udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqërorë.

Përzgjedhja dhe miratimi i operatorit ekonomik fitues, të cilët kanë paraqitur aktet administrative AMHS të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) Dega Rajonale/Qarku përkatës, sipas ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 për inspektimin sanitarë i ndryshuar, **neni 12**, ndonëse nëni në fjalë është shfuqizuar më datë 30.04.2020), për rrjedhojë janë pranuar akte të panevojshme, të kundraligjshme si dhe akte të lëshuara disa vite përpara, jo në koherencë me realizimin e procedurës me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëni 66 "Shqyrtimi i ofertave"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

pika 3 dhe me DST për rrjedhojë, **vlera prej 3,936,834 lekë**, përbën shpenzim financiar, pa ekonomikitet, pa efikasitet dhe pa efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

Vendosja e të njëjtit punonjës pjesëmarrës në strukturat prokuruese, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 56 të, të LPP, 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, të cilët kanë njohuri të dobëta së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos hartimit dhe ndjekjes së trajnimeve që organizon APP mbi prokurimet publike, si dhe nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. ~~o~~ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

Në lidhje mbi monitorimin e kontratave të ushqimeve, u konstatuan kontrole të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e tyre, komisionet e pritjes së ushqimeve të miratuara në fillim viti buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallra nga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrrur.)

(iii) në fushën e prokurimeve me objekt ~~o~~ Shërbim Roje, në cilësinë e titullarit të AK, duke miratuar veprimet e punonjësve të institucionit që drejton, duke konstatuar se:

Përlllogaritjen e fondit limit jo të saktë të vlerës së kontratës, në kundërshtim me ligjin 75/2014 Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, me ligjin nr. 74/2014 Për armët, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.157, datë 01.04.2016 Për shërbimin privat të sigurisë fizike, me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe me VKM nr.77, datë 28.01.2015 Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor;

Të anëtarëve të njësisë së prokurimit duke vendosur kriteret, në kundërshtim me ligjin 75/2014 Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, me ligjin nr. 74/2014 Për armët, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.157, datë 01.04.2016 Për shërbimin privat të sigurisë fizike, me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe me VKM nr.77, datë 28.01.2015 Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor;

Të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, duke përzgjedhur operatorin ekonomik fitues në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3. *(Trajtuar më hollësisht pikën 5 në faqet 92-117 dhe në pikën 6 në faqet 138-152, të Raport Auditimit)*.

1. Znj.S.L, me detyrë Drejtor i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë ~~o~~ Zyber Hallulli Tiranë dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Titullar i Autoritetit Kontraktor;

2. Znj.A.H, me detyrë përgjegjëse i sektorit të administratës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ)/ anëtare e përlllogaritjes së fondit limit/anëtare e njësisë së prokurimit/ anëtare e KVO;

3. Znj.E.L, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përlllogaritjen e fondit limit, të procedurave me objekt ~~o~~ Blerje ushqimeshë, kryetare e komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt ~~o~~ Shërbim roje civile;

4. Znj.S.H, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përlllogaritjen e fondit limit, të procedurave me objekt ~~o~~ Blerje ushqimeshë dhe ~~o~~ Shërbim roje civile;

5. Znj.E.K, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, të procedurave me objekt ~~o~~ Blerje ushqimeshë;

6. Znj.D.N, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt ~~o~~ Shërbim roje civile;

7. Znj.L.Aj, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt ~~o~~ Shërbim roje civile;

8. Znj.A.Zh, me detyrë me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

cilësinë e anëtarit e komisionit të pritjes së ushqimeve dhe anëtare e KVO me objekt òShërbim roje civileò;

9. Znj.E.D, me detyrë përgjegjëse e sektorit social në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;

10. Znj.M.I, me detyrë psikologe në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit me objekt òShërbim roje civileò.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

1. **Znj. F.A**, ish-kujdestare larguar nga Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përlogaritjen e fondit limit të procedurave me objekt òBlerje ushqimeshò dhe òShërbim Rojeò, anëtare e komisionit të inventarizimit;

2. **Znj.K.L**, ish-ish-mjeke në detyrë në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 01.12.2021, në cilësinë e anëtarit njësisë së prokurimit për procedurën me objekt òBlerje ushqimeshò, anëtare e komisionit të pritjes së ushqimeve;

3. **Znj.B.B**, ish- edukatore në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë larguar nga puna në datë 14.09.2020, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me objekt òBlerje ushqimeshò;

4. **Znj.Xh.F**, me detyrë ish-kryekujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 10.11.2020, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me objekt òBlerje ushqimeshò;

5. **Znj.B.Gj**, me detyrë ish-punonjëse sociale në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, me arsim të lartë, profile juridik (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 15.07.2020, në cilësinë e kryetare e KVO me objekt òShërbim roje civileò.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



V. ANEKSI 1 - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinionëve të aplikuara nga KLSH.

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si òtheksimi i çështjes ò përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
 - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
 - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

Opinion i modifikuar. Opinion i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinion negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI 2 -QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1,5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1,5%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602, 606 dhe me llogarinë 231 u vlerësuan me 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Në mijë lekë

Struktura buxhetore (2019)	Shuma	Risk Factor (can be 0.7 or 2 or 3)	Çështjet për shqyrtim
Paga (600)	22,984	0.70	5
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (601)	3,750	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	18,693	2.00	21
604	0	0	0
Transferime korente me jashtë (605)	0	0	0
606	0	0	0
Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)	0	0	0

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2019, grupi i auditimit mori në shqyrtim 70 raste për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 6 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 102 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 150 çështje të llogarive 602, 605, 606 dhe 231 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione

Në mijë lekë

Struktura buxhetore (2020)	Shuma	Risk Faktor (can be 0.7 or 2 or 3)	Çështjet për shqyrtim
Paga (600)	23,257	0.70	5
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (601)	3,902	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	18,077	2.00	21
604	0	0	0
Transferime korente me jashtë (605)	0	0	0
606	0	0	0
Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)	0	0	0

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2020, grupi i auditimit mori në shqyrtim 70 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 6 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 105 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 159 çështje të llogarive 602, 605, 606 dhe 231 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Në mijë lekë

Struktura buxhetore (2021)	Shuma	Risk Faktor (can be 0.7 or 2 or 3)	Çështjet për shqyrtim
Paga (600)	105,564	0.70	7
Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore(601)	17,378	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	81,194	2.00	16
604	0	0	0

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Transferime korente me jashtë (605)	0	0	0
606	0	0	0
Shpenzime kapitale të trupëz. (231)	0	0	0

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2021, grupi i auditimit mori në shqyrtim 52 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 7 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 140 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë nga 215 çështje të llogarive 602, 605, 606 dhe 231 që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

Nga analiza e pasqyrës òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj netoò konstatohet se Llogaria 214 òInventar ekonomikò, ka pësuar ulje si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën prej 341,280 lekë, vlerë për të cilën nuk është sqaruar nëse është vlerë e mbetur apo është vlera bruto e këtyre aktiveve. Nëse është vlerë e mbetur atëherë në formatin 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò duhet të ishte pasqyruar vlera bruto e tyre dhe anasjelltas, pasi mospasqyrimi i drejtë i ndryshimit ndikon në vlerën neto të aktiveve dhe në vlerën e fondit neto të institucionit.

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Në mijë lekë

Nr	EMERTIMI	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
		Fakti	U Audituan	Fakti	U Audituan	Fakti	U Audituan
1	Pagat (600)	22,984	25%	23,257	35%	21,434	37%
2	Sig. Shoqërore	3,750	25%	3,902	35%	3,605	37%

U audituan me zgjedhje listë pagesat e muajve tetor-nëntor-dhjetor për vitin 2019, listë pagesat tetor-nëntor 2020 si dhe janar-shkurt-mars për vitin 2021- Në listë pagesat e zgjedhura u audituan numri i punonjësve të paguar me kohë të plotë dhe kontratë të përkohshme, paga sipas funksionit, shtesat e veçanta, prezenca, vjetërsia, llogaritja e ndalesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

2.Mbulimi me auditim i shpenzimeve të realizuara nga institucioni, veprimet me bankën. (llogaria 602, 605, 606)

Dokumentacioni i audituar i shpenzimeve të bankës është përzgjedhur bazuar në vlerën më të lartë:

Në mijë lekë

Periudha	Transaksione në numër			Transaksione në vlerë (në lekë)		
	Kryer	Audituar	Përqindje	Likuiduar	Audituar	Përqindje
01.01.2019-31.12.2019	198	170	86%	46,690	40,153	85%
01.01.2020-31.12.2020	229	183	80%	45,270	36,216	80%
01.01.2021-31.12.2021	267	213	80%	43,669	34,935	80%
SHUMA	694	566		135,629	111,304	

3. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye duke patur parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlera e procedurave të realizuara;
- Lakimi në median e shkruar;
- Risku që shoqëron procedura të caktuara nisur nga niveli i gjetjeve në auditimet e tjera, etj..:

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË***(Në mijë lekë)*

Viti	Parashikuar		Realizuar		% ndaj parashikimit	Audituar		% ndaj realizimit
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë		Numër	Vlerë	
Janar -dhjetor 2019	17	2,749,280	13	2,331,666	84.81%	4	1,508,003	64.67%
Janar -dhjetor 2020	26	7,152,440	23	3,532,175	49.38%	7	2,130,493	60.32%
Janar -dhjetor 2021	18	3,530,000	14	2,897,430	82.08%	4	2,180,501	75.26%

Viti	Parashikuar		Realizuar			Parashikuar për auditim		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	% ndaj parashikimit	Numër	Vlerë	% ndaj realizimit
Janar -dhjetor 2019	17	2,749,280	13	2,331,666	84.81%	4	1,508,003	64.67%
Janar -dhjetor 2020	26	7,152,440	23	3,532,175	49.38%	7	2,130,493	60.32%
Janar -dhjetor 2021	18	3,530,000	14	2,897,430	82.08%	4	2,180,501	75.26%
Totali	61	13,431,720	50	8,761,271		15	5,818,997	66,75 %

ANEKSI 3: “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale monetare” nga faqja 47-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Donacionet Për Vitin 2019

Nr.	Emri i Donatorit	Muaji	Dokumenti	Artikulli	Vlera(Lekë)
1	E.B	Janar	fh.nr 1 datë 16.01.2019	Ushqime	4,550.00
2	Sh. C	Janar	fh.nr2 date16.01.2019	Ushqime	29,700.00
3	B.O	Janar	fh.nr1 datë 04.01.2019	Artikuj te ndryshëm shtëpiak	36,710.00
4	A.T	Janar	fh.nr2 date04.01.2019	Lodra te ndryshme	4,990.00
5	J. Gj	Shkurt	fh.nr4 datë 28.02.2012	Ushqime+ detergjent	22,934.00
6	Sh.....	Shkurt	fh.nr 53date 28.02.2012	Ushqime	81.00
7	U. P	Mars	fh.nr5date20.03.2019	Orendi shtëpiake	22,400.00
8	Sh.P. B	Mars	fh, nr 4 date28.03.2019	Lodra te ndryshme	900.00
9	Sh.P.B	Maj	fh.nr 6 datë 08.05.2019	Veshje	10,000.00
10	Xh.P	Qershor	fh.nr 8 datë 12.06.2019	Tharëse rrobash e përdorur	10,000.00
11	B.G	Qershor	fh.nr 9date 25.06.2019	Frigorifer beko	38,990.00
12	I.P	Korrik	fh.nr 7 datë 09.07.2019	Lëngje	2,160.00
13	A.T.	Gusht	fh.nr.10 datë 01.08.2019	Veshje	9,000.00
14	Q	Gusht	fh.nr 8 datë 08.08.2019	Ushqime	2,700.00
15	K.P.	Gusht	fh.11 datë 15.08.2019	Libra	16,500.00
16	A.T.	Tetor	fh.nr 9date 31.10.2019	Ushqime	5,600.00
17	V.F.	Tetor	fh.nr 12 datë 07.10.2019	Medikamente	63,488.00
18	M.B	Nëntor	fh.nr 10 datë 18.11.2019	Ushqime	11,870.00
19	Z.N.	Dhjetor	fh.nr 11 datë 02.12.2019	Ushqime	86,813.00
20	Sh.A	Dhjetor	fh.nr 14 datë 14.12.2019	Veshje	82,950.00
21	B.D	Dhjetor	fh.nr 15 datë 18.12.2019	Libra	600,000.00
22	U.T	Dhjetor	fh.nr 16 datë 24.12.2019	Jorgan	40,000.00
Totali 2019					1,102,336.00

Shpërndarja E Donacioneve Gjatë Vitit 2019.

Nr.Fl. Dalje	Data	Marrësi	Përshkrimi	Vlera
1	01.01.2019	kuzhina	Ushqime	4,800.00
2	02.01.2019	kuzhina	Ushqime	5,500.00
3	07.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,450.00
1	13.01.2019	kuzhina	Ushqime	440.00
2	14.01.2019	kuzhina	Ushqime	440.00
3	16.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,125.00
4	17.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,100.00
5	18.01.2019	kuzhina	Ushqime	2,225.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

6	21.01.2019	kuzhina	Ushqime	6,785.00
7	23.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,700.00
8	24.01.2019	kuzhina	Ushqime	800.00
9	25.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,200.00
12	26.01.2019	kuzhina	Ushqime	5,070.00
13	26.01.2019	kuzhina	Ushqime	4,410.00
11	27.01.2019	kuzhina	Ushqime	800.00
15	28.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,100.00
16	29.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,550.00
17	30.01.2019	kuzhina	Ushqime	1,600.00
17	31.01.2019	kuzhina	Ushqime	800.00
Total Dalje Janar 2019				42,895.00
17	01.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
18	02.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
19	03.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
20	04.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
21	05.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,750.00
22	05.02.2019	kuzhina	Ushqime	2,000.00
23	06.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
24	07.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
25	08.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
26	09.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,400.00
27	10.02.2019	kuzhina	Ushqime	5,400.00
28	11.02.2019	kuzhina	Ushqime	900.00
29	12.02.2019	kuzhina	Ushqime	21,410.00
30	13.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
31	14.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
32	15.02.2019	kuzhina	Ushqime	800.00
33	16.02.2019	kuzhina	Ushqime	5,550.00
34	17.02.2019	kuzhina	Ushqime	6,675.00
35	18.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
36	19.02.2019	kuzhina	Ushqime	4,025.00
37	20.02.2019	kuzhina	Ushqime	1,605.00
38	25.02.2019	kuzhina	Ushqime	4,000.00
39	26.02.2019	kuzhina	Ushqime	765.00
Total Dalje Shkurt 2019				66,280.00
40	03.03.2019	kuzhina	Ushqime	2,400.00
41	04.03.2019	kuzhina	Ushqime	2,610.00
42	05.03.2019	kuzhina	Ushqime	848.00
43	06.03.2019	kuzhina	Ushqime	8.00
44	07.03.2019	kuzhina	Ushqime	8.00
45	08.03.2019	kuzhina	Ushqime	12.00
46	08.03.2019	kuzhina	Ushqime	3,960.00
47	09.03.2019	kuzhina	Ushqime	5,065.00
48	11.03.2019	kuzhina	Ushqime	765.00
49	13.03.2019	kuzhina	Ushqime	765.00
50	22.03.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
51	23.03.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
52	25.03.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
53	27.03.2019	kuzhina	Ushqime	765.00
54	29.03.2019	kuzhina	Ushqime	360.00
55	30.03.2019	kuzhina	Ushqime	180.00
Total Dalje Mars 2019				20,266.00
56	01.04.2019	kuzhina	Ushqime	1,560.00
57	02.04.2019	kuzhina	Ushqime	200.00
58	03.04.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
59	11.04.2019	kuzhina	Ushqime	300.00
60	12.04.2019	kuzhina	Ushqime	300.00
61	13.04.2019	kuzhina	Ushqime	1,040.00
62	14.04.2019	kuzhina	Ushqime	1,160.00



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

63	15.04.2019	kuzhina	Ushqime	320.00
64	16.04.2019	kuzhina	Ushqime	961.50
65	16.04.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
66	21.04.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
67	26.04.2019	kuzhina	Ushqime	840.00
Total Dalje Prill 2019				9,361.50
68	3.05.2019	kuzhina	Ushqime	175.00
69	31.05.2019	kuzhina	Ushqime	870.00
Total Dalje Maj 2019				1,045.00
70	01.06.2019	kuzhina	Ushqime	1,000.00
71	02.06.2019	kuzhina	Ushqime	1,280.00
72	03.06.2019	kuzhina	Ushqime	1,280.00
73	04.06.2019	kuzhina	Ushqime	3,040.00
74	05.06.2019	kuzhina	Ushqime	1,080.00
75	10.06.2019	kuzhina	Ushqime	1,280.00
76	07.06.2019	kuzhina	Ushqime	300.00
Total Dalje Qershor 2019				9,260.00
77	15.07.2019	kuzhina	Ushqime	2,160.00
78	29.07.2019	kuzhina	Ushqime	550.00
Total Dalje Korrik 2019				2,710.00
79	06.08.2019	kuzhina		780.00
80	07.08.2019	kuzhina		780.00
81	08.08.2019	kuzhina		270.00
82	09.08.2019	kuzhina		2,430.00
83	16.08.2019	kuzhina		780.00
84	21.08.2019	kuzhina		290.00
85	26.08.2019	kuzhina		770.00
Total Dalje Gusht 2019				6,100.00
86	16.09.2019	kuzhina	Ushqime	1,400.00
Total Dalje Shtator 2019				1,400.00
87	19.11.2019	kuzhina	Ushqime	3,160.00
88	20.11.2019	kuzhina	Ushqime	1,140.00
89	21.11.2019	kuzhina	Ushqime	400.00
90	22.11.2019	kuzhina	Ushqime	2,300.00
91	23.11.2019	kuzhina	Ushqime	500.00
92	25.11.2019	kuzhina	Ushqime	1,300.00
93	26.11.2019	kuzhina	Ushqime	900.00
94	27.11.2019	kuzhina	Ushqime	500.00
95	28.11.2019	kuzhina	Ushqime	500.00
96	29.11.2019	kuzhina	Ushqime	620.00
Total Dalje Nëntor 2019				11,320.00
97	02.12.2019	kuzhina	Ushqime	5,600.00
98	24.12.2019	kuzhina	Ushqime	40.00
Total Dalje Dhjetor 2019				5,640.00

Materiale Te Tjera Industriale

Fd	Data	Përshkrimi	Destinacioni	Vlera
1	10.01.2019	xhup i bardh	apartamenti 2	5,000.00
2	21.01.2019	detergjent sole	apartamenti 2	950.00
	22.01.2019	solucion larje enësh	apartamenti 2	185.00
3	08.01.2019	solucion larje enësh	kuzhina	185.00
	08.01.2019	detergjent sole	apartamenti2	950.00
	08.01.2019	solucion larje enësh	apartamenti 2	185.00
	08.01.2019	detergjent sole	apartamenti 1	950.00
4	08.01.2019	solucion larje enësh	apartamenti 1	185.00
	08.01.2019	detergjent sole	apartamenti 1	950.00
	08.01.2019	solucion larje enësh	apartamenti 1	185.00
	10.01.2019	mushama shiu	apartamenti 1	800.00
	21.01.2019	batanije pambuku	apartamenti 1	2,400.00

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

total dalje janar 2019				12,925.00
5	11.02.2019	mbulesa tavolina	kuzhina	500.00
	11.02.2019	peshqirë	kuzhina	1,000.00
6	13.02.2019	komplet	apartamenti2	240.00
7	13.02.2019	komplet	migena korra	240.00
8	14.02.2019	kanatjere	apartamenti4	450.00
9	19.02.2019	top futbollli	apartamenti 4	100.00
10	19.02.2019	top futbollli	apartamenti 1.2	200.00
11	20.02.2019	komplet sportiv	apartamenti 4	960.00
	20.02.2019	tuta	apartamenti 4	1,500.00
	20.02.2019	triko	apartamenti 4	500.00
12	21.02.2019	ilaç rrobash	sanitaret	879.00
		solucion larje enësh	sanitaret	185.00
total dalje shkurt 2019				6,754.00
13	11.03.2019	çorape	apartamenti 4	500.00
14	12.03.2019	mbulesa buke	apartamenti 1	1,750.00
total dalje mars 2019				2,250.00
15	02.04.2019	çantë	apartamenti nr 1	2,000.00
16	02.04.2019	pulover	apartamenti nr 2	2,298.00
17	05.04.2019	top futbollli	apartamenti nr 2	450.00
18	05.04.2019	top futbollli	apartamenti nr 1	450.00
19	09.04.2019	pazella	apartamenti nr2	800.00
		monopoli	apartamenti nr2	500.00
		shah	apartamenti nr2	700.00
		letra bixhozi	apartamenti nr2	200.00
		lapustila	apartamenti nr2	300.00
		lapsa	apartamenti nr2	50.00
		fletore vizatimi	apartamenti nr2	600.00
		ngjyra	apartamenti nr2	240.00
20	15.04.2019	top futbollli	apartamenti nr 1	400.00
21	19.04.2019	boksa	apartamenti 4	3,860.00
total dalje prill 2019				12,848.00
22	3.05.2019	detergjent ava	apartamenti 4	1,450.0000
23	06.05.2019	peshqir sysh	apartamenti 4	500.0000
		xhup	apartamenti 4	2,000.0000
		triko	apartamenti 4	2,535.0000
		mbathje për çuna	apartamenti 4	210.0000
		çorape te bardha	apartamenti 4	80.0000
		çorape te bardha	apartamenti 4	150.0000
		bluze	apartamenti 4	500.0000
24	07.05.2019	detergjent sole +lëng	apartamenti nr2	879.9900
		bluza sportive	apartamenti nr2	2,100.0000
		çorape te bardha	apartamenti nr2	2,178.0000
25	07.05.2019	çorape te bardha	apartamenti 4	1,782.0000
		mbathje për çuna	apartamenti 4	490.0000
		pirun	apartamenti 4	100.0000
		luge	apartamenti 4	30.0000
26	07.05.2019	çorape te bardha	apartamenti 3	1,584.0000
		pirun	apartamenti 3	180.0000
		mbathje për goca	apartamenti 3	800.0000
		detergjent sole +lëng	apartamenti 3	879.9900
27	09.05.2019	detergjent ava	apartamenti nr 1	1,450.0000
		piruna	apartamenti nr 1	240.0000
		lapustila	apartamenti nr 1	14.0000
28	12.05.2019	mbulesa tavoline	kuzhina	250.0000
29	12.05.2019	pirun	apartamenti nr2	100.0000
		çarçaf	apartamenti nr2	1,440.0000
30	13.05.2019	batanije te holla	apartamenti nr 1	6,000.0000
		mbulesa tavoline	apartamenti nr 1	600.0000
		peshqir sysh	apartamenti nr 1	1,250.0000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

		mbathje për goça	aprtamenti nr 1	1,100.0000
		mbathje për cuna	aprtamenti nr 1	700.0000
		kanatjere e thjeshte	aprtamenti nr 1	2,000.0000
		bluze me mëngë te gjera	aprtamenti nr 1	280.0000
		çorape te bardha	aprtamenti nr 1	450.0000
		çorape	aprtamenti nr 1	1,683.0000
		bluza	aprtamenti nr 1	2,500.0000
31	13.05.2019	mbulesa tavoline	kuzhina	600.0000
32	21.05.2019	detergjent sole +lëng	apartamenti 4	879.9900
33	28.05.2019	ilaç rrobash	apartamenti 3	1,150.0000
34	28.05.2019	mbulesa tavoline	sanitaret	300.0000
total dalje maj 2019				41,415.97
35	04.06.2019	ilaç rrobash	apartamenti 3	1,150.00
		çorape	apartamenti 3	198.00
36	05.06.2019	ariel	apartamenti 4	1,100.00
37	10.06.2019	shapka	apartamenti 4	2,200.00
38	10.06.2019	shapka	apartamenti 2	2,200.00
39	10.06.2019	shapka	apartamenti 3	1,600.00
40	13.06.2019	lapustila	apartamenti 1	16.00
41	13.06.2019	shapka	apartamenti 1	3,000.00
total dalje qershor 2019				11,464.00
42	11.07.2019	shapka	apartamenti 3	600.00
43	12.07.2019	shapka	apartamenti nr2	400.00
44	16.07.2019	sobe	kuzhina	20,000.00
total dalje korrik 2019				21,000.00
45	07.08.2019	çorape	ap1	100.00
46	07.08.2019	peshqir sysh	sanitaret	250.00
total dalje gusht 2019				350.00
46	19.09.2019	prize treshe	mirëmbajtje	555.00
		shkop perde	mirëmbajtje	869.00
total dalje shtator 2019				1,424.00
47	07.10.2019	ilaçe	qkte	50,618.00
48	07.10.2019	ilaçe	doktoresha	12,870.00
49	08.10.2019	mushama shiu	ap1	3,600.00
50	09.10.2019	xhins	ap3	4,880.00
51	22.10.2019	blender beko	kuzhina	2,000.00
52	22.10.2019	lapustila	ap4	9.00
53	28.10.2019	lapustila	ap3	9.00
total dalje tetor 2019				73,986.00
54	04.11.2019	mushama shiu	ap3	400.00
55	04.11.2019	mushama shiu	ap4	2,850.00
56	12.11.2019	çorape dimri	ap1	1,500.00
57	12.11.2019	çorape	ap3	1,200.00
58	27.11.2019	lodra për tërmetin	sh.s.sh	2,869.00
total dalje nëntor 2019				8,819.00
59	05.12.2019	zgjatues	sanitaret	555.00
total dalje dhjetor 2019				555.00
totali janar-dhjetor 2019				193,790.97

Te Ardhura Nga Sponsora 2019		0 (lekë)
------------------------------	--	----------

Nr. Fd	Data	Marrësi	Përshkrimi	Vlera
1	17.01.2020	Kuzhina	Ushqime	2980
2	20.01.2020	Kuzhina	Ushqime	40
3	26.01.2020	Kuzhina	Ushqime	40
4	28.01.2020	Kuzhina	Ushqime	327
5	29.01.2020	Kuzhina	Ushqime	1638
6	31.01.2020	Kuzhina	Ushqime	4300
Total Dalje Janar 2020				9,325.00
7	07.02.2020	Kuzhina	Ushqime	4300
8	10.02.2020	Kuzhina	Ushqime	2980
9	11.02.2020	Kuzhina	Ushqime	550
10	17.02.2020	Kuzhina	Ushqime	2980
11	26.02.2020	Kuzhina	Ushqime	4470
Total Dalje Shkurt 2020				15,280.00
12	02.03.2020	Kuzhina	Ushqime	4943
13	03.03.2020	Kuzhina	Ushqime	3347
14	04.03.2020	Kuzhina	Ushqime	950
15	08.03.2020	Kuzhina	Ushqime	3555
16	09.03.2020	Kuzhina	Ushqime	5432.5
17	10.03.2020	Kuzhina	Ushqime	2760
18	15.03.2020	Kuzhina	Ushqime	2628
19	16.03.2020	Kuzhina	Ushqime	6258
20	22.03.2020	Kuzhina	Ushqime	2628
21	25.03.2020	Kuzhina	Ushqime	2628
Total Dalje Mars 2020				35,102.50
22	06.04.2020	Kuzhina	Ushqime	1971
23	08.04.2020	Kuzhina	Ushqime	890
24	09.04.2020	Kuzhina	Ushqime	3045
25	10.04.2020	Kuzhina	Ushqime	445
Total Dalje Prill 2020				6,351.00
26	01.06.2020	Kuzhina	Ushqime	26271
27	08.06.2020	Kuzhina	Ushqime	2400
28	09.06.2020	Kuzhina	Ushqime	2400
29	12.06.2020	Kuzhina	Ushqime	1344
30	13.06.2020	Kuzhina	Ushqime	1344
31	14.06.2020	Kuzhina	Ushqime	2400
32	30.06.2020	Kuzhina	Ushqime	2560
Total Dalje Qershor 2020				37,375.00
33	14.07.2020	Kuzhina	Ushqime	1120
34	17.07.2020	Kuzhina	Ushqime	1120
35	21.07.2020	Kuzhina	Ushqime	3728
36	24.07.2020	Kuzhina	Ushqime	2800
37	28.07.2020	Kuzhina	Ushqime	4360
38	30.07.2020	Kuzhina	Ushqime	516
39	31.07.2020	Kuzhina	Ushqime	2560
Total Dalje Korrik 2020				16,204.00
40	03.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1290
41	04.08.2020	Kuzhina	Ushqime	4677
42	06.08.2020	Kuzhina	Ushqime	912
43	07.08.2020	Kuzhina	Ushqime	5495
44	09.08.2020	Kuzhina	Ushqime	823
45	10.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1001
46	11.08.2020	Kuzhina	Ushqime	4263
47	13.08.2020	Kuzhina	Ushqime	961
48	14.08.2020	Kuzhina	Ushqime	178
49	15.08.2020	Kuzhina	Ushqime	7678
50	16.08.2020	Kuzhina	Ushqime	823
51	18.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1710
52	19.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1571
53	20.08.2020	Kuzhina	Ushqime	4455
54	19.08.2020	Kuzhina	Ushqime	178
55	20.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1442
56	21.08.2020	Kuzhina	Ushqime	951
57	22.08.2020	Kuzhina	Ushqime	6928
58	23.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1596



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

59	24.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1304
60	25.08.2020	Kuzhina	Ushqime	4174
61	27.08.2020	Kuzhina	Ushqime	516
62	28.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1344
63	29.08.2020	Kuzhina	Ushqime	129
64	30.08.2020	Kuzhina	Ushqime	645
65	31.08.2020	Kuzhina	Ushqime	1215
Total Dalje Gusht 2020				56,218.00
66	01.09.2020	Kuzhina	Ushqime	3334
67	02.09.2020	Kuzhina	Ushqime	258
68	03.09.2020	Kuzhina	Ushqime	1315
69	04.09.2020	Kuzhina	Ushqime	570
70	05.09.2020	Kuzhina	Ushqime	129
71	06.09.2020	Kuzhina	Ushqime	645
72	08.09.2020	Kuzhina	Ushqime	4530
73	09.09.2020	Kuzhina	Ushqime	578
74	10.09.2020	Kuzhina	Ushqime	956
75	11.09.2020	Kuzhina	Ushqime	952
76	12.09.2020	Kuzhina	Ushqime	972
77	13.09.2020	Kuzhina	Ushqime	972
78	18.09.2020	Kuzhina	Ushqime	507
79	21.09.2020	Kuzhina	Ushqime	114
Total Dalje Shtator 2020				15,761.00
80	07.10.2020	Kuzhina	Ushqime	850
81	30.10.2020	Kuzhina	Ushqime	1404
82	31.10.2020	Kuzhina	Ushqime	1335
Total Dalje Tetor 2020				3,589.00
83	02.11.2020	Kuzhina	Ushqime	850
84	03.11.2020	Kuzhina	Ushqime	700
85	04.11.2020	Kuzhina	Ushqime	2196
86	07.11.2020	Kuzhina	Ushqime	711
87	08.11.2020	Kuzhina	Ushqime	225
88	09.11.2020	Kuzhina	Ushqime	750
89	10.11.2020	Kuzhina	Ushqime	1115
90	11.11.2020	Kuzhina	Ushqime	520
91	12.11.2020	Kuzhina	Ushqime	825
92	13.11.2020	Kuzhina	Ushqime	285
93	14.11.2020	Kuzhina	Ushqime	225
94	15.11.2020	Kuzhina	Ushqime	300
95	16.11.2020	Kuzhina	Ushqime	825
96	17.11.2020	Kuzhina	Ushqime	675
97	18.11.2020	Kuzhina	Ushqime	680
98	19.11.2020	Kuzhina	Ushqime	1115
99	20.11.2020	Kuzhina	Ushqime	324
100	21.11.2020	Kuzhina	Ushqime	355
101	25.11.2020	Kuzhina	Ushqime	1050
102	26.11.2020	Kuzhina	Ushqime	1040
103	30.11.2020	Kuzhina	Ushqime	830
Total Dalje Nëntor 2020				15,596.00
104	03.12.2020	Kuzhina	Ushqime	210.00
Total Dalje Dhjetor 2020				210.00
Totali Janar-Dhjetor 2020				211,011.50

Materiale Te Tjera Industriale

Fd	Data	Emërtimi	Destinacioni	Vlere
1	06.01.2020	Peshqir Sysh	Kuzhina	750.00
Total Dalje Janar 2020				750.00
2	11.02.2020	Xhupa	Ap4	6,000.00
Total Dalje Shkurt 2020				6,000.00
3	05.05.2020	Çorape	Ap2	200.00

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

4	06.05.2020	Çorape	Ap3	160
Total Dalje Maj 2020				360.00
5	02.06.2020	Ilac Sole	Kuzhine	1,110.00
6	06.06.2020	Peshqir Sysh	Ap2	500.00
7	06.06.2020	Çorape	Ap4	1,089.00
8	07.6.2020	Çorape	Ap1	200.00
9	07.06.2020	Çorape	Ap2	200.00
		Batanije	Ap	18,700.00
		Batanije	Ap	500.00
		Mbulesa		600.00
Total Dalje Qershor2020				22,899.00
10	02.07.2020	Babagjysh	Ap1	1.00
11	02.07.2020	Tv	Ap3	10000
Total Dalje Korrik 2020				10001.00
12		Ace	Sanitare	1,111.60
13		Sobe Venera	Kuzhina	20000
Total Dalje Gusht 2020				2,111.60
14	16.09.2020	Ace	Sanitare	1,111.60
Total Dalje Shtator 2020				1,111.60
15	02.10.2020	Çorape	Ap2	220.00
		Bluza	Ap	3,360.00
16	02.10.2020	Çorape	Ap1	220.00
		Peshqir	Ap1	1,500.00
17	06.10.2020	Çorape	Ap3	200.00
18	13.10.2020	Sobe Gatimi	Kuzhine	20,000.00
19	16.10.2020	Sobe	Qktvdhf	20,000.00
20	29.10.2020	Veshje	Sh.S.Sh	3,120.00
Total Dalje Tetor 2020				48,620.00
21	04.11.2020	Çorape	Ap4	1,200.00
22	04.11.2020	Atlete	Ap4	6,000.00
23	05.11.2020	Atlete	Ap1	5,500.00
24	05.11.2020	Atlete	Ap2	5,500.00
25	05.11.2020	Atlete	Ap3	4,500.00
26	17.11.2020	Ndërse Rrobash	Ap4	1,000.00
		Luge	Ap4	1,200.00
		Pirun	Ap4	1,200.00
		Filxhan Çaji	Ap4	840.00
		Kosh Rrobash	Ap4	350.00
27		Ndërse Rrobash	Ap2	1,000.00
Total Dalje Nëntor 2020				28,290.00
28	03.12.2020	Sete Kuzhine	Ap2	9,370.00
29	08.12.2020	Sete Kuzhine	Ap1	2,450.00
30	10.12.2020	Veshje Dhe Sete Kuzhine	Ap3	33,580.00
31	10.12.2020	Sete Kuzhine	Ap4	4,800.00
Total Dalje Dhjetor 2020				50,200.00
Total Dalje Janar Dhjetor 2020				170,342.6

Donacionet Për Vitin 2020

Nr	Emri I Donatorit	Muaji	Dokumenti	Artikulli	Vlera(Lekë)
1	E. K	Maj	fh nr1 datë 23.05.2020	Ushqime	100,004.00
2	R.	Korrik	fh nr2 datë 02.07.2020	Televizor	10,000.00
3	C.	Korrik	fh nr 3 datë 22.07.2020	Art. te ndryshëm	11,870.00
4	K.K	Korrik	fh nr 2 datë 01.08.2020	Ushqime	14,250.00
5	E.E	Shtator	fh.nr 4 datë 14.09.2020	Ushqime	10,370.00
6	I.B	Shtator	fh.nr 4 datë 30.09.2020	Veshje	60,000.00
7	R	Tetor	fh,nr 5 datë 08.10.2020	Sobe gatimi	20,000.00
8	Sh.B.D.A.	Tetor	fh.nr 6date 02.10.2020	Libra	89,000.00
9	R.K	Tetor	fh.nr 7 datë 22.10.2020	Tableta	100,000.00

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

10	R.B	Tetor	fh.nr 8 datë 22.10.2020	Laptop	464,000.00
11	I.L	Tetor	fh.nr 9 datë 26.10.2020	Veshje	21,500.00
12	D.Z	Nëntor	fh. nr. 10 datë 13.11.2020	Materj shtëpiake	52,700.00
13	I.B	Nentor	fh.nr 10.datë 11.11.2020	Lodra dhe veshje	95,020.00
14	L.I	Dhjetor	fh.nr 11 datë 29.12.2020	Dhurata	41,000.00
15	P.C	Dhjetor	fh.nr 13 datë 30.12.2020	Veshje	43,000.00
16	M.Sh.M.S	Dhjetor	fh.nr 14 datë 30.12.2020	Tableta	8,000.00
17	M. Sh	Dhjetor	fh.nr 15 datë 31.12.2020	Veshje	27,700.00
18	S. D	Dhjetor	fh.nr 16 datë 31.12.2020	Lodra	21,500.00
19	A.	Dhjetor	fh.nr 17 datë 31.12.2020	Veshje	43,000.00
20	O.K	Dhjetor	fh.nr 18 datë 31.12.2020	Telefon	8,000.00
21	S.M.	Dhjetor	fh.nr 5 datë 23.12.2020	Ushqime	5,120.00
	Totali				1,246,034.00

Shpërndarja E Donacioneve Gjatë Vitit 2020.

Te ardhura nga sponsora për 2020	274,600.00 (Leke)
---	--------------------------

Donacionet Për Vitin 2021

Nr	Emri I Donatorit	Muaji	Dokumenti	Artikulli	Vlera(Lekë)
1	A.	Janar	Fh.Nr 1date 21.01.2021	Ushqime	30,810.00
2	A.G	Janar	Fh.Nr 2date 29.01.2021	Kompjuter	232,800.00
3	H.Gj	Shkurt	Fh.Nr 3 Datë 26.02.2021	Lodra	6,000.00
4	L.A	Mars	Fh.Nr 4 Datë 02.03.2021	Batanije	49,500.00
5	A.Z	Prill	Fh.Nr 5 Datë 26.04.2021	Çarçaf	25,500.00
6	K.O	Prill	Fh .Nr 3date 26.04.2021	Ushqime	30,680.00
7	K.O	Prill	Fh .Nr 6date 26.04.2021	Detergjent	35,530.00
8	M.K	Prill	Fh.Nr 2 Datë 15.04.2021	Ushqime	5,000.00
9	O.O	Maj	Fh.Nr 7 Datë 08.05.2021	Kancelari	19,000.00
10	B.J	Maj	Fh.Nr 4 Datë 11.05.2021	Ushqime	8,830.00
11	Sh.S.M	Qershor	Fh.Nr 8 Datë 01.06.2021	Kompjuter	200,000.00
12	K.K	Korik	Fh.Nr 5 Datë 20.07.2021	Ushqime	12,000.00
13	G.H	Korik	Fh.Nr 9 Datë 07.07.2021	Veshje	11,300.00
14	A.	Shtator	Fh.Nr 13 Datë 23.09.2021	Dollap	360,000.00
15	A.K	Shtator	Fh.Nr 11 Datë 20.09.2021	Shampo	4,500.00
16	Q.``G...``	Shtator	Fh.12 Datë 24.09.2021	Kancelari	32,300.00
17	M.P	Tetor	Fh.Nr 16 Datë 12.10.2021	Veshje	186,900.00
18	I.G	Tetor	Fh.Nr 14 Datë 12.10.2021	Veshje	4,100.00
19	Sh.P.B	Tetor	Fh.Nr 15 Datë 14.10.2021	Boljer	17,980.00
20	A.V	Tetor	Fh.Nr 17 Datë 18.10.2021	Carcaf	21,500.00
21	E.R	Dhjetor	Fh.Nr 18 Datë 22.12.2021	Dhurata	7,600.00
22	M.B	Dhjetor	Fh.Nr 19 Datë 22.12.2021	Dhurata	10,000.00
23	L.D	Dhjetor	Fh.Nr 20 Datë 24.12.2021.	Elektroshtëpiake	36,500.00
24	E.M	Dhjetor	Fh.Nr 21 Datë 26.12.2021	Vidio Projektor	10,000.00
25	I.G	Dhjetor	Fh.Nr 22 Datë 28.12.2021	Dhurata	38,000.00
26	P.R	Dhjetor	Fh.Nr 23 Datë 29.12.2021	Dhurata	45,000.00
27	A.C	Dhjetor	Fh.Nr 24 Datë 29.12.2021	Dhurata	26,000.00
28	O.T	Dhjetor	Fh.Nr 25 Datë 29.12.2021	Televizor	20,000.00
29	P.K	Dhjetor	Fh Nr 26 Datë 29.12.2021	Veshje	19,600.00
30	R...	Dhjetor	Fh.Nr 27 Datë 30.12.2021	Tv	20,000.00
31	R....	Dhjetor	Fh.Nr 28 Datë 30.12.2021	Orendi te Ndr.	26,390.00
32	B.M.	Dhjetor	Fh.Nr 29 Datë 30.12.2021	Tv	10,000.00
33	B.M	Dhjetor	Fh.Nr 30 Datë 30.12.2021	Detergjent	14,879.00
34	M.N	Dhjetor	Fh.Nr 31 Datë 30.12.2021	Kënd Lodrash	1,774,884.00
Totali Viti 2021					3,353,083.00

Shpërndarja E Donacioneve Gjatë Vitit 2021.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHTËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

Nr. Fl. Dalje	Data		Marrësi	Përshkrimi	Kredi
1	06.01.2021		Kuzhina	Ushqime	960.00
2	13.01.2021		Kuzhina	Ushqime	600.00
3	21.01.2021		Kuzhina	Ushqime	480.00
4	22.01.2021		Kuzhina	Ushqime	480.00
5	23.01.2021		Kuzhina	Ushqime	600.00
6	25.01.2021		Kuzhina	Ushqime	560.00
7	27.01.2021		Kuzhina	Ushqime	520.00
8	29.01.2021		Kuzhina	Ushqime	400.00
9	31.01.2021		Kuzhina	Ushqime	320.00
10	31.01.2021		Kuzhina	Ushqime	710.00
Total Dalje Janar 2021					5,630.00
11	03.02.2021		Kuzhina	Ushqime	1,500.00
12	25.02.2021		Kuzhina	Ushqime	3,400.00
Total Dalje Shkurt 2021					4,900.00
13	01.03.2021		Kuzhina	Ushqime	1,420.00
14	06.03.2021		Kuzhina	Ushqime	220.00
15	10.03.2021		Kuzhina	Ushqime	450.00
16	14.03.2021		Kuzhina	Ushqime	2,920.00
17	24.03.2021		Kuzhina	Ushqime	700.00
Total Dalje Mars 2021					5,710.00
18	19.04.2021		Kuzhina	Ushqime	2,000.00
19	26.04.2021		Kuzhina	Ushqime	1,250.00
20	29.04.2021		Kuzhina	Ushqime	800.00
Total Dalje Prill 2021					4,050.00
21	1.05.2021		Kuzhina	Ushqime	4,400.00
22	06.05.2021		Kuzhina	Ushqime	2,305.00
23	06.05.2021		Kuzhina	Ushqime	720.00
24	08.05.2021		Kuzhina	Ushqime	3,260.00
25	09.05.2021		Kuzhina	Ushqime	410.00
26	10.05.2021		Kuzhina	Ushqime	3,280.00
27	11.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,975.00
28	12.05.2021		Kuzhina	Ushqime	840.00
29	13.05.2021		Kuzhina	Ushqime	3,900.00
30	14.05.2021		Kuzhina	Ushqime	240.00
31	14.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,400.00
32	15.05.2021		Kuzhina	Ushqime	440.00
33	17.05.2021		Kuzhina	Ushqime	2,040.00
34	18.05.2021		Kuzhina	Ushqime	850.00
35	19.05.2021		Kuzhina	Ush	840.00
36	20.05.2021		Kuzhina	Ushqime	900.00
37	21.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,010.00
38	22.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,320.00
39	23.05.2021		Kuzhina	Ushqime	370.00
40	24.05.2021		Kuzhina	Ush	4,920.00
41	25.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,780.00
42	25.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,990.00
43	27.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,400.00
44	28.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,190.00
45	29.05.2021		Kuzhina	Ushqime	1,250.00
46	30.05.2021		Kuzhina	Ushqime	500.00
47	31.05.2021		Kuzhina	Ushqime	780.00
Total Dalje Maj 2021					44,310.00
48	02.06.2021		Kuzhina	Ushqime	2,020.00
49	03.06.2021		Kuzhina	Ushqime	610.00
50	04.06.2021		Kuzhina	Ushqime	300.00
51	05.06.2021		Kuzhina	Ushqime	2,150.00
52	08.06.2021		Kuzhina	Ushqime	410.00
53	09.06.2021		Kuzhina	Ushqime	200.00

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË,
“ZYBER HALULLI”, TIRANË**

54	10.06.2021		Kuzhina	Ushqime	1,240.00
55	11.06.2021		Kuzhina	Ushqime	300.00
56	15.6.2021		Kuzhina	Ushqime	600.00
57	18.06.2021		Kuzhina	Ushqime	1,050.00
58	19.06.2021		Kuzhina	Ushqime	780.00
59	20.06.2021		Kuzhina	Ushqime	1,360.00
60	22.06.2021		Kuzhina	Ushqime	1,330.00
Total Dalje Qershor 2021					12,350.00
61	08.07.2021		Kuzhina	Ushqime	480.00
62	10.07.2021		Kuzhina	Ushqime	480.00
63	20.07.2021		Kuzhina	Ushqime	320.00
Total Dalje Korrik 2021					1,280.00
64	01.08.2021		Kuzhina	Ushqime	160.00
65	15.08.2021		Kuzhina	Ushqime	6,000.00
66	22.08.2021		Kuzhina	Ushqime	6,000.00
67	28.08.2021		Kuzhina	Ushqime	800.00
Total Dalje Gusht 2021					12,960.00
68	15.08.2021		Kuzhina	Ushqime	1,300.00
69	19.08.2021		Kuzhina	Ushqime	1,850.00
Total Dalje Shtator 2021					3,150.00
Total Dalje Janar- Dhjetor 2021					94,340.00

materiale te tjera industriale

Fd	Data	Emërtimi	Destinacioni	Vlere
1	08.01.2021	Materiale Për Vetkujdesje Personale	Kuzhina	1,350.00
2	12.01.2021	Materiale Për Vetkujdesje Personale	Ap2	2,800.00
3	12.01.2021	Veshje Dhe Sete Kuzhine	Ap1	14,370.00
Total Dalje Janar 2021				18,520.00
4	09.02.2021	Veshje	Ap3	5,600.00
5	10.02.2021	Tharëse Flokësh	Ap1	800.00
6	15.02.2021	Ipad	Ap1	10000
7	15.02.2021	Ipad	Ap2	10000
8	15.02.2021	Ipad	Ap3	10000
9	15.02.2021	Ipad	Ap4	10000
Total Dalje Shkurt 2021				46,400.00
10	04.03.2021	Telef	Sekt Social	4,200.00
11	08.03.2021	Kompj	P.S.Social	77,598.00
12	08.03.2021	Kompj	P.S.Admin	77,598.00
13	08.03.2021	Kompj	Drejtor	77,598.00
14	11.03.2021	Veshje	Ap3	200.00
Total Dalje Mars 2021				237,194.00
15	09.04.2021	Veshje	Ap4	6,400.00
Total Dalje Prill 2021				6,400.00
16	05.05.2021	Veshmbathje	Ap4	11,330.00
17	06.05.2021	Hoteleri	Ap3	7,380.00
18	06.05.2021	Hoteleri	Ap2	25,740.00
19	06.05.2021	Hoteleri	Ap1	25,520.00
20	20.05.2021	Hoteleri	Ap1	11,010.00
21	20.05.2021	Hoteleri	Ap2	12,009.00
22	20.05.2021	Hoteleri	Ap3	9,010.00
23	20.05.2021	Hoteleri	Ap4	11,010.00
Total Dalje Maj 2021				113,009.00
24	1.06.2021	Hoteleri	Ap4	1,500.00
25	1.06.2021	Hoteleri	Ap3	9,900.00
26	1.06.2021	Hoteleri	Ap3	1,000.00
27	01.06.2021	Hoteleri	Ap2	12,000.00
28	01.06.2021	Hoteleri	Ap4	11,000.00
29	03.06.2021	Hoteleri	Ap1	16,500.00
30	03.06.2021	Hoteleri	Ap2	9,000.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË SHITËPINË E FËMIJËVE SHKOLLORË, “ZYBER HALULLI”, TIRANË

31	07.06.2021	Tv	Ap4	10,000.00
32	17.06.2021	Pako Kancelari	Drejtoresha	1,000.00
33	17.06.2021	Pako Kancelari	Financa	3,000.00
34	17.06.2021	Pako Kancelari	Erjola	3,000.00
35	17.06.2021	Pako Kancelari	Psikologe	3,000.00
36	17.06.2021	Pako Kancelari	Ish-mjeke	3,000.00
37	17.06.2021	Pako Kancelari	Kryekujdestare	3,000.00
38	28.06.2021	Peshqir 4	Ap1	1,000.00
			Total Dalje Qershor 2021	87,900.00
39	10.07.2021	Bluza Me Mëngë Te Shkurtër	Ap1	2,860.00
40	12.07.2021	Çorape	Ap4	1,688.00
41	26.7.2021	Çorape	Ap1	120.00
			Total Dalje Korrik 2021	4,668.00
42	03.08.2021	Ace	Kuzhina	317.60
43	08.08.2021	Ace	Sanitare	952.80
			Total Dalje Gusht 2021	1,270.40
45	01.09.2021	Peshqir Sysh	Kuzhina	750.00
46	01.09.2021	Çorape	Ap2	110.00
46	01.09.2021	Çorape	Ap4	110.00
47	01.09.2021	Çorape	Ap3	90.00
48	01.09.2021	Çorape	Ap1	330.00
49	07.09.2021	Ace	Sanitare	476.40
			Total Dalje Shtator 2021	1,866.40
50	06.10.2021	Peshqir Sysh	Ap2	1,000.00
51	15.10.2021	Veshje	Ap4	11,590.00
52	10.10.2021	Atlete	Ap1	6,600.00
53	10.10.2021	Atlete	Ap2	6,600.00
54	10.10.2021	Atlete	Ap3	4,700.00
55	10.10.2021	Atlete	Ap4	3,200.00
56	10.10.2021	Te Ndryshme	Ap1	3,100.00
57	20.10.2021	Te Ndryshme	Ap2	10,690.00
58	20.10.2021	Veshje	Ap2	2,000.00
59	10.10.2021	Veshje	Ap3	800.00
			Total Dalje Tetor 2021	50,280.00
60	04.11.2021	Hoteleri	Ap3	3,700.00
			Total Dalje Nëntor 2021	3,700.00
61	10.12.2021	Hoteleri	Ap3	1,800.00
62	31.12.2021	Kënd Lojrash	Fusha	1,774,884.67
			Total Dalje Dhjetor 2021	1,776,684.67
			Total Dalje Janar Dhjetor 2021	2,347,892.47

Te ardhura nga sponsorë për vitin 2021	167,960.00 (leke)
---	--------------------------